



RAPORTI VJETOR

Për veprimtarinë e institucionit të Avokatit të
Popullit – Viti 2020



PËRMBAJTJA

Fjala përshëndetëse e Avokatit Popullit

KREU 1

Kuadri ligjor dhe institucional

KREU II

Zbatimi i rezolutës së Kuvendit të RSH-së për vitin 2019 nga institucioni i Avokatit të Popullit

KREU III

Vlerësim i situatës së respektimit të të drejtave të njeriut nga administrata publike

3.1 Përmbledhje e veprimtarisë të Seksioneve të institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2020

3.2 Të drejtat e personave të privuar nga liria

3.3 Respektimi i të drejtave të njeriut nga organet e Policisë së Shtetit

3.4 Parandalimi i dhunës dhe torturës

3.5 Respektimi i të drejtave të njeriut nga Prokuroria

3.6 E drejta për një proces të rregullt ligjor

3.7 Ndihma juridike falas

3.8 Të drejtat e ish të dënuarve dhe përndjekurve politikë nga sistemi komunist

3.9 Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore civile dhe administrative

3.10 Respektimi i të drejtës së pronës

3.11 Rregullimi i marrëdhënieve të punës dhe respektimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor në procedurën administrative

3.12 E drejta për një mjedis të shëndetshëm

3.13 Mbrojtja e konsumatorit

3.14 Respektimi i të drejtave që lidhen me pushtetin vendor

3.15 Respektimi i lirisë së shprehjes

3.16 Mbrojtja dhe të drejtat e fëmijës

3.17 Respektimi i të drejtës për kujdes shëndetësor

3.18 Respektimi i të drejtës për arsimim

3.19 Respektimi i të drejtës për kujdes social

3.20 Respektimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara

3.21 Barazia gjinore dhe të drejtat e komunitetit LGTBI

3.22 Respektimi i të drejtave të personave të moshuar

3.23 E drejta e minoriteteve (pakicave) kombëtare

3.24 Respektimi i të drejtave në fushën e sigurimeve shoqërore

KREU 4

Angazhime të tjera institucionale

4.1 Veprimtaria e institucionit të Avokatit të Popullit gjatë periudhës së pandemisë të shkaktuar nga COVID-19

4.2 E drejta e shtetasve për të mos iu cënuar integriteti fizik dhe trajtuar me dinjitet (Rasti prishjes së Teatrit Kombëtar)

- 4.3 E drejta kushtetuese e shtetasve për tubim në gjendje pandemie
- 4.5 Monitorimi i protestave (të muajve maj dhe dhjetor 2020)
- 4.5 Monitorimi i veprimtarisë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED)
- 4.6 Monitorimi i institucioneve të rivlerësimit në kuadër të zbatimit të reformës në drejtësi
- 4.7 Raporti Alternativ në kuadër të zbatimit të Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), për periudhën 2016-2020
- 4.8 Operacionet e përbashkëta me FRONTEX për rikthimin e shtetasve të parregullt nga vendet e BE-së

KREU 5

Bashkëpunimi

- 5.1 Bashkëpunimi me institucionet e administratës publike dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve të AP-së
- 5.2 Bashkëpunimi ndërkombëtar
- 5.3 Bashkëpunimi në kuadër të projekteve

KREU 6

Shërbimet mbështetëse

- 6.1 Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Administrative
- 6.2 Vështrim mbi të ardhurat dhe shpenzimet

KREU 7

Shifra dhe fakte në lidhje me ankesat dhe trajtimin e tyre

Fjala përshëndetëse e Avokatit të Popullit

Prej Greqisë së lashtë kemi trashëguar bindjen se demokracia është, mbi të gjitha, pjesëmarrje. Të marrësh pjesë në demokraci, do të thotë të angazhohesh në të.

Ashtu si athinasit e vjetër, të marrësh pjesë në demokraci do të thotë që të gjithë qytetarët të jenë të pajisur me një aparat mendimi kritik si dhe me vullnetin për ta shndërruar mendimin kritik, në veprim shndërrues. Do të thotë të duash të shprehësh mendimin tënd, të vësh vullnetin tënd në dispozicion të ndryshimit, e plot kushte të tjera që e bëjnë demokracinë të jetë funksionale, efektive dhe përparuese.

Pjesëmarrja në demokraci megjithatë, nuk duhet të jetë thjesht një kërkesë e sistemit ndaj individit por edhe një nevojë e individit që sistemi të krijojë kushtet e mjaftueshme për të ushtruar pjesëmarrjen e tij. Nuk mund të ketë vërtet demokraci pa pjesëmarrje të qytetarëve, mirëpo duhet pasur kujdes që pjesëmarrja e qytetarëve dhe angazhimi i tyre të ketë si produkt demokracinë.

E drejta e votës është një nga mekanizmat që shoqëritë kanë ndërtuar për të garantuar pjesëmarrjen e qytetarëve në demokraci, e ndërvite shoqëritë tona kanë kërkuar që kjo e drejtë të ushtrohet në mënyrë të mirëinformuar.

Kuptimi i këtyre koncepteve është thelbësor dhe ato vihen në jetë nga një sërë mekanizmash “check and balance”¹ siç është sistemi gjyqësor apo institucionet e pavarura ndër të cilat është institucioni Avokati i Popullit. Gjatë vitit 2020 një pjesë e këtyre insitucioneve nuk ka qënë plotesisht funksionale e për këtë arsye ne jemi përballur me një kërkesë të shtuar të qytetarëve për qëndrimin tonë institucional për shumë çështje.

Informacioni është pushtet. Sidoqoftë, kjo aftësi e informacionit për të gjeneruar energji është gjithashtu një këmbanë alarmi për të ndarë të mirën nga e keqja, të vërtetën nga përshtypja, thelbin nga propaganda.

Mirëpo rreziku që informacioni të jetë i ekspozuar ndaj shtrembërimit dhe zbrazjes prej qëllimit të tij primar – informimit – për t’u shndërruar në krijues përshtypjesh të rreme, është i madh.

Këto lloj perceptimesh, e vendosin demokracinë dhe kushtin e saj të patjetërsueshëm për pjesëmarrjen e qytetarëve në të përmes së drejtës së votës, në një sfidë ekzistenciale.

Kjo sigurisht nuk është vetmja sfidë për shoqëritë tona. Viti 2020 na përballi thelbësisht me cenim të jetës në krejt globin. Mbarë njerëzimi u detyrua të lëshonte hapësira individuale lirie e të drejtash e të përballej me kufizime të pamendueshme më pare për shkak të pandemise Covid 19.

Ende pas më shumë se 12 muajsh ne nuk e kemi ende të qartë se sa prej kësaj tkurrjeje mund të rekuperohet e si.

Dilemat e kohëve ku jetojmë janë të shumëfishta, por mendoj se më thelbësorja prej tyre është pikërisht pyetja: Si ta ruajmë demokracinë nga zhveshja prej kontentit të saj demokratik? Si t’ia konservojmë asaj thelbin, ashtin e vet? E si ta bëjmë të drejtën e qytetarëve për të zgjedhur

¹ Kontrolle dhe ekuilibra

e për t'u zgjedhur një të drejtë të patjetërsueshme, të paprekshme, të pa shndërrueshme e të paimpërshtueshme?

Këto nuk janë pyetje të thjeshta e përgjigjet ndaj tyre sigurisht kanë nevojë për më shumë se ky tekst introduktiv. Duke e konsideruar këtë ekstrakt mbi të gjitha si një ftesë për reflektim, shpreh bindjen se megjithatë e sidoqoftë, ashtu si e vërteta mbi gënjeshtrenë, si e mira mbi të keqen, ashtu si drita pas errësirës, edhe demokracia e gjen rrugën e saj mbi çdo revansh momental të kufizimit apo dhe regresit.

Lufta për t'u kthyer në realitet s'mund të bëhet ndryshe veçse duke mbajtur të drejtat e njeriut në fokus e në thelb të saj. E për të krijuar një ide se ku duhet të fokusohemi në këndvështrimin e Avokatit të Popullit, në luftën për mbrojtjen e këtyre të drejtave, keni në duar këtë raport.

KREU 1

Kuadri ligjor dhe institucional

Institucionit të Avokatit të Popullit, në përputhje me legjislacionin kombëtar¹ por edhe atë ndërkombëtar (veçanërisht Parimet e Parisit dhe të Komisionit të Venecias), i është përcaktuar një mandat i gjerë, i bazuar në standardet ndërkombëtare si institucioni më i lartë kombëtar për promovimin, parandalimin e shkeljeve dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ky mandat jetësohet në juridiksionin dhe kompetencat që këtij institucioni i parashikohen në Kushtetutë, ligjin “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, si dhe detyra të tjera të caktuara në ligje të veçanta.

Me një përvojë tashmë 20 vjeçare, institucioni i Avokatit të Popullit funksionon në Shqipëri krahas institucioneve të tjera të pavarura apo të barazisë, duke kontribuar në përmirësimin e praktikave të mirëqeverisjes dhe garantimit të të drejtave të qytetarëve. Ai siguron një mbikqyrje të sjelljes administrative të organeve qeverisëse dhe autoriteteve publike, sa dhe si këta të fundit shërbejnë për qytetarët e tyre. Në këtë ndërveprim të përditshëm, objektivi i Avokatit të Popullit është respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të individit, dhe rivendosja e së drejtës së tijë shkelur eventualisht nga nëpunësi i administratës publike. Praktika e qeverisjes së mirë dhe ndërveprimi i binomit autoritet publik- qytetar sigurohen nga funksionimi i mekanizmave të pavarur e të paanshëm për të shqyrtuar mënyrën se si ka vepruar Qeveria. Sistemi i kontrollit dhe balancës sot është një parim bazë i qeverisjes në të gjithë vendet që mëtojnë të kenë sisteme demokratike qeverisjeje.

Pavarësia institucionale dhe kompetencat e Avokatit të Popullit nuk janë privilegje por garanci për të vepruar me profesionalizëm dhe përkushtim gjatë ndërmjetësimit midis qytetarit dhe autoritetit publik kur ky i fundit, me veprime apo mosveprime, lejon të shkelen të drejtat dhe liritë e individit, të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet. Pavarësia e institucionit është një tipar i cili ka gjetur garancinë e tij, së pari në parashikimet kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë krijimin dhe funksionimin e këtij institucioni dhe, së dyti, në mënyrën se si është realizuar gjatë këtyre viteve performanca administrative e institucionit.

Në një shoqëri që bazohet në parimet e shtetit të së drejtës parashikohet se, sistemi gjyqësor i pavarur, luan rolin e mbrojtësit kryesor e të pazëvendësueshëm të të drejtave të individit. Ndërkaq, edhe Avokati i Popullit, (Ombudsmani) ka rezultuar i suksesshëm, si një institucion që përfaqëson një mjet kontrolli dhe balance, pavarësisht se është një institucion ekstragjyqësor. Ai vepron si një agjenci unike në secilin vend, në ndihmë të qytetarëve, kur këta ndeshin vështirësi me administratën apo autoritetet publike. Funksionimi i tij bazohet në disa parime universale të tilla si pavarësia, paanshmëria, profesionalizmi dhe konfidencialiteti.

Përveç mbrojtjes së të drejtave të njeriut, një nga synimet e tij kryesore është të zhvillojë atë që quhet *kultura e qeverisjes së mirë*. Ky nocion përmban administrim të mirë të pronës publike, transparencë dhe llogaridhënie të administratës publike para qytetarëve. Avokati i Popullit, përmes rekomandimeve të tij, mundohet të tregojë standardin e funksionimit për Administratën Publike, duke e bërë atë të kuptojë rolin e saj të vërtetë ndaj qytetarëve, pra të kuptojë se arsyeja

¹ Nenet 60-63 të Ligji nr. 8417, datë 22.11.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.
Ligji nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

e vërtetë e ekzistencës së saj është që të jetë në shërbim të qytetarëve për të realizuar të drejtat e tyre.

Në punën tonë kemi konstatuar se krijimi i një kulture të të drejtave të njeriut në Shqipëri, kërkon bashkëpunim të ngushtë me organet e administratës publike, shoqërinë civile, institucionet ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit, qarqet akademike e median, si dhe rritje të njohurive dhe vetëdijes së publikut rreth të drejtave të tijë.

Funksioni dhe misioni i Avokatit të Popullit është të shqyrtojë çështjet që lindin si pasojë e keqadministrimit në administratën publike. Instrumenti i përditshëm, përmes të cilit Avokati i Popullit synon të arrijë rezultatin e tij është rekomandimi². Pas shqyrtimit dhe hetimit të çështjeve të ndryshme, Avokati i Popullit realizon ndërmjetësimin dhe, nëpërmjet rekomandimeve të tij, synon t'i zgjidhë problemet mbi baza ligjore. Zgjidhjet e arritura nga ai synojnë të sjellin përmirësime në standardet dhe cilësinë e shërbimeve të administratës publike ndaj qytetarëve.

Me “*keqadministrim*” kuptojmë sjelljen, pra veprimet apo mosveprimet e zyrtarit në kundërshtim me Kushtetutën, me ligjet në fuqi dhe me normat e gjithëpranuara morale në shtetin tonë. Duke goditur këtë dukuri, Avokati i Popullit promovon mirëqeverisjen dhe ndershmërinë në administratën publike.

Opinionet dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit synojnë të pasqyrojnë çështjet më të rëndësishme lidhur me standardet e të drejtave të njeriut në Shqipëri. Eksperienca ka treguar se zgjidhja e një rasti individual në fakt, shpesh evidenton një problem sistematik në fushën e respektimit të drejtave të njeriut, duke nxitur përgjegjësinë e organeve të administratës publike.

Finalizimi i procesit të akreditimit dhe vlerësimi me statusin A

Riakreditimi i Avokatit të Popullit si institucion me Statusin A shënoi angazhimin dhe plotësimin e standardeve ndërkombëtare të miratuara në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Rezolutën 48/134, datë 20.12.1993,³ ku parashikohen standardet që shtetet anëtare duhet të zbatojnë për të garantuar një sistem efektiv të mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut. Rezoluta është e njohur gjerësisht me emërtimin *Parimet e Parisit*, si dokumenti ku parashikohen standardet për funksionimin e Institucioneve Kombëtare për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

Me qëllim që Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut të konceptohen dhe të veprojnë në përputhje me këto parime si institucione udhërrëfyes në promovimin dhe mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, ato i nënshtrohen procesit të riakreditimit, i cili kryhet çdo katër vjet prej Aleancës Globale të të Drejtave të Njeriut (Global Alliance of Human Rights Institutions- GANHRI), që ushtron aktivitetin e saj si një organizatë e pavarur me mbështetjen e Kombeve të Bashkuara.

Institucioni i Avokatit të Popullit është akredituar me statusin “A” për herë të parë në vitin 2004 dhe është riakredituar në vitet 2008 dhe 2014 me të njëjtin status. Me letrën e datës 15 gusht 2019, Institucioni është njoftuar nga ana e Sekretariatit të Aleancës Globale të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut, se është në proces vlerësimi nga Nënkomiteti i Akreditimit në GANHRI (SCA), proces i cili pritej të përmbyllej në muajin mars 2020, por për shkak të

² Instrumente të tjera janë edhe deklaratat dhe qëndrimet publike si mjete për të realizuar pritshmëritë e publikut

³ <https://www.legal-tools.org/doc/b38121/pdf/>.

pandemisë u shty për në muajin dhjetor 2020, në përputhje me procedurat përkatëse të institucioneve ndërkombëtare akredituese.

Rishqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni i Avokatit të Popullit në tetor 2019 kërkoj një angazhim maksimal nga ana e stafit jo vetëm në raportimin e punës së kryer për periudhën (2014-2019) por edhe në adresimin me profesionalizëm të rekomandimeve të lëna për plotësim në akreditimin paraardhës nga ana e Nënkomitetit për Akreditimin.

Në vijim dhe në zbatim të procedurave të GANHRI, Sesioni për shqyrtimin e akreditimit nga ana e Nën-komitetit për Akreditimin u zhvillua virtualisht, vendimarrja e të cilit u finalizua nëpërmjet raportit të publikuar për mbledhjen e organizuar në datat 7-18 dhjetor të vitit 2020.⁴ Në këtë raport citohet se:

“Nën-Komiteti i Akreditimit (SCA) rekomandon që Institucioni i Avokatit të Popullit duhet të riakreditohet me statusin A. SCA vlerëson përpjekjet e AP për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut në Shqipëri. Ai inkurajon institucionin t'i vazhdojë këto përpjekje. SCA thekson se Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (NHRI-të) që janë akredituar me status A duhet të ndërmarrin hapa të arsyeshëm për të rritur efektivitetin dhe pavarësinë e tyre, në përputhje me Parimet e Parisit dhe rekomandimet e bëra nga SCA gjatë këtij rishikimi”.

Në dokumentin zyrtar “Grafiku i Statusit të Institucioneve Kombëtare të Akredituara nga Aleanca Globale e Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut” publikuar në 20 janar 2021 në faqen zyrtare, përfshihet dhe njoftimi zyrtar lidhur me akreditimin e institucionit të Avokatit të Popullit.

Rekomandimet shoqëruese të vendimit të akreditimit do të jenë një nga sfidat më të rëndësishme të institucionit të Avokatit të Popullit në të ardhmen. Detyrat apo rekomandimet që parashtrihen pas përfundimit të këtij procesi akreditimi/riakreditimi drejtohen në radhë të parë për shtetet përkatëse dhe institucionet e tyre përfaqësuese (qeverinë, kuvendin) si dhe për institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut (Ombudsmanin). Kjo pasi statusi që i jepet një institucioni kombëtar reflekton dhe është treguesi më i qartë i rolit dhe rëndësisë që shteti përkatës i jep një institucioni të tillë.

⁴<https://nhri.ohchr.org/EN/AboutUs/GANHRIAccreditation/Documents/SCA%20Report%20December%202020%20-%2024012021%20-%20En.pdf>

KREU II

Zbatimi i rezolutës së Kuvendit të RSH-së për vitin 2019 nga institucioni i Avokatit të Popullit

Në kuadër të vlerësimit të veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2019, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar, më datë 9.7.2020, rezolutën përkatëse ku, ndërmjet të tjerash, i ka rekomanduar institucionit të Avokatit të Popullit marrjen e një sërë masash, që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij kushtetuese dhe ligjore. Në zbatim të kësaj rezolute, institucioni i Avokatit të Popullit ka ndërmarrë veprimet e mëposhtme:

1. Përfundimin e procesit të hedhjes së të dhënave për rekomandimet e adresuara, përditësimin e të dhënave në kohë reale, si dhe ndjekjen në mënyrë sistematike të zbatimit të rekomandimeve të adresuara.

Në respektim të Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë Nr.134/2018, “Për miratimin e Manualit të Monitorimit Vjetor dhe Periodik”, institucioni i Avokatit të Popullit ka vazhduar të informojë në mënyrë periodike (në formë elektronike dhe shkresore) Kuvendin e Shqipërisë në lidhje me rekomandimet që institucioni i Avokatit të Popullit i ka adresuar institucioneve publike si dhe statusin e zbatimit të tyre (raportimi i fundit është bërë me shkresën nr.72, datë 11.02.2021 që i korrespondon periudhës janar-dhjetor 2020). Vazhdon në mënyrë periodike hedhja në kohë reale e rekomandimeve (teksti i plotë i tyre) në faqen zyrtare të institucionit të ndara sipas fushave të të drejtave të shkeluara, si dhe mundësia e qasjes së tyre nga çdo subjekt i interesuar, duke respektuar rregullat e transparencës dhe të mbrojtjes së të dhënave personale. Rregjistri i rekomandimeve tek Rubrika e Transparencës përditësohet në mënyrë periodike me të dhënat përkatëse (numri, titulli, institucionit që i drejtohet, statusi i rekomandimit, etj).

Ndërkohë ka vazhduar përditësimi i regjistrit të ankesave/kërkesave të marra nga qytetarët, ku përfshihet edhe statusi i trajtimit të tyre, regjistër i cili është publik dhe i aksesueshëm në faqen zyrtare të institucionit të Avokatit të Popullit në linkun:

<https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/article/transparency>

2. Marrjen e masave për pasqyrimin e plotë të rekomandimeve të Avokatit të Popullit drejtuar institucioneve të pushtetit ekzekutiv, organeve në nivel qendror dhe vendor në Platformën Ndërinstitucionale të publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë dhe raportimin në Kuvendin e Shqipërisë për shkallën e zbatimit të rekomandimeve nga institucionet qendrore dhe vendore si dhe pasqyrimin e realizimit të tyre në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë

Në lidhje me këtë pikë të Rezolutës është e rëndësishme të informohet se *janë hedhur në Platformën Ndërinstitucionale të gjitha rekomandimet e institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2019 dhe vitin 2020*, së bashku me shkresat e përgjigjeve të kthyer nga institucionet përkatëse ku është drejtuar rekomandimi. Gjithashtu është përditësuar dhe statusi i llojit të përgjigjes së kthyer ose jo, për çdo rekomandim të hedhur në sistem, duke evidentuar kështu zbatueshmërinë e tyre nga ana e institucioneve të cilëve u është drejtuar rekomandimi.

Informacioni i pasqyruar tregon nëse rasti që trajtohet në rekomandim është: *në proces; zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht; pa zbatuar; refuzuar ose ka qënë pa përgjigje.*

Duhet të theksohet se ky është një proces i cili në mënyrë periodike është në përditësim për çdo përgjigje të kthyer, duke nxitur kështu një sistem transparent dhe një vlerësim më efikas mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit.

Në çdo rast mbetemi në pritje të reflektimit që duhet të bëhet nga organet e administratës publike mbi këto rekomandime.

3. Rritjen e angazhimit në mbrojtje të interesave të shtetasve shqiptarë, që banojnë jashtë vendit, duke rritur bashkëpunimin me institucionet homologe

Bazuar në nenin 8/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas të cilës: “Republika e Shqipërisë mbron të drejtat e shtetasve shqiptarë me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të vet”, Avokati i Popullit vlerëson se është detyrë e institucioneve shqiptare të interesohen në mënyrë të vazhdueshme edhe për shtetasit shqiptar që ndodhen jashtë territorit e në mënyrë të veçantë për qytetarët shqiptarë të privuar nga liria në shtete të tjera.

Këtij qëllimi i ka shërbyer edhe nisma e institucionit të Avokatit të Popullit për krijimin e një rrjeti mes institucioneve shqiptare për adresimin, diskutimin dhe zgjidhjen e çështjeve të të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së shtetasve shqiptarë që ndodhen jashtë vendit tonë. Siç ju kemi informuar edhe në raportin e mëparshëm, kjo nismë fatkeqësisht nuk arriti të realizohej për shkak të mosreagimit nga ana e dy institucioneve kryesore përkatësisht Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Gjithsesi, angazhimi dhe kontaktet me homologët tanë për të forcuar bashkëpunimin në çështjet që lidhen me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, përfshirë dhe mbrojtjen e interesave të shtetasve shqiptarë që banojnë jashtë vendit, kanë qënë dhe mbeten një prioritet i institucionit. Për shkak dhe të situatës së pazakontë që vjen nga pandemia, gjatë vitit 2020 nuk kemi pasur raste ankesash apo informacione që lidhen me shkeljen e të drejtave të njeriut të qytetarëve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit. Ndërkohë, në faqen zyrtare të institucionit janë vendosur kontaktet zyrtare të Ombudsmanëve të disa vendeve kryesore evropiane ku punojnë dhe jetojnë dhe pjesa më e madhe e qytetarëve shqiptarë me qëllim të orientimit e tyre pranë këtyre institucioneve nëse konstatohen shkelje të të drejtave të tyre nga institucionet shtetërore të këtyre vendeve.

4. Gjetjen e mekanizmave të duhur për një informim gjithëpërfshirës të shtetasve në lidhje me kompetencat dhe natyrën e kërkesave/ankesave, që mund të adresohen në këtë institucion

Institucioni i Avokatit të Popullit për të rritur efektivitetin e tij si për të informuar qytetarët për të drejtat e tyre por edhe për t’u gjendur sa më pranë nëpërmjet këshillimit, orientimit apo dhe trajtimit të ankesave të problemeve të tyre, është përpjekur gjithnjë e me shumë që të përmirësojë mekanizmat për informimin e qytetarëve mbi kompetencat e tij.

Një mbështetës shumë i rëndësishëm për Avokatin e Popullit në përmbushjen e mandatit promovues është, padyshim, media (vizive dhe e shkruar) si dhe rrjetet sociale. Avokati i Popullit ka mbajtur një qasje proaktive ndaj medias duke hapur kanale të dyanshme të komunikimit me aktivitetet e institucionit të ndjekura dhe të paraqitura nga media dhe pyetjet e mediave dhe interesi i përgjigjur menjëherë nga institucioni.

Gjithashtu reagimet zyrtare të Avokatit të Popullit në raste të ndjeshme ndaj opinionit publik janë vazhdimisht të pranishme në media, pas publikimit të tyre përmes njoftimeve për shtyp dhe në faqen zyrtare të Institucionit ose në mediat sociale. Janë me dhjetëra intervista dhe paraqitje të rëndësishme të Avokatit të Popullit, Komisioneres të Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, Komisioneres së Seksionit të Përgjithshëm, Komisioneres së Seksionit të MKPT-së, në kanale të ndryshme kombëtare apo rajonale.

Faqja zyrtare e institucionit⁵ u rinovua dhe ridizejnuar plotësisht në vitin 2018. Kjo faqe përditësohet në mënyrë të vazhdueshme dhe përfshin më shumë hapësirë dhe më shumë ndërveprim për të 5 seksionet e institucionit si dhe një mbulim më të mirë të aktiviteteve, qasje për qytetarët për të bërë ankesa në internet dhe gjithashtu shembuj të rasteve të trajtuara.

Aplikacioni mobile “Avokati i Popullit”, i vënë në funksion gjatë vitit 2018 ka krijuar një urë interaktive midis përdoruesit dhe institucionit me njoftime në kohë reale dërguar përdoruesit në lidhje me progresin e ankesës gjatë trajtimit të tij nga stafi ynë. Ai gjithashtu përfshin informacione themelore se si funksionon institucioni i Avokatit të Popullit, cilat janë të drejtat civile të mbrojtura nga institucioni ynë dhe gjithashtu shembuj ku, bazuar në rekomandimet e Avokatit të Popullit, u arrit ndryshimi pozitiv. Për më shumë, referojuni edhe përgjigjes së dhënë në pikën 9.

Në Mediat Sociale (faqe në Facebook) "Avokati i Popullit" vazhdon të rritet me aktualisht më shumë se 8150 ndjekës të rregullt, duke treguar një rritje të qëndrueshme nga viti në vit (në vitin 2020 rritja ishte 20% në krahasim me 2019), ndërkohë që secili seksion ka faqen e tij të Facebook-ut cila përditësohet në mënyrë të vazhdueshme. Institucioni e përditëson faqen me informacione periodike mbi aktivitetet e ndërmarra për tu gjendur pranë qytetarëve në cdo rast të shkeljeve të të drejtave themelore të individit. Gjithashtu, edhe përmes rrjetit mesanger stafi i institucionit të AP-së merr ankesat e qytetarëve por dhe i këshillon dhe i orienton ata sipas rasteve.

Duhet të theksohet gjithashtu se në muajin maj të vitit 2020, institucioni i AP-it ka realizuar dhe një video si një shpjegues i thjeshtë “Çfarë është Avokati i Popullit”. Video është e publikuar në faqen zyrtare të institucionit, në faqen e tij të Facebook-ut⁶ por edhe në ato të seksioneve.

Avokati i Popullit thekson se ky vit ka qenë, nga ana tjetër, një vit i vështirë për të realizuar programet dhe aktivitetet sipas Strategjisë së Komunikimit të miratuar nga institucioni që prej vitit 2018.

5. Rritjen e angazhimit në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndërmarrjen e nismave konkrete në zbatim të kësaj marrëveshjeje dhe raportimin në Kuvendin e Shqipërisë në mënyrë sistematike për nismat e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në fushën e të drejtave të njeriut.

Duhet të theksohet fillimisht se rekomandimet e ECRI-t që lidhen me organet e barazisë (equality bodies), u drejtohen strukturave të krijuara me një mandat të qartë për të luftuar racizmin, intolerancën dhe diskriminimin. Këto rekomandime shkojnë drejt qasjes së përcaktimit të standardeve që duhet të kenë organet e barazisë sa i përket ngritjes, funksionimit, kompetencave, pavarësisë dhe aksesueshmërisë. Gjithashtu, ndërmjet të tjerash, këto rekomandime kërkojnë që organet e barazisë të koordinojnë dhe të bashkëpunojnë me njëri-

⁵ www.avokatipopullit.gov.al.

⁶ <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/multimedia/shpjegues-i-thjesht-far-sht-avokati-i-popullit-482/>

tjetrin (nëse ekziston më tepër se një strukturë e tillë) si dhe me institucionet e tjera të të drejtave të njeriut, përfshirë institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut/Ombudsmanin.

Ky bashkëpunim është i nevojshëm me synimin për të maksimizuar impaktin e tyre të përgjithshëm në lidhje me mandatin e barazisë. Ato duhet të sigurojnë, gjithashtu, arritjen e një mbulimi sa më të gjerë të çështjeve të barazisë, adresimin e çështjeve të ndërlidhura, si dhe shmangjen e përpjekjeve/veprimeve të dyfishta. Koordinimi dhe bashkëpunimi përfshin dialogun në procesin e planifikimit të tyre, iniciativa të përbashkëta në punën e tyre si dhe një komunikim të vazhdueshëm e të qendrueshëm.

Nisur nga sa më sipër, në kuadër të marrëveshjes së lidhur ndërmjet dy institucioneve, është dakortësuar mbështetja respektive e zyrave vendore në ato hapësira gjeografike ku ato janë ngritur dhe funksionojnë, për të shërbyer si pika kontakti të përbashkët për qytetarët në marrjen e kërkesave/ankesave dhe përcjelljen e tyre me qëllim trajtimin dhe adresimin e tyre sipas të drejtave të shkelura.

Të dy institucionet janë angazhuar në realizimin e trajnimeve të përbashkëta për ngritjen profesionale të përfaqësuesve të zyrave vendore me qëllim zhvillimin e një kulture të re dhe standarteve më të larta në ofrimin dhe cilësinë e shërbimeve.

Për këtë qëllim, në fund të muajit maj 2020, u zhvillua një trajnim i përbashkët me të gjithë përfaqësuesit e zyrave rajonale të të dyja institucioneve (7 zyrat rajonale të AP dhe 3 të KMD) në lidhje me procedurat dhe mënyrën e marrjes së ankesave për institucionet respektive. Në bazë të marrëveshjes dhe trajnimit të realizuar, për periudhën në fjalë nga zyrat rajonale të Avokatit të Popullit⁷ janë marrë 24 ankesa që i përkasin zyrës së KMD.

Gjatë kësaj periudhe nuk kanë munguar edhe aktivitetet dhe takimet e përbashkëta të punës ndërmjet përfaqësuesve të zyrave rajonale të dy institucioneve në hapësirat gjeografike ku ata operojnë me qëllim forcimin e bashkëpunimit dhe adresimin e çështjeve të ndërlidhura.

Gjithashtu, të dy institucionet janë pjesë aktive e Marrëveshjes së Bashkëpunimit për krijimin e “*Aleancës kundër urrejtjes*”⁸, e cila ka si qëllim angazhimin e aktorëve kryesorë të përfshirë në aspekte të ndryshme të parandalimit të gjuhës së urrejtjes, për të koordinuar dhe bashkuar përpjekjet, për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të advokuar si një front kundër këtij fenomeni.

6. Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës të monitorojë zbatimin e rekomandimeve të Komitetit European për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues, si dhe të raportoje në kohë Kuvendin e Shqipërisë për nevojën e adresimit të problematikave të përsëritura ose për të cilat kërkon angazhim nga ana e Kuvendit të Shqipërisë

Në lidhje me zbatimin e këtij rekomandimi ju informojmë se Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT), që nga momenti i bërjes publike të raportit të CPT-së (Shtator 2019), në inspektimet periodike të kryera pranë këtyre institucioneve ka monitoruar në vijimësi hapat e ndjekura nga institucionet për zbatimin e rekomandimeve të CPT-së, si dhe ka risjellë

⁷ Zyra Rajonale Berat, Sarandë, Vlorë, Pogradec.

⁸ Kjo Marrëveshje është firmosur në kuadër të Programit të Përbashkët të BE-së dhe Këshillit të Evropës- “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2020”, në të cilën marrin pjesë Institucioni i Avokatit të Popullit; Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi; Autoriteti i Mediave Audiovizive, dhe Shoqata “Këshilli Shqiptar i Medias”.

në vëmendjen e tyre nëpërmjet rekomandimeve masat që duhet të ndërmerren nga organet kompetente për zbatimin e tyre.

Për këtë, Avokati i Popullit ka adresuar edhe përgjigjen e dhënë nga qeveria Shqiptare në lidhje me rekomandimet e CPT-së dhe ka vlerësuar si mision të tij edhe monitorimin e zbatimit apo efektshmërisë të masave të marra sipas kësaj përgjigje.⁹

Institucioni i Avokatit të Popullit në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, si dhe duke mbajtur në konsideratë angazhimet e ndërmarra nga Qeveria Shqiptare nëpërmjet përgjigjes datë 27 Shkurt 2020, mbi raportin e Komitetit European për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor dhe Degradues (CPT), gjatë vizitës së tij në Shqipëri në datat 20 - 30 Nëntor 2018¹⁰, ka kërkuar nga institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtyre rekomandimeve një informacion të detajuar mbi masat konkrete të ndërmarra deri më tani si dhe fazën në të cilat ndodhet zbatimi i tyre.

Për sa më lart, ju janë nisur shkresat përkatëse me lëndë “Kërkesë për informacion mbi zbatimin e rekomandimeve të Komitetit European për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor dhe Degradues”, drejtuar ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale¹¹, drejtorit të Përgjithshëm të Policisë (për dijeni Ministrisë së Brendshme)¹² dhe drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve (për dijeni Ministrit të Drejtësisë)¹³.

Pas marrjes së përgjigjeve të këtyre institucioneve¹⁴ dhe mbi bazën e gjetjeve faktike do të hartohet nga ana e MKPT-së dhe një raport i veçantë për Kuvendin me konstatimet dhe rekomandimet përkatëse.

7. Rritjen e angazhimit konkret në monitorimin e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të fëmijëve, të barazisë gjinore, të drejtat e pakicave kombëtare dhe komunitetit LGBTI, si dhe raportimin në Kuvendin e Shqipërisë në mënyrë periodike për gjetjet dhe sugjerimet përkatëse për adresimin e problemeve të konstatuara

➤ Të drejtat e fëmijëve¹⁵

Viti 2020, në ndryshim nga viti 2019, cilësohet si një vit i veçantë, për shkak të pandemisë, ndaj dhe zbërthimi i funksionit kushtetues dhe ligjor i Komisionerit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve në institucionin e Avokatit të Popullit është parë ngushtësisht në raport me sjelljen dhe administrimin e pushtetit nga ana e organeve të administratës shtetërore në drejtim të:

- mirëfunksionimit;
- zbatimit të ligjit;
- mirëadministrimit.

⁹ Përgjigjja e qeverisë Shqiptare është dërguar në datë 27 Shkurt 2020.

¹⁰ Mund të konsultohet në link-un: <https://rm.coe.int/16809cb571> “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020).

¹¹ Shkresa me nr. K4/M4-2 prot., datë 11.12.2020.

¹² Shkresa me nr. K4/M4-3 prot., datë 11.12.2020.

¹³ Shkresa me nr. K4/M4-4 prot., datë 11.12.2020.

¹⁴ Deri më datë 31.12.2020 nuk ka pasur asnjë përgjigje nga institucionet përkatëse. Ndërkohë, përgjigjet e ardhura i përkasin periudhës janar-mars 2021.

¹⁵ Për më shumë referojuni edhe Kreut 3, pika 3.15.

Avokati i Popullit, për vitin 2020 ka trajtuar 195 ankesa/kërkesa/raste me iniciativë, nga të cilat 155 të tilla me iniciativë dhe 15 ankesa drejtëpërdrejt nga fëmijët. Gjithashtu, janë realizuar edhe 11 inspektime, 66 veprimtari të karakterit promovues, si dhe janë hartuar 98 rekomandime konkrete adresuar institucioneve përgjegjëse shtetërore.

Nisur nga praktika administrative e institucionit të AP, për vitin 2020, konstatohet se problematikë kryesore në realizimin e të drejtave të fëmijës, vazhdon të mbetet *shkelja e të drejtës së jetës* për një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe gëzimi i një jetese të shëndetshme e pa privime, si rezultat i varfërisë. Ky faktor është pengues për interesin më të lartë të fëmijës dhe passjell edhe shkeljen e të drejtave të tjera të fëmijës, si e drejta për t'u arsimuar, mbrojtja nga çdo formë e dhunës, si dhe e drejta për kujdes shëndetësor.

Në drejtim të ***mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve***, me qëllim garantimin e ushtrimit të këtyre të drejtave, përfshirjes dhe edukimit për/rreth tyre në programet mësimore, detyrim ky kushtetues, institucioni i AP-së, për vitin 2020, ka realizuar dy dokumente të qenësishëm:

- **së pari**, doracak “Për edukimin për/rreth të drejtave të njeriut dhe fëmijëve në veçanti në programet mësimore”;
- **së dyti**, Instrumenti për Vlerësimin e Ndikimit të politikave dhe ligjeve mjedisore tek të drejtat e fëmijëve (CRIA).

Për më shumë rreth mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve, referojuni Kreut 3, pika 3.16.

➤ *Barazia Gjinore, LBGT dhe të drejtat e pakicave kombëtare*

Për shkak të karantinës dhe masave të dinstancimit social në fuqi gjatë periudhës së raportimit shumë prej aktiviteteve të parashikuara për tu zhvilluar nga Seksioni i Përgjithshëm si (ditë të hapura nëpër bashki të ndryshme, takime me grupe të disavantazuara si gra e vajza të dhunuara, gra kryefamiljare, persona të komuniteteve LGBTI, Rom dhe Egjiptian, etj) nuk mund të zhvilloheshin për të respektuar protokollat e vendosura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Instituti i Shëndetit Publik.

Duke ju përshtatur kushteve të reja lidhur me komunikimin, Seksioni i Përgjithshëm përshtati qasjen ndaj grupeve vulnerabël duke dhënë informacionin e nevojshëm për barazinë gjinore, dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje si dhe të drejtat e komuniteteve LGBTI, Rom dhe Egjiptian, përmes publikimit në faqen zyrtare të institucionit apo nëpërmjet mediave sociale (facebook), të deklaratave dhe qëndrimeve të institucionit për respektimin e të drejtave të grupeve të ndryshme, të informacioneve të nevojshme si nr telefoni apo adresa e-maili të institucioneve përgjegjëse për garantimin e të drejtave dhe të sigurimit të mbështetjes për keto grupe vulnerable të shoqërisë.

Përmes takimeve e forumeve online me përfaqësues të organizatave që punojnë për të drejtat e grave dhe të komunitetit LGBTI, organizatat e Romëve dhe Egjiptianëve, janë diskutuar dhe janë shkëmbyer informacione lidhur me situatën e të drejtave të komuniteteve gjatë periudhës së pandemisë, situatën e ofrimit të shërbimeve nga institucionet përgjegjëse, përdorimin e gjuhës së urrëjtjes në media dhe rrjetet sociale, problematikat e komuniteteve, etj.

Në datën 16 Shtator u zhvillua takimi konsultues online me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që punojnë për të drejtat e komunitetit LGBTI në Shqipëri.

Takimi u thirr nga institucioni i AP në zbatim të Nenit 30 të Ligjit “Për Avokatin e Popullit” si dhe në kuadër të bashkëpunimit të Avokatit të Popullit me organizatat e shoqërisë civile për të marrë mendimet e tyre mbi gjendjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut të këtij komuniteti.

Në datën 5 Nëntor 2020, u organizua një aktivitet online në bashkëpunim me Aleancën LGBTI dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi ku u prezantuan gjetjet e një studimi mbi “Situatën e komunitetit LGBTI gjatë pandemisë së COVID-19”.

Në datën 10 dhjetor 2020, u zhvillua takim një online me përfaqësues të OJF-ve që punojnë për të drejtat e grave dhe kundër dhunës me bazë gjinore, për prezantimin e gjetjeve të Raportit Alternativ mbi zbatimin e Konventës CEDAW në Shqipëri. *Për më shumë rreth monitorimit të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të grave dhe komunitetit LGBTI referojuni Kreut 3, pika 3.21.*

Në fushën e mbrojtjes së të drejtave të minoriteteve, krahas shqyrtimit të ankesave individuale të paraqitura, vend të rëndësishëm kanë zënë rekomandimet përkatëse që kanë të bëjnë me një qasje sistematike ndaj problematikave që ata parashtrojnë për zgjidhje. Më konkretisht janë përgatitur dhe dërguar këto rekomandime:

- Rekomandim për përmbylljen e procesit të nxjerrjes së akteve nënligjore, në bazë dhe për zbatim, të Ligjit nr.96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, drejtuar (me shkresën Nr.K1/I10-2 datë 25.02.2020), Kryetarit të Këshillit të Ministrave dhe Kryetarit të Komisionit Qendroror të Zgjedhjeve. Ende pa përgjigje.
- Rekomandim “Për marrjen e masave të domosdoshme, të menjëhershme, për komunitetet Rome dhe Egjiptiane. (Për evidentimin e numrit real të individëve dhe familjeve në nevojë, pjesë e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, të vendosura brenda territorit të njësisë administrative, të administruar nga ana e bashkive). Ky rekomandim i është dërguar me shkresën nr. K1/I15-2 datë 04.04.2020 të gjitha bashkive.
- Rekomandim për realizimin e procesit të ratifikimit të Kartës Evropiane të Gjuhëve Rajonale, ose Minoritare, dërguar me shkresën Nr.K1/I74-2 datë 10.09.2020, Kryetarit të Kuvendit dhe Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë. Ende pa përgjigje.
- Rekomandim për marrjen e masave të mëtejshme, për përballimin e kostove financiare të sigurimit të barrierave mbrojtëse (maskave) ndaj përhapjes së COVID-19 për pjesëtarët e komuniteteve Rom dhe Egjiptian. Ky rekomandim u është dërguar të gjitha bashkive me shkresën nr. K1/I171-2 datë 19.11.2020,.

Nga ana jonë është marrë pjesë në një sërë aktivitetesh online të organizuara nga OJF të ndryshme në mbrojtje të të drejtave të pakicave kombëtare, ku janë analizuar dhe diskutuar gjendja e të drejtave të këtyre minoriteteve.

Para shfaqjes së pandemisë së COVID-19, nga ana e Seksionit të Përgjithshëm, ishte parashikuar zhvillimi i disa inspektimeve në zona të ndryshme të vendit, ku edhe ka përqëndrim të komuniteteve përfaqësuese të minoriteteve kombëtare në vend. Në pamundësi, kemi zhvilluar dhe po zhvillojmë aktivitete “online” me disa shoqata dhe qendra, që përfaqësojnë pikërisht këto minoritete.

Kështu në datën 13.11.2020, është zhvilluar nga ana jonë takimi mbi gjendjen e të drejtave të minoritetit kombëtar Rom dhe Egjiptian, duke u përqëndruar tek zbatimi i *Planit Kombëtar të Integritimit për Romët dhe Egjiptianët, 2016-2020*, arsimimi i fëmijëve Romë dhe Egjiptianë, në

kushtet e pandemisë së COVID-19, si dhe gjendja e përgjithshme e kushteve të jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në situatën e pandemisë së COVID-19.

Në datën 18.12.2020, u zhvillua një trajnim “on line”, nga ana e institucionit tonë, në bashkëpunim me Roma Versitas Albania, për të rinj Rom, me temë “*Njohje me institucionin dhe mënyrën e funksionimit të Avokatit të Popullit*”. Ky trajnim do të pasohet nga të tjerë.

Së fundmi, në kuadër të plotësimit dhe përmirësimit të kuadrit ligjor për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve, janë dhënë mendime, vërejtje dhe sugjerime për katër projektvendime të Këshillit të Ministrave, të hartuara në kuadër të akteve nënligjore që janë nxjerrë dhe do të nxirren në zbatim të Ligjit nr.96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”. *Për më shumë rreth monitorimit të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të minoriteteve referojuni Kreut 3, pika 3.23.*

8. Rishikimin e strukturës dhe organikës së institucionit, në funksion të përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe objektivave institucionale, në mënyrë që të adresohen problematikat për kryerjen e detyrave funksionale me efektivitet dhe në përmbushje të rekomandimeve evropiane për organet e barazisë.

Është gjerësisht e pranuar që menaxhimi i burimeve njerëzore luan një rol thelbësor në zhvillimin e një vendi dhe në veçanti, në zbatimin e aktiviteteve të rëndësishme strategjike të administratës publike. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore është pjesë e rëndësishme e funksionit të procesit të menaxhimit. Gjithashtu, ky menaxhim duhet të jete i orientuar në zhvillimin e aftësive të punonjësve, mbështetjen në punë, drejt qasjeve më efektive të drejtimit duke synuar përfshirjen e personelit dhe rritjen e angazhimit drejt zhvillimit të qëndrueshëm institucional dhe performancës së suksesshme.

Për këtë arsye, menaxhimi i burimeve njerëzore në institucionin e Avokatit të Popullit përbën një qasje sistematike që synon:

- *Zhvillimin e vazhdueshëm dhe rekrutimin e personelit të përshtatshëm që t’i shërbejë më mirë objektivave organizative dhe institucionale, në përputhje me legjislacionin në fushën e shërbimit civil;*
- *Sigurimin e mundësive të barabarta për trajnimin dhe zhvillimin e karrierës;*
- *Motivimin e punonjesve.*

Hartimi i një strukture efektive në përputhje me parimet e legjislacionit në fushën e shërbimit civil, kërkon domosdoshmërisht nevojën e përcaktimit të metodologjisë për strukturimin e institucionit në përputhje me parimet e vendosura dhe të zbatueshme për të gjithë administratën publike.

Mënyra e miratimit të strukturës dhe organikës së institucionit, është parashikuar shprehimisht në nenin 35, paragrafi 3 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar. Në ndryshim nga shumë institucione të pavarura kushtetuese të tjera të krijuara me ligj, struktura dhe organika e institucionit caktohet nga vetë Avokati i Popullit.

Caktimi i strukturës administrative nga vetë institucioni konsiderohet një faktor i rëndësishëm i pavarësisë së tij. Aftësia e institucionit për të krijuar strukturat e veta dhe fleksibiliteti i përshtatjes së tyre në mënyrë që t’u përgjigjen sa më mirë funksioneve e detyrave të institucionit, është mjaft e rëndësishme për funksionimin efikas të një institucioni të pavarur kushtetues, siç është Avokati i Popullit.

Kjo është arsyeja që edhe Gjykata Kushtetuese, kur interpreton pavarësinë e institucioneve kushtetuese në lidhje me strukturën, thekson ndërmjet të tjerash se “...pavarësia organizative gjen shprehje edhe në të drejtën e tyre që të hartojnë e caktojnë vetë, në përputhje me kritere të caktuara, strukturën dhe organikën e tyre...”

Kur flitet për “kritere të caktuara”, nënkuptohen ato rregulla të përcaktuara nga legjislacioni në fushën e shërbimit civil dhe të cilat zbatohen detyrimisht nga të gjitha organet shtetërore veprimtaria e të cilave realizohet brenda fushës së shërbimit civil, ku përfshihet edhe institucioni i Avokatit të Popullit.

Që nga krijimi i institucionit (viti 2000), struktura dhe organika e tij ka pësuar ndryshime të herëpashershme, ndryshime që kanë synuar rritjen e efikasitetit dhe përshtatjen me rregullat dhe procedurat e parashikuara nga kuadri ligjor në fuqi në fushën e shërbimit civil. Këto ndryshime kanë synuar pasjen e një strukture të qëndrueshme në kohë, relativisht homogjene me strukturat dhe kategorizimet e punonjësve të institucioneve të tjera shtetërore, plotësimin e standardeve në drejtim të formatimit të njësive të strukturës, që lidhen me drejtoritë dhe seksionet përkatëse.

Gjithsesi, këto ndryshime më së shumti lidhen me strukturat mbështetëse të institucionit pasi vetë ligji nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, në nenin 31 të saj ka të përcaktuar numrin e seksioneve dhe emërtesën e tyre, pavarësisht se në varësi të nevojave të institucionit, Avokatit i Popullit ka të drejtë të vendosë që pranë seksioneve të ngrihen dhe të funksionojnë *nënseksione të posaçme*. Kjo e drejtë ka qenë thuajse e pamundur të implementohet *për shkak të kufizimeve në burime njerëzore*.

Nisur nga numri i përgjithshëm i miratuar për punonjësit e institucionit, vlerësimit të njësive dhe strukturave aktuale, problematikave dhe mangësive të konstatuara sa i përket menaxhimit të burimeve njerëzore, siç dhe jeni në dijeni, gjatë 2-3 viteve të fundit (përfshirë edhe kërkesat dhe propozimet e bëra gjatë diskutimit të projekt-buxhetit për vitin 2019), e kemi konsideruar emergjente mbështetjen nga Kuvendi i Shqipërisë për shtimin e burimeve njerëzore.

Duke qenë se këto kërkesa permanente, pavarësisht nevojave dhe argumenteve të paraqitura, nuk janë marrë në konsideratë, struktura e institucionit ka pësuar në vazhdimësi disa ndryshime në formën që ajo është dhe brenda mundësive dhe kapaciteteve ekzistuese, duke u përpjekur të adresojë shqetësimet e konstatuara, problematikat dhe sugjerimet e parashtruara si dhe të ofrojë të gjitha garancitë e nevojshme për t’iu përgjigjur më së miri realizimit në mënyrë të suksesshme dhe të plotë të objektivave dhe misionit të institucionit të Avokatit të Popullit.

Ndryshimet e fundit të strukturës së institucionit, janë miratuar me Urdhërin e Avokates së Popullit, nr.42., datë 18.02.2020, “Për disa ndryshime në Urdhërin nr.252, datë 22.11.2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Institucionit të Avokatit të Popullit.”, i ndryshuar, që kanë synuar një funksionim më të mirë të shërbimeve mbështetëse (sektorit të shërbimeve dhe pritjes së qytetarëve).

9. Përmirësimin e aplikacionit “Avokati i Popullit” për të rritur efektivitetin e tij, si dhe informimin e qytetarëve për të drejtat e tyre.

Siç ju kemi informuar edhe më parë, me qëllim rritjen e aksesit të qytetareve, është mundësuar funksionimi për publikun i aplikacionit “Avokati i Popullit” për telefonat inteligjentë me të njëjtin emër. Aplikacioni ka për qëllim të ofrojë një platformë shtesë për marrjen e ankesave nga qytetarët lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut dhe raportimin e korrupsionit, duke

përmirësuar vazhdimisht procesin e brendshëm të trajtimit të ankesave në mënyrë që qytetarët të marrin përgjigje profesionale dhe në kohë.

Aplikacioni është veçanërisht i dobishëm për qytetarët që jetojnë jashtë Tiranës dhe ata që nuk zotërojnë një kompjuter. Këta qytetarë kanë mundësi të dërgojnë ankesa lehtësisht nëpërmjet telefonit të tyre celular dhe të ndjekin ecurinë e ankesës së tyre. Aplikacioni u bë i mundur falë mbështetjes së Agjensisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar USAID nëpërmjet projektit “Transparenca në Sistemin shëndetësor”.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka zhvilluar një fushatë të vazhdueshme informimi rreth aplikacionit në të gjithë vendin për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve për përdorimin e tij në dërgimin e ankesave. Pas funksionimit të tij është parë e nevojshme marrja e masave për mirëfunksionimin dhe mirëmbajtjen vjetore të tij, përmes Update-ve të përshtatshëm me versionet e reja të Android dhe iOS si dhe Upload-it të versioneve të reja të aplikacionit në App Store dhe Play Store.

Në aplikacionin mobile, i cili është i aksesueshëm në të gjitha platformat android, këtë vit institucioni ka ndërhyrë për të përmirësuar dhe shtuar fushat e të drejtave në të cilët qytetarët mund të adresojnë problemet e tyre si dhe të mund të informohen mbi statusin e këtyre ankesave. *Kështu në total, 9% të numrit të përgjithshëm të ankesave të depozituara pranë institucionit të AP-së kanë ardhur nëpërmjet këtijë aplikacioni, ku në vitin 2020 vihet re një rritje prej 53% krahasuar me vitin 2019.*

10. Ndërmarrjen e hapave konkretë për informimin e qytetarëve për kompetencat e Avokatit të Popullit, në nivel qarku ku funksionojnë zyrat, nëpërmjet zhvillimit të sesioneve informuese/ndërgjegjësuëse, duke angazhuar punonjësit e zyrave rajonale me fokus grupet e marginalizuara, të cilat nuk kanë aksesin e duhur në informacion e nevojshëm për mekanizmat e realizimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Mbarëvajtja, mirëfunksionimi dhe efektiviteti i Zyrave Vendore të Avokatit të Popullit mbetet në vëmendjen jo vetëm të Kuvendit të Shqipërisë, por edhe të organizmave ndërkombëtarë që synojnë të mbështesin një institucion kombëtar për të drejtat e njeriut, siç është Avokati i Popullit, për të ushtruar sa më mirë funksionet e tij kushtetuese dhe ligjore.

Zyrat rajonale janë pjesë e vizionit të institucionit të Avokatit të Popullit që ka në fokus mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të qytetarëve përmes kultivimit të një kulture të re dhe standardeve më të larta në ofrimin dhe cilësinë e shërbimeve, si dhe në rritjen e aksesit të qytetarëve për të adresuar në kohë ankesat e tyre ndaj veprimeve dhe mosveprimeve të administratës publike, pranë institucionit të Avokatit të Popullit. Ato janë pika të rëndësishme kontakti me qytetarët për marrjen e ankesave por, njëkohësisht, prania e tyre në këto rajone ka ngushtuar distancën dhe ka afruar institucionin e Avokatit të Popullit më pranë qytetarëve.

Zyrat rajonale kanë vijuar të forcojnë një prani të vlerësueshme të institucionit të Avokatit të Popullit më afër qytetarëve në këto rajone, nëpërmjet një pune të vazhdueshme të përfaqësuesve në terren, duke u mundësuar qytetarëve informacione të nevojshme mbi rolin dhe funksionin e institucionit të Avokatit të Popullit, marrjen e ankesave dhe dërgimin në kohë për shqyrtim nga ekspertët sipas seksioneve, si dhe kthimin e përgjigjeve qytetarëve brenda një kohe të shkurtër dhe optimale.

Fushatat promovuese dhe puna në terren e përfaqësuesve rajonalë, kanë qenë pjesë të rëndësishme të aktivitetit të përditshëm të punës së tyre, duke synuar në vazhdim rritjen dhe

forcimin e besimit të qytetarëve tek Avokati i Popullit jo vetëm si një objektiv për t'u arritur por edhe si sodisfaksion dhe përgjegjësi. Puna në terren është bazuar në një planifikim paraprak të gjithësecilit, nëpërmjet hartimit dhe realizimit të plotë të planeve mujore duke evidentuar aktivitetin dhe problematikat e hasura. Më konkretisht, duhen të përmenden aktivitetet promovuese si me poshte:

- 12 aktivitete të përbashkëta me organizatat e shoqërisë civile (Zyra Rajonale Shkodër, Dropull, Kukës, Pogradec, Vlorë);
- 9 aktivitete promovuese në mediat vizive/radio (Zyrat Rajonale Dropull, Shkodër, Kukës, Pogradec);
- 4 aktivitete në Institucionet Arsimore paraUniversitare (Zyrat Rajonale Dropull, Kukës);
- 10 aktivitete në institucione të ndryshme vendore (Zyrat Rajonale Dropull, Kukës, Pogradec).

Zyrat rajonale të Avokatit të Popullit kanë treguar të jenë shumë efektive dhe në plotësim të pritshmërive të Institucionit të Avokatit të Popullit, referuar promovimit të këtij institucioni dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në gjithë hapësirat gjeografike ku këto zyra operojnë. Një indikator matës që tregon efektivitetin e zyrave rajonale të Avokatit të Popullit si dhe për rrjedhojë edhe rritjen e besimit të qytetarëve tek këto zyra është numri i ankesave gjithmonë në rritje.

Nga 3759 raste të paraqituara pranë institucionit, 1721 janë raste të përcjella nga zyrat rajonale, pra rreth 46% e të gjithë totalit të ankesave të depozituara pranë Institucionit të Avokatit të Popullit këtë vit.

Në tabelën e mëposhtme jepen të dhënat e rasteve (ankesa, raste me iniciative, këshillime/orientime) për periudhën Janar – Dhjetor të viteve 2019 dhe 2020, të raportuara nga 7 Zyrat Rajonale.

Nga krahasimi i të dhënave vihet re një rritje e numrit të përgjithshëm me 31.5%

Rastet sipas Z. Rajonale (Janar - Dhjetor 2019-2020)			
Zyra Rajonale	2019	2020	% Ndryshimit
Z.R Sarandë	328	342	4%↑
Z.R Dropull	115	95	-17.0%↓
Z. R Berat	296	365	23%↑
Z.R Fier/Vlorë	361	172	-52%↓
Z.R Kukës	139	184	32%↑
Z.R Pogradec	206	427	107%↑
Z.R Shkodër	78	136	78%↑
Total	1532	1721	
	31.5%↑		

Gjithashtu, duhet theksuar se *gjatë periudhës tetor 2020*, përfaqësuesit e shtatë Zyrave Rajonale ndërmorën një hetim të pavarur administrativ në disa kopshte dhe shkolla 9-vjeçare e të mesme të përgjithshme në zonat e tyre gjeografike për një shqyrtim sa më objektiv të respektimit të urdhërit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr.289, datë 04.05.2020 <<Për miratimin e udhëzuesit për “Masat ndaj COVID-19 që duhet të ndërmarin institucionet arsimore”>>.

Qëllimi i realizimit të monitorimit administrativ ishte vlerësimi i dokumentacionit dhe procedurave administrative, të ndjekura nga mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, të cilët, në mbështetje të legjislacionit në fuqi, garantojnë ushtrimin me efektivitet të të drejtave, respektimin dhe promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës.

Në zbatim të urdhërit të dhënë nga institucioni i Avokatit të Popullit, nga përfaqësuesit e Zyrave Rajonale të Avokatit të Popullit në total *janë monitoruar 59 shkolla të arsimit të ulët e të mesëm si dhe 2 kopshte*.

Përfaqësuesit e institucionit të Avokatit të Popullit, kanë përdorur si metodologji inspektimin për një shqyrtim dhe gjykim korrekt dhe objektiv si më poshtë vijon:

- Monitorim në ambientet e institucioneve arsimore.
- Intervistim dhe bashkëbisedim me drejtorinë/administratën e institucionit arsimor.
- Plotësimi i një pyetësoi/formulari inspektimi në institucionet arsimore.
- Fotografimin e ambienteve të institucioneve arsimore për të mbikëqyrur praninë ose jo të masave të marra mbi sinjalistikën orientuese, postera informuese, dezinfektantë, maska, ujë të rrjedhshëm dhe sapun për larjen e duarve, etj.

Nga monitorimet e kryera nga zyrat rajonale të Avokatit të Popullit në institucionet arsimore mbi masat e marra ndaj COVID-19 është vënë re se udhëzimi i ministrisë në pjesën më të madhe është ndjekur me përpikmëri. Në çdo rast, viti 2020 ka qenë viti i distancimit social dhe punës së kufizuar me kontaktin fizik.

11. Raportimin në mënyrë periodike në Kuvendin e Shqipërisë për natyrën e kërkesave/ankesave të adresuara në nivel vendor

Qeverisja Vendore është një nga fushat kryesore të angazhimit publik të Avokatit të Popullit në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve shqiptarë nga organet e qeverisjes vendore. Në këtë aspekt, institucioni i Avokatit të Popullit ka luajtur rol proaktiv si një element thelbësor për një qeverisje të mirë, në mbrojtjen e individit kundër abuzimeve administrative, si dhe forcimin e besimit të publikut në shërbimet që ofron pushteti në nivel vendor dhe rajonal.

Në fokusin e punës dhe veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit, sigurisht ka qenë trajtimi dhe roli ndërmjetësues në zgjidhjen e ankesave të individëve dhe subjekteve, sipas problematikave që lidhen me veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike në nivel qendror, lokal dhe atë vendor.

Nga numri i përgjithshëm i ankesave/rasteve të regjistruara gjatë vitit 2020 pranë institucionit të Avokatit të Popullit nga *1797 ankesa, rezultojnë se rreth 520 prej tyre (ose rreth 30% e rasteve)* janë adresuar ndaj institucioneve në nivel qarku dhe organeve të Njesisë të Qeverisjes Vendore.

Këto ankesa lidhen kryesisht me fushat e mëposhtme:

- ankesa për të drejtën e pronësisë;
- ankesa për zgjidhjen e problemit të strehimit (përfshirë dhe problematikat e krijuara nga tërmeti);
- ankesa për papunësinë;
- ankesa për ndërprerjen e ndihmës ekonomike;
- ankesa për mjedis të shëndetshëm;
- ankesa për të drejtat e fëmijëve;

- ankesa për zgjidhjen e problematikave që shqetësojnë personat me aftësi të kufizuara;
- ankesa që lidhen me problematika të krijuara si rezultat i situatave të krijuara nga pandemia (në arsim, shëndetësi, etj), si dhe një numër i konsiderueshëm i tyre që ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve publike nga bashkitë, mungesën e investimeve në infrastrukturë, etj.

Gjithashtu, për vitin 2020 janë adresuar gjithsej 96 rekomandime për njësitë e pushtetit vendor, që, përkthyer në përqindje, rezulton të jetë rreth 38% e totalit prej 256 rekomandimesh të adresuara.

Institucioni i Avokatit të Popullit do të vijojë angazhimin e tij publik, si dhe të kryejë me përgjegjësi të plotë dhe të pavarur rolin e tij Kushtetues dhe ligjor, në funksion të mirëqeverisjes të organeve të pushtetit vendor, duke patur në qendër të vëmendjes mbrojtjen e të drejtave të individëve (subjekteve) nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, përmirësimin e jetës së tyre sipas standarteve ndërkombëtare, si dhe rritjen e cilësisë të shërbimeve ndaj qytetarëve me qëllim që ato të jenë sa më efikase si dhe në përputhje me interesat e komunitetit.

12. Raporti vjetor i Avokatit të Popullit duhet të jetë në përputhje me standardet e përcaktuara në manualin e miratuar me vendimin nr.134/2018 “Për miratimin e Manualit të Monitorimit Vjetor dhe Periodik të institucionave të pavaruara kushtetuese ose të krijuara me ligj”, dhe detyrimisht të përmbajë raportimin e veprimtarisë së secilit komisioner të tij.

Që nga miratimi i vendimit të Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me formën dhe mënyrën e raportimit vjetor, institucioni është përpjekur maksimalisht për të respektuar afatet proceduriale, çështjet që duhet të përfshihen në përmbajtjen e raportit vjetor si dhe dokumentet shoqëruese të tij dhe e konsideron të plotësuar këtë pikë të rezolutës. Gjithsesi, institucioni, në hartimin e raportit vjetor për aktivitetin e tij për vitin 2020, do të vlerësojë me shumë kujdes çdo kërkesë që përcaktohet në vendim përfshirë dhe një prezantim më të qartë të punës dhe aktivitetit të çdo komisioneri dhe seksionit që përfaqëson.

Duhet theksuar që ligji parashikon raport të Avokatit të Popullit në Kuvend dhe jo raportime individuale. Avokati i Popullit ka pasqyruar punën e bërë për çdo të drejtë e fushë sipas parashikimeve të ligjit dhe mendojmë se puna është në nivel skuadre që bëhet për të çuar përpara kauzën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në vend.

Në çdo rast duke qenë transparent e duke besuar te llogaridhënia si një element që përmirëson në vijimësi performancën institucionale, në këtë raport do të qartësojmë edhe fushat përkatëse të përgjegjësisë.

KREU III

Vlerësim i situatës së respektimit të të drejtave të njeriut nga administrata publike

3.1 Përmbledhje e veprimtarisë të Seksioneve të institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2020¹⁶

➤ Veprimtaria e Seksionit të Veçantë

Për shkak të situatës pandemike të krijuar dhe masave të marra për të kufizuar përhapjen e virusit COVID-19, veprimtaria e Seksionit të Veçantë si pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit sikundër gjithë institucionet e tjerë, u vu në kushte jo pak të vështira gjatë vitit 2020. Në këto rrethana, përpos marrjes e trajtimit të ankesave, jemi përshtatur me kushtet e reja të punës duke monitoruar çdo ditë lajmet e përcjella nga mediat, si një burim më shumë informacioni dhe duke komunikuar në vijimësi me institucionet përgjegjëse me anë të email-it, veçanërisht në muajt e parë të kufizimit të lëvizjeve.

Gjatë vitit 2020 për rastet që kemi përfunduar hetimin administrativ dhe provuar se ankesat e shtetasve kanë qenë të bazuara, janë përgatitur **41** rekomandime, të cilat u janë drejtuar **81** organeve ligjzbatuese të administratës publike me një total prej **106** pikash për t'u zbatuar nga ana e tyre.

Të drejtat të personave të paraburgosur/dënuar, kanë qenë në një vëmendje të shtuar pasi përveç veçimit të tyre nga pjesa tjetër e shoqërisë, ata do të duhej të përballeshin edhe me disa kufizime të tjera të diktuar nga pandemia sikurse janë: ndërprerja e konsultave dhe ekzaminimeve jashtë IEVP-së, përveç urgjencave mjekësore; pezullimi i aktiviteteve sociale, kulturore-sportive; ndalimi i takimeve me familjarët që u zëvendësuan me lidhjen në distancë, nëpërmjet pajisjeve elektronike dhe programit Skype, etj. Përveç këtyre shqetësimeve të trajtuara nga ana jonë, një sërë ankesash kanë patur të bëjnë pikërisht me refuzimin e kërkesës për të përfituar lejen e veçantë “qëndrimi të përkohshëm në shtëpi për një periudhë 3-mujore” sipas aktit normativ të miratuar me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, në sistemin penitenciar si dhe garantimit të kushteve për mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të të dënuarve. Rëndësi u kemi kushtuar edhe ankesave të paraqitura nga punonjës të policisë së burgjeve, jo vetëm për faktin se edhe kjo kategori është subjekt i punës sonë për sa i përket të drejtave që gëzojnë, por edhe se mënyra e trajtimit të tyre pasqyrohet në marrëdhëniet me të burgosurit dhe ofrimin e shërbimeve ndaj tyre.

Institucioni i Avokatit të Popullit duke vlerësuar rolin e strukturave dhe punonjësve të Ministrisë së Brendshme dhe të Policisë së Shtetit gjatë pandemisë, ka konstatuar në një mori rastesh se nuk janë respektuar të drejtat themelore të shtetasve, raste për të cilat janë dërguar rekomandimet përkatëse.

Në objektin e ankesave apo rasteve me iniciativë të administruara ndaj këtyre strukturave, do të evidentonim rastet për pengim të ushtrimit të të drejtës kushtetuese të tubimeve gjatë pandemisë së shkaktuar nga COVID-19; për mos informimin e shtetasve lidhur me masat shtrënguese dhe

¹⁶ Ky kapitull është hartuar në mbështetje të kërkesës së Kuvendit në rezolutë.

kufizimin e lëvizjes së lirë për shkak të pandemisë apo për bllokimin e rrugëve në rastet e prishjeve të ndërtimeve pa leje, në mbështetje të IMT dhe IKMT; për dëmtim të shëndetit të qytetarëve nga gazi lotsjellës i hedhur gjatë tubimeve; për vendosje të masave administrative gjatë pandemisë; për keqtrajtime fizike ose psikologjike në momentet e arrestimit, shoqërimit apo gjatë marrjes në pyetje të shtetasve në organet e policisë; për shoqërimi të paligjshme apo mbajtje në gjendje shoqërimi tej afatit ligjor; për mos marrje, mos administrim ose mos ndjekje të kallëzimeve apo ankesave të bëra prej tyre; për mos mbajtje dhe mos dhënie të procesverbaleve për veprimet e kryera nga punonjësit e policisë; për shkelje të të drejtave të shtetasve të huaj në Shqipëri etj.

Në fokusin e institucionit ka qenë edhe mbrojtja dhe respektimi i të drejtave ligjore të punonjësve të Policisë së Shtetit duke çmuar se është e domosdoshme edhe mbrojtja e të drejtave të tyre kur ato u shkelen apo cenohen nga organet e tyre eprore dhe organet e tjera të administratës publike.

Avokati i Popullit (Seksioni i Veçantë) në kuadër të respektimit dhe mbrojtjes të të drejtave të njeriut është munduar të luajë një rol aktiv në shqyrtimin dhe verifikimin e shqetësimeve të parashtruara nga shtetas të ndryshëm, për procedurat e ndjekura nga prokurorët, gjatë hetimit të procedimeve penale, duke qenë palë në procesin penal, në cilësinë e kallëzuesit apo të personit nën hetim. Kemi konstatuar një rritje të numrit të ankesave dhe çështjeve që janë administruar nga ana jonë, kjo e lidhur me faktin se vijimi i reformës në drejtësi ka rritur volumin e punës në sistem për shkak të mungesave dhe largimeve të një numri të konsiderueshëm prokurorësh. Nga ana tjetër, reforma e iniciuar e ka vendosur organin procedues përpara detyrimeve ligjore në zbatimin korrekt të procedurave të parashikuara si, marrjen e vendimit përfundimtar, apo edhe hetimin e fakteve, provave dhe rrethanave që janë në favor të personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet.

Përveç vështirësive të mësipërme, edhe sistemi gjyqësor u përball me vështirësi të reja të shkaktuara nga pandemia globale COVID-19, krahas atyre me të cilat është hasur ky sistem vitet e fundit për arsye të procesit të zgjatur të vetingut i cili ka ecur me ritme të ngadalta, me vonesa të panevojshme dhe me sfida të mëdha sociale dhe profesionale. Sigurisht, pezullimi i veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e vendit, të juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm, me përjashtim të çështjeve me natyrë të ngutshme, për një periudhë të gjatë 3-mujore solli si pasojë zvarritje të proceseve gjyqësore, shtyrje të gjykimit të çështjeve të reja, si dhe problematika në respektimin e plotë të të drejtave procedurale gjatë gjykimit.

Gjatë këtij viti një rëndësi e veçantë i është kushtuar monitorimit dhe vënies në zbatim të ligjit nr.111/2017 *“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”*, nisur nga vonesa evidente në ngritjen e strukturave përkatëse si dhe nxjerrjes së akteve nënligjore që ligji parashikon. Kjo vjen ndesh me nevojën e qytetarëve që shteti t'ua garantojë këtë shërbim.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson punën e disa OJF-ve të mbështetura financiarisht përmes projekteve nga donatorë për të siguruar aksesin e shtresave në nevojë për ndihmë juridike që, nga ana tjetër, synon vënien në funksion të mekanizmave ligjorë shtetërorë të parashikuar nga ligji i lartëpërmendur. Pra, që qytetarët e interesuar të përfitojnë nga ndihma juridike shtetërore dhe jo vetëm /kryesisht nga OJF-të e specializuara në këtë fushë.

Sa i përket të drejtave të ish të dënuarve dhe përndjekurve politikë nga sistemi komunist, vihet re se procesi i kompensimit nuk ka përparuar me normat e dëshiruara apo të pritshme, për arsye që lidhen kryesisht me mungesën e fondeve të nevojshme, por edhe me ndryshimet që ka pësuar legjislacioni përgjatë viteve dhe mospërcaktimin e një afati të arsyeshëm për përfundimin e tij.

Po ashtu, nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë janë vërejtur problematika që lidhen me akordin e kështit të tretë të dëmshtëpërblimit, proces që po ecën me hapa shumë të ngadaltë, si dhe me problematika që lidhen shpeshherë me keqinterpretimin e ligjit dhe akteve nënligjore. Avokati i Popullit (Seksioni i Veçantë) e ka ndjekur me vëmendje këtë proces, si dhe ka adresuar një sërë rekomandimesh për çështje individuale.

➤ **Veprimtaria e Mekanizmit Kombëtar kundër Torturës (MKPT)**

Mekanizmi Kombëtar kundër Torturës (MKPT), gjatë vitit 2020, ka patur në fokus të punës së tij zbatimin e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore në lidhje me garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të të burgosurve, si dhe respektimin e standardeve të përcaktuara në aktet ndërkombëtare të Këshillit të Evropës dhe Rregulloren Evropiane të Burgjeve. Gjatë ushtrimit të detyrës, Mekanizmi Kombëtar zbaton një sërë aktesh kombëtare dhe ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, që normojnë dhe mandatojnë veprimtarinë tonë të përditshme¹⁷, ku në bazë të autorizimeve ligjore¹⁸, realizon vizita të rregullta dhe pa paralajmërim në të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (burgje dhe paraburgime), në institucionet e Policisë së Shtetit, në institucionet shëndetësore spitale psikiatrike, pikat e kalimit kufitar, në qendrat e tjera të strehimit të emigrantëve të paligjshëm dhe personave të trafikuar dhe çdo vend tjetër kur dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe të lirive të njeriut, si dhe të kontrollojë çdo dokumentacion, qoftë dhe të klasifikuar të organeve të administratës publike, kur ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

Vizitat inspektuese dhe rekomandimet drejtuar institucioneve shtetërore përgjegjëse të sistemit penitenciar, kanë synuar ndërmarrjen e hapave të mëtejshëm për përmirësimin e kushteve dhe trajtimin e të burgosurve, marrjen e masave për rehabilitimin social dhe reintegrimin e të dënuarve në jetën familjare, sociale dhe ekonomike, përmirësimin e të drejtave të të miturve në burgje dhe zbatimin e parimeve sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit, zgjidhjen përfundimtare të problematikave që ekzistojnë për të burgosurit e dënuar me vendime të gjykatave “për mjekim të detyruar”, etj. Zbatimi i rekomandimeve të pranura ka qenë gjithashtu në fokusin e punës tonë për të garantuar përmirësimin efektiv të kushteve të këtij sistemi.

Në kushtet e situatës së rënduar që po kalon Shqipëria për shkak të sëmundjes infektive COVID-19 si dhe respektimit të “Akteve ligjore për COVID-19”¹⁹, duke mbajtur në konsideratë situatën emergjente të krijuar e cila solli pamundësinë e inspektimeve sipas metodologjisë të ndjekur ndër vite, MKPT-ja, si një mënyrë alternative, ka zgjedhur kryerjen e inspektimeve edhe online.

Është zgjedhur kjo praktikë e re dhe e domosdoshme për të shmangur rrezikun e infektimit dhe parandalimin e përhapjes së mëtejshme të pandemisë duke pasur në fokusin tonë zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe respektimin e akteve ndërkombëtare për parandalimin e torturës, trajtimit të egër, çnjerëzor e poshtërues. Inspektimet online si praktikë e re, do të vijojnë dhe do të alternohen sipas mundësisë për sa kohë do të jenë në fuqi masat kufizuese për parandalimin e pandemisë. Gjatë vitit 2020, janë kryer 6 *inspektime online me institucionet e privimit të lirisë*

¹⁷ Neni 60/1 i Kushtetutës së Shqipërisë, neni 31/1 të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, si dhe nenet 81,82 dhe 83 të ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, dispozitat e Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT)”, miratuar me Ligjin Nr. 9094, datë 03.07.2003.

¹⁸ Neni 19/1 i Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

¹⁹ <https://qbz.gov.al/news/33b00e4f-8efb-4c99-8c45-595cd9b84f1b>

si me IEVP Reç, IEVP Burrel, IEVP Durrës, IEVP Kavajë, IEVP Kosovë, Lushnje, si dhe IEVP Krujë.

Mekanizmi Kombëtar gjatë periudhës së *lockdown*, në përmbushje të funksionit mbrojtës dhe parandalues, ka ushtruar detyrën e tij edhe nëpërmjet shkëmbimit të informacioneve mujore, duke monitoruar kryesisht institucionet e privimit të lirisë, qendrat e trajtimit të shtetasve të huaj të parregullt në Shqipëri, qendrat e antitrafikimit, spitalet psikiatrike, si dhe pikat e kalimit kufitar. Kryesisht në fokus kanë qenë IEVP për të Miturit Kavajë, Qendra Spitalore e Burgjeve, Tiranë, Qendra e Mbyllur për të Huajt Karreç, Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkues Babrru, Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit Linzë, spitalet psikiatrike në Shkodër, Elbasan dhe Vlorë, si dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

Gjatë periudhës së pandemisë, MKPT ka vijuar të ndajë informacionet e lartëpërmendura në lidhje me aktivitetin e këtij seksioni, si dhe situatën në të cilën ndodhen institucionet e privimit të lirisë në vendin tonë, me institucionet ndërkombëtare si CPT-në si dhe me MKPT-të homologe të vendeve anëtare të KE, ENHHRI, etj, duke shkëmbyer sugjerime dhe propozime konkrete për përballimin e kësaj situatë.

Në kuadrin e monitorimit për të drejtat e të moshuarve dhe të personave me aftësi të kufizuara në Institucionet Rezidenciale të Përkujdesjes Sociale lidhur me masat e marra nga autoritetet shtetërore për parandalimin e përhapjes së COVID-19 në bashkëpunim dhe me Seksionin e Përgjithshëm, është kontaktuar me drejtuesit e Shtëpive të të Moshuarve Tiranë, Shkodër, Kavajë, Gjirokastrë, Fier, të Qendrës Polivalente Poliçan si dhe të Qendrave të Zhvillimit “Unë jam si ju” Berat dhe Qendrën Rezidenciale të Zhvillimit, Korçë.

➤ **Veprimtaria e Seksionit të Administratës**

Gjatë vitit 2020, puna dhe veprimtaria e institucionit të Avokatit të Popullit ka qenë e fokusuar në mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.²⁰ Seksioni i Administratës ka vijuar dhe është përqendruar në monitorimin e disa prej të drejtave themelore të njeriut, të garantuara dhe parashikuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut me Protokollin e saj Shtesë.

E drejta e Pronës ka qenë dhe mbetet një prej të drejtave më të prekshme, të çënueshme dhe relevante në objektin e punës së Seksionit të Administratës, kjo për shkak se jo vetëm që përbën një prej prioriteteve që Shteti Shqiptar duhet të përmbushë për tu anëtarësuar në BE, por gjithashtu dhe për shkak se vazhdon të mbetet një fushë problematike dhe ende e pa zgjidhur e me numër të lartë ankesash.

Nga gjithë kompleksiteti i realizimit të kësaj të drejte, ajo e kthimit apo kompensimit të pronave tek të shpronësuarit nga sistemi i kaluar, mbetet një nga çështjet më problematike e të mprehta. Tashmë individët duhet të ndjekin procedurat gjyqësore për mbrojtjen apo kërkimin e të drejtave me karakter pronësor, për shkak të mbarimit të afatit ligjor të trajtimit të kërkesave të tyre nga Agjencia e Trajtimit të Pronave. Në lidhje me të drejtën e pronës, Seksioni i Administratës ka ndjekur me vëmendje edhe problematika të tjera që lidhen me të si ajo e legalizimit të ndërtimeve pa leje dhe shpronësimeve për interes publik, duke hartuar dhe dërguar një sërë rekomandimesh strukturave të administratës shtetërore në nivel qendror dhe lokal.

²⁰ Pavarësisht situatës konkrete dhe derogimeve nga disa të drejta dhe liri themelore të individit që u ndërmorrën nga pushteti ekzekutiv.

Një problematikë e rëndësishme e trajtuar nga Seksioni i Administratës është ajo që lidhet me shqyrtimin e ankesave për *marrëdhëniet e punës*, lidhur me ankimet për largimet nga puna në administratën shtetërore të depozituara nga persona që gëzojnë ose jo statusin e nëpunësit civil, hartimit të rekomandimeve, për garantimin e stabilitetit dhe mbrojtjes së të drejtave që burojnë nga marrëdhënia e punës, sidomos në nivel vendor.

Strehimi mbetet një nga çështjet më të mprehta sociale. Problematikat kryesore të evidentuara lidhen me: mungesë transparence mbi aktet apo dokumentat që duhen dorëzuar; zvarritje të procedurave të shqyrtimit të dosjeve përkatëse; mungesë transparence gjatë procedurave të përcaktimit të kriterëve për përzgjedhjen, si dhe mungesë transparence të vendimmarrjes, e cila kalon për miratim në organet kolegjiale të njësisë të qeverisjes vendore. Kjo e drejtë është trajtuar në këtë seksion edhe në vijim të ankesave që janë depozituar nga qytetarët për shkak të tërmetit në nëntor 2019.

Mbrojtja e konsumatorit paraqitet një nga fushat kryesore që lidhet drejtpërdrejtë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ku Seksioni i Administratës ka luajtur një rol për mbrojtjen e interesave të parashikuara në legjislacionin respektiv. Në fokusin e punës tonë ka qenë edhe e drejta e qytetarëve për të jetuar në një *mjedis të shëndetshëm*. Ne vlerësojmë se zbatimi me rigorozitet i dispozitave të ligjeve në fuqi që rregullojnë këto fusha, do të ndikojnë në përmirësimin e situatës mjedisore në Shqipëri si dhe rritjen e standarteve të ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarit, në përputhje me kërkesat dhe standartet e jetës së qytetarëve të vendeve evropiane.

Ofrimi dhe garantimi i shërbimeve publike është një nga detyrimet e tjera thelbësore të qeverisjes, në nivel qendror dhe lokal. Në këtë aspekt për tu përmendur kanë qenë ankesat drejtuar Institucionit tonë lidhur me problematikën që haset më së shumti në *fushën e infrastrukturës* dhe kryesisht në atë të pasjes së rrugëve sipas standardeve të përcaktuar, mirëmbajtjes së tyre, ambienteve të përbashkëta sipas të gjitha normave mbi të drejtën në komunitet e më gjerë.

Në këndvështrimin e institucionit e drejta për një ambient dhe infrastrukturë të përshtatshme përveç se çon në zhvillimin ekonomik në tërësi por shërben edhe në zhvillimin sa më të mirë social dhe kulturor të individëve. Për rrjedhojë, nëpërmjet rekomandimeve, u është kërkuar dhe i kërkohet institucioneve që të veprojnë pozitivisht në ndërmarrjen e hapave të nevojshëm për garantimin dhe sigurimin e ofrimit të shërbimeve të cilat kanë ndikim në sigurinë dhe mbrojtjen e jetës.

Institucioni i Avokatit të Popullit, ka monitoruar me shumë vëmendje masat e marra nga autoritetet shqiptare për përballimin e pandemisë së COVID-19. Pranë tij, dhe në mënyrë të veçantë, në Seksionin e Administratës janë depozituar një numër i konsiderueshëm ankesash të lidhura ngushtësisht me masat e marra dhe problematikat e hasura. Aktet Normative, vendimet, urdhrat, udhëzimet kanë patur për objekt përcaktimin e masave të veçanta që do të merren gjatë kohëzgjatjes së periudhës së COVID-19.

Në këtë kuadër, janë trajtuar ankesa/raste me iniciativë, problematika të lidhura ngushtësisht me situatën pandemike si: shtrenjtimi i biletave të transportit ndërqytetas, mospërfitimin e të ashtëquajturës *paga e luftës* me të gjitha problematikat e hasura për përfitimin e saj, pagesat e punonjësve gjatë karantinimit të detyruar, rritja drastike e çmimeve gjatë pandemisë, pamundësia për aplikim për pasaportë e ID si brenda vendit ashtu edhe në përfaqësitë shqiptare jashtë vendit, masat administrative të marra si për qytetarët ashtu edhe për automjetet, kushtet e karantinimit të qytetarëve të ardhur nga shteti grek e ai i Maqedonisë së Veriut lidhur me mos

përballimin e mirëmenaxhimit të situatës së emergjencës, largimet/pezullimet nga puna, mbylljet e tregjeve të cilët nuk plotësonin kushtet higjieno sanitare, etj.

Lidhur me problematikat e parashtruara më sipër, institucioni i Avokatit të Popullit ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe zgjidhjen e tyre përmes hartimit të rekomandimeve përkatëse drejtuar institucioneve.


➤ **Veprimtaria e Seksioni të Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve**

Veprimtaria e institucionit të Avokatit të Popullit për të drejtat e fëmijëve gjatë vitit 2020, është përqëndruar në funksionet kryesore, *të mbrojtjes, promovimit dhe të garantimit të të drejtave të fëmijëve*, të orientuara nga pikëpamjet dhe interesat e fëmijëve.

Gjatë vitit 2020, vitit të pazakontë të pandemisë, në kuadër të promovimit të të drejtave të fëmijëve, institucioni i Avokatit të Popullit, nëpërmjet Komisionerit, ka luajtur një rol proaktiv në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare, me institucionet homologe evropiane të të drejtave të njeriut dhe fëmijëve, duke ndarë eksperiencë dhe praktika të mira pune, për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijës.

Situata e pandemisë globale, shoqëruar me masa të kufizimit të lëvizjes së popullatës, izolimit dhe vetëkarantinimit, solli edhe qasje të reja të të punuarit *online* (telepuna), për institucionet në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar, në funksion të përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësi brenda fushës së veprimtarive të tyre.

Ashtu sikundër e përmendëm edhe në kreun II, zbërthimi i funksionit kushtetues dhe ligjor i Komisionerit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve në institucionin e Avokatit të Popullit, është parë ngushtësisht në raport *me sjelljen dhe administrimin e pushtetit nga ana e organeve të administratës shtetërore* dhe paraqitja skematike ilustron si vijon:



Në krahasim me vitin 2019, gjatë vitit 2020, SMPDF ka një rritje të trajtimit të numrit të ankesave/kërkesave/rasteve me iniciativë me rreth 34.5%. Rezultati pozitiv edhe për këtë vit, konsiston në rritjen e numrit të ankesave të adresuara në institucionin e Avokatit të Popullit nga vetë fëmijët me rreth 50%, nga të cilat 40% kanë marrë zgjidhje pozitive. Ky numër ankesash nga vetë fëmijët, është motivues nisur edhe nga veprimtaritë promovuese të institucionit, përgjatë viteve të fundit.

Po kështu, në ndryshim nga viti 2019, në 2020, institucioni i AP-së ka monitoruar nivelin e respektimit të të drejtave të fëmijëve gjatë pandemisë COVID-19 në institucionet shtetërore përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve publike për fëmijë,²¹ nëpërmjet inspektimeve në terren. Për këtë qëllim, janë realizuar 11 inspektime, prej të cilave 4 inspektime në komisarite/stacione të Policisë së Shtetit,²² 4 inspektime në institucionet e përkujdesit social rezidencial²³ që ofrojnë shërbime për fëmijët dhe 3 të tilla në institucionet e edukimit.²⁴ Pas inspektimeve të kryera dhe evidentimit të problematikave, janë hartuar rekomandime konkrete, të cilat i janë adresuar strukturave përkatëse shtetërore.

Për sa i përket rekomandimeve të adresuara, gjatë vitit 2020, institucioni i AP-së i është drejtuar 66 institucioneve shtetërore të administratës publike në nivel qendror dhe vendor, nëpërmjet 98 rekomandimeve specifike.

➤ **Veprimtaria e Seksionit të Përgjithshëm**

Veprimtaria e Seksionit të Përgjithshëm, si pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2020, ka qënë e fokusuar, duke i kushtuar një vëmendje kryesore dhe të dukshme grupeve, komuniteteve dhe individëve vulnerabël apo në risk, të cilët janë më të cënueshëm dhe të pambrojtur nga pjesa tjetër e popullsisë nga pasojat e situatës së jashtëzakonshme të krijuar nga pandemia e COVID-19.

Për shkak të masave kufizuese të vendosura nga autoritetet shtetërore për parandalimin e pandemisë së COVID-19, veprimtaria jonë lidhur me respektimin e të drejtave të minoriteteve kombëtare ka njohur një hop të dukshëm proaktiviteti, të bazuar në identifikimin e çështjeve nga media dhe shtypi i shkruar dhe investigimin e tyre “ex-officio” apo me nismën tonë. Vend të rëndësishëm kanë zënë rekomandimet, që kanë të bëjnë me një qasje sistematike ndaj problematikave të konstatuara, të cilat kërkonin një zgjidhje afatshkurtër, si dhe një ndryshim në politikat dhe aktivitetin e përditshëm, specifikisht të njësive të vetëqeverisjes vendore në të gjithë vendin.

Megjithë përpjekjet për rritjen e efektivitetit dhe modernizimin e skemës së ndihmës ekonomike, disavantazhet e kësaj skeme të aplikuar në vendin tonë janë shfaqur në mungesën e mbulimit të gjerë të të gjitha familjeve që jetojnë në varfëri dhe pa mbështetje financiare. Masa e ndihmës ekonomike gjatë vitit 2020, vijoi të mbetet, në vlerësimin e qytetarëve por edhe të Avokatit të Popullit, shumë e ulët në raport me shpenzimet mujore më të domosdoshme për të mbijetuar.

²¹ Shërbimet publike që mundësojnë garantimin e të drejtave të fëmijëve, të cilat janë prekur nga situata e pandemisë COVID-19.

²² Inspektimet në komisaratin e Policisë Tropojë, Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër, Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë dhe Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës.

²³ Inspektimet në Shtëpinë e Fëmijës “Zyber Hallulli” Tiranë, në Shtëpinë e Fëmijës 0-6 vjeç Vlorë dhe në Shtëpinë e Fëmijës Shkodër.

²⁴ Inspektimi në shkollën 9-vjeçare “Emin Duraku”, Tiranë, shkollën e mesme të përgjithshme “Ismail Qemali”, Tiranë, shkollën 9-vjeçare “Jusuf Puka” Durrës.

Duke e konsideruar si të pajustificueshme mungesën e përcaktimit të një minimumi jetik, është iniciuar gjatë vitit 2020 me mbështetjen e UNDP, hartimi i një raporti të veçantë, “Për Standardin e Minimumit Jetik në Shqipëri”, i cili është në proces.

Respektimi dhe implementimi i së drejtës për të përfituar nga *sistemi i sigurimeve shoqërore* është me rëndësi jetike për qytetarët. Në këndvështrimin tonë, konstatohet se problematikat në këtë fushë vijnë të jenë të njëjta apo të ngjashme me ato të raportura në vitet pararendës. Megjithatë gjatë vitit 2020 kanë zënë një vend më të gjerë trajtimi i ankesave lidhur me mosmarrjen e përgjigjes pas kërkesës për verifikimin e vjetërsisë së punës, si dhe për masën e ulët të përfitimit të pensionit të pleqërisë. Shihet i nevojshëm në këtë kuadër, përmirësimi i legjislacionit në fushën e sigurimeve shoqërore.

Pandemia e COVID-19, solli detyrimisht mbylljen e institucioneve të *edukimit arsimor*, çka ka kompromentuar thellësisht nivelin aktual të arsimit, duke e përkeqësuar atë. Fëmijë nga familje me të ardhura të ulëta, fëmijë që jetojnë në zona rurale me infrastrukturë të dobët, fëmijë nga pakica etnike dhe gjuhësore, fëmijë me aftësi të kufizuara e fëmijë në konflikt me ligjin, përpos problematikave të hershme me të cilat përballen në përditshmërinë e tyre, tanimë po përballen edhe me barriera të reja domethënëse e të pakapërcyeshme si pasojë e mungesës së aksesit në mësimin “on-line”, duke përfituar për pasojë arsim të një niveli më të dobët, i cili materializohet në më pak rezultate pozitive krahasuar me bashkëmoshatarët e tyre. Gjithashtu, mësuesit u përballën me vështirësitë konkrete në kushtet e mungesës së trajnimit për ofrim e dhënie të mësimin on-line. Në kushtet e një qasjeje të re të edukimit dhe nxënies, përmes platformave on-line vijon të mbetet detyrim prioritar kryerja e trajnimeve të mësuesve dhe rritja e kapaciteteve të tyre, përshtatja e teksteve shkollore si dhe gjetja e teknologjive sa më të aksesueshme, jo vetëm për nxënësit në zonat rurale por edhe ato urbane.

Pandemia e COVID-19 është një sfidë që veçanërisht rezultoi e vështirë në fushën e *mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara*. Masat për të parandaluar infeksionin, të tilla si distancimi shoqëror e fizik dhe izolimi, ishin të pamundura për këtë kategori që mbështeshtja në ndihmën e të tjerëve është themelore për mbijetesën e tyre. Mungesa e aksesit në mjediset publike dhe private, në marrjen e infomacionit, aksesit në drejtësi, vonesa në lëvrimin e fondeve për personat me aftësi të kufizuara, moszbatimi i dispozitave ligjore për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, moszbatimi i rimbursimit të biletës në transportin urban, i mjeteve didaktike të posaçme, mbeten problematika ende të pazgjidhura për këtë kategori individësh.

Në lidhje me të *drejtën e kujdesit shëndetësor*, pandemia e COVID-19, thelloi, duke risjellë edhe njëherë në vëmendje problematikat e hershme, si dhe evidentoi problematika të reja, me të cilat u ballafaqua shoqëria, në raport me të drejtën e saj për kujdes shëndetësor të garantuar nga shteti. Individët e varfër dhe të cënueshëm financiarisht u përballen me kosto të larta ekonomike shtesë sa i përket kujdesit shëndetësor shoqëruar kjo edhe me mungesën e ofrimit të shërbimeve bazë të kujdesit shëndetësor gjatë vitit 2020. Sasia e kufizuar e kursimeve, mbulimi i ulët me sigurime shoqërore dhe përdorimi relativisht i ulët i shërbimeve publike çoi në rëndim të efekteve negative afatgjata të përballjes me krizën e pandemisë. Rezultoi se familjet në nevojë u prekën nga diskriminimi social si dhe u goditën më shumë nga masat kufizuese kundër COVID-19. Gjithashtu të moshuarit ishin relativisht më të predispozuar ndaj problemeve shëndetësore, më të rrezikuarit nga shpërthimi i pandemisë dhe më të shumtë në humbje jete gjatë pandemisë.

Zbatimi i akteve normative të nxjerra nga Qeveria apo Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në këto kushte, evidentoi problematika të qarta veçanërisht në raport me të drejtën e informimit dhe transparencës ndaj publikut të gjerë lidhur me numrin e përgjithshëm të testeve, mundësinë reale dhe kapacitetin që kishte Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për

kryerjen e tyre, sasitë e porositura të testeve, si dhe shpalosjen e strategjisë së testimit si dhe respektimin e të drejtave të pacientëve të akomoduar në stukturat spitalore përgjatë pandemisë.

Ankesat dhe rastet me inisiativë të shqyrtuara nga ana e Avokatit të Popullit, evidentuan ekzistencën e problematikave kryesore të tilla si: trajtimi mjekësor jo konform standardeve, burokracia lidhur me rradhët e pritjes në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUT) dhe spitalet Covid 1 dhe 2, mungesa e protokolleve mjekësore të trajtimit të COVID-19, mungesa e mjeteve mbrojtëse për personelin mjekësor dhe mungesa e dezinfektantëve në spitale e poliklinika, apo edhe mungesa e personelit mjekësor dhe infermier në spitale rajonale dhe zona rurale.²⁵

Të moshuarit janë një ndër grupet më vulnerabël dhe më të ekspozuar ndaj riskut të mosrespektimit dhe garantimit të të drejtave të tyre, të saksionuara në legjislacionin vendas dhe atë ndërkombëtar. Qysh në një fazë të hershme të pandemisë (Mars 2020) institucioni i Avokatit të Popullit ka bërë thirrje për solidaritet shoqëror, duke iu drejtuar autoriteteve shtetërore, qendrore dhe vendore, me kërkesën specifike për zgjerimin e gamës së shërbimeve sociale të ofruara për këtë kategori, veçanërisht për të moshuarit me aftësi të kufizuar dhe ata që janë të vetmuar.

Gjatë vitit 2020 *gratë, vajzat dhe komuniteti LGBTI* kanë qënë pjesë e një vëmendjeje të shtuar institucionale të Avokatit të Popullit. Përgjatë këtij viti ka njohur rritje dhuna ndaj grave e vajzave, si dhe dhuna në familje, si një fenomen për të cilin Avokati i Popullit hershëm ka bërë thirrje për ta denoncuar në institucionet shtetërore përgjegjëse. Një problematikë tipikisht e këtij viti pandemik është ajo e humbjes së vendit të punës të një numri të konsiderueshëm grash e vajzash të punësuar si kujdestare për fëmijë apo të moshuar, apo punëtore ndihmëse në familje, me pasojë të drejtpërdrejtë mospërfitimin e “*pagës së luftës*” për shkak të punësimit informal. Kjo është ndjekur nga problematika të tjera si, kërkesat për punësim, ndihmë ekonomike, pension, aksesin në drejtësi, mosekzekutimin e detyrimeve ushqimore të vendosura në vendimet e gjykatave, etj.

Në fushën e *barazisë gjinore*, Avokati i Popullit me mbështetjen financiare të UNDP ka përgatitur Raportin Alternativ mbi nivelin e zbatimit të Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), i cili ofron informacion në lidhje me shkallën e zbatimit të rekomandimeve të bëra nga Komiteti në fjalë për Shqipërinë gjatë periudhës paraardhëse të raportimit. Ky raport shpalos gjetjet e institucionit të Avokatit të Popullit mbi zbatimin e Konventës CEDAW nga Shteti Shqiptar gjatë periudhës 2016-2020.

Në vlerësimin e institucionit të Avokatit të Popullit, *komuniteti LGBTI* u ballafaqua me problematika të shtuara përgjatë vitit 2020, të tilla si: ekonomia e përkeqësuar, punësimi, strehimi dhe siguria, si dhe mundësinë e komunitetit LGBTI për të plotësuar nevojat e tij bazike. Papunësia e lartë mes anëtarëve të komunitetit LGBTI, ka të bëjë me faktin se ky komunitet vuan nga numri i lartë i papunësisë sistematike që përpara shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, për shkaqe të tilla si: diskriminimi, bullizmi dhe largimi i komunitetit LGBTI nga sistemi arsimor.

I gjithë ky vit karakterizohet nga një vlerësim më sensitiv ndaj të drejtave të të gjithë grupeve, komuniteteve dhe individëve vulnerabël apo në risk, në kushtet kur tendenca e kushtëzuar e kufizimit të disa të drejtave kërkon pashmangshmërisht prezencën dhe ndërhyrjen e nevojshme të një garantit kushtetues të pavarur, sikundër institucioni i Avokatit të Popullit.

²⁵ Këto gjetje i referohen momentit kohor kur është bërë hetimi dhe/ose rekomandimi.

3.2 Të drejtat e personave të privuar nga liria²⁶

Efikasiteti ynë për të mbikëqyrur sistemin penitenciar gjatë vitit 2020 u vu në provë të vështirë nga masat e marra për të kufizuar përhapjen e virusit COVID-19. Këto masa të diktuar nga një emergjencë shëndetësore ndikuan në procedurën tonë për të verifikuar ankesat e të burgosurve dhe në këmbimin e informacionit me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP-të. Për shkak të situatës së krijuar dhe mjediseve të IEVP-ve, ku është e vështirë të ruhet distancimi fizik, kryesisht nuk janë kryer veprime hetimore në vend nga punonjësit e Institucionit të Avokatit të Popullit për sa i përket ankesave individuale por është proceduar me hetime në formë shkresore. Në këto rrethana, jemi përshtatur me kushtet e reja të punës duke monitoruar çdo ditë lajmet e përcjella nga mediat, si një burim më shumë informacioni dhe duke komunikuar në vijimësi me institucionet përgjegjëse me anë të email-it, veçanërisht në muajt e parë të kufizimit të lëvizjeve.

Si shumë institucione publike, edhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe IEVP-të u vendosën në kushte jo pak të vështira me shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore si pasojë e përhapjes së virusit COVID-19. Roli i administratës së sistemit penitenciar në situatën e krijuar nuk ka qenë i lehtë, pasi duhet të ruhej një ekuilibër ndërmjet masave kufizuese shtesë në burgje për të parandaluar përhapjen e virusit dhe ofrimit të shërbimeve ndaj të burgosurve, në mënyrë që të shmangej shtimi i tensionit si kundërpërgjigje e masave shtrënguese, tension që bashkë me frikën e prekjes nga virusi mund të bëhej i pakontrollueshëm. Masat e marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për të përballuar këtë situatë, i kemi gjetur përgjithësisht në përputhje me qëllimin për të cilën ato janë vënë si dhe me udhëzimet e organizmave ndërkombëtarë që mbrojnë të drejtat e të paraburgosurve/dënuarve siç është edhe Komiteti për Parandalimin e Torturës së Këshillit të Evropës.

Në mënyrë të përmbledhur, masat shtesë kufizuese të vendosura në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale janë si vijon:

- Ndërprerja e konsultave dhe ekzaminimeve jashtë IEVP-së, përveç urgjencave mjekësore;
- Zëvendësimi i takimeve me familjarët me lidhjen në distancë, nëpërmjet pajisjeve elektronike dhe programit Skype;
- Pezullimi i aktiviteteve kulturore-sportive.

Këto masa duhet të ndryshojnë dhe të mos jenë absolute pasi tani duhet të gjenden alternativa që të përmirësohen kushtet.

Me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19 në sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale, Këshilli i Ministrave miratoi Aktin Normativ Nr.7, datë 23.03.2020 “*Për qëndrimin e përkohshëm në shtëpi të të dënuarve*”. Masa e përkohshme që ky akt parashikonte ishte qëndrimi në shtëpi i të dënuarve për një periudhë 3-mujore. Por jo çdonjëri prej tyre mund ta përfitonte këtë leje. Kriteret për ta përfituar kishin të bënin me masën e dënimit penal, kohën e mbetur të dënimit të dhënë dhe rrezikshmërinë shoqërore që paraqiste i dënuari.

Ne e gjetëm këtë masë në përputhje me udhëzimet e dhëna dhe nga Komisioneri i Lartë për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara.²⁷

Ankesat më të shpeshta të paraqitura nga të burgosurit gjatë periudhës së pandemisë kanë patur të bëjnë pikërisht *me refuzimin e kërkesës për të përfituar lejen e veçantë “qëndrimi të*

²⁶ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Veçantë në institucionin e Avokatit të Popullit.

²⁷ <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/categories/mechanisms-against-torture>.

përkohshëm në shtëpi për një periudhë 3-mujore”, në zbatim të Aktit normativ nr. 7, datë 23.03.2020.²⁸ Nga ana jonë është verifikuar procedura e ndjekur nga institucionet kompetente për dhënien ose jo të kësaj leje të veçantë. Në disa raste, gjatë shqyrtimit të ankesës nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit, vendimi i komisionit të IEVP-së për refuzimin e lejes është rrëzuar nga Komisioni i Posaçëm për Shqyrtimin e Ankimeve pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe i burgosuri ka përfituar leje të veçantë. Ndërsa në raste të tjera, kur dhënia e lejes është refuzuar për shkak të rrezikshmërisë që paraqiste i burgosuri, është bërë orientimi përkatës për të ankimuar vendimin në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Një tipologji tjetër e ankesave ka pasur të bëjë me pretendimin e të burgosurit se, *nuk është dërguar për konsulta dhe ekzaminime jashtë IEVP-së*. Disa prej tyre kanë rezultuar të pabazuara, pasi pas verifikimeve ka rezultuar se të burgosurve u ishte ofruar shërbimi i duhur shëndetësor. Në ndonjë rast, IEVP ka pritur lehtësimin e masave kufizuese të diktuar nga situata e pandemisë dhe shifrat e raportuara nga institucionet përgjegjëse e më pas kanë dërguar të burgosurin për vizitë mjekësore jashtë IEVP-së. Sjellim në vëmendje rastin e ankesës së paraqitur nga një e burgosur në IEVP “Ali Demi”, Tiranë lidhur me trajtimin e saj shëndetësor. Në përfundim të hetimit nga ana jonë është dalë me rekomandim, pasi nuk ishte respektuar e drejta për informim lidhur me trajtimin e problemit që kishte e burgosura si dhe parimi i parandalimit të sëmundjeve tumorale²⁹. Në përgjigjen që kemi marrë nga IEVP “Ali Demi” jemi vënë në dijeni se e burgosura ka kryer konsultën me mjekun specialist.

Kufizim tjetër i zbatuar për të burgosurit gjatë pandemisë është *kufizimi i marrjes së ushqimeve dhe veshjeve nga familjarët*. Në përgjigjet që iu kemi kthyer të burgosurve apo familjarëve të tyre që kishin paraqitur ankesë lidhur me këtë kufizim kemi sqaruar se kjo masë është marrë për të parandaluar përhapjen e virusit COVID-19 dhe janë orientuar nga ana jonë se këto sende duhet të dërgohen me postë dhe jo të dorëzohen nga familjarët pranë IEVP-ve, siç ka ndodhur më parë. Një tjetër problematikë e hasur gjatë trajtimit të ankesave *lidhet me mungesën e aktiviteteve në IEVP* gjatë vitit 2020, të cilat janë pezulluar për të parandaluar përhapjen e virusit COVID-19.

Në raportin vjetor të vitit të kaluar kemi vënë në dukje faktin se, organika e stafit shëndetësor në IEVP-të, herë pas here, është e paplotësuar për shkak të largimeve të mjekëve/infermierëve dhe vështirësisë për të gjetur zëvendësues. Disa prej mjekëve, që i përgjigjen kërkesës që të punojnë në burgje, pranojnë të punojnë vetëm me kohë të pjesshme. Shkaku i identifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për këtë mungesë interesi është vështirësia e punës në burgje dhe paga e ulët e personelit mjekësor, më e ulët se e kolegëve që punojnë në spitalet publike. Për këtë arsye është kërkuar rritja e pagave të mjekëve, stomatologëve dhe farmacistëve në sistemin e burgjeve, kërkesë që ka gjetur mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë, e cila i ka kërkuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë rritjen e kategorisë së pagave të stafit mjekësor në sistemin e burgjeve. Gjithsesi, interesimi ynë lidhur me rritjen e pagave, si masë e domosdoshme që mendohet se mund të zgjojë interesin për të punuar në sektorin shëndetësor në burgje, ka ndeshur me burokraci të disa institucioneve si Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave dhe Departamenti i Administratës Publike, të cilat i adresojnë njëra-tjetrës zgjidhjen e problematikës në fjalë por pa i dhënë zgjidhje problemit. Ngarkesa e punës dhe vështirësitë me të cilën u përballën punonjësit e sektorit shëndetësor gjatë pandemisë,

²⁸ Nga komunikimet zyrtare me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve jemi informuar se numri total i të dënuarve që kanë përfituar leje shpërblyese të përkohshme është 372 persona.

²⁹ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandohet%20d%C3%ABrgimi%20i%20t%C3%AB%20paraburgosur%C3%ABs%20B.%20G.%20p%C3%ABr%20vizit%C3%AB%20t%C3%AB%20specializuar%20dhe%20garantimi%20i%20t%C3%AB%20drejt%C3%ABs%20s%C3%AB%20saj%20p%C3%ABr%20informim%20si%20dhe%20p%C3%ABr%20t%C3%AB%20b%C3%ABr%C3%AB%20k%C3%ABrkesa%20sip.pdf>

janë faktorë shtesë, tregues të rëndësisë të rritjes së pagave për këtë kategori punonjësish. Në muajin Nëntor 2020 u informuam nga Ministria Financave dhe Ekonomisë se, për vitin 2021, nga qeveria është paraqitur politika e rritjes së pagave edhe për sistemin shëndetësor. Referuar kësaj politike, kjo ministri ka përfshirë në projektbuxhetin e vitit 2021, fondin e parashikuar prej 8 miliardë lekë. Ministria shprehej se, detajet e mëtejshme të projektbuxhetit do të ishin objekt diskutimi gjatë hartimit të projektvendimeve përkatëse. Pas marrjes së këtij informacioni i jemi drejtuar me dy shkresa Komisionit të Ekonomisë dhe Financave pranë Kuvendit, nëse është pranuar kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë për rritjen e pagave të stafit shëndetësor në sistemin e burgjeve, por ende nuk kemi marrë një përgjigje.

Një nga të drejtat që gëzojnë të paraburgosurit/të dënuarit është dhe *e drejta për të punuar*. Mundësia e vetme e punësimit për të burgosurit është brenda IEVP-së, në veprimtari që lidhen kryesisht me nevojat e institucionit të tilla si ndihmës në kuzhinë, pastrues i mjediseve të përbashkëta dhe ato të mirëmbajtjes. Legjislacioni shqiptar parashikon, që puna e të burgosurve duhet të shpërblehet, por kjo e drejtë e tyre vazhdon të mos gjejë zbatim, për shkak të mos nxjerrjes së akteve nënligjore. Aktualisht pavarësisht rekomandimeve të Avokatit të Popullit, puna e të burgosurve vazhdon të mospaguhet. Ligji i ri Nr.81/2020 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*”, ashtu sikurse ligji i mëparshëm, parashikon shpërblimin e punës së kryer nga i burgosuri (neni 43/2). Përgjigjet që kemi marrë ndër vite nga Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve mund t’i përmbledhim duke thënë se, hartimi i projekt VKM-së për shpërblimin e punës ndodhet në një procedurë të përhershme studimi. Në përgjigjen e datës 14.01.2021 të Drejtorisë së Përgjithshme e Burgjeve, ndër të tjera thuhet se, përveç nismave ligjore dhe nënligjore ka patur përpjekje për të tërhequr interesin e subjekteve private drejt tregut të punësimit të burgosurve.

Në fokusin e punës të Avokatit të Popullit ka qenë edhe *trajtimi i rasteve të vetëvrasjeve dhe vdekjeve në burgje*, të nisura me nismën e vet apo të vënë në lëvizje nga ankesa e familjarëve të të ndjerëve. Në 4 raste vetëvrasjesh, hetimi i kryer nga ana e Avokatit të Popullit ka patur për qëllim për të kuptuar shkaqet dhe rrethanat që kanë shtyrë të burgosurin për të kryer vetëvrasje; nëse vdekja e të burgosurit ka ardhur për shkaqe natyrore dhe nëse ai ka marrë shërbimet që duhet të ofrojë IEVP-ja, veçanërisht shërbimin shëndetësor. Në përfundim të hetimit të ankesës së paraqitur nga i afërmi i një të burgosuri që ka ndërruar jetë në IEVP Tepelenë në vitin 2019, i cili hidhte dyshime se kishte patur neglizhencë nga stafi i IEVP-së në ofrimin e shërbimit shëndetësor, konstatuam se: dinamika e ngjarjes tregonte qartë se për shkak të mungesës së një automjeti të përshtatshëm për transportimin e të paraburgosurit për në spitalin rajonal, pasi ai ishte gjetur në gjendje të rëndë shëndetësore në dhomën e tij, kishin humbur minuta të vlefshme për ta dërguar atë sa më parë në një institucion shëndetësor ku mund të merrte trajtim më të specializuar dhe mund të shpëtohej një jetë. Në fund të hetimit, të përmbyllur në vitin 2020, i kemi rekomanduar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve marrjen e masave të nevojshme për pajisjen e IEVP Tepelenë me autoambulancë, për të garantuar ofrimin e shërbimeve dhe shoqërimin e të burgosurve për trajtim më të specializuar në institucionet shëndetësore³⁰. Mungesa e autoambulancës është konstatuar edhe në përfundim të hetimit të një vetëvrasje që ka ndodhur në IEVP “Jordan Misja”, Tiranë, në muajin Shkurt 2020. Së fundmi, jemi vënë në dijeni nga kjo IEVP, se në datën 24.09.2020 institucioni është pajisur me autoambulancë.

Kontaktet me familjen dhe miqtë janë thelbësore për riintegrimin e të burgosurit pas lirimit të tij dhe janë jetësore për mirëqënien e tij të përgjithshme. Megjithëse të burgosurit janë të veçuar

³⁰ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.
<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandohet%20pajisja%20e%20IEVP%20Tepelene%20me%20autoambulanc%C3%AB%20si%20dhe%20mbajtja%20e%20procesverbalit%20nga%20stafi%20p%C3%ABrgjegj%C3%ABs%20n%C3%AB%20rastet%20kur%20i%20burgosuri%20refuzon%20t%C3%AB%20marr%C3%AB%20trajtim.pdf>

nga pjesa tjetër e shoqërisë, atyre u garantohet e drejta për të patur kontakte të kufizuara me botën e jashtme nëpërmjet letërkëmbimit, telefonatave dhe takimeve me familjarët, të afërmit dhe miqtë. Sipas Rregullores së Burgjeve, të burgosurit madhorë kanë të drejtë të takohen 4 herë në muaj me familjarët, të afërmit dhe miqtë dhe të kryejnë me ta, 8 telefonata në muaj. Ndërsa për të paraburgosurit/të dënuarit e mitur dhe femra këto kontakte janë më të shpeshta. Dy urdhëresa të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve që kanë të bëjnë me kufizimin dhe regjistrimin e numrave të telefonave drejt të cilëve dëshiron të bëjë thirrje i burgosuri dhe me disa kriteret për pranimin e kërkesës të të dënuarit për të përfituar leje shpërblyese kanë qenë objekt shqyrtimi, pas ankesave që janë regjistruar në zyrën tonë.

Me Urdhërin Nr.4218 prot., datë 13.05.2019 “*Për administrimin e telefonatave që kryhen nga të dënuarit dhe të paraburgosurit në IEVP*”, u është kërkuar të gjitha IEVP-ve që të kryejnë regjistrimin e numrave fiks, celularë (kombëtarë dhe ndërkombëtarë) të familjarëve apo të tretëve (të afërm dhe/ose miq) sipas deklarimit me shkrim të secilit të burgosur. Sipas këtij urdhri, të dënuarit/paraburgosurit e sigurisë së zakonshme, gra dhe minorenë duhet të deklarojnë deri në 15 numra telefoni, ndërsa ato të sigurisë së lartë duhet të deklarojnë deri në 10. Qëllimi i këtij kufizimi ka qenë parandalimi i keqpërdorimit të thirrjeve telefonike dhe shkelja e privatësisë. Nga ana jonë ky urdhër është konsideruar në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore³¹ pasi kufizimi i telefonatave mund të bëhet vetëm me vendim të prokurorit dhe gjykatës; e drejta e nxjerrjes së aktit nuk është parashikuar në ligj siç përcaktohet në Kushtetutë³²; ai kufizon të drejtën e të burgosurit për të mbajtur kontakte me botën e jashtme dhe krijon premisa për cenimin e privatësisë së familjarëve dhe të afërmeve të të burgosurit, për shkak të deklarimit të emrit dhe numrit të tyre të telefonit. *Rekomandimi ynë³³ për shfuqizimin e këtij urdhri nuk është pranuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.*

Gjatë trajtimit të një ankese për refuzim të kërkesës për leje shpërblyese, konstatuam se me Urdhërin Nr.9657 Prot., datë 18.10.2017 “Tërheqje vëmendje mbi problematikat e konstatuara në lidhje me praktikën e lejeve shpërblyese në IEVP”, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka vendosur disa kriteret shtesë për dhënien e lejes shpërblyese një të dënuari. Në zbatim të këtij urdhëri, IEVP-të refuzojnë kërkesat e të dënuarit për të përfituar leje shpërblyese nëse ai nuk ka patur takime me familjarët gjatë qëndrimit në IEVP, nëse nuk ka një familje ku të shkojë dhe të kalojë ditët që do të trajtohet me leje dhe nëse në momentin e daljes me leje, i dënuari nuk pritet të paktën nga njëri nga pjesëtarët e familjes, i cili duhet të paraqesë dokumentin e tij të identifikimit. Ky urdhër është konsideruar nga ana jonë në kundërshtim me ligjin³⁴, pasi një akt nënligjor nuk mund të krijojë apo të vendosë kriteret të reja shtesë për dhënien e lejeve shpërblyese, përtej atyre që ka caktuar ligjvënësi si dhe nuk merr parasysh situatat, kur i dënuari është në pamundësi objektive për të marrë takim me familjarët dhe për t’u pritur prej tyre. Shkaqet e mosrealizimit të shpeshtë të takimeve me familjarët mund të jenë nga më të ndryshmet dhe që varen nga rrethana objektive, sikurse është pamundësia financiare apo shëndetësore e familjarëve, largësia e vendbanimit të familjarëve me institucionin ku vuajnë dënimin të dënuarit ose si në rastin e ankuesit që na ka vënë në lëvizje, ndodhja e të afërmeve në një vend të huaj për arsye ekonomike. Përgjithësisht të dënuarit shkojnë me leje pranë familjes

³¹ Konkretisht, Neni 75/3 i Ligjit Nr.8328, datë 16.04.1998 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*”, (që ka qenë në fuqi në periudhën e trajtimit të rastit dhe nxjerrjes së rekomandimit tonë); neni 44/3 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

³² Neni 118 dhe 119 i Kushtetutës.

³³ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20shfuqizimin%20e%20Urdhrit%20t%C3%AB%20Drejtorit%20t%C3%AB%20P%C3%ABrgjithsh%C3%ABm%20t%C3%AB%20Burgjeve%20nr.%204218%20prot.,%20dat%C3%AB%2013.05.2019.pdf>

³⁴ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20per%20DPB,%20zbatimi%20i%20procedures%20se%20lejeve.pdf>

dhe kjo është një garanci më shumë për sjelljen e tyre jashtë institucionit, por ka edhe raste përjashtimore kur ata mund ta shpenzojnë këtë leje edhe me të afërm të tjerë apo vetëm në banesën e tyre. Qëllimi i parashikimit të kësaj të drejtë është që leja shpërblyese, të ndihmojë të dënuarit të ruajnë kontaktet apo rikrijojnë kontaktet e humbura me të afërmit, miqtë apo dhe komunitetin ku ata do të banojnë e punojnë në të ardhmen. Pra, ky mekanizëm ligjor mundëson që ata të përgatiten për një kalim sa më të lehtë në jetën e lirë, pas periudhës së dënimit.

Rëndësi e veçantë i është dhënë edhe ankesave të paraqitura nga punonjës të policisë së burgjeve, jo vetëm për faktin se edhe kjo kategori është subjekt i punës sonë për sa i përket të drejtave që gëzojnë, por edhe se mënyra e trajtimit të tyre pasqyrohet në marrëdhëniet me të burgosurit.

Në përfundim të hetimit administrativ të ankesës së paraqitur nga një ish punonjës i policisë së burgjeve, i cili pretendonte se nuk ishin respektuar kriteret ligjore për tre masat disiplinore të dhëna ndaj tij, ndër to edhe ajo e largimit nga detyra, konstatoam se nuk ishte zbatuar procedura ligjore për dhënien e këtyre masave. Në përmbajtjen e rekomandimit tonë drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, për të zbatuar në përputhje me legjislacionin, procedurën e dhënies së masës disiplinore ndaj punonjësit të policisë së burgjeve, ndër të tjera, kemi arsyetuar se: *“Shmangia e shfrytëzimit të hapësirave ligjore për të gjetur zgjidhje për këtë rast apo raste të ngjashme, i heq mundësinë vetë strukturave të sistemit të burgjeve për të konstatuar nëse masat disiplinore janë të bazuara ose jo, largon nga radhët e administratës një punonjës me përvojë, për të cilin është investuar në kohë të përgatitet dhe në të njëjtën kohë, ul besimin tek punonjësit e tjerë për vlerësimin e meritave”*³⁵.

Në vitin 2020 kemi dalë me qëndrimin tonë lidhur me ankesat e paraqitura nga disa punonjës të policisë së burgjeve për sa i përket ndërprerjes së pagesës në masën 25-50% mbi pagën normale kur ata punojnë të shtunën, të dielën dhe në ditë festash³⁶. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, jo vetëm kishte ndërprerë pagesën shtesë mbi pagë për këto ditë pune, duke e quajtur praktikën të gabuar, por edhe kishte mbajtur nga paga e punonjësve shumë shtesë që ata kishin marrë për vitin 2018, vit kur kjo pagesë është bërë nga disa IEVP pa konsultim me organin epror. Ne kemi vlerësuar se qëndrimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nuk është në përputhje me aktet normative në fuqi, më konkretisht me nenet 87 dhe 123 të Kodit të Punës, pavarësisht natyrës së veçantë të punës të punonjësve të Policisë së Burgjeve. Në përfundim të hetimit i kemi rekomanduar këtij institucioni, që shtesën mbi pagë, punonjësit e policisë së burgjeve ta përfitojnë edhe kur ata thirren në punë në ditët kur kanë qenë planifikuar për të qëndruar pushim; marrjen e masave të nevojshme për të bërë planifikimin e buxheteve të ardhshme duke mbajtur në konsideratë të drejtën për kompensimin e punës të punonjësve në rastet e angazhimit të tyre në ditët e pushimit javor dhe të festave zyrtare; marrjen e masave për përgatitjen e një VKM-je për rregullimin dhe unifikimin e praktikës në të gjitha IEVP-të për kompensimin e punës të kryer nga punonjësit e policisë së burgjeve në ditët e pushimit javor dhe të festave zyrtare. Gjithashtu u rekomandua marrja e masave për përditësimin e kontratave individuale të punës me punonjësit e Policisë së Burgjeve, me stafin civil të DPBurgjeve dhe të IEVP-vë me ndryshimet që ka pësuar Kodi i Punës si dhe lidhja e kontratës kolektive të punës ndërmjet punëdhënësit, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Sindikatës së Punonjësve të Policisë së Burgjeve.

³⁵ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandohet%20zbatimi%20i%20procedur%C3%ABs%20p%C3%ABr%20dh%C3%ABnien%20e%20mas%C3%ABs%20disiplinore%20ndaj%20punonj%C3%ABsit%20t%C3%AB%20policis%C3%AB%20s%C3%AB%20burgjevesi%20dhe%20ndryshimi%20i%20Urdhrit%20t%C3%AB%20Ministrit%20t%C3%AB%20Drejt%C3%ABsis%C3%AB.pdf>

³⁶ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20per%20marrjen%20e%20masave%20te%20nevojshme%20per%20respektimin%20e%20te%20drejtes%20ligjore%20te%20punonjesve%20te%20Policise%20se%20Burgjeve.pdf>

3.3 Respektimi i të drejtave të njeriut nga organet e Policisë së Shtetit³⁷

Objekti i ankesave apo rasteve me iniciativë të administruara në institucionin e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2020, ndaj strukturave dhe punonjësve të Ministrisë së Brendshme dhe të Policisë së Shtetit ka qenë i gjerë, ku do të evidentonim rastet për keqtrajtime fizike ose psikologjike në momentet e arrestimit, shoqërimit apo gjatë marrjes në pyetje të shtetasve në organet e policisë; për shoqërime të paligjshme apo mbajtje në gjendje shoqërimi tej afatit ligjor; për mos marrje, mos administrim ose mos ndjekje të kallëzimeve apo ankesave të bëra prej tyre; për pengim të ushtrimit të të drejtës kushtetuese të tubimeve gjatë pandemisë së shkaktuar nga COVID-19; për mos informimin e shtetasve lidhur me masat shtrënguese dhe kufizimin e lëvizjes së lirë për shkak të pandemisë apo për bllokimin e rrugëve në rastet e prishjeve të ndërtimeve pa leje nga IMT dhe IKMT; për dëmtim të shëndetit të qytetarëve nga gazi lotsjellës i hedhur gjatë tubimeve; për vendosje të masave administrative gjatë pandemisë; për mos mbajtje dhe mos dhënie të procesverbaleve për veprimet e kryera nga punonjësit e policisë; për refuzimim e pajisjes me licencën e shërbimit; për dhënie të përgjigjeve negative nga organet e policisë ndaj të dënuarve të cilët kanë kërkuar nga IEVP-të përfitimin e të drejtës për leje shpërblyese; për shkelje të të drejtave të shtetasve të huaj në Shqipëri; për cënim të të drejtave ligjore të punonjësve të Policisë së Shtetit lidhur me mos ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe trajtimin e familjarëve të punonjësve të Policisë së Shtetit të vrarë në krye të detyrës, etj.

Disa nga të drejtat kushtetuese dhe ligjore për të cilat janë bërë rekomandime gjatë vitit 2020 mund të përmenden si vijon:

➤ *E drejta e shtetasve për të mos iu cënuar integriteti fizik dhe trajtuar me dinjitet*

Ankesat e shtetasve kryesisht kanë qenë për ushtrim të dhunës fizike e psikologjike dhe tejkallim të forcës në rastet e shoqërimit, pyetjes apo arrestimit/ndalimit të tyre si autorë të dyshuar të veprave penale, gjatë tubimeve të ndryshme të organizuara gjatë pandemisë nga grupime të ndryshme qytetarësh. Ndërkohë lidhur me cënimin e kësaj të drejte nga Policia e Shtetit, janë filluar dhe regjistruar me nismën tonë edhe disa raste të bëra publike në media. Për rastet kur shkeljet e të drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasve janë provuar dhe kanë qenë të rënda për arsye se përmbanin elementët e veprës penale të kryerjes së veprimeve arbitrare janë bërë rekomandime drejtuar organeve kompetente të prokurorisë për fillimin e hetimeve ndaj autorëve të tyre. Ndërsa, kur shkeljet kanë qënë më të lehta rekomandimet iu janë drejtuar strukturave të Policisë së Shtetit për fillimin e procedimeve disiplinore.

Një nga rastet e ndjekura, të filluar me nismën e Avokatit të Popullit pas bërjes publike nga media, është protesta e organizuar nga artistë dhe qytetarë që kundërshtonin prishjen e godinës së Teatrit Kombëtar (TK). *Për më shumë për këtë çështje referojuni Kreut 4, pika 4.1 (Angazhime të tjera institucionale).*

➤ *Shoqërimi i shtetasve në organet e Policisë së Shtetit, respektimi i kritereve ligjore dhe i të drejtave të tyre*

Ankesat e shtetasve për shoqërimin e tyre në organet e Policisë së Shtetit kanë qënë të konsiderueshme, sepse bëhet fjalë për kufizimin e lirisë së tyre ndonëse të përkohshme. Ndërkohë nga shqyrtimi i rasteve konkrete dhe nga inspektimet e bëra në organet e Policisë së Shtetit kemi konstatuar se numri i personave të shoqëruar ka qenë i lartë dhe veçanërisht në rastet e protestave/tubimeve të organizuara nga subjekte politike, organizata të shoqërisë civile dhe grupime të ndryshme shoqërore.

³⁷ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Veçantë në institucionin e Avokatit të Popullit.

Sjellim në vëmendje se e drejta e punonjësve të Policisë së Shtetit për të bërë shoqërimin e shtetasve në organet e policisë, rastet dhe qëllimet e aplikimit të masës së shoqërimit, përgjegjësitë e punonjësve të policisë në rastet e shoqërimit, zbatimi i të drejtave të njeriut dhe siguria për personin e shoqëruar, dokumentimi i shoqërimit në polici dhe rregullat teknike të shoqërimit janë parashikuar në mënyrë shumë të qartë në nenet 6/25, 109 dhe 122/1 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, si dhe në Procedurën standarde të punës për “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me urdhërin nr. 938 datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Por në veprimtarinë e përditshme të punonjësve të policisë kanë ndodhur edhe raste që shoqërimi i shtetasve është bërë jashtë kriterëve ligjore; mbajtja në gjendje shoqërimi ka qenë tej afatit maksimal deri në 10 orë, ose janë mbajtur të shoqëruar deri në afatin maksimal ndonëse, problematika për të cilin është kryer ky veprim, është sqaruar më herët; të shoqëruarit nuk trajtohen në mënyrë humane; nuk iu jepen procesverbalet e veprimeve të kryera me ta, etj.

Gjatë vitit 2020 janë bërë 5 rekomandime drejtuar organeve qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit për rastet që kemi provuar se ankesat e shtetasve kanë qenë të bazuara. Disa nga këto raste po i përmendim më poshtë:

- Shtetasja S.M. ngrinte shqetësimin se, në Pikën e Kalimit Kufitar (PKK) Kapshticë, punonjësi i policisë i ka komunikuar asaj se nga kontrolli në sistem rezultonte se ishte shpallur në kërkim nga Policia për falsifikim dokumentesh. Pas kësaj ajo është dërguar në Stacionin e Policisë Kufitare (SPK) Kapshticë dhe më pas është marrë nga punonjësit e Drejtorisë Vendore të Policisë (DVP) Tiranë. Ankuesja pretendonte se refuzimi i saj për të dalë jashtë shtetit është bërë në mënyrë të kundërligjshme, sepse ajo nuk kishte asnjë pengesë ligjore, nuk i ishte siguruar avokati i kërkuar dhe ishte mbajtur e shoqëruar tej afatit ligjor.
Në përfundim të shqyrtimit të kësaj ankese konstatuam se, refuzimi i bërë asaj për të dalë jashtë shtetit nga strukturat e Policisë Kufitare ishte konform akteve normative në fuqi. Ndërkohë vlerësuam se mbajtja e saj në gjendje shoqërimi për rreth 22 orë, përbënte shkelje të dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe të Procedurës standarde të punës.
Për sa më sipër i rekomanduam³⁸ Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit marrjen e masave të nevojshme për respektimin e kriterëve ligjore të shoqërimit të shtetasve në organet e Policisë së Shtetit si dhe të të drejtave të personave të shoqëruar; analizimin e shkeljeve ligjore të kryera dhe nxjerrjen e përgjegjësisë ligjore ndaj personave përgjegjës si dhe përgjithësimin e këtij rasti në strukturat e Policisë së Shtetit, me qëllim mos përsëritjen në të ardhmen të shkeljes. Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua.
- Ankesa e shtetasit B.B. me profesion gazetar dhe redaktor i Televizionit Fax News, i cili pretendonte se në orët e natës të datës 09.03.2020 ishte shoqëruar padrejtësisht në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë (DVP) Tiranë, ndërkohë që ishte duke kryer detyrën e tij si gazetar pranë Ministrisë së Brendshme ku po zhvillohej një tubim.
Në përfundim të hetimit konstatuam se shoqërimi i shtetasit B.B. në ambientet e DVP Tiranë nuk ishte bërë në përputhje me kriteret ligjore të parashikuara në aktet normative në fuqi. Ndërkohë në momentin e shoqërimit, shtetasi B. B. ka qenë duke ushtruar detyrën e tij si gazetar. Kjo ka sjellë si pasojë edhe pengimin e tij për të ushtruar profesionin e gazetarit, i cili është i garantuar me ligj. Gjithashtu rezultoi se nga punonjësit e policisë të cilët kanë kryer veprime me të shoqëruarin, nuk ishte përpiluar dhe dhënë ankuesit një kopje e

³⁸ Për më shumë informacion, drejtoheni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.
<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20zbatimin%20me%20korrekt%C3%ABsi%20t%C3%AB%20kriterëve%20ligjore%20lidhur%20me%20shoq%C3%ABrimin%20e%20shtetasve%20n%C3%AB%20ambientet%20e%20Policisë%20s%C3%AB%20Shtetit,%20si%20dhe%20p%C3%ABr%20respektimin%20e%20t%C3%AB%20drejtave%20t%C3%AB%20personave%20t%C3%AB%20shoq%C3%ABruar..pdf>

procesverbalit për veprimet e kryera me të, sikurse parashikohet në nenin 109/5 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” dhe në Kreun VII, pika 1, gërma “f” të Procedurës standarde të punës. Për këto arsye u rekomanduar³⁹ Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë marrjen e masave të nevojshme për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj punonjësve të policisë, efektivë të Forcës së Posaçme “Shqiponja” për shoqërimin në organin e policisë të shtetasit B. B. në kundërshtim me kriteret ligjore si dhe të specialistëve të Njësisë Rajonale të Antiterrorit Tiranë për mos zbatimin e detyrimit ligjor për përpilimin dhe dhënien e një kopjeje të procesverbalit për veprimet e kryera me personin e shoqëruar, sikurse parashikohet në nenin 109/5 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” dhe në Kreun e VII-të, pika 1, gërma “f” dhe Kreun e VIII-të, pikat a.3.3 dhe a.3.4 të Procedurës standarde të punës. Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua.

- Rasti i filluar me iniciativë, lidhur me shoqërimin e shtetasës M.M. nga banesa në gjykatë në datën 12.09.2020. Shtetësja M.M. ngriti para mediave disa pretendime ndaj strukturave të Policisë së Shtetit për shkeljen e procedurës standarde dhe të rregullave që normojnë veprimtarinë e këtij organi lidhur me shoqërimin e shtetasve në organet e drejtësisë. Sipas saj, punonjësit e policisë kur i kanë shkuar në banesë, nuk dispononin urdhërin e shoqërimit të saj të nxjerrë nga gjykata për këtë veprim që do të kryhej. Po ashtu, ajo është shprehur se gjatë shoqërimit të saj për në gjykatë në përbërjen e grupit të shoqërimit nuk kishte një punonjëse të policisë femër, e të njëjtës gjini me personin e shoqëruar, sikurse parashikohet në aktet normative përkatëse.

Pas shqyrtimit të këtij rasti, rezultuan të provuara shqetësimet e ngritura nga ana e saj. Për sa më sipër i rekomanduar⁴⁰ Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë dhe Komisarariatit të Policisë nr. 6 Tiranë, marrjen e masave të nevojshme për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj personave përgjegjës për vonesën në dërgimin e urdhërit të shoqërimit si dhe mos planizimin me shërbim në përbërje të grupit të shoqërimit të shtetasës M.M. nga banesa për në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në datën 12.09.2020 të një punonjësi të policisë të gjinisë femër, në zbatim të detyrimit të parashikuar në Kreun VII/5/h të Procedurës standarde të punës; marrjen e masave të menjëhershme për përgjithësimin e këtij rasti në strukturat vendore të Policisë së Shtetit me qëllim që shkelje të tilla të mos përsëriten në të ardhmen. Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua.

Pavarësisht punës së mirë të bërë në këtë drejtim, evidentojmë se disa nga rekomandimet tona janë të përsëritura, ndaj vlerësojmë se duhet të bëhen përpjekje edhe më të medha në vijimësi për analizimin dhe përgjithësimin e rasteve të tilla në të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit, në mënyrë që praktika të tilla mos të përsëriten në të ardhmen.

➤ *E drejta kushtetuese e shtetasve për informim*

E drejta e informimit, e cila është një nga të drejtat themelore të njeriut nuk është respektuar gjithnjë nga organet e Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit. Nga shqyrtimi i disa rasteve të filluara me iniciativë kemi konstatuar se këto organe gjatë periudhës së pandemisë jo në çdo rast kanë informuar publikun për masat e marra në këtë kuadër me qëllim ofrimin e

³⁹ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20zbatimin%20me%20ko rrekt%C3%ABsi%20t%C3%AB%20rasteve%20dhe%20kriterave%20ligjore%20t%C3%AB%20shoq%C3%ABrimit%20t%C3%AB%20shtetasve%20n%C3%AB%20ambientet%20e%20organeve%20t%C3%AB%20Policis%C3%AB%20s%C3%AB%20Shtetit%20dhe%20trajt.pdf>

⁴⁰ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20respektimin%20e%20rregullave%20dhe%20t%C3%AB%20t%C3%AB%20drejtave%20t%C3%AB%20shtetasve%20gjat%C3%AB%20shoq%C3%ABrimit%20t%C3%AB%20tyre%20n%C3%AB%20ambientet%20e%20organeve%20t%C3%AB%20Policis%C3%AB%20s%C3%AB%20Shtetit%20apo%20n%C3%AB%20ins.pdf>

shërbimit të nevojshëm, informacionin e duhur dhe krijimin e lehtësive në veprimtarinë e tyre të përditëshme. Lidhur me këtë të drejtë po referojmë rastet e mëposhtme.

Rasti i filluar me iniciativë pas miratimit të Aktit normativ nr. 3, datë 15.3.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar, Urdhërit nr. 168/1, datë 15.03.2020 “Për kufizimin e lëvizjeve brenda vendit”, si dhe Urdhërit nr. 193, datë 20.03.2020, “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilët krijuan disa shqetësime në veçanti për drejtuesit e mjeteve, të cilët donin që të lëviznin me mjetet e tyre për probleme nga më të ndryshme.

Nga shqyrtimi i këtij rasti konstatuam se deri në datën 26.03.2020, dy urdhërat e cituar më sipër nuk ishin botuar në Fletoren Zyrtare. Mos botimi i tyre në Fletoren Zyrtare ishte në kundërshtim të plotë dhe të hapur me nenet 116/1 dhe 117/1 të Kushtetutës. Ndërkohë konstatuam se këto urdhëra nuk gjendeshin të pasqyruara as në faqen zyrtare të këtij institucioni.

Mungesa e informacionit të shtetasve lidhur me përmbajtjen e tyre dhe procedurën e aplikimit drejtuar Policisë Rrugore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, kishte sjellë si pasojë që pjesa më e madhe e aplikuesve/kërkuesve jo vetëm që nuk kishin marrë autorizimin e kërkuar për të lëvizur me mjetet e tyre, por nuk kishin marrë asnjë lloj përgjigje nga kjo strukturë. Gjithashtu nga verifikimet rezultoi se për shkak të fluksit të madh të telefonatave, dy numrat e telefonit të Policisë së Shtetit të vëna në dispozicion të publikut për të marrë informacion lidhur me këtë problem nuk ishin të disponueshëm.

Ndërkohë në ditët e para të zbatimit të këtyre akteve u krijuan edhe disa shqetësime shtetasve shqiptarë që po ktheheshin nga Greqia dhe Maqedonia e Veriut në Shqipëri, nëpërmjet pikave të kalimit kufitar Kakavijë, Kapshticë dhe Qafë Thanë, sepse pas hyrjes në territorin e vendit tonë, gjendeshin në vështirësi për të lëvizur drejt vendbanimeve përkatëse për shkak të mungesës së mjeteve të transportit.

Për këto arsye i rekomandua⁴¹ Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit si më poshtë:

- Marrjen e masave të nevojshme për botimin e menjëhershëm në Fletoren Zyrtare të dy urdhërave të cituar më lartë, nxjerrë nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- Marrjen e masave të menjëhershme nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për pasqyrimin në faqen zyrtare të akteve nënligjore të nxjerra për masat e marra në zbatim të ligjit nr. 15/2016, të ndryshuar dhe të akteve normative të Këshillit të Ministrave, në kuadër të marrjes së masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.
- Marrjen e masave të nevojshme për decentralizimin e kompetencës për dhënien e autorizimeve për lëvizjen e mjeteve, ose shtimin e personelit në Drejtorinë e Policisë Rrugore që ofron këtë shërbim apo gjetjen e mënyrave alternative të organizimit të punës.
- Marrjen e masave të nevojshme për lejimin apo ofrimin e shërbimit të transportit në të gjitha pikat e kalimit kufitar, veçanërisht me Greqinë dhe Maqedoninë e Veriut, për të bërë të mundur lëvizjen dhe shpërndarjen në vendbanimet përkatëse, të shtetasve shqiptarë të ardhur nga këto vende përgjatë kësaj periudhe kohore.

Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit u informuam se rekomandimet ishin mirëpritur dhe marrë në konsideratë.

⁴¹ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.
<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20lidhur%20me%20aksesin%20shtetasve%20ne%20aktet%20normative%20date%2026%20mars%20seksioni%20i%20vecante.pdf>.

Një rast që morri vëmendje gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore, i regjistruar me iniciativë pas bërjes publike në media, është ai lidhur me bllokimin në tokën neutrale në Pikën e Kalimit Kufitar Kakavijë të 21 shtetasve shqiptarë në datën 14.04.2020, në tentativë për të hyrë në Shqipëri. Sipas mediave ata nuk kishin autorizime për kalim të kufirit nga autoritetet kompetente, si përfaqësitë konsullore apo ambasada shqiptare në Greqi. Autoritetet shqiptare kishin deklaruar se, shtetasit shqiptarë që janë rezident të rregullt në Greqi apo në shtetet e tjera nuk do të lejoheshin të hynin në territorin e vendit tonë dhe do të ktheheshin pas. Ndërsa me shtetasit shqiptarë që kishin arsye për të hyrë në Republikën e Shqipërisë po negociohej që ata të karantinoreshin në hotelet e Gjirokastrës për 14 ditë dhe pritej hyrja e tyre në territorin shqiptar.

Pas kërkesës tonë, nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit u informuam se strukturat e Policisë Kufitare kishin vepruar në zbatim të Urdhërit të Përbashkët nr. 240, datë 07.04.2020, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Brendshëm, "Për vetëkarantinimin e shtetasve shqiptarë të cilët duan të futen në territorin e Republikës së Shqipërisë nga të gjitha pikat kufitare tokësore".

Gjatë shqyrtimit të këtij rasti konstatuam se Urdhëri i Përbashkët nr. 240, datë 07.04.2020, nuk ishte botuar në Fletoren Zyrtare sikurse parashikohet në nenin 117/1 të Kushtetutës dhe ndërkohë nuk gjendej i pasqyruar as në faqet zyrtare të këtyre institucioneve, duke sjellë si pasojë mungesën e aksesit të shtetasve për të marrë një informacion të plotë dhe të saktë rreth masave të marra dhe kufizimeve të bëra nga autoritetet përgjegjëse në vend.

Për sa më sipër me shkresën e datës 30.04.2020 drejtuar Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe Ministrit të Brendshëm u rekomanduar⁴²:

- Marrjen e masave të nevojshme për botimin e menjëhershëm në Fletoren Zyrtare të Urdhërit të Përbashkët nr. 240, datë 07.04.2020, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Brendshëm "Për vetëkarantinimin e shtetasve shqiptarë të cilët duan të futen në territorin e Republikës së Shqipërisë nga të gjitha Pikat Kufitare tokësore".
- Marrjen e masave për të garantuar të drejtën e ankimit të shtetasve për masat e karantinimit, e përfshirja e kësaj të drejte në aktet që komunikojnë masa detyruese të tilla.
- Marrjen e masave të menjëhershme nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe Ministria e Brendshme për pasqyrimin në faqet zyrtare respektive të aktit nënligjor të cituar më sipër, si dhe për të gjitha masat e marra në zbatim të ligjit nr. 15/2016, të ndryshuar, apo të akteve të tjera normative të nxjerra prej tyre, në kuadër të marrjes së masave të veçanta administrative, gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.

Ky rekomandim u mirëprit, u pranua dhe zbatua nga organet kompetente, të cilave iu adresua.

Sa i përket të drejtës për informim, një çështje tjetër e filluar me iniciativë është ajo që lidhet me situatën e krijuar në rastet e bllokimit të rrugëve të kalimit nga Policia e Shtetit pa njoftuar më parë qytetarët gjatë kryerjes së procedurave nga IKMT-së dhe IMT Tiranë për prishjen e objekteve të ndryshme të ndërtuara pa leje apo për shkak të zbatimit të projekteve të ndryshme nga organet shtetërore.

Në përfundim të hetimit administrativ vlerësuam se, rastet e bllokimit të rrugëve nga Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake pa njoftim paraprak të qytetarëve, sillnin si pasojë cenimin e

⁴² Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.
https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20marrjen%20e%20masave%20p%C3%ABr%20botimin%20e%20menj%C3%ABhersh%C3%ABm%20n%C3%AB%20Fletoren%20Zyrtare%20t%C3%AB%20Urdhrit%20t%C3%AB%20P%C3%ABr%20bashk%C3%ABt%20nr.%20240,%20dat%C3%AB%2007.04.2020_Sfm6EJV.pdf.

lëvizjes së shtetasve dhe krijimin e radhëve të gjata të automjeteve që shkonte edhe deri në disa kilometra. Kjo situatë shkaktonte stres dhe irritim të drejtuesve të mjeteve dhe të qytetarëve të ndryshëm që udhëtonin me mjetet e transportit publik apo privat për shkak të vonesës për të mbërritur në destinacionin e planifikuar për arsye pune, shëndetësore, etj. Ky qëndrim vinte në kundërshtim me nenin 15/2 të Kushtetutës dhe nenin 76/1 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.

Për sa më sipër, i rekomanduar⁴³ Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë dhe Policisë Bashkiake Tiranë, marrjen e masave të nevojshme për njoftimin paraprak të qytetarëve në rastet e bllokimit të rrugëve për arsye të prishjes së objekteve të ndryshme nga IMT dhe IKMT, të organizimit të tubimeve nga subjekte të ndryshme politike ose grupime qytetarësh, të rikonstruksionit të tyre apo të kryerjes së aktiviteteve social-kulturore, etj. Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua.

➤ Të drejtat ligjore e punonjësve të policisë dhe e familjarëve të tyre

Gjatë vitit 2020, në fokusin e institucionit të Avokatit të Popullit ka qenë edhe mbrojtja dhe respektimi i të drejtave ligjore të punonjësve të Policisë së Shtetit. Në veprimtarinë tonë jemi udhëhequr nga parimi kushtetues i barazisë para ligjit dhe në zbatim të tij kemi vlerësuar se të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të çdo shtetasi duhet të respektohen nga organet e administratës publike. Në vijim të kësaj kemi çmuar se është e domosdoshme edhe mbrojtja e të drejtave të vetë punonjësve të Policisë së Shtetit kur ato u shkelen apo cenohen nga organet e tyre eprore dhe organet e tjera të administratës publike. Çmohet se përmbushja e detyrimeve të shtetit në cilësinë e punëdhënësit për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtës kushtetuese të mbrojtjes shoqërore në punë, të garantuar nga neni 49 i Kushtetutës dhe i të drejtave ligjore të punonjësve të Policisë së Shtetit të garantuara nga ligji organik, Kodi i Punës dhe aktet nënligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës të kësaj strukture ndikon drejtpërdrejtë në edukimin, motivimin dhe përkushtimin e tyre në kryerjen e misionit ligjor të Policisë së Shtetit, pjesë e pandarë e të cilit është edhe respektimi i të drejtave të shtetasve. Lidhur me këtë problematikë po referojmë rastet e mëposhtme.

Ankesa e shtetasit S.B., punonjës i Policisë së Shtetit me gradën “Drejtues”, të cilit i është kërkuar të ulej në gradë për mungesë të vendeve të lira në pozicionin me gradën që ai gëzonte. Nga ana e tij është pranuar kjo kërkesë, por pas uljes në gradë dhe në detyrë, ka konstatuar se ishin hapur vende të lira për gradën “Drejtues”, për të cilët ishin organizuar konkurse dhe se kishte disa punonjës policie që nuk kishin gradën që i përkiste funksionit organik me gradën “Drejtues”.

Meqënëse ai nuk po e merrte emërimin sipas përcaktimeve ligjore ka bërë kërkesë padi drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Pas përfundimit të gjykimit të kësaj çështjeje, është vendosur “Detyrimi i palës së paditur për t’i dhënë paditësit gradën “Drejtues” dhe emërimin në një funksion korrespondues të gradës “Drejtues”. Ky vendim përbën titull ekzekutiv, menjëherë të ekzekutueshëm nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor”.

Ankuesi ka bërë disa herë kërkesa drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Ministrit të Brendshëm dhe meqënëse prej tyre nuk pati asnjë reagim, iu drejtua me kërkesë Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor, por edhe pas kësaj vendimi gjyqësor nuk u ekzekutua. Pas shqyrtimit të kësaj ankese konstatuam se nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ishte shkelur neni 142/3 i Kushtetutës dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe i

⁴³ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.
<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20per%20njoftim%20paraprak%20ne%20rast%20te%20bllokimit%20te%20rrugeve%20nga%20Policia%20e%20Shtetit%20.pdf>.

rekomanduar⁴⁴ këtij institucioni, marrjen e masave të nevojshme për zbatimin e menjëhershëm të vendimit nr. 5356, datë 14.02.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë në favor të shtetasit S.M. duke i dhënë gradën “Drejtues” dhe emërimin e tij në një funksion korespondues të gradës “Drejtues”.

Meqënëse rekomandimi nuk u zbatua, i drejtuam rekomandim⁴⁵ Ministrit të Brendshëm që me cilësinë e organit epror të merrte masat e nevojshme për ekzekutimin e vendimit të gjykatës. Ndonëse afati ligjor për kthimin e përgjigjes ka kaluar me disa muaj dhe kërkesave të përsëritura, ende nuk na ka ardhur përgjigje.

Një rast tjetër i trajtuar nga ana jonë është ankesa e shtetasës E. M., e veja e Komisar G. M., i cili është vlarë në krye të detyrës në datën 06.08.2003. Ajo pretendonte se kishte 8 vjet, që po përballej me padrejtësi në mënyrën e trajtimit si familje e punonjësit të Policisë së Shtetit të rënë në krye të detyrës. Sipas saj, trajtimi i diferencuar ishte diskriminues dhe bëhej nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) Tiranë dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Gjithashtu ajo ngrinte edhe shqetësimin për ndryshimin e masës së pensionit familjar të saj si rrjedhojë e ndryshimit të bazës ligjore të trajtimit, duke ia ulur atë.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj ankese konstatuam se ankueses i ishte shkelur një e drejtë e ligjshme sepse i ishte ulur masa e përfitimit të pensionit familjar mujor si dhe në trajtimin e saj ishte cenuar edhe parimi i sigurisë juridike dhe i barazisë para ligjit të garantuara nga nenet 4/1⁴⁶ dhe 18/1⁴⁷ i Kushtetutës. Me qëllim rivendosjen në vend të së drejtës të shkelur, i rekomanduar⁴⁸ DRSSH Tiranë marrjen e masave të nevojshme për trajtimin e ankueses me pension familjar në bazë të Dekretit nr. 758, datë 01.02.1994 "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut" si dhe dhënien e diferencës të shumave monetare të mbajtura në mënyrë të padrejtë për shkak të ndryshimit të bazës ligjore të trajtimit të saj me pension familjar.

DRSSH Tiranë na informoi se nuk e kishte pranuar rekomandimin. Ndodhur në këto rrethana, iu drejtuam me rekomandim Institutit të Sigurimeve Shoqërore Tiranë me cilësinë e organit epror, por edhe ky institucion nuk e pranoi rekomandimin.

➤ *Mbrojtja e të drejtave të shtetasve të huaj që gjenden në territorin e Republikës së Shqipërisë*

Sipas nenit 2 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për mbrojtjen e të drejtave të të huajve, të cilët janë ose jo rezidentë të rregullt në Shqipëri, të refugjatëve, azilkërkuesve si dhe të personave pa shtetësi që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Bazuar në këtë dispozitë ligjore si dhe në aktet normative ndërkombëtare të njohura dhe ratifikuara nga shteti ynë, institucioni i Avokatit të Popullit ka marrë në shqyrtim edhe raste me iniciativë apo ankesa të bëra nga shtetasit e huaj, të cilët kanë pasur pretendime për shkeljen e të drejtave të tyre ligjore nga organet e administratës publike shqiptare.

Një rast i tillë i shqyrtuar me iniciativë nga institucioni ynë është ai që lidhet me dëbimin e shtetasit turk H.Ç. drejt Turqisë nga autoritetet e Policisë së Shtetit. Shtetasi H.Ç., i cili kishte

⁴⁴ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.
[https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandohet%20marrja%20e%20masave%20te%20nevojshme%20per%20zbatimin%20e%20vendimit%20nr%205356%20\(1\).pdf](https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandohet%20marrja%20e%20masave%20te%20nevojshme%20per%20zbatimin%20e%20vendimit%20nr%205356%20(1).pdf).

⁴⁵ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.
[https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20per%20marrjen%20e%20masave%20te%20nevojshme%20per%20zbatimin%20e%20vendimit%20nr%205356%20\(1\).pdf](https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20per%20marrjen%20e%20masave%20te%20nevojshme%20per%20zbatimin%20e%20vendimit%20nr%205356%20(1).pdf).

⁴⁶ E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit.

⁴⁷ Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.

⁴⁸ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.

qenë i paraburgosur për afër 6 muaj në IEVP “Mine Peza”, tërhoqi vëmendjen e mediave kombëtare dhe më gjerë, por edhe vëmendjen e europarlamentarëve të ndryshëm⁴⁹.

Nga hetimi administrativ i këtij rasti dhe dokumentacioni i administruar konstatuam se nga autoritetet shtetërore shqiptare ishin kryer një sërë shkeljesh të të drejtave themelore të njeriut, të njohura nga legjislacioni i brendshëm dhe aktet ndërkombëtare si:

- mosmarrja, mosadministrimi i kërkesës për azil të shtetasit H.Ç. dhe mosrespektimi i parimit të moskthimit në vendin e origjinës;
- nxjerrja e urdhërit të dëbimit në kundërshtim me ligjin “Për të huajt”, si për sa i përket ekzistencës së shkakut të dëbimit, por edhe mënyrës së ekzekutimit të tij;
- mosrespektimi i procedurave dhe afateve ligjore për mënyrën e ekzekutimit të këtij dëbimi;
- mosdhënia e mundësisë për ushtrimin e të drejtës së ankimit ndaj urdhrit të dëbimit.

Për këto arsye, i rekomandua⁵⁰ Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit si më poshtë:

- Analizimin me përparësi të procedurave të ndjekura dhe dokumentacionit të hartuar nga Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë për rastin e dëbimit të shtetasit turk H.Ç., duke nxjerrë përgjegjësitë ligjore dhe marrë masat administrative ndaj personave përgjegjës.
- Marrjen e masave për hartimin e një udhëzuesi që të garantojë respektimin e të drejtave të shtetasve të huaj të përcaktuara në aktet ndërkombëtare dhe legjislacionin e brendshëm të Republikës së Shqipërisë, si dhe mospërsëritjen në të ardhmen të këtyre rasteve me shkelje flagrante.
- Marrjen e masave për sigurimin e një bashkëpunimi më të mirë të të gjitha strukturave të Policisë së Shtetit me institucionin e Avokatit të Popullit, duke shmangur burokratitë dhe vonesat e pajustificuara gjatë hetimeve administrative, për përcjelljen e materialeve dhe dokumenteve hetimore.

Theksojmë se zbatimi i këtij rekomandimi nuk është pranuar, por është refuzuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

3.4 Parandalimi i dhunës dhe torturës⁵¹

Gjatë vitit 2020, për shkak të situatës së pandemisë të shkaktuar nga COVID-19, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) ka kryer *48 inspektime periodike (fizike dhe online)*, kontrolle me tematikë të veçantë si dhe vizita inspektuese në të gjitha institucionet e tjera të privimit të lirisë. I gjithë aktiviteti i mësipërm është shoqëruar me *54 rekomandime* dhe me një korrespondencë zyrtare të dëdurr për të sqaruar shumë detaje dhe fenomene të konstatuara gjatë inspektimeve. Veç inspektimeve, MKPT-ja ka trajtuar edhe *40 ankesa individuale* të shtetasve shqiptarë dhe të huaj që ju janë shkelur të drejtat në mjediset e komisariateve të policisë, si dhe të burgosurve të cilët vuajnë dënimin në IEVP.

Qëllimi i këtyre vizitave dhe inspektimeve ishte vlerësimi i progresit të autoriteteve kompetente në zbatimin e rekomandimeve të MKPT-së, si dhe respektimi i të drejtave të të burgosurve dhe

⁴⁹ Deklaratat e eurodeputetëve Ramona Strugariu dhe Marius Botoș, anëtarë të Delegacionit të BE-së për marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, përveç shprehjes së shqetësimit lidhur me respektimin e ligjit në rastin e dëbimit të shtetasit turk, bëjnë prezent se këto veprime mund të cenojnë perspektivën evropiane të vendit.
<https://exit.al/wp-content/uploads/2020/01/Letter-Harun-%C3%87elik.pdf>.

⁵⁰ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.
<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20per%20policine.pdf>.

⁵¹ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i MKPT-së në institucionin e Avokatit të Popullit.

personave që ju privohet liria, të drejta të cilat garantohen nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë si dhe nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Përveç kësaj, nga ana e MKPT-së është mbajtur në konsideratë edhe veprimtaria promovuese e të drejtave të njeriut në bashkëpunim me Administratën e Burgjeve dhe Drejtorinë e Policisë së Shtetit.

Disa nga gjetjet e inspektimeve në institucionet penitenciare pasqyrohen si vijon:

- Kushtet materiale tejet degraduese dhe pamundësinë e rikonstruktimit të mjediseve në regjimet e brendshme, të cilat bëjnë të pamundur garantimin e të drejtave të të burgosurve, si në IEVP Zahari Krujë, IEVP Lezhë, IEVP Sarandë, IEVP Bëç, Tepelenë, IEVP Kukës, të sanksionuara në aktet ndërkombëtare dhe legjislacionin kombëtar në fuqi. Meqenëse këto gjetje vazhdojnë të konstatohen në mënyrë të përsëritur, madje me kushte edhe më të degraduara si rrjedhojë e mungesës së investimeve dhe amortizimit, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Ministrin të Drejtësisë mbylljen e menjëhershme të këtyre institucioneve dhe transferimin e personave në institucione të tjera penitenciare.
- *Infrastruktura ndërtimeve e godinave të banimit dhe ambienteve të përbashkëta*, paraqesin probleme të amortizimit, lagështirës, furnizimit me ndërprerje të energjisë elektrike dhe ujit, sigurimit të ndriçimit natyral dhe të ajrosjes së plotë të qelive, pranisë së insekteve, kushteve jashtë standardeve të tualeteve, kuzhinave, dusheve, ambienteve të ajrimit, dhomave të izolimit, etj. Institucionet me problematika emergjente infrastrukturore paraqiten IEVP Zahari, Krujë, IEVP Durrës, IEVP Rrogozhinë, IEVP Tepelenë, IEVP Shënkoll, Lezhë. Përgjithësisht në IEVP-të e reja dhe ato të rikonstruara të cilat praktikisht kanë krijuar dy standarde në sistemin penenciar shqiptar.
- *Mbipopullimi, megjithëse ka pësuar një rënie vitet e fundit* në disa nga IEVP-të si në IEVP 302, IEVP 313, Jordan Misja, Tiranë, si dhe IEVP Durrës, ky fenomen vazhdon të jetë prezent. Gjatë vizitave, grupet e inspektimit kanë gjetur 4 (katër) deri në 6 (gjashtë) persona të akomoduar në një qeli, duke mos respektuar standardin 4m² për çdo të burgosur. Situata e mbipopullimit është më e rëndë në institucionet me kushtet më të këqija infrastrukturore e konkretisht në Zahari.
- *Mosbatim i marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë për ngritjen e një institucioni të posaçëm mjekësor*, të parashikuar në ligjin Nr. 44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”, me qëllim strehimin dhe trajtimin e personave që kanë marrë nga gjykata masën “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm”. Investimi i filluar gjatë vitit 2019 në përshtatjen e dy ndërtesave të IEVP Lezhë, ende nuk ka përfunduar, duke shkelur afatin e përcaktuar në kontratë dhe për më tepër nuk dihen arsyet e ndërprerjes së punimeve. Trajtimi i kësaj kategorie vazhdon të kryhet në IEVP Zahari-Krujë, i cili është në kushte materiale degraduese, me mungesa në organik të një mjeku psikiatër dhe ku akseset për konsulta pranë spitaleve psikiatrike rajonale paraqet vështirësi. Gjithashtu, trajtimi në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve për rastet me episode akute, vijon të mbetet i paligjshëm, gjë e cila vazhdon të reflektohet në raportet kombëtare, ndërkombëtare dhe në konferencat rajonale por edhe në vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.
- *Mungesa e mjekëve* në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale vijon të mbetet një problematikë shqetësuese e sistemit tonë penenciar. Avokati i Popullit gjatë vitit 2020, në IEVP-të e inspektuara në rang vendi ka rekomanduar marrjen e masave për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë sipas parashikimeve në organikën e institucionit. Më problematike paraqitet situata në IEVP Zahari, IEVP 302, IEVP Tepelenë, IEVP Kukës, IEVP Korçë, IEVP Durrës, IEVP Fier, IEVP Peqin, situatë e cila është rënduar më shumë në kohë pandemie.
- Gjatë vitit 2020 ka patur *mangësi të theksuara në ofrimin e mundësisë për arsim dhe aktivitete social-kulturore* për të burgosurit, për shkak të kufizimeve si pasojë e pandemisë COVID-19.

- *Shpërblimet për punën e kryer në të gjitha institucionet*, vazhdon të kryhet me ditë ulje nga dënimi. Po në këtë kuadër, për punën që kryenin të paraburgosurit në këto institucione, nuk paguhet vlera përkatëse e sigurimeve shoqërore, gjë që sjell mos vlerësimin e kohës së punës në institucion si kohë vjetërsie në punë, si dhe mohimin e një të drejte, atë të përfitimit të pensionit të pleqërisë.
- *Stafi i kujdesit shëndetësor në burgje ka nevojë për krijimin e ambienteve të përshtatshme për kryerjen e vizitave mjekësore*, pasi përgjithësisht janë të pa pajisura me mjetet e nevojshme dhe materiale ndihmëse.
- *Vonesa dhe mangësi paraqiten në pajisjen e të dënuarve/paraburgosurve me librezë shëndetësore* apo me të dhënat elektronike në sistemin e sigurimeve shëndetësore në shumicën e I EVP-ve, me pasojë moszbatimin e skemës së rimbursimit të ilaçeve dhe probleme në furnizimin me medikamente.
- *Vështirësi në realizimin e konsultave, ekzaminimeve dhe analizave laboratorike* specifike, vëreheshin ende në disa prej I EVP-ve, për arsye të lidhura me mungesën e mjekëve me kohë të plotë në organikë apo mungesën e autoambulancave, si dhe rezistencën e spitaleve rajonale për të trajtuar personat për shkak të mungesës së kushteve të sigurisë në to, etj.
- *Probleme të ofrimit të shërbimit stomatologjik në I EVP-të* që vinin si rrjedhojë e mungesave në aparatura dhe materiale ndihmëse. Shërbimet dentare, përveç ekstrakcioneve, kryheshin me vështirësi në poliambulancat publike apo në klinikat private me shpenzimet e vetë të dënuarve.
- *Sistemet qendrore të ngrohjes*, pothuajse në të gjitha I EVP-të ku ishin të instaluar, nuk funksiononin si rezultat i defekteve teknike ose të mungesës së karburantit. Në shumicën e rasteve të dënuarit/paraburgosurit nuk i sigurohet ngohja sipas parashikimeve ligjore.
- *Mungesat në furnizimin me produktet bazë të higjienës personale* (pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo, etj.) dhe të detergjenteve të nevojshme për të pastruar qelitë, si dhe mungesat në uniforma dhe doreza gjatë shpërndarjes së ushqimit u konstatuan në shumicën e I EVP-ve.
- *Mungesa e dollapëve, rafte të rrobave*. Rrobat mbaheshin nga të dënuarit/paraburgosurit në qese plastike ose në thasë, kryesisht poshtë shtretërve.
- *Cilësia dhe larmia e ushqimit* mbetej problem shqetësues thuajse në të gjitha I EVP-të.

Gjatë inspektimeve të kryera nga MKPT-ja për vitin 2020 në I EVP, ankesat më të shumta të të burgosurve kanë patur për objekt cilësinë e ulët të gatimit, mungesën e larmisë së ushqimit, si dhe ndryshimin e kuotës ditore. Theksojmë se, pavarësisht rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit, që prej vitit 2006 e në vazhdim, urdhëri i përbashkët i Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ende nuk është rishikuar. Kjo situatë ka sjellë për pasojë moskonsumimin e vakteve ushqimore nga të burgosurit dhe njëkohësisht ka rritur koston ekonomike të familjarëve të tyre, të cilët detyrohen t'u dërgojnë ushqime plotësuese.

Për sa më sipër, në përgjigje të rekomandimeve dhe kërkesave të institucionit tonë drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe DPB rezulton se janë ngritur grupet e punës të përbashkëta për hartimin e akteve nënligjore të cilat lindin si detyrim nga zbatimi i ligjit nr. 81/2020. Referuar afateve ligjore të përcaktuara në këtë ligj këto akte nuk janë miratuar ende edhe pse kanë kaluar afatet ligjore për miratimin e tyre.

MKPT-ja u ka dërguar autoriteteve kompetente rekomandimet⁵² me problematikat e vërejtura të cilat nevojitet të adresohen me vendimmarrje nga organet e larta shtetërore, pasi në shumicën e rasteve ato janë rezultat i ashpërsimit të politikës penale, mungesës së fondeve dhe mungesës së nxjerrjes së akteve nënligjore për të gjeneruar përmirësime të dukshme të sistemit, si në formë ashtu dhe në përmbajtje.

⁵² Rekomandimet gjenden në linkun: <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/categories/mechanisms-against-torture>.

Vlen të theksojmë se, nisur nga gjetjet e inspektimeve të kryera gjatë vitit 2020 në institucionet e sistemit penitenciar është evident fakti se Shqipëria ka bërë përmirësime lidhur me mbipopullimin, por mbetet shqetësues numri i lartë i të paraburgosurve ose të dënuarve për numër popullsie, gjë e cila bën të domosdoshme një vlerësim më të kujdesshëm të politikave penale.

Avokati i Popullit në rolin e MKPT-së, në kuadër të trajtimit dhe shqyrtimit të ankesave drejtuar institucionit tonë, në zbatim të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ka kryer një *inspektim tematik në ambientet e regjimit të posaçëm të ushtrimit të të drejtave të burgosurve të sigurisë së lartë (41 Biss) në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) 313 “Jordan Misja” dhe IEVP Peqin*.

Transferimi i të burgosurve në ambientet e regjimit të posaçëm të sigurisë së lartë (41 Biss), ishte një eksperiencë e re në sistemin penitenciar, bazuar në kërkesat e nenit 17/1 të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” dhe Rregulloren e Regjimit të Posaçëm të Sigurisë së Lartë në IEVP, miratuar me urdhër nr.380, datë 19.07.2019 të Ministrit të Drejtësisë. Në zbatim të tyre, Ministri i Drejtësisë miratoi urdhërat respektivë datë 01.08.2020, për kalimin në këtë regjim të 7(shtatë) të burgosurish, të dyshuar apo të dënuar me vendim të formës së prerë për veprat penale të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore, për këtë qëllim.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e kushteve materiale për të burgosurit në kuadër të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore, si dhe trajtimin me dinjitet të të burgosurve dhe të dënuarve me burgim, sipas standardeve të përcaktuara në aktet kombëtare dhe kryesisht në aktet ndërkombëtare, të miratuara për këtë qëllim.

Gjithashtu, grupi i inspektimit verifikoi edhe pretendimet e ngritura në ankesën drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit nga Av. V. M, mbrojtësi dhe përfaqësuesi ligjor i të paraburgosurit E. Sh, si dhe ankesat e të dënuarve A. A dhe G. B, të cilët aktualisht vuajnë dënimin në regjimin e posaçëm të sigurisë së lartë, përkatësisht në IEVP 313 “Jordan Misja” dhe IEVP Peqin.

Vlen të theksohet se institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar ato ankesa përsa ato bëjnë pjesë në mandatin kushtetues e ligjor të tij e që kanë të bëjnë me kushtet në të cilat këta persona po vuajnë dënimin. Vëmendje të veçantë i kemi kushtuar faktit nëse kushtet garantojnë standardin minimal dhe të paprekshëm të trajtimit njerëzor e me dinjitet të të burgosurve, edhe nën masat e jashtëzakoshme të marra në kushtet e rrezikut të sigurisë publike që justifikon këto masa. Në të njëjtën kohë, Avokati i Popullit ka konstatuar se *nuk është në mandatin e institucionit vlerësimi nëse një i burgosur i caktuar duhet apo jo të jetë pjesë e regjimit të posaçëm, dhe as vlerësimi nëse ky regjim duhet të përfshijë vetëm personat e dënuar me vendim të formës së prerë apo edhe të paraburgosurit*.

Krahas masave të marra nga autoritetet shtetërore të ngarkuara me ligj, si për hartimin dhe miratimin e rregullores për mënyrën e funksionimit të seksioneve të regjimit të posaçëm, nxjerrjen e urdhërave nga Ministri i Drejtësisë mbi kërkesën e arsyetuar të Drejtuesit të Prokurorisë të Posaçme për transferimin e 7 (shtatë) të burgosurve nga regjimi i sigurisë së lartë për në regjimin e posaçëm të sigurisë së lartë, përzgjedhjen dhe trajnimin e stafeve të sigurisë që kryenin shërbim në këto seksione, informimin e të burgosurve lidhur me të drejtat dhe detyrimet gjatë periudhës së qëndrimit në regjimin e posaçëm, si dhe krijimin e disa kushteve materiale për jetesë normale në dhomat e banimit, *gjatë inspektimit u konstatuan një sërë mangësish* në këto seksione që kishin të bënin me organizimin e jetës dhe veprimtarisë së

përditshme të të burgosurve në regjimin e posaçëm dhe një trajtim në disa aspekte, jo dinjitoz i tyre, që bie ndesh me standardet e përcaktuara në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut⁵³ dhe Lirive Themelore, Rregullat Evropiane të Burgjeve të miratuara nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës në 11 Janar 2006, Standardet minimale të Rregullave për Trajtimin e të Burgosurve (Nelson Mandela Rules) të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 17 Dhjetor 2015, si dhe rekomandimet e CPT-së gjatë vizitave të kryera në Itali.

Vendimet e GJEDNJ⁵⁴ në shqyrtimin e disa kërkesave nga të burgosur italianë, të dënuar apo të akuzuar për veprimtari mafioze dhe të mbajtur në Regjimin e Posaçëm, përbëjnë gjithashtu një standard për interpretimin dhe zbatimin e këtyre masave në pajtim me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut për organet shtetërore dhe ato ligjzbatuese të Shqipërisë. Ky standard duhet të shtrihet si në procesin e hartimit e miratimit të rregullave, por edhe në zbatimin në praktikë të rregullave që rregullojnë veprimtarinë e këtyre seksioneve, me qëllim që masat e marra nga ana e tyre të mos bien ndesh me kërkesat e neneve të KEDNJ për të drejtat dhe liritë e të burgosurve, pavarësisht kufizimeve të të drejtave të tyre gjatë qëndrimit për një periudhë prej një viti (me të drejtë ripërsëritjeje⁵⁵) në këtë regjim.

Në kushtet kur legjislatori shqiptar ka parashikuar se, kundër vendimit të Ministrit të Drejtësisë, për vendosjen ose zgjatjen e regjimit të posaçëm, i burgosuri nëpërmjet mbrojtësit të tij ligjor, brenda 20 ditëve duhet ta ankimojë në Gjykatën e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, vlerësimi i përputhshmërisë apo përshtatshmërisë së këtyre masave do vlerësohet prej asaj gjykatë. Ndërkohë, kushtet fizike dhe garantimi e respektimi i të drejtave të parashikuara në nenin 17 të ligjit nr.81/2020, për të burgosurit e vendosur në regjimin e posaçëm, *monitorohet nga Avokati i Popullit* për të garantuar që këto kushte apo një pjesë e tyre nuk përbëjnë trajtim çnjerëzor dhe denigrues për ta.

Gjithashtu, në ecurinë e këtyre masave në vende të tjera (rasti i Republikës së Italisë), kushtet e përgjithshme të të burgosurve nën këtë regjim kanë qenë më të mira se sa ato të të burgosurve të tjerë, për shkak se ata kanë qenë të detyruar t'u nënshtrohen periudhave të gjata të izolimit apo mospërfshirjes në aktivitetet sociale me të burgosur të tjerë jashtë këtij regjimi⁵⁶.

Seksionet e regjimit të posaçëm të krijuara në IEVP 313 dhe IEVP Peqin, ishin të miratuara me urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr.381, datë 19.07.2019 “Për disa ndryshime në urdhërin nr.8927/1 prot., datë 27.09.2018 të Ministrit të Drejtësisë “Për klasifikimin e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale”. Infrastruktura e ndërtimit të tyre nuk lejonte asnjë lidhje apo mundësi kontakti me seksionet e tjera.

⁵³ Ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr.9137, datë 31.07.1996.

⁵⁴ Në referim të çështjeve të trajtuara nga GJEDNJ:

a. Marcelo Viola kundër Italisë:

<https://www.jurist.org/commentary/wp-content/uploads/sites/3/2019/10/Judgment-Marcello-Viola-v.-Italy-no.-2-irreducible-life-sentence-breached-the-Convention.pdf>.

b. Enea kundër Italisë:

<https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22%3A%22001-94072%22%7D>.

⁵⁵ Praktika ka treguar se këto masa për këta të burgosur në vendet e tjera ku janë zbatuar më parë, janë zgjatur apo rinovuar edhe për periudha të tjera kohore të njëpasnjëshme.

⁵⁶ Për më tepër shikoni qarkoren në 35171996 të Autoritetit Italian të Burgjeve pas daljes së Vendimit 351 të vitit 1996 të Gjykatës Kushtetuese Italiane në lidhje me faktin nëse në vetvete ekzistenca e regjimit të posaçëm është në përputhje me kushtetutën apo jo. Ndërsa ekzistenca në vetvete e këtij regjimi nuk përbën parimisht shkelje të Kushtetutës Italiane apo edhe Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, kushtet fizike duhet të ishin të përshtatshme për të mos krijuar probleme në nenin 24 të Kushtetutës së Republikës së Italisë dhe nenin 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Ndonëse natyra e vendimarrjeve të sipërcituara dhe efekti që ata mund të kenë në rastin tonë është i ndryshëm, mendojmë se trajtimi i bërë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Italisë duhet të merret parasysh në kuadër të gjetjes së asaj praktike si një interpretim në përputhje me parimet e Konventës dhe si një praktikë që në masën më të madhe është pranuar si e drejtë nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Institucioni i Avokatit të Popullit në rolin e MKPT-së, nisur nga masat kufizuese të parashikuara në ligjin nr.81/2020 dhe kryesisht në rregulloren e regjimit të posaçëm të sigurisë së lartë, si dhe nga pretendimet për shqetësimet e ngritura në intervistat konfidenciale me të burgosurit që po vuajnë dënimin në kushtet e këtij regjimi, duke i ballafaquar me aktet ndërkombëtare të miratuara për këtë qëllim (kryesisht bazuar në eksperiencën italiane), konstaton se legjislatori shqiptar në disa raste ka parashikuar *masa më të rrepta dhe në tejkalim të standardeve ndërkombëtare*, të cilat çenojnë në disa aspekte parimin e garantimit të trajtimit human dhe me dinjtet të të burgosurve dhe të dënuarve në këtë regjim.

Gjithashtu, sa i takon Rregullores së Regjimit të Posaçëm të Sigurisë së Lartë në këndvështrimin e Avokatit të Popullit, vënia e të gjitha parashikimeve në Rregullore e bën pothuajse të pamundur ndërhyrjen e Gjykatës për të vlerësuar vendimmarrjen, bazuar në parimin e proporcionalitetit apo përshtatshmërisë me rrezikun që duhet mënjeluar, sepse në kushtet kur në aktet rregulluese përcaktohen kushte uniforme për çdo të burgosur të drejtat e të cilit pezullohen përkohësisht, nuk ka hapësirë që i burgosuri të kundërshtojë masat e marra ndaj tij dhe rrjedhimisht nuk ka hapësirë të mjaftueshme ligjore efektive për t'ia nënshtruar vlerësimit të Gjykatave masat e marra për secilin rast. Fakti që rregullorja ndalon në mënyrë të veçantë mundësinë e marrjes së ushqimit nga jashtë, nuk duket në pamje të parë si një kufizim që lidhet me qëllimin që legjislatori ka pasur në vendosjen e një përcaktimi të tillë.

Konsolidimi i një sistemi efektiv të ankimit kërkon që çdo i dënuar dhe i paraburgosur të ketë të drejtën e pacënueshme të ankimit pranë Avokatit të Popullit apo organizmave të tjera ndërkombëtare në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore. Kjo e drejtë ankimi mbetet mënyra e vetme për komunikimin me botën e jashtme. Aksesit në drejtësi dhe kontakti me përfaqësuesit ligjorë gjithashtu janë çështje shumë të rëndësishme të cilat janë adresuar nga GJEDNJ në rastet e shqyrtuara kundër Italisë.

Duke marrë në konsideratë periudhën 1-vjeçare të zbatimit të këtyre masave, lind nevoja për konsolidimin e një sistemi monitorimi të brendshëm profesional dhe efektiv i cili do të ndiqte zbatimin e kësaj mase shtrënguese dhe përgatitjen e informacionit nga ana e strukturave penitenciare. Në këtë mënyrë, strukturat penitenciare konsolidojnë pozicionin e tyre për administrimin e këtyre masave me efektivitet dhe në përputhje me qëllimet ligjore për të cilat janë ndërmarrë ato.

Në përfundim të këtij inspektimi, Avokati i Popullit u ka rekomanduar Ministrin të Drejtësisë dhe drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve:⁵⁷

- Ngritjen e një grupi pune për rishikimin e Rregullores të Regjimit të Posaçëm të Sigurisë së Lartë në IEVP, miratuar me urdhër nr.380, datë 19.07.2019 të Ministrin të Drejtësisë, *e cila duhet të sqarojë, në përputhje me ndryshimet e reja ligjore të qershorit 2020, të drejtat bazë, përgjegjësitë, kushtet e zbatimit dhe monitorimit të brendshëm të regjimit të posaçëm, si dhe garantimin e një sistemi efektiv ankimi.*
- Miratimin e programit individual të këshillimit psiko-social të të burgosurve në regjimin e posaçëm, njoftimin e të dënuarit dhe marrjen e pëlqimit me shkrim për pjesëmarrjen në program.
- Pasurimin e bibliotekave të të burgosurve në regjimin e posaçëm, me larmi titujsh të librave të cilët duhet të vihen në dispozicion të të burgosurve.
- Krijimin e dhomave të veçanta të edukimit psiko-social në çdo seksion.

⁵⁷ Për më tepër rekomandimin përkatës gjendet në faqen zyrtare të institucionit në linkun:

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Varianti%20final%20regjimi%2041%20biss%20mkpt.pdf>.

- Rishikimin e urdhërit të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë nr.104/5 prot., datë 19.07.2006 dhe Ministrit të Shëndetësisë nr.205 prot., datë 27.07.2006, “Për miratimin e normave të ushqimit ditor për të dënuarit”, duke shtuar larmishmërinë dhe rritur në mënyrë të veçantë kuotat ushqimore për personat e transferuar në regjimin e posaçëm, por jo vetëm. Deri në rishikimin e këtij urdhëri, të merren masat e menjëherëshme që personat e ndodhur në këtë regjim të kenë mundësinë për të marrë ushqime nga jashtë në mënyrë që të mos u cënohet e drejta për ushqim dhe dietë të përshtatshme.
- Krijimin e sallave të forcës në të dy seksionet e regjimit të posaçëm, për kalimin e një pjese të kohës me ushtrime fizike.
- Eliminimin e lagështirës në dhomat e banimit ku ky problem u evidentua. Deri në zgjidhjen e këtij problemi të shihet mundësia e përdorimit të qelive në katet e tjera përse rezultoi se kishte kapacitete të lira në godinë.
- Përmirësimin e kushteve të përgjithshme të qëndrimit në lidhje me orenditë që nevojiten për të siguruar një standard minimal të përshtatshëm në kushtet kur të paraburgosurit dhe/ose të dënuarit vendosen në kushtet e ndalimit të kontakteve sociale dhe qëndrimit të zgjatur brenda dhomave të caktura për ta. Këto përmirësime duhet të përfshijnë edhe krijimin e kushteve minimale rekreative dhe informuese të përgjithshme që të zëvendesojnë mungesën e kontakteve sociale. Rishikimin e përmasave të tavolinave të cilat nuk janë të përshtatshme për të kryer funksionin e tyre.
- Organizimin e punës për të siguruar higjenën e përshtatshme në ambientet e përbashkëta.

Në përgjigje të rekomandimit, Ministria e Drejtësisë na ka informuar se është në proces të hartimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” të cilat do t’i nënshtrohen një konsultimi të gjerë publik sipas legjislacionit në fuqi⁵⁸.

➤ *Niveli i respektimit të të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar në njësitë e policisë*

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT), ka vijuar të kryejë veprimtarinë e tij në inspektimin e ambienteve të Policisë së Shtetit, duke u ndalur dhe kontrolluar veçanërisht ligjshmërinë dhe rregullsinë e shoqërimit, ndalimit apo arrestimit të individëve, kushtet dhe trajtimin e tyre brenda komisariateve, problematikat infrastrukturore dhe materiale të tyre, etj.

Për të gjitha rastet e konstatuara janë prezantuar edhe vërejtjet përkatëse në rekomandimet që u janë dërguar organeve eprorë të Policisë së Shtetit.

Inspektimet e kryera në njësitë policore gjatë vitit 2020 kishin si qëllim vëzhgimin e objekteve si dhe mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave mbi veprimet dhe praktikat e ndjekura nga Policia e Shtetit në përmbushje të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019 për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019 për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, si dhe verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimet e mëparshme.

Nga inspektimet e kryera në strukturat e policisë u konstatua sa më poshtë vijon:

⁵⁸ Shkresa e Ministrisë së Drejtësisë nr. 402/2 prot., datë 24.02.2021.

- *Në disa raste ka patur mbipopullim të konsiderueshëm në DPV Tiranë, si dhe në disa nga komisariatet në varësi të saj, ku ka ambiente sigurie. Në këto struktura punohej në pjesën më të madhe të kohës mbi kapacitetin zyrtar. Mbiipopullimi ishte krijuar kryesisht si pasojë e arrestimeve e ndalimeve të shumta të bëra gjatë vitit nga policia për vepra penale të përfshira rishtazi në Kodin Penal, por edhe për shkak se personat e dënuar me vendim të formës së prerë në mungesë, vononin të pranoheshin nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.*
- *Pretendime për raste të ushtrimit të torturës dhe keqtrajtimit fizik e psikologjik të shtetasve nga punonjësit e policisë ka patur në disa komisariate. Ankesat e gjetura të bazuara janë ndjekur kryesisht nga grupe të përbashkëta me Seksionin e Veçantë dhe janë pasuar nga rekomandimet konkrete për marrjen e masave lidhur me personat përgjegjës.*
- *Mospërmbyshje e detyrimeve ligjore për ndërtimin apo përshtatjen e ambienteve të shoqërimit sipas standardit të kërkuar (3 dhoma shoqërimi, 1 për të rritur, 1 për femra dhe 1 për të mitur). Dhomat e shoqërimit në pjesën më të madhe të komisariateve nuk i plotësonin standardet për trajtim dinjitoz të personave, pasi rezultonin të pakta në numër dhe nuk krijonin ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, të rritur dhe të mitur.*
- *Mospërmbyshje e detyrimeve ligjore për ndërtimin apo përshtatjen e ambienteve të sigurisë, sipas standardeve të kërkuara e të miratuara nga Konventat Ndërkombëtare dhe Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”. Përgjashtim bënin ambientet e sigurisë në DPV Tiranë, Gjirokastrë, Kukës, Korçë dhe Fier. Komisaritet e varësisë të DPV Tiranë ku gjenden dhoma sigurie, po ashtu ishin në shkelje të dukshme të këtyre standardeve. Në komisaritet e policisë nr.1, 2 dhe 3 në Tiranë, nga inspektimi rezultoi se disa dhoma sigurie janë mbyllur dhe janë nxjerrë jashtë funksionit me procesverbal⁵⁹.*
- *Probleme në ofrimin e një shërbimi shëndetësor nga disa DPV, sa i përket plotësimit korrekt të regjistrave e kartelave mjekësore, si dhe ambienteve të papërshtatshme për ofrimin e konsultave; në disa drejtori mjeku mungonte. Në disa prej këtyre institucioneve, vizitat mjekësore kryheshin përtej afatit 12 orësh, të përcaktuar në procedurat standarde të Policisë së Shtetit.*
- *Probleme me instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në korridoret e dhomave të shoqërimit, sigurisë dhe ambientet e marrjes në pyetje të shtetasve në disa komisariate.*

➤ *Niveli i respektimit të drejtave të personave në spitalet psikiatrike*

Avokati i Popullit vazhdimisht ka tërhequr vëmendjen për gjendjen në spitalet e kujdesit të shëndetit mendor në Shqipëri. Për vitin 2020 nëpërmjet MKPT-së janë inspektuar institucionet e shëndetit mendor si Spitali Psikiatrik Vlorë, Spitali Psikiatrik Shkodër, IEVP Zahari, IVSHB dhe Spitali Psikiatrik “Xhavit Gjata” Tiranë.

Nga këto inspektime, problematikat e konstatuara janë:

- Trajtimi në kushte burgu pranë I.V.SH.B. Tiranë dhe IEVP Zahari, Krujë i personave me çrregullime të shëndetit mendor të cilët kanë kryer vepra penale dhe me vendim gjykatë është vendosur masa “mjekim të detyruar në një institucion mjekësor”, është në shkelje të

⁵⁹ Në lidhje me numrin e dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë në komisaritet e policisë, për më shumë referojuni tabelës që gjendet në Aneksin 1, bashkëlidhur këtij raporti.

ligjit nr.44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor” dhe vijon të mbetet një problematikë shqetësuese. Mekanizmi Kombëtar (MKPT), me qëllim përmirësimin e situatës dhe trajtimin e të sëmurëve me çrregullime të shëndetit mendor, ka adresuar rekomandimet përkatëse institucioneve shtetërore të ngarkuara me ligj.

- Vënien në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor” nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për ngritjen e institucioneve të posaçme mjekësore dhe për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, që kanë kryer një vepër penale, për të cilët gjykata kompetente ka vendosur mjekimin e detyruar në një institucion mjekësor, të të paraburgosurve apo të të dënuarve që shfaqin çrregullime të shëndetit mendor gjatë vuajtjes së dënimit, si dhe për trajtimin e personave, për të cilët gjykata ka vendosur shtrimin e përkohshëm në një institucion mjekësor të posaçëm, sipas nenit 239 të Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar.
- Gjetjen e një zgjidhjeje të shpejtë, efektive dhe të qëndrueshme, për shqyrtimin kryesisht brenda afateve ligjore nga gjykatat të të gjitha vendimeve të dhëna për “mjekim të detyruar në një institucion mjekësor”, si dhe për dërgimin e vendimeve në institucionet ku trajtohen personat përkatës.
- Në organikat e spitaleve psikiatrike ka mungesa të mjekëve psikiatër, infermierëve “kujdestarë/task forcë”, stafit të sigurisë, sanitarëve dhe berberit, me qëllim ofrimin e një shërbimi të përshtatshëm për specifikat e këtij shërbimi të shëndetit mendor me shtretër. Avokati i Popullit në rekomandimet e tij ka vlerësuar se është i nevojshëm:
 - Shtimi i menjëhershëm dhe në vitet në vijim i kuotave për specializantë në Psikiatri (*Viti 2020 ka parashikuar vetëm 15 kuota*);
 - Riformulimi i kritereve të punësimit për funksionet klinike “kujdestar” dhe “task forcë”, me edukim infermieristik dhe njohuri të thelluara në rehabilitim psikiatrik spitalor, si dhe me aftësi moshore e fizike të përshtatshme për menaxhimin e axhitimit dhe riskut të lartë;
 - Trajnimi i punonjësve aktualë.
- Vendosjen e sistemit monitorues me kamera vëzhgimi në ambientet e përbashkëta të spitaleve psikiatrike.
- Krijimin/rikonstrukcionin e plotë të dhomave të izolimit, duke i kompletuar ato në përputhje me pikën 4.6 “Infrastruktura e Izolimit”, të “Standardeve të Kufizimit Fizik në Shërbimet e Shëndetit Mendor të Specializuar me Shtretër”, miratuar me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë, pjesë e paketës së akteve nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”.
- Pajisjen e spitaleve me mjete të kufizimit mekanik, konform pikës 1.2 “Elementët e kufizimit”, germa b “Kufizimi Mekanik”, aktit nënligjor të cituar në pikën e mësipërme.
- Mundësimin e riorganizimit të pavijoneve të pacientëve akutë më vite.
- Përmirësimin e kushteve në pavijone, ngrohje, dushe dhe tualete në mënyrë që të ofrohet një shërbim sa më dinjitoz të personave që trajtohen në spitalet psikiatrike, si dhe sigurimin e bazës së nevojshme materiale për stafet psiko-sociale.
- Pajisjen/vënien në funksion të plotë të laboratorëve klinikë bio-kimikë si dhe të aparateve të EKG-së.

2. Shërbimi mjekësor mbetet me mungesa dhe nevojë të përhershme për kushte më të mira materiale dhe mbështetje me staf sigurie. Për shkak të kushteve minimale të sigurisë, mjekët dhe stafi mbështetës janë gjithmonë të rrezikuar.

3. Nevojitet ndarja dhe riorganizimi i pavijoneve të veçanta të personave me aftësi të kufizuar intelektuale, rezidentë, pacientëve akutë, subakutë, në mënyrë që të ofrohet një shërbim më i plotë dhe sipas nevojave për secilën kategori, pasi vendosja e tyre në të njëjtin pavijon vështirëson trajtimin e tyre sipas standardeve të parashikuara në ligjin për shëndetin mendor dhe aktet nën ligjore të tij.

➤ *Monitorimi i pavarur i të drejtave të emigrantëve të huaj*

Institucioni i Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës vijoi të zbatojë, edhe gjatë vitit 2020, marrëveshjen e bashkëpunimit të nënshkruar me UNHCR në kuadër të projektit të përbashkët “Refugjatët dhe Azilkërkuesit në vendet e Europës Juglindore”, për kontrollin e kufirit dhe mbrojtjen e refugjatëve në Shqipëri, në zonën jugore të Shqipërisë (Gjirokastrë, Sarandë, Përmet) dhe në zonën juglindore (Korçë, Devoll Bilisht).

Në bashkëpunim me Zyrën e terrenit të UNHCR-së Gjirokastrë, si dhe pikat fokale nga UNHCR, për zonat e tjera kufitare, në partneritet me organizatën “Caritas” në Gjirokastrë dhe Korçë, në koordinim me Drejtoritë Rajonale të Kufirit në nivel vendor, autoritetet qëndrore të kufirit dhe migracionit në Gjirokastrë dhe Korçë, si dhe në partneritet edhe me organizata të tjera që punojnë në fushën e migracionit, ekspertët e jashtëm të institucionit të Avokatit të Popullit u përfshinë në monitorimin sistematik të kufijve, raportimin periodik të gjetjeve, trajtimin e zgjidhjen e problematikave të hasura në ofrimin e mbrojtjes për të huajt e parregullt që hyjnë nga kufiri grek në Shqipëri.

Ekspertët kanë punuar për informimin e personave, garantimin e standardit të intervistave të përzgjedhjes; zhvillimin e marrëdhënieve me komunitetet në zonat ndërkufitare për t'i ndërgjegjësuar për mikpritjen e refugjatëve; promovimin dhe monitorimin e aksesit në territor dhe në procedurat e azilit për azilkërkuesit dhe refugjatët e identifikuar në kufijtë shqiptarë.

Në funksion të këtij objekti janë zhvilluar aktivitetet e mëposhtme:

- Monitorimi sistematik i kufirit, nga ku rezulton se forcat policore kufitare shqiptare kanë rritur numrin e kthimeve drejt territorit grek, duke e lidhur me situatën e pandemisë dhe legjislacionin shqiptar për situatat e tilla.
- Monitorimi i procedurave të përzgjedhjes; kryerja e intervistave të thelluara; kryerja në bashkëpunim me stafin e UNHCR-së me zyrë në Gjirokastrë e vizitave monitoruese; ofrimi i analizave mbi funksionimin e procedurave të përzgjedhjes si dhe rekomandimet se si të përmirësohet zbatimi i tij.
- Rritja e kapaciteteve të autoriteteve përgjegjëse lidhur me azilin dhe të drejtat e njeriut dhe rritja e cilësisë së intervistave të përzgjedhjes.

Problematikat e evidentuara në terren në *Qarkun e Gjirokastrës*, gjatë monitorimeve janë:

- mbingarkesë e GOS Kakavijë në rastet kur ka njëkohësisht grupe refugjatësh të huaj të ndaluar në territorin shqiptar dhe grupe refugjatësh të paligjshëm shqiptarë që janë kthyer nga policia greke për të cilët bëhet procedura e riatdhesimit.
- mungesë kapacitetesh/mjedisesh dhe mbështetje nëse ka flukse në grupe të medha (mbi 15 refugjatë).
- procedurat e kthimit vullnetarisht në Greqi kryhen pa një protokoll me palën greke.
- nevoja e identifikimit të instrumenteve të reja krahas aktorëve të qëndrueshëm në menaxhimin e problematikave, që lidhen me kufirin dhe refugjatët. Konkretisht përfshirja në zinxhirin e trajtimit të problemeve të Agjensisë së Mbrojtjes së fëmijëve, përfshirja e asistencës mjekësore të organizuar në raste të problemeve shëndetësore, përfshirja e trajtimit mjekësor në raste problemesh më të rënda të shëndetit. Për refugjatët e paligjshëm por sidomos për gratë dhe fëmijët në rrezik duhen fushata ndërgjegjësimi tek banoret e zonave kufitare në Gjirokastrë dhe Sarandë.
- nevoja e një skeme për menaxhimin e mbetjeve urbane si në Grehot dhe Kakavijë, pasi ato hidhen në mjedise të pakontrolluar dhe nuk tërhiqen nga makinat e pastrimit.

Tabelat përmbledhëse për periudhën Janar - Dhjetor 2020 (Eksperti Gjirokastrë)

Muajt	Intervista të thelluara	Raste të mbuluara/nr i personave
Janar	13	15 raste /30 persona
Shkurt	17	19 raste /145 persona
Mars	33	49 persona
Prill	3	16 raste / 9 persona
Maj	11	17 raste / 22 persona
Qershor	6	21 raste
Korrik	23	23 raste/ 111 persona
Gusht	33	23 raste /145 persona
Shtator	21	25 raste / 65 persona
Tetor	40	17 raste/ 135 persona
Nentor	25	10 raste/ 93 persona
Dhjetor	31	14 raste/ 110 persona

Problematikat e evidentuara në terren në *Qarkun e Korçës*, gjatë monitorimeve janë:

- Numër jo i mjaftueshëm burimesh njerëzore dhe specialistësh nga policia e kufirit për t'ju përgjigjur dinamikave dhe numrit të lartë të ardhjeve. Mungesa e stafit dhe logjistikës ka sjellë mbingarkesë të stafit ekzistent, duke ulur cilësinë e punës, si dhe kohën e nevojitur për identifikimin e problematikave si: viktimat të mundshme të trafikimit, mbijetues të dhunës familjare apo gjinore, identifikimin e personave, pjesë të grupeve vulnerable, etj.
- Mungesë e qasjes në respekt të gjinisë, sipas VKM 293/ 2015.
- Rikthimi i parregullt në Greqi në kundërshtim me ligjin 108/2013, mosrespektimi i kërkesave ligjore në identifikimin e personave në nevojë të mbrojtjes ndërkombëtare (azilkërkuesve të mundshëm).
- Gjatë periudhës së monitorimit janë evidentuar shumë raste ku nuk është marrë parasysh kërkesa për azil.
- Mungesa e Mekanizmit Kombëtar Referues për rastet e personave me nevoja specifike si: fëmijët e ndarë apo të pashoqëruar (ligji 18/2017), viktimat e mundshme të trafikimit (VKM 499/2018).
- Mungesa e stafit mjekësor në identifikimin e rasteve të cilat mund të jenë mbartës e përçues të sëmundjeve infektive.

Tabelat përmbledhëse për periudhën Janar - Dhjetor 2020 (Eksperti Korçë)

Muajt	Intervista të thelluara	Raste të mbuluara/nr i personave
Janar	33	33 raste /768 persona
Shkurt	28	40 raste /1198 persona
Mars	19	15/ 1216 persona (Monitorim online ⁶⁰)
Prill		Monitorim online / 133 persona
Maj	34	Monitorim online/ 616 persona

⁶⁰ Monitorimet online janë kryer gjatë kohës së pandemisë dhe konsistojnë në takimet e oficerëve të kontaktit me përfaqësuesit e Caritas-it dhe oficerët e Policisë Kufitare.

Qershor	30	Monitorim online/ 1214 persona
Korrik	36	35 raste / 1829 persona
Gusht	34	27 raste / 2128 persona
Shtator	25	34 raste / 2779 persona
Tetor	31	38 raste/ 2125 persona
Nëntor	38	26 raste / 870 persona
Dhjetor	20	22 raste / 658 persona

Problematika të përbashkëta të evidentuara në të dy qarqet gjatë periudhës janar- dhjetor 2020 janë:

- numri i përkthyesve dhe mediatorëve kultural vazhdon të jetë i reduktuar.
- Mungon lista e përkthyesve dhe psikologëve të licensuar.
- Mungon mbështetja me psikologë në qendrat e përkohshme.
- Mungon personeli femëror (punonjëse policie, përkthyes, psikologe).
- Lëvizja e personelit në disa nga Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve pranë Bashkive nga njëri sektor në tjetrin. Në rastet e ndihmës ndaj të miturve të pashoqëruar kjo krijon probleme me kualifikimin e stafëve që duhet të kenë trajnime në vijueshmëri.
- Mungon udhëzimi i Ministrit të Brendshëm për akomodimin afatgjatë të të miturve të pashoqëruar.
- Qendrat nuk kanë kushtet për strehim afatgjatë për të miturit e pashoqëruar.

Duhet të theksohet se ekspertët e jashtëm janë rekrutuar në bashkëpunim me UNHCR dhe se monitorimi i vazhdueshëm nga Avokati i Popullit në funksion të garantimit të të drejtave të emigrantëve të huaj, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar, do të kërkonte rritje të kapaciteteve të burimeve njerëzore.

3.5 Respektimi i të drejtave të njeriut nga Prokuroria⁶¹

Avokati i Popullit si një institucion i pavarur kushtetues, pavarësisht situatës së krijuar nga pandemia gjatë vitit 2020, në kuadër të respektimit dhe mbrojtjes të të drejtave të njeriut është munduar të luajë një rol aktiv në shqyrtimin dhe verifikimin e shqetësimeve të parashtruara nga shtetas të ndryshëm, për procedurat e ndjekura nga prokurorët, gjatë hetimit të procedimeve penale, duke qenë palë në procesin penal, në cilësinë e kallëzuesit apo të personit nën hetim.

Theksojmë paraprakisht se, vijimi i reformës në drejtësi, ka rritur volumin e punës në sistem për shkak të mungesave dhe largimeve të një numri të konsiderueshëm prokurorësh. Nga ana tjetër, reforma e iniciuar e ka vendosur organin procedues përpara detyrimeve ligjore në zbatimin korrekt të procedurave të parashikuara si, marrjen e vendimit përfundimtar, apo edhe hetimin e fakteve, provave dhe rrethanave që janë në favor të personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet.

Gjatë vitit 2020 në institucionin e Avokatit të Popullit janë administruar dhe trajtuar 113 ankesa të qytetarëve, me një rritje të konsiderueshme të numrit të ankesave dhe çështjeve që janë administruar dhe hetuar nga ana jonë gjatë vitit 2019⁶².

⁶¹ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Veçantë në institucionin e Avokatit të Popullit.

⁶² Gjatë vitit 2019, në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë ardhur dhe janë trajtuar 79 ankesa të qytetarëve.

Problematikat kryesore të përmbledhura sipas llojit të cenimit të të drejtave gjatë procesit penal, mund të paraqiten si më poshtë:

- Zvarritje e pajustificuar e hetimeve të procedimeve penale, problematikë e cila është ndjekur me përparësi nga ana jonë, duke e vlerësuar në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor në respekt të detyrimeve të parashikuara në pikën 2 të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të KEDNJ;
- Mosvënie në dispozicion të akteve të ndryshme procedurale nga fashikulli i hetimit apo dokumenteve të sekuestruara, duke cenuar në këtë kuadër edhe të drejtën dhe interesin e ligjshëm të qytetarëve për të ndjekur procedurat e nevojshme gjyqësore, siç është e drejta e ushtrimit të ankimit në gjykatë për vendime të ndryshme të organit të prokurorisë;
- Mosinformim i personave kallëzues apo të interesuar për procedimin penal lidhur me veprimet e kryera gjatë fazës së hetimit apo vendimet përfundimtare të procedimeve dhe hetimeve;
- Ndalime të paligjshme apo të pajustificuara të personave të ndryshëm që u atribuohet vepra penale. Në nenin 228 të Kodit të Procedurës Penale parashikohen kushtet për caktimin e masave të sigurimit personal, mbi bazën e provave që të bëjnë të dyshosh që është kryer apo është duke u kryer një vepër penale. Natyrisht, kjo bindje apo dyshim i arsyeshëm krijohet kur personi ndalohet, ose arrestohet në flagrancë, e cila më pas duhet të vlerësohet nga organet gjyqësore. Në të dyja rastet respektohet parimi i prezumimit të pafajësisë. Fakti që një individ ka precedentë penal nuk konsiderohet i mjaftueshëm për të krijuar dyshime të arsyeshme.

Në vijim të shqetësimeve të ngritura nga institucioni ynë, theksojmë gjithashtu faktin se nga ana e disa organeve të procedimit penal ka patur zvarritje dhe vonesa në kthimin e përgjigjeve apo sqarimeve lidhur me kërkesat tona për informacion, duke e justifikuar me karakterin sekret të hetimit, qëndrim i cili nuk është në përputhje me standardet dhe kriteret ligjore në bazë të të cilave Avokati i Popullit mund të administrojë edhe informacione që janë klasifikuar si sekret.⁶³ Aq më tepër, që në një mori rastesh, nga ana jonë është konstatuar që akte të tëra të fashikullit të hetimit publikohen në media të ndryshme, duke cenuar kështu punën dhe procedurat efektive hetimore që mund dhe duhet të ndiqen nga organi i Prokurorisë. Në vijim të trajtimit të këtyre rasteve, kemi sjellë të drejtën e Avokatit të Popullit për të kërkuar edhe informacione apo dokumente që lidhen me çështjen në shqyrtim të klasifikuara si sekret shtetëror, e cila parashikohet në nenin 20 të ligjit funksional të Avokatit të Popullit.

Një problem tjetër i evidentuar është dhe interpretimi i gjendjes së flagrancës në kundërshtim me interpretimin e bërë nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut⁶⁴ të çështjeve konkrete. Standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut kërkojnë që çdo kufizim i lirisë duhet të jetë përjashtim objektivist i justifikuar dhe për një kohëzgjatje jo më shumë se sa është absolutisht i domosdoshëm duke inkurajuar shprehimisht mospërdorimin e masave shtrënguese të kufizimit të lirisë gjatë hetimit dhe gjykimit, deri në dhënien e vendimit. Aq më tepër, që në situatë

⁶³ Neni 63, pika 4, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe neni 19/1 i ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

⁶⁴ GJEDNJ ka theksuar se shprehjet “e ligjshme” dhe “në përputhje me një procedurë të parashikuar nga ligji” në Nenin 5 § 1 në thelb i referohen ligjit kombëtar dhe parashikojnë detyrimin për t’u përputhur me rregullat thelbësore dhe procedurale të tij. Megjithatë në radhë të parë është detyrë e autoriteteve kombëtare, veçanërisht gjykatave, për të interpretuar dhe zbatuar ligjin e brendshëm, sipas nenit 5 § 1 të KEDNJ mosrespektimi i ligjit të brendshëm sjell shkelje të Konventës dhe Gjykata mund dhe duhet të shqyrtojë nëse ky ligj është përmbushur (shih, midis shumë referencave të tjera, Benham kundër Mbretërisë së Bashkuar, 10 qershor 1996, § 41, Raportet 1996-III, dhe Assanidze kundër Georgia [GC], nr. 71503/01, § 171, KEDNJ 2004-II). Në bazë të Nenit 5 § 1 (c) një person mund të ndalohet në kontekstin e procedurave penale vetëm për qëllimin e sjelljes së tij para autoritetit ligjor kompetent për dyshimin e arsyeshëm të tij se ka kryer një vepër penale. Një “dyshim i arsyeshëm” se një vepër penale është kryer presupozon ekzistencën e fakteve ose informacionit që do të kënaqte një vëzhgues objektiv që personi në fjalë mund të ketë kryer një vepër penale (shih *Ēłoch v. Poland*, nr. 27785/95, § 108, KEDNJ 2000 - XI).

pandemie duhet të mbahet parasysh shmangia e masave të rënda të sigurimit personal për të mos u gjendur në kushtet e mbipopullimit të ambienteve ku mbahen, ruhen e trajtohen personat e arrestuar/ndaluar në organet e Policisë së Shtetit. Për shkak të mungesës së kapaciteteve akomoduese në këto ambiente bëhet edhe më e vështirë respektimi i masave anti COVID-19 për parandalimin e përhapjes së virusit, duke u kthyer në një burim të përhapjes së infeksionit.

Ne vlerësojmë se për aplikimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” nga organet e policisë gjyqësore, prokurorisë dhe gjykatës duhet të mbahen parasysh rrezikshmëria shoqërore e veprës penale dhe e autorëve të saj, si dhe rrethanat lehtësuese e rënduese. Kjo masë e sigurimit personal duhet të aplikohet si rast përjashtimor dhe si masë e fundit për personat e dyshuar si autorë të kryerjes së veprave penale të cilat parashikojnë dënime të rënda penale. Po ashtu, kjo masë duhet të aplikohet në përshtatje me shkallën e nevojave të sigurimit, të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikon vepra penale, si dhe kur masat e tjera nuk janë të përshtatshme për shkak të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe të autorit të saj.

Në vijim të hetimeve të kryera nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit janë hartuar dhe dërguar disa rekomandime, e më konkretisht:

- Rekomandim drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat Tiranë, duke vënë në dijeni edhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit lidhur me identifikimin dhe fillimin e hetimit penal ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit, për veprën penale “Kryerja e veprimeve arbitrare”, parashikuar nga nenet 250 e 25 të Kodit Penal, për veprimet e kundërligjshme të kryera ndaj shtetases ***, në çështjen me numër 202000601⁶⁵.
- Rekomandim lidhur me marrjen e masave të nevojshme për respektimin e lirisë kushtetuese të tubimit edhe gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, drejtuar Komitetit Ndërmnistror të Emergjencave Civile, Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si edhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit⁶⁶.
- Rekomandim drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke vënë në dijeni edhe Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat Tiranë, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Komisaratin e Policisë nr. 4 lidhur me fillimin e hetimit të procedimit penal ndaj punonjësve të policisë së Komisaratis nr.4 Tiranë, për veprën penale “Kryerja e veprimeve arbitrare”, parashikuar nga nenet 250 e 25 të Kodit Penal, për prangosjen e shtetasit A.G në Spitalin Universitar të Traumës, në çështjen me numër 201900553⁶⁷.
- Rekomandim drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, duke vënë në dijeni edhe Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës lidhur me fillimin e hetimeve ndaj punonjësve të policisë së Komisaratis të

⁶⁵ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20identifikimin%20dhe%20fillimin%20e%20hetimit%20penal%20t%C3%AB%20punonj%C3%ABsve%20t%C3%AB%20Policis%C3%AB%20s%C3%AB%20Shtetit.%20p%C3%ABr%20vepr%C3%ABn%20penale%20e%20E2%80%9CKryerja%20e%20veprimeve%20arbitrare%20e%20E2%80%9D.%20parashikuar%20nga%20nenet%20250%20e%2025%20t%C3%AB%20Kodit%20Penal.pdf>

⁶⁶ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20marrjen%20e%20masave%20t%C3%AB%20nevojshme%20p%C3%ABr%20respektimin%20e%20liris%C3%AB%20kushtetuese%20t%C3%AB%20tubimit%20edhe%20gjat%C3%AB%20gjendjes%20s%C3%AB%20jasht%C3%ABzakonshme.%20.pdf>

⁶⁷ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20fillimin%20e%20hetimit%20t%C3%AB%20procedimit%20penal%20ndaj%20punonj%C3%ABsve%20t%C3%AB%20policis%C3%AB%20s%C3%AB%20Komisaratis%20nr.4%20Tiran%C3%AB.%20p%C3%ABr%20vepr%C3%ABn%20penale%20e%20E2%80%9CKryerja%20e%20veprimeve%20arbitrare.pdf>

Policisë Durrës për veprën penale “*Kryerja e veprimeve arbitrare*”, parashikuar nga nenet 250 e 25 të Kodit Penal, në çështjen me numër 201900918⁶⁸.

3.6 E drejta për një proces të rregullt ligjor⁶⁹

Gjatë vitit 2020, sistemi gjyqësor u përball me vështirësi të reja të shkaktuara nga pandemia globale COVID-19, krahas atyre me të cilat është hasur ky sistem vitet e fundit për arsye të procesit të zgjatur të vetingut i cili ka ecur me ritme të ngadalta, me vonesa të panevojshme dhe me sfida të mëdha sociale dhe profesionale. Sigurisht, pezullimi i veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e vendit, të juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm, me përjashtim të çështjeve me natyrë të ngutshme, për një periudhë të gjatë 3 muajve solli si pasojë zvarritje të proceseve gjyqësore, shtyrje të gjykimit të çështjeve të reja, si dhe problematika në respektimin e plotë të të drejtave procedurale gjatë gjykimit.

Kryesisht, ankesat e përcjella nga shtetasit pranë institucionit të Avokatit të Popullit janë përqendruar në:

- zvarritje të proceseve gjyqësore dhe në veçanti afate të tejzgjatura për marrjen në shqyrtim të çështjeve nga Gjykatat e Apelit, Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë;
- nxjerrjen me vonesë të vendimit të arsyetuar/mosnjohimit të palëve nga gjykata brenda afateve të përcaktuara në Kodet e Procedurës;
- mosmarrjen në shqyrtim të çështjeve të reja nga gjykatat e shkallës së parë për një afat disa muaj;
- kërkesa të shumta për përshpejtim të gjykimit nga gjykatat e apelit, për shkaqe të justifikuara si sëmundje dhe vështirësi ekonomike;
- kërkesa për përfitim të ndihmës juridike dytësore nga gjykatat, etj.

Këto çështje të adresuara nga qytetarët, Avokati i Popullit i ka bërë prezente pranë organeve gjyqësore përkatëse, duke theksuar se kanë të bëjnë me thelbin e procesit të rregullt ligjor. Pavarësisht nga mirëkuptimi i situatës së krijuar, nuk mund të neglizhohet për asnjë moment e drejta e qytetarëve për një proces të rregullt ligjor sipas garancive të parashikuara në nenin 6 të KEDNJ-së.

Në disa raste, në korrespondencën e mbajtur me organet gjyqësore është theksuar nga ana e tyre se procesi i vetingut ka krijuar vështirësi të mëdha gjatë punës. Kështu, në një pjesë të mirë të gjykatave të apelit në shkallë vendi, janë krijuar shumë mungesa për shkak të shkarkimeve të gjyqtarëve nga procesi i vetingut, nga njëra anë, si dhe nga moszëvendësimi i tyre nga ana tjetër, me magjistratë. Këshilli i Lartë Gjyqësor në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve kanë qenë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, ka caktuar gjyqtarë edhe për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë. Kjo ka bërë që disa gjyqtarë apeli që ende janë në detyrë duhet të lëvizin në gjykata apeli të ndryshme për të marrë pjesë në gjykime.

Reforma në drejtësi vijon të konsiderohet zhvillimi më i rëndësishëm institucional në Shqipëri që prej korrikut 2016. Por vetëm pas gati 2.5 vitesh është arritur të krijohen Këshilli i Lartë

⁶⁸ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20fillimin%20e%20hetim%20ndaj%20punonj%C3%ABsve%20t%C3%AB%20policis%C3%AB%20t%C3%AB%20Komisariatit%20t%C3%AB%20Policis%C3%AB%20Durr%C3%ABs%20p%C3%ABr%20vepr%C3%ABn%20penale%20t%C3%AB%20E2%80%9C%20Kryerjes%20s%C3%AB%20veprimeve%20arbitrare%E2%80%9D,%20parashikuar%20nga%20nenet%20250%20dhe%2025%20t%C3%AB%20Kodit%20Penal,%20t%C3%AB%20ndryshuar..pdf>

⁶⁹ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Veçantë në institucionin e Avokatit të Popullit.

Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, që përfaqësojnë kalimin nga procesi i rivlerësimit tek procesi i ngritjes së institucioneve të reja të qeverisjes së drejtësisë në Shqipëri. Gjithashtu, në fund të vitit 2019 u ngrit edhe Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Duke iu kushtuar një rëndësi thelbësore përjashtimit nga sistemi të individëve që nuk plotësojnë njërin ose disa prej tre kritereve kushtetuese, janë lënë jashtë vëmendjes aspektet e tjera të rëndësishme të reformës, sikurse janë prurjet e reja në sistem, karriera, përmirësimi i cilësisë së punës në dhënien e drejtësisë, transparenca, rritja e pavarësisë dhe profesionalizmi.

Mbetet e paplotësuar Gjykata Kushtetuese, si dhe mbetet ende jo funksionale Gjykata e Lartë⁷⁰. Gjithashtu, është krijuar boshllëk i theksuar në gjykatat e niveleve të tjera, në mënyrë të veçantë në gjykatat e apelit. Ne vlerësojmë, se zgjatja e afatit të konsolidimit të institucioneve funksionale të drejtësisë, është e dëmshme dhe cenon besimin te publiku.

E drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm e përcaktuar në nenin 6 të KEDNJ-së i detyron shtetet anëtare të organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë që të lejojnë gjykatat në përmbushjen e këtij detyrimi.

Vetë Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, me vendimin nr.6/2006 ka përcaktuar për herë të parë pozicionimin dhe efektin e drejtpërdrejtë të Konventës në nivelin vendas, duke trajtuar: 1. vendin që zë Konventa në sistemin juridik; 2. interpretimin e Konventës dhe të jurisprudencës së GJEDNJ-së; 3. efektet ligjore të vendimeve të GJEDNJ-së. Më herët, Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.655/1999, interpretoi nenin 17 të Kushtetutës, i cili i referohet shprehimisht standardeve të KEDNJ-së, kur flitet për kufizimet e të drejtave dhe lirive individuale nga autoritetet shtetërore, duke deklaruar se "... *Këto kufizime nuk mund të çënojnë thelbin e të drejtave dhe lirive dhe, në asnjë rast, nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në KEDNJ.*"

Standardi minimal për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të KEDNJ-së është i detyrueshëm për autoritetet shtetërore, por kjo nuk e pengon legjislacionin vendas që të vendosë një standard më të lartë për mbrojtjen e të drejtave individuale.

Ndryshimet e Kodit të Procedurës Civile nëpërmjet ligjit nr.38/2017, datë 30. 03. 2017, parashikojnë aspekte të reja sa i takon përcaktimit të periudhës optimale të kohëzgjatjes për proceset gjyqësore (civile, penale, administrative, si dhe ekzekutimin e vendimeve përfundimtare) dhe gjykatën përgjegjëse ku duhen drejtuar ankesat për vonesa të pajustificuara, specifikisht në nenet 399/2 dhe 399/6/. Neni 399/2 i Kodit të Procedurës Civile parashikon sa më poshtë:

"1.Afate të arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, për qëllimet e përcaktuara në nenin 399/1, do të konsiderohen:

- a. në gjykimin administrativ në shkallën e parë dhe në apel, përfundimi i gjykimit brenda një viti nga fillimi i tij në secilën shkallë;*
- b. në gjykimin civil në shkallë të parë përfundimi i procesit të gjykimit brenda dy viteve, në gjykim civil në apel brenda dy vjetëve; dhe gjykimin civil në Gjykatën e Lartë, brenda dy vjetëve;*
- c. në procedurën e ekzekutimit të një vendimi civil apo administrativ, me përjashtim të detyrimeve periodike ose të përcaktuara në kohë, afati njëvjeçar fillon nga dita e paraqitjes së kërkesës për vënie në ekzekutim;*

⁷⁰ Referenca bëhet për periudhën deri në 31.12.2020.

ç. në hetimin e veprave penale afati maksimal i kohëzgjatjes së hetimeve, sipas Kodit të Procedurës Penale;

d. në gjykimin penal në shkallë të parë, afati i gjyimit të krimeve 2 vjet dhe i kundërvajtjeve 1 vit, në gjykimin në apel përfundimi i gjyimit për krimet në një afat kohor prej 1 viti dhe për kundërvajtjet 6 muaj dhe në Gjykatën e Lartë, përfundimi i gjyimit për krimet në një afat kohor prej 1 viti dhe për kundërvajtjet 6 muaj.”

Gjithashtu një risi e parashikuar me këto ndryshime është edhe e drejta për të kërkuar konstatimin e tejzgjatjes së procedurave nga gjykata, përcaktuar në nenin 399/2, pika 2 e Kodit të Procedurës Civile. Edhe pa kaluar afatet e parashikuara më lart, palët kanë të drejtë të kërkojnë konstatimin e tejzgjatjes së procedurave, duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes, objektin e mosmarrëveshjes, të procedimit ose të gjyimit, sjelljen e organit që po kryen procedurat, si dhe të çdo personi tjetër të lidhur me çështjen, kur pretendojnë zvarritje të hetimit, gjyimit ose ekzekutimit të vendimit.

Në përmbyllje, është detyrim i institucioneve kushtetuese përgjegjëse plotësimi i vendeve vakante në gjykatat përkatëse, duke filluar nga Gjykata Kushtetuese deri te gjykatat e shkallës së parë, me qëllim garantimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor për qytetarët, të cilët kanë humbur besimin dhe shpresën për gjykimin e çështjeve të tyre brenda një afati të arsyeshëm.

3.7 Ndihma juridike falas⁷¹

E drejta e aksesit në drejtësi është parimi kushtetues me anë të të cilit garantohet ushtrimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, një kusht esencial për ekzistencën e shtetit të së drejtës, që udhëheq organizimin dhe funksionimin e drejtësisë në vend. Me aksesin e lirë në gjykatë, kuptohet një e drejtë publike, e cila i jep titullarit të saj garancinë ligjore që të drejtohet për të kërkuar mbrojtjen e shtetit, duke detyruar organet gjyqësore kompetente të prononcohen mbi pretendimet e tij.

Aksesi në drejtësi është konsideruar si element thelbësor i të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa iu njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t’iu drejtuar gjykatës. Kjo e drejtë është e lidhur ngushtë me nenin 6 të KEDNJ, duke nënkuptuar jo vetëm të drejtën e individit për t’iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t’ia garantojë atij këtë mundësi

Edhe gjatë vitit 2020 një rëndësi e veçantë i është kushtuar pa dyshim monitorimit dhe vënies në zbatim të ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, nisur nga fakti i kohëzgjatjes së vonuar të ngritjes të strukturave përkatëse si dhe nxjerrjes së akteve nënligjore dhe, nga ana tjetër, nevojës së qytetarëve që shteti t’ua garantojë këtë shërbim.

Edhe në Raportin e Komisionit Evropian për vitin 2019 për Shqipërinë vihet në dukje vonesa e ngritjes së këtyre strukturave. Krahas vlerësimit të ndryshimeve pozitive në fushën e ndihmës juridike dhe legjislacionin penal në këtë drejtim, theksohet se pjesa më e madhe e rasteve që prekin grupet vulnerabël si personat me aftësi të kufizuara, romët, personat me probleme ekonomike, etj, vazhdojnë të trajtohen nga shoqëria civile me mbështetjen financiare të donatorëve.

Evidentojmë se në vendin tonë veprojnë disa qendra (OJF) të mbështetura financiarisht nga donatorë, të cilat ofrojnë ndihmë juridike falas përmes zbatimit në afate të projekteve, me

⁷¹ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Veçantë në institucionin e Avokatit të Popullit.

objektiv rritjen e aksesit të individëve dhe grupeve në nevojë në sistemin e drejtësisë⁷². Institucioni i Avokatit të Popullit është i vetëdijshëm dhe vlerëson punën e këtyre OJF-ve për të siguruar aksesin e shtresave në nevojë për ndihmë juridike falas dhe iniciativat e tyre për ngritjen e qendrave të ndihmës juridike me mbështetjen e donatorëve të ndryshëm, por nga ana tjetër synon vënien në funksion të mekanizmave ligjorë shtetërorë të parashikuar në ligjin nr.111/2017. Pra, që individët e interesuar të përfitojnë nga ndihma juridike shtetërore dhe jo vetëm /kryesisht nga OJF-të e specializuara në këtë fushë.

Për këtë arsye, rekomandimet e Avokatit të Popullit adresuar ministrit të Drejtësisë⁷³, kanë pasur në fokus çështjet më të rëndësishme si:

- plotësimin e organikës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas me stafin e parashikuar në zbatim të urdhërit nr.59, datë 25.03.2019 të Kryeministrit “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas*”, duke konsideruar se drejtuesit e nivelit të lartë dhe të mesëm kanë rolin kryesor në administrimin, koordinimin dhe identifikimin e nevojave për ndryshime dhe përmirësime në sistemin e ofrimit të ndihmës juridike falas. (*I zbatuar gjatë vitit 2020*)
- miratimin e dy projektudhëzimeve me Dhomën Kombëtare të Avokatisë konkretisht: “Për kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore”; “Për rregullat për zbatimin e parimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore”, në zbatim të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr.111/2017. (*Janë miratuar në muajin shtator 2020*)
- miratimin me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të udhëzimit për shpërblimin e avokatëve. (*Është miratuar në shtator 2020*)
- ngritjen e qendrave të ndihmës juridike falas parësore, duke siguruar një shpërndarje të drejtë gjeografike. (*Janë hapur 7, por vetëm një me fondet e buxhetit të shtetit*)
- realizimin e fushatave informuese lidhur me mënyrën e adresimit, kushtet që duhet të plotësojnë dhe procedurat që duhet të ndjekin për të aplikuar, duke u kushtuar më shumë vëmendje problematikave të grupeve në nevojë, me qëllim rritjen e aksesit të qytetarëve për ndihmën juridike falas.
- autorizimin e organizatave jofitimprurëse dhe listimin e tyre sipas detyrimeve ligjore, me qëllim ofrimin e ndihmës juridike parësore. (*Janë autorizuar 12 OJF*)
- shtimin e klinikave ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë në bazë të marrëveshjeve përkatëse në shkallë vendi. (*Janë hapur 10 të tilla*)
- konsultimin e gjerë në të ardhmen lidhur me prioritetet e ndihmës juridike falas dhe përmirësimet, ku të jenë pjesë përfaqësues të institucioneve shtetërore, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit.

Rekomandimet e Avokatit të Popullit u pranuan dhe u zbatuan gjatë vitit 2020.

Shpeshherë, shumë qytetarë për shkak të emërimit e përceptojnë institucionin e Avokatit të Popullit si një lloj agjencie që ofron shërbim avokator shtetëror falas dhe jo si një institucion që mbikëqyr respektimin e të drejtave të njeriut nga organet e administratës publike. Ndaj, në thelb, disa kërkesa të paraqitura konsistojnë në nevojën për shërbim avokator në çështjet gjyqësore, ku ata janë palë. Vlen të përmendim se ndihma juridike parësore është ofruar dhe vazhdon të ofrohet në vijimësi nga stafi i institucionit të Avokatit të Popullit.

⁷² Si OJF të tilla mund të përmenden: Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL), Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Qendra "Res Publica", Qendra për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri (CRCA), Albanian Disability Rights Foundation (ADRF), Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS), Qendra "Streha" etj.

⁷³ Për më shumë informacion, drejtoheni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.
<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/ëebbsite/media/Rekomandohet%20marria%20e%20masave%20p%C3%ABr%20garantimin%20e%20aksesit%20n%C3%AB%20drejt%C3%ABsi%20p%C3%ABrmes%20sistemit%20t%C3%AB%20ndihm%C3%ABs%20juridike%20n%C3%AB%20zbatim%20t%C3%AB%20ligjit.pdf>.

Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore janë shtuar gjatë vitit 2020. Ato gjenden në këto qytete: Lushnjë (me buxhetin e shtetit); Tiranë (me mbështetjen e OSFA), Durrës, Lezhë, Shkodër, Gjirokastrë, Pogradec (me mbështetjen e UNDP). Gjithashtu, gjatë vitit 2020 ka funksionuar edhe Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore në Fier me fondet e donatorëve të huaj sikurse janë PNUD dhe qeveria e Republikës së Austrisë, për t'u ardhur në ndihmë shtresave në nevojë.

Janë realizuar fletëpalosje ku përcaktohen: mënyra e adresimit, kushtet që duhet të plotësojnë përfituesit dhe procedurat që duhet të ndjekin për të aplikuar, duke u kushtuar më shumë vëmendje problematikave të kategorive të veçanta, me qëllim rritjen e aksesit të qytetarëve për ndihmën juridike falas.

Në muajin shtator 2020 janë autorizuar 12 organizata jofitimprurëse, me të cilat është në bashkëpunim Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas. Problematikë mbetet kryesisht financimi i tyre, i cili është në proces në kuadër të buxhetit të vitit 2021.

Nga Ministria e Drejtësisë janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me 10 institucione të arsimit të lartë, publike dhe private, por nuk ka mbështetje financiare për to, pasi nuk parashikohet në ligj.

Nga ana tjetër, evidentojmë se ka pasur raste kur vendimet e gjykatave për përfitimin e ndihmës juridike dytësore dhe përjashtimin nga pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore nuk janë zbatuar nga dhomat vendore të avokatisë. Gjithashtu, kriteret minimale të përcaktuara në ligj, bëjnë që vetëm një kategori e vogël e gupeve me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme të përfitojnë nga ndihma juridike dytësore falas.

Në kushtet e vendosjes së masave kufizuese si pasojë e pandemisë për shkak të përhapjes së COVID-19, u mbyllën qendrat e ndihmës parësore si dhe u pezulluan një pjesë e proceseve të punës. Ministria e Drejtësisë për të garantuar aksesin e qytetarëve nëpërmjet ndihmës juridike falas, ka vijuar ofrimin e shërbimeve online përmes platformës juristionline.al.

3.8 Të drejtat e ish të dënuarve dhe përndjekurve politikë nga sistemi komunist⁷⁴

Regjimi komunist për gati gjysmë shekulli ka shkaktuar një numër të madh viktimash në shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut dhe të ligjit ndërkombëtar humanitar. Shumë prej familjeve të viktimave nuk kanë arritur edhe sot e kësaj dite të gjejnë dhe të njohin fatin e të afërmeve të tyre. Shumica e krimeve dhe shkeljeve serioze të të drejtave të njeriut të kryera në Shqipëri gjatë epokës komuniste nuk janë hetuar dhe dënuar ende.

Edhe pse për këtë shtresë janë miratuar disa ligje, në Shqipëri, nga viti 1991 e deri tani, ato nuk janë zbatuar në mënyrën më të mirë të mundshme. Në jo pak raste ato kanë krijuar edhe kundërthënie midis tyre dhe kjo shtresë sot është shumë larg integritit, sidomos në aspektin e dëmshpërblimit financiar, i cili është në proces. Gjatë hartimit të akteve ligjore/nënligjore nuk ka pasur faza konsultimi efektive me viktimat, si edhe nuk janë marrë masa për të siguruar pjesëmarrjen e tyre në hartimin e legjislacionit për dëmshpërblimin.

Pikërisht në vitin 2007, u miratua ligji nr.9831, datë 12.11.2007 *“Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”*, në zbatim të të cilit janë nxjerrë akte nënligjore, me qëllim miratimin e skemës së shpërndarjes për kompensimin e ish të dënuarve politikë të komunizmit.

⁷⁴ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Veçantë në institucionin e Avokatit të Popullit.

Ndërkohë që mbetet i pazbatuar rekomandimi ynë për marrjen e masave organizative për nxjerrjen e Vendimit të Këshillit të Ministrave për miratimin e skemës së pensionit të veçantë për të internuarit dhe dëbuarit gjatë regjimit totalitar.

3.9 Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore civile dhe administrative⁷⁶

Gjatë vitit 2020 procesi i ekzekutimit të një numri titujsh ekzekutiv nga ana e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror apo atij Privat, si dhe autoriteteve të tjera të ngarkuar me ligj për ekzekutimin e tyre, rast pas rasti, në një afat të përcaktuar apo të arsyeshëm. Rezulton se ka pasur probleme lidhur me zhvillimin e tij në përputhje me parimin e ligjshmërisë.

Në procesin e shqyrtimit të 29 ankesave të paraqitura pranë institucionit të Avokatit të Popullit, nga të cilat 7 raste janë mbyllur në favor të ankuesve, është konstatuar se në disa prej tyre është cënuar e drejta themelore për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e moszekutimit të titujve ekzekutivë në një afat të arsyeshëm, sikundër sanksionohet në nenin 42/2, të Kushtetutës, apo në nenin 6/1, të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Edhe pse procesi i ekzekutimit të titujve ekzekutivë mbart problematika të njëjta sikundër dhe në vitet e mëparshme, autoritetet e ngarkuara me ligj nuk kanë kryer apo nuk kryejnë në afatin e përcaktuar ose në një afat të arsyeshëm, veprimet e parashikuara në ligj për ekzekutimin e tyre. Vlen të përmendet, se fryma e aplikimit të ligjit në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë ndaj subjektit privat është më “agresive” dhe efiçente krahasuar me atë shtetëror.

Në veprimtarinë e përmbartuesve gjyqësorë, si atyre të Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror apo Privat, për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv, janë vërejtur veprime dhe qëndrime në të cilat është konstatuar:

- Mungesë e cilësisë profesionale të autoriteteve të ngarkuara me ligj për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, e cila shfaqet në veprimet dhe mosveprimet institucionale gjatë procesit të ekzekutimit të titujve ekzekutiv.
- Mosnjohje e legjislacionit civil dhe atij procedural nga ana e përmbartuesve gjyqësorë.
- Kryerje e veprimeve përmbartimore jashtë objektit të ekzekutimit, si dhe keqinterpretim i dispozitivit të vendimit gjyqësor.
- Mungesë vullneti prej përmbartuesve gjyqësorë për vendosjen e sanksioneve ndaj subjektit pranë personit të detyruar, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, apo personave të tjerë në procesin e ekzekutimit, të cilët refuzojnë, ose kryejnë në mënyrë të parregullt, nuk respektojnë afatet ose kryejnë të kundërtën e asaj që është vendosur me vendim të gjykatës.
- Moskryerje e veprimeve prej autoriteteve të ngarkuara me ligj për ekzekutimin e titujve ekzekutivë, të cilat mundësojnë përmbushjen e detyrimit në të holla, që institucioni shtetëror detyrohet të paguajë sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Përgjatë vitit 2020, institucioni i Avokatit të Popullit ka konstatuar qartësisht se zbatimi i titujve ekzekutivë me palë debitore një organ të administratës publike, mbetet një çështje problematike. Referuar Kodit të Proedurës Civile, ekzekutimi i detyrimeve në të holla ndaj institucioneve buxhetore bëhet vetëm në llogarinë e tyre përkatëse bankare, në kredi që ata kanë te të tretët

[3%ABnligjor%20p%C3%ABr%20aplikimet%20p%C3%ABr%20d%C3%ABmshp%C3%ABrblim%20t%C3%AB%20ish%20t%C3%AB%20d%C3%ABnuarit%20politik,%20p%C3%ABr%20t%C3%AB%20cil.pdf.
https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/ëebbsite/media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20marrjen%20e%20masave%20p%C3%ABr%20rishikimin%20e%20dosjes%20s%C3%AB%20d%C3%ABmshp%C3%ABrblimit%20t%C3%AB%20ish%20t%C3%AB%20d%C3%ABnuarit%20politik%20H.K.%20duke%20rivler%C3%ABsuar%20trash%C3%ABgimtar%C3%ABt%20dhe%20m%C3%ABnyr%C3%ABn%20e.pdf.](https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/ëebbsite/media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20marrjen%20e%20masave%20p%C3%ABr%20rishikimin%20e%20dosjes%20s%C3%AB%20d%C3%ABmshp%C3%ABrblimit%20t%C3%AB%20ish%20t%C3%AB%20d%C3%ABnuarit%20politik%20H.K.%20duke%20rivler%C3%ABsuar%20trash%C3%ABgimtar%C3%ABt%20dhe%20m%C3%ABnyr%C3%ABn%20e.pdf)

⁷⁶ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Administratës në institucionin e Avokatit të Popullit.

dhe kur nuk ka të tilla në llogari të thesarit. Akti nënligjor, Udhëzimi nr.1, datë 04.06.2014, i Këshillit të Ministrave, *“Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisë të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”*, mbart në gjykimin dhe vlerësimin tonë probleme mospërputhshmërie me parimet kushtetuese, si, ai për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor (neni 42 i Kushtetutës) apo detyrimin e organeve shtetërore për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore (neni 142/3 të Kushtetutës).

Përcaktimet e bërë në pikat 5, 9, 10, dhe 11 të udhëzimit nr.1/2014, gjykojmë, se vijnë ndesh me nenet 116/1 dhe 118 të Kushtetutës, pasi jo vetëm rregullojnë çështje që eventualisht janë të rregulluara nga akte normative më të larta në hierarki, por tejkalojnë caqet dhe fushën e rregullimit të dhënë nga akti normativ, mbi bazë të të cilit ka dal ky Udhëzim.

Procesi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore ndaj institucioneve shtetërore debitore, gjykojmë, se është penguar dhe pengohet nga përcaktimet e kryera në udhëzimin në fjalë.

Në ndryshim nga vitet e shkuara numri i ankesave të marra në shqyrtim, që kanë pasur si objekt mosdorëzimin e detyrimeve në të holla nga ana e organit shtetëror debitor, sikurse është vendosur nga gjykata, ka qenë i ulët.

Në procesin e shqyrtimit të ankesave janë konstatuar qëndrime të parregullta nga ana e autoriteteve të ngarkuara me ligj për përmbushjen e detyrimeve ligjore të vendosura sipas titujve ekzekutivë. Procesi i ekzekutimit të titujve ekzekutivë prej Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor, si dhe autoriteteve të tjera të ngarkuar me ligj për ekzekutimin e tyre, në një afat të përcaktuar apo të arsyeshëm, nuk ka qenë objekt shqyrtimi gjatë vitit 2020 nga ana e Gjykatës Kushtetuese, për shkak të mosfunksionimit të kësaj Gjykate gjatë këtij viti.

Gjatë vitit 2020, institucioni i Avokatit të Popullit, në procesin e shqyrtimit të rasteve të pranura ka gjykuar se në një numër rastesh është cënuar dhe vijon të cënohet parimi për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të titullit ekzekutiv në një afat të arsyeshëm. Cënimi i këtij parimi, vërehet si në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutivë me objekt detyrimin e organeve të administratës publike të paguajnë detyrime në të holla ashtu dhe në rastin e detyrimit të tyre për kryerjen e një veprimi të caktuar. Cënimi i parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor është tregues, se nga ana e institucioneve përgjegjëse nuk merren masat përkatëse për shmangien e kësaj situate të përsëritur.

Kjo situatë përveç se, ndikon në humbjen e besimit të individit ndaj dhënies së drejtësisë, gjeneron dhe fatura financiare të cilat paguhet nga taksapaguesi dhe nuk i rikthehen atij në respektim të parashikimeve ligjore të Kodit Civil, apo akteve të tjera nënligjore si Udhëzimi nr.2, datë 06.02.2012, i Ministrit të Financave, *“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”*, (neni 62); Udhëzimi nr.1, datë 13.06.1997, i Ministrit të Financave, sipas Aktit Financiar nr.1, datë 13.10.1997, paragrafi 7, sipas të cilit, përcaktohet detyrimi i titullarit të institucionit debitor të kryej auditimin e gjithë procesit, i cili ka sjellë dëmin ekonomik, si dhe të marrë masa administrative e të fillojë procedime civile, kundër personave që kanë shkaktuar dëmin.

Mosrespektimi i akteve ligjore të lartpërmendura, ka sjellë dhe do të sjellë cënim të interesave pasurore për çdo taksapagues në Republikën e Shqipërisë. Çështja e cënimit të parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, prej autoriteteve të ngarkuara me ligj për ekzekutimin e titujve ekzekutivë në Shqipëri, është konstatuar dhe prej Gjykatës Evropiane të të Drejtave të

Njeriut, në vendimet e saj të vitit 2020, për një numër çështjesh⁷⁷.

Kanë vijuar ankesa lidhur me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të dhëna në favor të ish-punonjësve, veçanërisht në rastet kur gjykata është shprehur me vendim për rikthim në detyrë të nëpunësit. Në disa raste kemi hartuar rekomandime konkrete në drejtim të institucioneve që janë bërë pengesë për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, pasi, në gjykim të Avokatit të Popullit, mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, me justifikimin prej vitesh, të mungesës së një pozicioni pune të njëjtë për rikthimin në vendin e mëparshëm të punës apo në pozicione pune të ngjashme ka ndikuar në mosfinalizimin e procesit të dhënies së drejtësisë por dhe në një faturë financiare të shtuar për shtetin.

Duke qenë se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës duhet konsideruar si pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, do të vijojmë të monitorojmë zbatimin e Urdhërit nr.5151/1 datë 28.10.2015, të Ministrisë të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, lidhur me zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e vet, është shprehur se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme për rastet e rikthimit të gjyqfituesit në detyrë me qëllim vënien në vend të së drejtës së tij⁷⁸.

Po kështu, Gjykata Kushtetuese në vendimarrjet e saj ka theksuar se autoritetet shtetërore nuk mund të justifikohen me mungesën e fondeve për të mos respektuar një detyrim financiar që vjen nga një vendim gjyqësor.⁷⁹

Çështja e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë të dhëna prej gjykatave në Republikën e Shqipërisë, apo Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në një afat të arsyeshëm, mbetet me rëndësi thelbësore për shtetin, pasi lidhet me krijimin, forcimin dhe zhvillimin e një sistemi gjyqësor të besueshëm dhe respektueshëm për të gjithë.

Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimeve të gjykatave është një nga hallkat kryesore të shoqërisë demokratike. Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë në një afat të arsyeshëm, nga ana e organeve të administratës publike, në cilësinë e debitorit, mbetet një çështje që shkel parashikimet e bëra në nenin 142/3, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenin 451/a, të Kodit të Procedurës Civile, si dhe parimet mbi të cilat zhvillohet veprimtaria e organeve të administratës publike. Në procesin e shqyrtimit të ankesave gjatë vitit 2020, me objekt mosekzekutimin e titujve ekzekutivë, Avokati i Popullit gjykon se, shkak i cili sjell cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor është sikurse shprehur më lart problematika që mbart Udhëzimi nr.1, datë 04.06.2014, i Këshillit të Ministrave, *“Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisë të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”*. Për përmirësimin e kësaj situatë, Avokati i Popullit, rast pas rasti ka ndërhyrë dhe do të vijojë ndërhyrjen pranë organeve përkatëse për rregullimin e saj e deri në adresimin e plotë të këtyre gjetjeve me rekomandimet përkatëse.

Edhe pse objektivi i Qeverisë ka qenë dhe është moslejimi i borxheve të reja, i shprehur ky edhe në VKM nr.50, datë 05.02.2014, *“Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”*, rezulton, se ky objektivi nuk është arritur. Organet apo institucionet debitoare, me rastin e dorëzimit të detyrimit në të holla, sikurse është

⁷⁷ Ankimet nr.25038/08, 64376/09, 64399/09, 347/10, 1376/10, 4036/10, 12889/10, 20240/10, 29442/10, 29617/10, 33154/11 dhe 2032/12; Kërkesa nr.34602/16; Kërkesa nr. 1175/06.

⁷⁸ Shih vendimin nr.2, datë 01.02.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

⁷⁹ Shih vendimin nr.16, datë 04.05.2011 të Gjykatës Kushtetuese, Vendim datë 18.11.2004, I GJEDNJ-së *“Qufaj kundër Shqipërisë”*.

vendosur nga gjykata, nuk kanë kryer dhe nuk kryejnë në mënyrë të rregullt procedurat e përcaktuara në Udhëzimin Nr.2, Datë 06.02.2012, të Ministrit të Financave “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*”, (Neni 62), apo në Udhëzimin nr.1, datë 13.06.1997, të Ministrit të Financave, sipas Aktit Financiar nr.1, datë 13.10.1997, Paragrafi 7. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, titullarët e tyre, si organe përgjegjëse për ekzekutimin e detyrimeve në të holla të rrjedhura nga vendimet gjyqësore civile të formës së prerë, nga konstatimet e institucionit tonë, në asnjë rast nuk kanë kryer dhe nuk kryejnë analizimin e vendimeve gjyqësore civile, si dhe kërkimin për nxjerrjen e përgjegjësi administrative.

Situata në të cilën ndodhet prej vitesh procesi i ekzekutimit të titujve ekzekutiv, me objekt “*Detyrim të organit, institucionit shtetëror për pagim të hollash*”, shtron nevojën e marrjes së masave të menjëhershme prej institucionit qendror, si në aspektin administrativ ashtu dhe civil, sipas shkallës së përgjegjësisë së individit përgjegjës. Respektimi i procedurës sikurse përcaktuar në aktet nënligjore të lartpërmendura, do të mundësojë jo vetëm rikthimin në buxhetin e shtetit të vlerave në të holla të paguara në zbatim të vendimit gjyqësor civil, por do të minimizojë detyrimet në të holla të institucioneve shtetërore.

3.10 Respektimi i të drejtës së pronës⁸⁰

Çështja e respektimit të së drejtës së pronës private, sikurse garantuar nga sanksionimi i kryer në nenin 41 dhe 42/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, apo nenin 1 të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996, “*Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore*”, gjatë vitit 2020, ka pasur dhe vijon të ketë probleme të cilat lidhen si me kuadrin ligjor ashtu dhe me veprimtarinë e organeve të administratës publike në procesin e shqyrtimit dhe garantimit të kësaj të drejte.

E drejta e pronës përgjatë vitit 2020 ka qenë në fokus të veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit e lidhur kryesisht kjo jo vetëm me ankesat e ardhura në adresë të institucionit por dhe me aktet e ndërmarra gjatë këtij viti nga ana e organeve shtetërore të cilat në thelb të veprimeve apo mosveprimeve të tyre kanë patur shkeljen flagrante të së drejtës së pronës të individëve/pronarëve apo një grupi më të gjerë komuniteti në forma dhe mënyra të ndryshme.

Gjatë vitit 2020 janë *trajtuar 59 ankesa* të cilat kanë rezultuar pozitive pas ndërhyrjes së institucionit të Avokatit të Popullit. Objekti i ankesave të administruara në institucionin e Avokatit të Popullit ka qenë i orientuar kryesisht ndaj strukturave të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorive Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Agjencisë së Trajtimit të Pronave dhe Bashkive.

Ankesat kanë patur për objekt kundërshtimin e veprimeve apo mosveprimeve të institucioneve të sipërpërmendura lidhur me:

- mosregjistrim të pasurive të paluajtshme, konkretisht Akte të Marrjes së Tokës në Pronësi/përdorim;
- regjistrim të pasurive të fituara me një nga mënyrat e parashikuara në nenin 193 të Kodit Civil;
- akte të nxjerra nga institucionet e pushtetit vendor për regjistrim të truallit;
- legalizim dhe regjistrim të pasurive të ndërtuara në zonat urbane dhe ato rurale;

⁸⁰ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Administratës në institucionin e Avokatit të Popullit.

- mosrespektim të afateve procedurale për trajtim të kërkesave të qytetarëve;
- pajisje me akte kadastrale për pasuritë e regjistruara në regjistrat kadastralë;
- qasje me dy standarte në regjistrimin e pasurive të paluajtshme (shtet/privat);
- vështirësi dhe problematikë të theksuar në aplikim të portalit e-albania, mosrakordim të veprimtarisë midis Institucionit Qendror ASHK me Drejtoritë Vendore dhe institucionet që kanë prodhuar akte të detyrueshme për regjistrim në kuptim të ligjit 111/2018 “Për kadastrën”.

Gjatë vitit 2020 kuadri ligjor në fushën e të drejtës së pronësisë u plotësua me ligjin nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare në RSH”, i cili synon që brenda një periudhe afatshkurtër të përfundojë proceset kalimtare në regjistrimin e titujve të pronësisë për pasuritë e paluajtshme në pronësi shtetërore dhe private në Republikën e Shqipërisë, si dhe inventarizimin, transferimin, trajtimin dhe regjistrimin përfundimtar të tyre.

Për tu theksuar është edhe fakti se në fazën e projekt-ligjit, janë dhënë vlerësime dhe opinione si nga organizma ndërkombëtarë ashtu edhe institucionet vendase, të cilat kanë evidentuar paqartësi apo mosrespektim të së drejtës së pronës sikurse garantuar nga Kushtetuta dhe KEDNJ-ja.

Në tërësinë e tij, në këndvështrimin e institucionit të Avokatit të Popullit, ligji merr përsipër dhe synon të formalizojë dhe finalizojë regjistrimin e pasurive të paluajtshme të cilat janë përfituar me akte ligjore e nënligjore për pronësinë, kryesisht AMTP në pronësi apo përdorim, përfundimin e proceseve të pajisjes me tituj pronësie të përdoruesve të tokave të ish kooperativave dhe ish-ndërmarrjeve bujqësore, legalizimin e objekteve pa leje, kur mungojnë aktet e pronësisë për ato pasuri të cilat disponohen apo dhe ato në përdorim, etj.

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji institucionet si Drejtoritë Vendore Rajonale të Kadastrave kanë hasur vështirësi në zbatimin e tij për faktin se bëhet gati 1 (një) vit nga fillimi i zbatimit të tij dhe ligji ende nuk është plotësuar me aktet nënligjore gjë që e bën pothuajse të vështirë zbatimin e tij. Mosplotësimi me aktet nënligjore (14 dispozita që duhet të plotësohen me akte nënligjore) i këtij ligji ka shoqëruar problematikën më të madhe të kërkesave në fushën e të drejtës së pronësisë që ka trajtuar institucioni i Avokatit të Popullit, konkretisht:

- Mungesa e procedurave të regjistrimit të AMTP të dhëna në pronësi të paregjistruara më parë në regjistrat e pasurive të paluajtshme;
- Mungesa e procedurave të regjistrimit të AMTP në përdorim, si një risi që do të sillte ligji;
- Korrigjimet, saktësimet dhe rregullimi i sipërfaqeve grafike të pasurive të përfituara me AMTP, të cilat janë shoqëruar shpeshherë me konflikte dhe situata kontradiktore pronësie;
- Përfundimi i procesit të legalizimit të objekteve pa leje apo në shkelje të lejes si një nga proceset më të rëndësishme të së drejtës së pronësisë;
- Mospërfundimi i procedurave nga organet e njëjësive të qeverisjes vendore për formalizimin dhe finalizimin e akteve mbi trojet e dhëna për qëllime ndërtimi;
- Mungesa e procedurave për regjistrimin e lejeve të ndërtimit të cilat janë në shkelje të ligjit;
- Mungesa e procedurave për prodhimin dhe finalizimin e aktit të pronësisë për pasuritë që nuk zotërojnë një titull pronësie, apo “oborret në përdorim”.

Theksojmë se shkeljet dhe cënimet e të drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasve të kryera nëpërmjet veprimeve ose mosveprimeve të punonjësve apo strukturave të caktuara të Drejtorive Vendore të Kadastrave kanë ardhur edhe si rezultat i mosnjohjes së ligjit dhe keqpërdorimit të tij në zgjidhje të problematikave të krijuara. Në raport me çka është paraqitur në raportin përfundimtar të institucionit të Avokatit të Popullit në Kuvend për vitin 2019 në pikëpamje të

mbrojtjes të së drejtës së pronësisë vërehet me keqardhje se situata nuk ka ndryshuar. Qasja e këtyre institucioneve ndaj problemeve të regjistrimit të pasurive të paluajtshme mbetet e njëjtë, ajo e refuzimit të interesimit të shtetasve për zotërimin e pasurisë duke mos u garantuar atyre të drejtën për tu pajisur me certifikata pronësie.

Ankesat e shtetasve drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me cënimin e kësaj të drejte kanë qenë të shumta në të cilat është vërejtur se edhe pas hyrjes në fuqi dhe fillimit të zbatimit qoftë të ligjit 111/2018 *“Për Kadastrën”* dhe ligjit 20/2020 *“Për përfundimin e proceseve kalimtare në RSH”*, situata në drejtim të respektimit të afateve procedurale të ofrimit të shërbimit ndaj qytetarëve është ende shumë larg pritshmërisë. Kjo situatë është referuar edhe në raportin e vitit 2019, por gjendja vazhdon të mbetet e njëjtë ndoshta akoma më problematike.

ASHK-ja si autoritet publik përgjegjës për zbatimin e ligjit 20/2020, ushtron përgjegjësi jo vetëm për detyrat e ngarkuara sipas ligjit nr.111/2018, *“Për Kadastrën”*, por edhe ato të ngarkuara sipas ligjit nr.20/2020, të cilat më parë përmbusheshin nga disa organe të tjera publike. Rritja e numrit të detyrave, kompleksiteti i tyre, paqartësia e dispozitave ligjore të ligjit nr.20/2020, ka cënuar dhe cënon parimin për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor në dhënien e shërbimeve në një afat të arsyeshëm. Afatet ligjore të përcaktuara në listën e shërbimeve të ASHK-së, ligjin nr.111/2018 *“Për Kadastrën”* apo *“Kodin e Procedurës Administrative”*, shkelen në mënyrë të vazhdueshme nga ana e drejtorive vendore të ASHK-së, veprimtari e cila vjen në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë, i detyrueshëm në kuptim dhe zbatim të nenit 2 të Kodit të Procedurës Administrative.

Situata e mosrespektimit të afateve procedurale të ofrimit të shërbimit është evidente kryesisht në trajtimin e dosjeve të legalizimit dhe të kërkesave për regjistrim të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi/Përdorim. Në këndvështrimin e institucionit të Avokatit të Popullit, për mospërgjigjen në kohë dhe trajtim brenda afateve të përcaktuara vetë në ligj (neni 29), rol ka luajtur dhe futja e aplikimit on-line nëpërmjet portalit e-albania e cila i ka vështirësuar kërkesat për përpunim dhe marrjen e informacionit prej saj për vazhdimin e mëtejshëm të ofrimit të shërbimit. Lidhur me mosrespektimin e afateve procedurale nga drejtoritë vendore të kadastrave, institucioni i Avokatit të Popullit ka bërë rekomandime drejtuar institucioneve kompetente si dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Reagimet ndaj rekomandimeve të institucionit tonë kanë qenë të pakta dhe jo shteruese. Drejtoritë rajonale të kadastrës përveç faktit të informimit jo vetëm nuk zbatojnë rekomandimin e institucionit tonë por vazhdojnë të veprojnë në shkelje të ligjit organik si dhe të Kodit të Procedurave Administrative. Për më tepër, mospajisja me certifikatë i pasurive të përfituara me një nga mënyrat e përcaktuara me ligj, cënon rëndë parimin e sigurisë juridike të pasurisë dhe disponimit lirisht të tij duke penguar faktin e qarkullimit civil të pasurisë.

Në zbatim të ligjit 20/2020 *“Për përfundimin e proceseve kalimtare në RSH”*, për dispozitat nr. 9, 10, 34, 18, 21 dhe dispozitat nr. 30, 63 dhe 71 e ligjit 111/2018 *“Për Kadastrën”*, qeveria ka miratuar aktet nënligjore të cilat, në vlerësim të institucionit të Avokatit të Popullit, janë konfuze dhe marrin përsipër të zgjidhin një mori gjendjesh juridike të pasurive qoftë të regjistruara apo të parregjistruara, por nuk kanë të përcaktuar qartë procedurat që duhet të ndjekë poseduesi apo pronari dhe roli që ka institucioni, në këtë rast, Drejtoritë Vendore të Kadastrës.

Marrëdhëniet e institucionit të Avokatit të Popullit me drejtoritë rajonale të kadastrës, mbi paraqitjen e informacionit në funksion të identifikimit të problematikës së ankesave/kërkesave të shtetasve, ka qenë problematike pasi në rastet më të shpeshta ky informacion ka munguar ose ka qenë i paqartë dhe jo i plotë. Në këto kushte, institucioni i Avokatit të Popullit ka kërkuar nga ASHK fillimin e ecursisë disiplinore për ato drejtori rajonale të kadastrës dhe punonjës që nuk kanë zbatuar detyrimin ligjor për dërgimin e informacionit pranë institucionit të Avokatit

të Popullit duke sjellë vonesë në trajtimin e dosjes dhe vështirësi në hetimin administrativ të nisur nga institucioni ynë.

Një çështje aktuale në marrëdhënien midis subjekteve të interesuar dhe ASHK-së është përcaktimi në pikën 6, të VKM-së. 389, datë 13.5.2020, “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”, ku përcaktohet se: “Të gjitha subjektet e interesuara, duke përfshirë edhe institucionet publike, e paraqesin kërkesën për shërbime kadastrale në rrugë digjitale online, nëpërmjet platformës e-Albania. Tarifa e shërbimit paguhet në momentin e paraqitjes së kërkesës për shërbim nga subjekti i interesuar ose në momentin e dhënies së pëlqimit për përfitim të shërbimit nëpërmjet noterit”.

Nisur nga përcaktimi i sipërcituar, ASHK-ja nuk pranon kërkesa/aplikime të subjekteve të interesuar për marrje shërbimi veçse në rrugë digjitale nëpërmjet platformës e-Albania. Kuptimi dhe zbatimi i pikës 6 të VKM-së nr.389/2020, interpretohet dhe zbatohet në mënyrë të gabuar prej ASHK-së kur kushtëzon dhënien e shërbimit vetëm në rrugë elektronike. Ky kuptim dhe zbatim i pikës 6 të aktit nënligjor në fjalë, vjen ndesh me parashikimin e nenit 10/2 të Kodit të Procedurës Administrative, në të cilin parashikohet: *Organi publik promovon mundësinë e palës për të aksesuar autoritetin publik në mënyrë elektronike. Kjo mundësi nuk është e lidhur me ndonjë detyrim të palës për të përdorur mjete të komunikimit elektronik.*

Në kushtet e mosrespektimit të detyrimit ligjor si më sipër cituar, veprimtaria e ASHK-së, nuk vjen në përputhje me parimin e ligjshmërisë, dhënies së ndihmës aktive, si dhe detyrimin ligjor të parashikuar në pikat 1 dhe 3 të nenit 10 të K.Pr.A., përkatësisht:

- Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre.
- Organi publik, që zhvillon procedurën administrative, siguron që padia e palës të mos përkeqësojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave që pala gëzon sipas ligjit.

Tjetër çështje e lindur nga kuptimi dhe zbatimi i gabuar i pikës 6 të VKM-së nr.389/2020, është kërkitimi i pagimit të tarifës prej institucionit të Avokatit të Popullit me rastin e kërkitimit të informacioneve dhe shpjegimeve për çështjet në proces shqyrtimi. Për këto probleme të krijuara prej ASHK-së, institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar zgjidhjen e tyre nëpërmjet rekomandimit⁸¹ i cili u është dërguar Këshillit të Ministrave dhe ASHK-së.

Një nga detyrat kryesore në ushtrim të kompetencave të ASHK në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale të Kadastrës, është fillimi dhe përfundimi i procesit të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme në zonat ku ky proces nuk ka filluar apo dhe në ato zona ku ende nuk ka përfunduar. Kjo situatë ka sjellë, sidomos në zonën bregdetare, një problematikë të madhe lidhur me të drejtën e pronësisë, pasi personat juridikë apo fizikë që disponojnë pasuritë e tyre në këto zona në mungesë të certifikimit të pronave të tyre po përballen me veprimtarinë antiligjore dhe në shkelje të të drejtave të njeriut nga ana e institucioneve vendore dhe qendrore lidhur edhe me procedurat e shpronësimit për pasuritë që për interes publik po ju merren individëve apo personave juridike në shkelje të ligjit për shpronësim me argumentin që pasuritë nuk janë të regjistruara dhe të certifikuara.

⁸¹ Ky rekomandim gjendet në linkun:

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/P%C3%ABr%20zgjidhjen%20e%20disa%20problemeve%20t%C3%ABr%20evidentuara%20n%C3%ABr%20komunikimin%20me%20disa%20Z.%20Sh.pdf>.

ASHK u krijua si institucion në kompetencë të të cilit do të ishte jo vetëm regjistrimi i titujve të pronësisë të prodhuara nga institucione të cilat kanë patur të drejtën e prodhimit të akteve të pronësisë por edhe menaxhimi i kadastrës digjitale si një tregues dhe hap pozitiv në ruajtjen e të dhënave kadastrale. Por mungesa e hartimit të akteve nënligjore nuk ka bërë të mundur mënyren e krijimit, grumbullimit dhe ruajtjes së të dhënave digjitale, si një element që do të garantonte ruajtjen dhe sigurinë e informacionit kadastral.

Për sa i takon trajtimit të ankesave për Agjencinë e Trajtimit të Pronave në përputhje me ligjin nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompesimit të pronave” konstatohet se numri më i madh i ankesave është në drejtim të zvarritjes së procesit të kompensimit financiar, proces i cili nuk ka dhënë rezultat dhe për më tepër subjektet e kompesuara ende nuk kanë marrë kompensimin financiar. Për këtë problematikë nga institucionet përkatëse nuk ka përgjigje shteruese duke rënduar më tej gjendjen e ish pronarëve përballë përfitimit financiar. Lidhur me të drejtën e kompensimit konkretisht në përputhje me VKM-në nr.699 datë 30.10.2019, “*Për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi parcelat e objekteve të legalizuara dhe kompensimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken prej tyre*” në bazë të cilit është bërë Njoftimi Publik mbi fillimin e procesit të pranimit të kërkesave për kompensimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet informale, gjeneralitetet dhe të dhënat e të cilëve janë sipas VKM Nr.699, datë 30.10.2019, ende pronarët e pasurive të cilët preken nga ndërtimet informale nuk kanë përfituar sipas kësaj VKM-je kompesimin financiar.

Një realitet i përsëritur dhe i trajtuar edhe në raportin e vitit 2019 është *mosregjistrimi i mbi 26 mijë titujve të pronësisë*⁸², vendimeve të dhëna në vite prej ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, ish-Agjencisë Shtetërore të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, sot Agjencia e Trajtimit të Pronave, me objekt njohje e pronësisë me të drejtë kompesimi nga ana e ish-zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, sot drejtorive vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Ky qëndrim vjen ndesh me parashikimin e kryer në nenin 196 të Kodit Civil si dhe nenin 24 të ligjit nr.111/2018 “*Për Kadastrën*”. Nëse do të ishte respektuar ky detyrim ligjor, asnjë pasuri e paluajtshme nuk do të mund të tjetërsohej nga subjektet përfitues sipas ligjit 7501/1991 “Për tokën”, etj, pa u kryer më parë kompesimi i subjektit pronar.

Ish-Komisioni i Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, ish-Agjencia Shtetërore e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, sot Agjencia e Trajtimit të Pronave, nuk kanë përmbushur dhe nuk përmbushin detyrimin për dërgimin pranë zyrës që administron regjistrin e pasurive të paluajtshme ku ndodhet prona, të mbi 26 mijë vendimeve për regjistrim, sipas të cilëve është vendosur për njohjen e pronës me të drejtë kompesimi.

Një ndër problematikat e konstatuara gjatë veprimtarisë së Avokatit të Popullit, gjatë viteve të mëparshme por që vazhdon edhe për vitin 2020, është shpronësimi për interes publik i pronës private nga shteti. Shpronësimi për interes publik i pronës private në RSH, përveç garancive kushtetuese dhe parashikimit nga KEDNJ, rregullohet edhe nga përcaktimet e Ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” (ndryshuar me ligjin nr. 20/2016, datë 10.3.2016) dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Ky i fundit është ndryshuar së fundmi me ligjin nr. 11/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar.

⁸² Raporti vjetor i ATP për vitin 2019.

Pothuaj në të gjitha rastet, konstatohet se, organet e administratës shtetërore sillen “në mënyrë arbitare” me titullarët e së drejtës së pronës/pronarët por edhe poseduesit, duke qenë se i zhveshin këta të fundit nga e drejta e pronësisë dhe nuk i dëmshperblejnë/kompensojnë paraprakisht, kundrejt një shpërblimi të drejtë dhe brenda afateve ligjore. Qytetarët ndihen të pafuqishëm nga forca shtrënguese e shtetit i cili në këtë rast e përdor “forcën” jo në mbrojtje të tyre por ndaj tyre. Shteti, nëpërmjet organeve të administratës publike, duhet të kujdeset për interesat pronësore të qytetarëve, në rast shpronësimi, duke pasur në konsideratë procesin e rregullt ligjor dhe nevojat social-ekonomike të tyre. Vërtet kushtetuta, KEDNJ, si dhe ligjet, parashikojnë kufizime të së drejtës së pronësisë, por këto kufizime duhet të jenë të ligjshme, të bëhen vetëm në rast të një interesi publik, kundrejt shpërblimit të drejtë, si dhe të kenë në themel parimin e proporcionalitetit. Koncepti i shpronësimit dhe shpërblimit të pronës nuk përfshihet vetëm për pasuritë e regjistruara por edhe për ato që i janë nënshtruar një procesi të ligjshëm, sikurse pasuritë në proces legalizimi.

Në lidhje me këtë problematikë, pranë institucionit të Avokatit të Popullit janë administruar 21 ankesa të paraqitura nga individët, të cilët ankohen ndaj institucioneve përgjegjëse për shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si dhe 6 raste të ndjekura me iniciativë nga institucioni ynë. Nga ankesat e depozituara pranë institucionit tonë, për të cilat kemi adresuar edhe rekomandime tek institucionet përgjegjëse, konstatohet se shpërblimi njihet vetëm kundrejt atyre individëve të cilët e kanë regjistruar pasurinë.

Një problematikë e bërë prezente në ankesat pranë institucionit të Avokatit të Popullit, është fakti që edhe pse individëve u janë marrë pasuritë për interes publik, ende zvarritja e procedurave administrative nga ana e institucioneve që kanë për detyrim plotësimin e dokumentacionit për marrjen e shpërblimit është shqetësuese dhe cënon të drejtën për një shpërblim në kohë. Shtuar këtij shqetësimi është dhe fakti se institucionet sjellin pengesa dhe zvarritje pa asnjë logjikë dhe pa bazë në mënyrën e pagimit të dëmshpërblimit kosto kjo që rëndon në anën e subjekteve të shpronësuara.

Ndërkohë, për pasuritë në proces legalizimi nuk janë marrë masa për shpërblimin e tyre, madje as në rastet kur ka kaluar parcela ndërtimore në pronësi kundrejt çmimit dhe lidhjes së kontratës, nuk janë marrë masa për shpronësimin e truallit. Ky veprim i organeve të administratës shtetërore justifikohet me faktin se nuk kanë konfirmim për regjistrimin e truallit. Një fakt i tillë konstatohet psh. në rastin e shembjes së disa objekteve, me qëllim *zbatimin e projektit “Bulevardi Verior dhe Rehabilitimi i Lumit të Tiranës”*.⁸³ Kjo analizë dhe ky justifikim nuk është aspak ligjor dhe cënon drejtpërdrejt të drejtat pronësore të qytetarëve. Institucionet shtetërore në këtë rast nuk kanë respektuar parimin e një procesi të rregullt ligjor, duke cënuar të drejtën për strehim dhe të drejtën për jetë familjare, të drejta këto që duhet të qëndrojnë në themel të veprimtarisë së organeve të administratës shtetërore.

Edhe Gjykata e Strasburgut në disa vendime të saj me fokus problematikën e procesit të kompesimit, ka bërë të qartë se, e drejta për strehim përfshin edhe rastin e godinave të ndërtuara në mënyrë të paligjshme ose që ju mungon dokumenti i pronësisë. Në çështjen “*Affaire Bagdonavicius et autres*” kundër Rusisë, kjo e fundit, konstatoi se ankuesit kishin pësuar një shkelje të së drejtës për respektimin e jetës private, jetës familjare dhe shtëpisë. Thelbi i konstatimit të gjykatës ishte që autoritetet shtetërore nuk shqyrtuan faktin nëse prishja e shtëpive të ankuesve ishte në përputhje me parimin e proporcionalitetit, përpara se të vijonin me prishjen e objekteve. Institucionet shtetërore gjatë veprimtarisë së tyre administrative duhet të kenë

⁸³ <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20ndaj%20IMT,%20DVASHK%20Tiran%20projektit%20E2%80%9CBulevardi%20Verior%20dhe%20Rahabilitimi%20i%20Lumit%20t%C3%AB%20Tiran%C3%ABs.pdf>

parasysh edhe t'i referohen këtyre vendimeve të cilat ndër vite kanë rënduar buxhetin e shtetit dhe për pasojë atë të shtetasve shqiptarë.

Organet e administratës shtetërore duhet të jenë shembull i zbatimit të parimit të ligjshmërisë, ku me ligjshmëri kuptohet kërkesa për respektimin e përpiktë dhe pa kushte të kushtetutës, ligjeve dhe akteve nënligjore nga të gjithë organet e administratës shtetërore, personave zyrtarë, organizatave shoqërore dhe shtetasve në Republikën e Shqipërisë. Neni 9 i Kodit të Procedurave Administrative sanksionon se organet e administratës publike e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare, ligjet dhe brenda kufijve dhe kompetencave që u janë dhënë, si dhe konform qëllimit për të cilat janë dhënë këto kompetenca.

Zbatimi i parimit të ligjshmërisë, përveç se parashikohet shprehimisht në Kushtetutë, i cili gjen shprehjen e vet në nenet 116 dhe 118 të saj, është kusht për ekzistencën e shtetit ligjor. Ndër të tjera, ligjshmëria nënkupton garantimin e të drejtave të njeriut, gjë që nuk rezulton të jetë garantuar nga institucionet shtetërore si bashkitë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, IKMT, ministria përgjegjëse për shpronësimet, etj. Si përfundim theksojmë se, shpronësimi për interes publik i pronës private, përbën një kufizim sensitiv/delikat në të drejtën kushtetuese. Këto kufizime duhet të trajtohen me kujdesin e duhur dhe të jetë në vëmendjen e institucioneve shtetërore, në mënyrë që të mos perceptohen arbitrare nga individët.

3.11 Rregullimi i marrëdhënieve të punës dhe respektimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor në procedurën administrative⁸⁴

Menaxhimi i marrëdhënieve të punës në administratën publike dhe respektimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor në procedurat administrative, kanë qenë ndër fushat për të cilat institucioni i Avokatit të Popullit është investuar nëpërmjet kryerjes së hetimeve të thelluara administrative dhe adresimit të rekomandimeve, për shkak të ankesave të depozituara nga vetë punonjësit të cilët janë liruar, transferuar, pezulluar apo kanë marrë masë disiplinore, por edhe nisur nga situata e pazakontë që u krijua për shkak të gjendjes së pandemisë COVID-19 në vendin tonë. Gjatë vitit 2020, janë trajtuar gjithsej 63 raste/ankesa që lidhen me marrëdhëniet e punës, prej të cilave 43 raste të zgjidhura në favor të qytetarëve.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se çështja e rregullimit dhe menaxhimit të duhur të marrëdhënieve të punës në administratën publike, si për punonjësit, marrëdhënia e punës së të cilëve rregullohet sipas dispozitave të Kodit të Punës, ashtu dhe për nëpunësit, marrëdhënia e punës së të cilëve rregullohet sipas legjislacionit në fushën e shërbimit civil, është tepër e rëndësishme për të garantuar ndërtimin, funksionimin dhe qëndrueshmërinë e një administrate publike të bazuar në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka konstatuar në disa raste se nga organet e administratës publike ka kuptueshmëri dhe zbatueshmëri të pamjaftueshme lidhur me parimet dhe procedurat e duhura që duhet të ndiqen për të garantuar respektimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në procedurën administrative, jo vetëm lidhur me marrëdhënien e punës, por edhe në përgjithësi. Në disa raste, kemi vlerësuar se procedurat administrative kanë qenë të paqarta dhe të paplota, duke mos krijuar garanci për respektimin e parimit të qartësisë dhe sigurisë juridike, i cili është një nga parimet më të rëndësishme në procedurat administrative, aq më tepër në

⁸⁴ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Administratës në institucionin e Avokatit të Popullit.

rastet kur procedura administrative cënon drejtpërdrejt një interes dhe të drejtë të ligjshme të palës, siç është e drejta për punësim e, rrjedhimisht, për mirëqenie shoqërore dhe ekonomike.

Procesi i rregullt ligjor, i garantuar si e drejtë themelore e njeriut zbatohet edhe në procedurat administrative, ndonëse ai nuk është i parashikuar shprehimisht në ligjin horizontal për procedurat administrative (Kodi i Procedurave Administrative). Kjo e drejtë gjendet e pasqyruar dhe mishëruar plotësisht përmes elementëve thelbësorë të këtij parimi, të cilat janë ligjshmëria, transparenca, informimi, proporcionaliteti, drejtësia dhe paanësia, objektiviteti, përdorimi i gjuhës të njohur nga subjekti, e drejta e aksesit dhe përfaqësimit, e drejta e informimit, e drejta për t'u dëgjuar, kontradiktoriteti, koha e arsyeshme, arsyetimi i vendimmarjes, e drejta e ankimit administrativ dhe gjyqësor, etj. E drejta për një proces të rregullt në procedurat administrative, e sanksionuar nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (neni 6), Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (neni 42), është një parim themelor kushtetues i konfirmuar tashmë nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, që shërben si garanci për subjektet e së drejtës nga veprime apo mosveprime të organeve të pushtetit shtetëror, e reflektuar gjerësisht në Kodin e Procedurave Administrative, i cili është ligji horizontal që rregullon organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë administrative dhe të administratës publike në tërësi.

Në rastet kur, pas analizimit me kujdes të shpjegimeve të dërguara nga institucionet si edhe të dokumentacionit të përcjellë, institucioni i Avokatit të Popullit ka vlerësuar se ka vend për përmirësim të procedurës administrative, duke adresuar edhe rekomandimet përkatëse.⁸⁵ Në këtë kuadër, për shembull, në marrëdhënien e punës por edhe në marrëdhënien juridike në përgjithësi, Avokati i Popullit ka rekomanduar⁸⁶ disa herë që institucionet të kryejnë një analizë të rasteve konkrete (të rrethanave të faktit) dhe të hartojnë relacione të plota e të detajuara të masës së përgjegjësisë në nivel hierarkik ndërmjet strukturave të institucionit lidhur me emërimet dhe lirimet/largimet e ankuesve në kundërshtim me ligjin. Kjo, për të konkluduar qartësisht të paktën lidhur me masën e përgjegjësisë në nivel hierarkik të institucionit, duke adresuar drejt përgjegjësinë tek personat përkatës.

Shtysa për të ndërhyrë në zgjidhjen e këtyre problematikave nëpërmjet rekomandimeve ka ardhur, ndër të tjera, edhe për shkak të faktit se, në mjaft raste, në dokumentacionin e vënë në dispozicion pranë institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me ankesat, përgjithësisht nuk është përcjellë akti administrativ konkret. Kjo do të shërbente për të vërtetuar metodologjinë e ndjekur nga institucioni për realizimin e vendimmarjes, ose veprimet që janë kryer për identifikimin e përgjegjësisë në të gjithë nivelet e hierarkisë që kanë shkaktuar shkeljen e të drejtave të qytetarëve. Shpesh moskryerja e analizave të argumentuara, ka penguar marrjen e një vendimi të drejtë për qytetarin.⁸⁷

Konkretisht, ndër problematikat kryesore të evidentuara nga ankesat e depozituara apo nga rastet e ndjekura me iniciativë nga institucioni i Avokatit të Popullit lidhur me marrëdhënien e punës në administratën publike, nënvizojmë:

- Ankesa/raste lidhur me lirim/largim të padrejtë nga detyra;

⁸⁵<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20lidhur%20me%20p%C3%ABrmir%C3%ABsimin%20e%20procedurave%20t%C3%AB%20mira%20administrative%20n%C3%AB%20kuad%C3%ABr%20t%C3%AB%20respektimit%20t%C3%AB%20t%C3%AB%20drejt%C3%ABs%20s%C3%AB%20qytetar%C3%ABve%20p%C3%ABr%20nj%C3%AB%20proces%20t%C3%AB%20.pdf>.

⁸⁶<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20kryerjen%20e%20nj%C3%AB%20analize%20t%C3%ABr%C3%ABsore%20lidhur%20me%20rastin%20endjekur%20me%20iniciativ%C3%ABn%20e%20Avokatit%20t%C3%AB%20Popullit%20p%C3%ABr%20heqjen%20e%20punonj%C3%ABsve%20nga%20puna.pdf>.

⁸⁷<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandohet%20marrja%20e%20masave%20urgjente%20p%C3%ABr%20furnizimin%20me%20uj%C3%AB%20t%C3%AB%20pijsh%C3%ABm%20brenda%20kushteve%20higjieno-sanitare%20p%C3%ABr%20banor%C3%ABt%20e%20fshatit%20Bogdan,%20Nj%C3%ABsia%20.pdf>.

- Ankesa/raste lidhur me procedurat e emërimit në administratën publike;
- Ankesa/raste për transferim të padrejtë në një tjetër pozicion;
- Ankesa/raste lidhur me zbatimin e institutit të pezullimit të marrëdhënies në shërbimin civil;
- Ankesa/raste lidhur me procedurat e ristrukturimit të institucioneve të administratës publike;
- Kërkesë/ankesa për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë.

Në zbatim të procedurës së ndjekur nga institucioni i Avokatit të Popullit për zhvillimin e hetimit administrativ, kemi kërkuar shpjegime dhe dokumentacion nga institucionet e administratës publike, për të shqyrtuar procedurën e ndjekur dhe për të vlerësuar mundësitë e ndërhyrjes për rivënien në vend të të drejtave të shkelura, në ato raste kur janë konstatuar shkelje të legjislacionit apo procedurës.

Në rastet e ankesave lidhur me lirim/largim të padrejtë nga detyra, kemi kërkuar nga institucionet informacion mbi arsyet ligjore të lirimit apo largimit, kopje të dosjes personale të nëpunësit/nëpunësve (e cila, për hir të së vërtetës, rrallë herë është vendosur në dispozicion). Po kështu, kemi kërkuar edhe kopje të dokumentacionit ku materializohet procedura administrative e ndjekur nga institucioni. Pjesa më e madhe e rasteve rezulton të jenë lirime si shkak i procedurave të ristrukturimit për punonjës, marrëdhëniet e punës të të cilëve, janë rregulluar sipas Kodit të Punës apo legjislacionit të shërbimit civil.

Problematikë shqetësuese mbetet funksionimi i duhur i komisioneve të ristrukturimit, veçanërisht sa i takon mbajtjes në konsideratë të kriterëve që lidhen me vjetërsinë e punës apo dhe kushtet social-ekonomike për punonjësit e larguar nga puna. Shumë prej institucioneve të administratës publike duke e konsideruar shkak të justifikuar ristrukturimin, kanë urdhëruar edhe zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës. Në gjykim të institucionit të Avokatit të Popullit dhe në analizë të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet e punës, në rastin konkret Ligjit Nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, në nenet 153 dhe 154 të tij përcaktohet zgjidhja e menjëhershme e kontratës së punës për shkaqe të justifikuara. Në rekomandimet që kemi adresuar, kemi arsyetuar faktin se ristrukturimi dhe shkurtimi i vendit të punës nuk janë shkak i justifikuar sipas dispozitës së sipërcituar, pikërisht për të justifikuar zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës. Megjithëse janë kërkuar disa herë argumentat shteruese, analiza, pasojat lidhur me lirimet nga puna, nuk rezulton që institucionet të kenë realizuar një analizë konkrete nëse zgjidhja ka qenë efektive si në marrjen e shërbimeve nga qytetarët ashtu edhe në mbingarkesën e punonjësve me strukturën e shkurtuar. Analiza duhet të përfshijë edhe përllogaritjen e vlerës së dëmshpërblimeve për lirimet nga puna në lidhje me rikuperimin e uljes së vlerës nga buxheti në këtë zë. Kjo analizë ka penguar marrjen e një vendimi të drejtë për lirimet nga detyra në shumicën e rasteve.

Institucioni i Avokati i Popullit gjatë vitit 2020 është angazhuar maksimalisht për të dhënë kontributin institucional për çdo iniciativë, analizë apo çështje që kërkon të zgjerohet apo edhe garantojë hapësirën e individëve për ushtrimin e të drejtave dhe lirive të tyre themelore në përputhje me Kushtetutën, aktet ndërkombëtare dhe legjislacionin në fuqi. Administrata publike duhet të vijojë të zbatojë procedura administrative transparente dhe të bazuara në parimin e meritokracisë për rekrutimin, transferimin, pezullimin dhe lirimet e nëpunësve civilë apo punonjësve në të gjitha institucionet shtetërore.

Veçanërisht, çështja e largimeve nga puna do të vijojë të mbetet një nga pikat kyçe për punën e Avokatit të Popullit, me qëllim dhënien e kontributeve në përmirësimin e punës dhe krijimin e një administrate publike model, e cila duhet të funksionojë sipas parimeve evropiane. Institucioni i Avokatit të Popullit ka konstatuar në vazhdimësi mungesë bashkëpunimi nga

shumë prej institucioneve të administratës publike, çka ka sjellë pengesë të punës duke shkaktuar vështirësi për shqyrtimin brenda një afati sa më të shpejtë të rasteve/problematikave.

Avokati i Popullit ka ndjekur gjithashtu me prioritet edhe problematikën dhe shqetësimin serioz të parashtruar nga punonjësit e Kombinatit të Përpunimit të Thellë të Naftës si dhe të Stacionit të Pompimit dhe N/Stacionit Elektrik në Poçem lidhur me zvarritje të pagesave mujore nga punëdhënësi i tyre. Lidhur me këtë problem, ata kanë ndërmarrë edhe nismën ekstreme të futjes në grevë urie, me qëllim ndërgjegjësimin dhe reagimin e strukturave shtetërore për verifikimin dhe trajtimin brenda kuadrit ligjor në fuqi të kësaj çështjeje jetike për ta dhe të ardhmen e familjeve të tyre.

Përfaqësues të institucionit të Avokatit të Popullit kanë vizituar dhe marrë kontakt me këta punonjës me datë 18.02.2020 në ambientet ku ata po zhvillonin grevën e urisë. Gjendja gjatë komunikimit me grevistët paraqitej serioze dhe kërkonte angazhim maksimal nga strukturat shtetërore⁸⁸. Në vijim të trajtimit të këtyre shqetësimeve, Avokati i Popullit i është drejtuar me një shkresë zyrtare Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë duke i rekomanduar shqyrtimin e kërkesave dhe problematikave të punonjësve, rregullimin e marrëdhënies juridike civile midis përfituesve të aseteve të ARMO sh.a. dhe furnizuesve të shërbimeve jetike për qytetarët si edhe ngritjen e një grupi pune për evidentimin e detyrimeve që kanë lindur ndër vite për punonjësit e dy kompanive dhe ushtrimin e ndikimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e aksionerit, për ekzekutimin e këtyre detyrimeve nga ana e Kontraktorëve apo n/Kontraktorëve.

Pas insistimit dhe përpjekjeve edhe të institucionit të AP, është konstatuar fakti se ka patur reagime pozitive, pas shumë përpjekjeve dhe reagimeve të forta të grevistëve, pasi tashmë Qeveria ka marrë përsipër të trajtojë me rrogë për një vit punonjësit e kësaj industrie.

3.12 E drejta për një mjedis të shëndetshëm⁸⁹

Institucioni i Avokatit të Popullit vijon të ketë prioritet të punës së tij monitorimin e situatës mjedisore në Republikën e Shqipërisë, si edhe zbatimin e legjislacionit respektiv për këtë fushë nga institucionet qendrore dhe organet e qeverisjes vendore.

Gjatë vitit 2020, pavarësisht situatës të rëndë pandemike, kemi patur një fokus të veçantë në zbatimin me rigorozitet të dispozitave të akteve ligjore dhe nënligjore, me qëllim që të ndikojmë në përmirësimin e gjendjes së mjedisit në Shqipëri, si edhe garantimin e standardeve të një mjedisi sa më të shëndetshëm.

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2020 ka trajtuar gjithsej 50 çështje ndaj organeve të administratës publike të ngarkuara me ligj për mbrojtjen e mjedisit, si edhe promovimin e një ambienti të shëndetshëm sa më të pastër dhe të shëndetshëm, duke përfshirë edhe një numër të konsiderueshëm të çështjeve që janë iniciuar nga ana jonë me qëllim që të mbrohen

⁸⁸ Duhet theksuar fakti se punonjësit e Stacionit të Pompimit të Ujit dhe N/Stacionit Elektrik që ndodhet në afërsi të tij në Poçem, ushtrojnë dhe përbushin një detyrë jetike dhe të rëndësishme për qytetin e Ballshit dhe fshatrat përreth, pasi furnizojnë me ujë të pijshëm dhe energji elektrike jo vetëm këtë zonë, por edhe Kombinatit të Përpunimit të Thellë të Naftës. Refuzimi dhe ndalimi i ofritit të një shërbimi të tillë çënon direkt jetën e komunitetit dhe përbën vepër penale sipas legjislacionit penal në fuqi. Subjektet që kanë privatizuar këtë Rafineri, por edhe nënkontraktorët e tyre ndër vite, janë paraqitur si punëdhënësit e këtyre punonjësve. Njëkohësisht, sipas informacioneve të përfuara, rezultojnë se edhe shteti ka ende rreth 15% të aksioneve në këtë Shoqëri, e në këtë kuadër, mund dhe duhet të ushtrojë kontrollin dhe verifikimin e respektimit dhe garantimit të kuadrit ligjor në fuqi, me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të Punëmarrësve, të cilët në rastin konkret po përballen me mohim të pagesës për një punë të kryer. Sa më sipër, punonjësit janë shprehur para përfaqësuesve të institucionit të Avokatit të Popullit se u janë drejtuar edhe strukturave shtetërore, duke përfshirë edhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me kërkesën e datës 30.01.2020, por ende nuk kishte një trajtim dhe shqyrtim të shqetësimeve të ngritura nga ana e tyre.

⁸⁹ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Administratës në institucionin e Avokatit të Popullit.

dhe promovohen standardet dhe nivelet kombëtare dhe ndërkombëtare të mbrojtjes së mjedisit dhe garantimit të një ambienti sa më të pastër.

Në këtë kuadër mund të theksojmë çështjet e iniciuara lidhur me masakrën mjedisore në malin e Lunikut, ndotjen e ambientit në zonën e Zharrzës nga veprimtaria naftënxjerrëse, problematikën e vendgrumbullimit të mbetjeve në fshatin Babicë e Madhe, ndotjen e qytetit të Durrësit të pushtuar nga mbeturinat, shqetësimin e banorëve të fshatit Shën Pjetër në Fier lidhur me burimin e infeksionit nga shkarkimi i ujërave të zeza në lumin e Vdekur, shkarkimin e ujërave të ndotura në lumin Fan nga fabrika e pasurimit të bakrit, mbetjet urbane në qytetin e Lushnjës, ndotjen dhe djegien e plehrave tek ish fusha e aviacionit në Vlorë e shumë të tjera me shtrirje në mbarë Shqipërinë.

Avokati i Popullit i ka dërguar një rekomandim strukturave të pushtetit vendor dhe Drejtorisë Spitalore në Dibër lidhur me trajtimin e mbetjeve spitalore që ishin hedhur në rrugën kombëtare në afërsi të qytetit të Peshkopisë. Ky rast është trajtuar me iniciativë nga ana jonë pas njoftimeve në media lidhur me hedhjen pa kriter në ambiente publike të mbetjeve spitalore që nuk po administroheshin sipas rregullave nga strukturat përgjegjëse. Në vijim të rekomandimit tonë, kemi marrë përgjigje zyrtare nga strukturat përkatëse lidhur me masat konkrete që ishin ndërmarrë për trajtimin dhe përpunimin e tyre.

Nga ana jonë konstatohet në vazhdimësi së shkakut i burimit ndotës është pikërisht mosveprimi i organeve shtetërore të ngarkuara me ligj ndaj subjekteve të ndryshme që shkaktojnë ndotjen mjedisore.

Avokati i Popullit konfirmon rëndësinë që duhet t'i kushtohet gjendjes së mjedisit dhe mbrojtjes së ambientit në Shqipëri. Këto fusha kërkojnë një vëmendje të veçantë dhe bashkëpunim të të gjithë faktorëve, me qëllim që të garantohet kujdesi për shëndetin dhe të rritet cilësia e jetës për brezat aktual dhe ato të ardhshëm.

Avokati i Popullit gjen rastin t'u bëjë sërish thirrje autoriteteve shtetërore që të respektojnë dhe garantojnë të drejtën për një mjedis sa më të shëndetshëm për individët edhe gjatë procesit të rindërtimit, i cili po zbatohet tashmë në zona të caktuara të prekura nga tërmeti tragjik i 26 nëntorit 2019. Planet dhe projektet e rindërtimit duhet të jenë në harmoni me ambientin dhe tu garantojnë individëve një mjedis sa më të shëndetshëm e të qëndrueshëm, në përputhje edhe me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, të proklamuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara në kuadër të Axhendës 2030.

3.13 Mbrojtja e konsumatorit⁹⁰

Gjatë vitit 2020, menaxhimi dhe respektimi i të drejtave të qytetarit kanë qënë ndër fushat për të cilat institucioni i Avokatit të Popullit është investuar nëpërmjet kryerjes së hetimeve administrative dhe adresimit të rekomandimeve, për shkak dhe të ankesave të depozituara pranë tij.⁹¹

Ndërtimi i një bashkëpunimi institucional kërkon angazhim ndërinstitucional real dhe efektiv, të cilin institucioni i AP në disa raste, për hir të së vërtetës, nuk e ka patur me OSHEE dhe Ujësjetllësin. Kemi vlerësuar/konstatuar se konstatimet/shpjegimet e tyre kanë qënë të paqarta dhe të paplota, duke mos krijuar garanci për respektimin e të drejtave të qytetarit. Në këtë kuptim, institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se çështja e rregullimit dhe menaxhimit të duhur është tepër e rëndësishme për të garantuar respektimin e të drejtave të qytetarit.

⁹⁰ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Administratës në institucionin e Avokatit të Popullit.

⁹¹ Gjatë vitit 2020, nga institucioni i Avokatit të Popullit janë trajtuar gjithsej 31 raste.

Në rastet kur, pas analizimit me kujdes të shpjegimeve të dërguara nga institucionet si edhe të dokumentacionit të përcjellë, institucioni i Avokatit të Popullit ka vlerësuar se ka vend për përmirësim të procedurës dhe mundësitë të rivënien në vend të të drejtave të shkelura, ai ka adresuar gjithashtu edhe rekomandimet përkatëse.

Shtysë për të ndërhyrë në zgjidhjen e këtyre problematikave nëpërmjet rekomandimeve ka ardhur ndër të tjera edhe për shkak të faktit se në mjaft raste, dokumentacioni vënë në dispozicion pranë institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me ankesat, përgjithësisht nuk është përcjellë i argumentuar. Kjo do të shërbente për të vërtetuar veprimet që janë kryer për identifikimin e përgjegjësisë në të gjithë nivelet e hierarkisë që kanë shkaktuar shkeljen e të drejtave të qytetarëve. Shpesh moskryerja e analizave të argumentuara, ka penguar marrjen e një vendimi të drejtë për qytetarin.

Institucioni i Avokati i Popullit gjatë vitit 2020 është angazhuar maksimalisht për të dhënë kontributin institucional për çdo iniciativë/ankesë në mënyrë që të garantojë hapësirën e individëve për ushtrimin e të drejtave dhe lirive të tyre themelore. Siç e theksuam edhe më sipër, është konstatuar në vazhdimësi mungesa e bashkëpunimit nga OSHEE dhe Ujësjiellësi, çka ka sjellë pengesë të punës duke shkaktuar vështirësi për shqyrtimin brenda një afati sa më të shpejtë të rasteve/problematikave

Në nenin 56 të ligjit Nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar, Avokatit të Popullit i njihet një rol i veçantë për mbrojtjen e interesave të ligjshme dhe të drejtave të konsumatorit, si për rastet e paraqitjes së ankesave individuale ashtu dhe të rasteve me iniciativë të marra në shqyrtim kur preken interesat e një komuniteti të gjerë. Pranë institucionit të Avokatit të Popullit vazhdojnë të adresohen ankesa të cilat lidhen kryesisht me pretendime për mbifaturime në energji dhe ujë, ndërprerje të energjisë/ujë, faturime aforfe, mosveprimeve të operatorëve kundrejt ankesave të qytetarëve, mungesë e sahatëve, pamundësi ekonomike për të paguar shërbimin si edhe për cilësinë e shërbimeve që ofrohen prej tyre.

E drejta për të pasur disa shërbime elementare si shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe furnizimi me energji elektrike është një nevojë thelbësore njerëzore, një e drejtë themelore, mungesa e së cilës përbën një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut. Një pjesë e territorit të Shqipërisë, e sidomos në zonat rurale, ende vazhdojnë të mos furnizohen me ujë të pijshëm, apo furnizohen pjesërisht, duke përbërë kështu një vështirësi të madhe të jetesës për shërbime bazë të nevojshme për banorët. Ky problem ka pasur ndikim të madh në cilësinë e jetës së qytetarëve pas dëmtimeve të tërmetit të nëntorit 2019. Rritja e investimeve në këtë fushë si dhe zhvillimi i modeleve të shërbimeve të ofruara në përputhje me nevojat në zhvillim të komunitetit do të mundësojnë arritjen e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm.

Në veçanti duhet të sigurohen masa për mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë, duke përfshirë masat për të ndihmuar dhe për të shmangur ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike dhe ujë. Në disa ankesa operatorët e furnizimit me energji dhe ujë e orientojnë qytetarin për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura duke zbatuar një aktmarrëveshje si të vetmen mundësi lehtësuese për të shlyer detyrimet e akumuluar, por pa i analizuar e zgjidhur problemet në thelb.

Sa më sipër, megjithëse në raportet vjetore/raporte të transparencës të institucioneve shprehen për përmirësime të performancës, rritje të cilësisë, mbrojtje të konsumatorit dhe shtresave në nevojë, transparencë dhe të drejtë informimi, etj, sërisht konsumatori nuk i gjen të mishëruar efektivisht e ligjërisht. Ndër të tjera, informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë i plotë, i saktë, i përditësuar, i thjeshtë në konsultim, i kuptueshëm, lehtësisht i aksesueshëm, i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit.

3.14 Respektimi i të drejtave që lidhen me pushtetin vendor⁹²

Njesite e pushtetit vendor luajnë një rol kryesor në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Qeverisja lokale ka forma dhe funksione të ndryshme në varësi të sistemeve kushtetuese dhe ligjore të një shteti të caktuar. Një nga funksionet e tij të rëndësishme është *të sigurojë shërbime publike që adresojnë nevojat lokale dhe përparësitë në lidhje me realizimin e të drejtave të njeriut në nivelin lokal.*

Roli i qeverisjes lokale për të parandaluar pabarazitë dhe për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut tani po bëhet më kritik se kurrë. Veprimet e tyre janë thelbësore për të ruajtur hapësirën qytetare dhe lirinë e shprehjes, për të siguruar qasjen në shërbimet themelore dhe për të përmirësuar planifikimin urban. Ky rol i qeverisjes vendore është tashmë i njohur dhe konfirmuar në shumë akte të organizmave ndërkombëtare, përfshirë dhe rezolutat e miratuara nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut të OKB.

➤ E drejta për strehim

E drejta për strehim është një prej të drejtave themelore më të rëndësishme të njeriut, që lidhet drejtpërdrejt me të drejtën për jetën dhe shëndetin. E drejta për strehim përfshihet në një numër të konsiderueshëm të instrumentave të së drejtës ndërkombëtare.⁹³ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, në nenin 25.1 të saj, parashikon që: *“Çdokush ka të drejtën e një standardi jetese të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqënien e tij dhe të familjes së tij duke përfshirë ushqimin, veshjen dhe strehimin”*. Po ashtu, edhe konventa të tjera të rëndësishme në nivel ndërkombëtar sanksionojnë rëndësinë e respektimit dhe garantimit maksimal të kësaj të drejte.⁹⁴ Konventa e të Drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, gjithashtu kërkon marrjen e të gjitha masave të nevojshme për të nxitur realizimin e së drejtës për strehim të përshtatshëm. E drejta për strehim duhet të nënkuptojë jo vetëm qiranë, por edhe kostot që lidhen me strehimin (si energjia dhe uji) duhen përcaktuar të tilla që, pjesa e mbetur e të ardhurave të personit të jetë e mjaftueshme për t'i përballuar nevojat e tjera bazike. Shteti duhet të garantojë mbrojtje ligjore për strehim dhe të ofrojë një bazë për realizimin progresiv të të gjitha aspekteve të së drejtës për strehim të përshtatshëm.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka luajtur rol proaktiv në përcjelljen e mendimeve dhe komenteve në lidhje me hartimin e legjislacionit që në fokus të tij ka të drejtën për strehim, ashtu sikurse dhe hetimin administrativ të rasteve të trajtuara.


Gjatë vitit 2020 janë trajtuar një numër i konsiderueshëm rastesh nga institucioni ynë, të cilat i referohen të drejtës për strehim. Shprehur në përqindje, rastet që kanë në fokus këtë të drejtë zënë rreth 10% të të gjitha rasteve të trajtuara nga Seksioni i Administratës. Këto raste i përkasin problematikave të ndryshme, ku peshën më të madhe e zënë problematikat e ardhura si pasojë e

⁹² Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Administratës në institucionin e Avokatit të Popullit.

⁹³ Kjo e drejtë është riafirmuar në një numër instrumentash ndërkombëtarë: Konventa e të Drejtave Ekonomike Sociale dhe Kulturore u kërkon vendeve anëtare të marrin të gjitha masat e nevojshme për të nxitur realizimin e së drejtës për strehim të përshtatshëm. Traktate të tjera, si për shembull, Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, Konventa për të Drejtat e Fëmijëve dhe Konventa për Statusin e Refugjatit parashikojnë gjithashtu dispozita për të drejtën për strehim.

⁹⁴ Karta Sociale Evropiane dhe Karta Sociale Evropiane e Rishikuar, ratifikuar me ligjin nr.8960, datë 24.10.2002, në nenin 16 përcakton se “E drejta e mbrojtjes sociale, ligjore dhe ekonomike e familjes. Me qëllim që të sigurojnë kushtet e nevojshme për zhvillimin e plotë të familjes, e cila është bërthama themelore e shoqërisë, Palët Kontraktuese marrin përsipër të nxisin mbrojtjen e jetës familjare ekonomike dhe sociale me anë të mjeteve të tilla si përfitimet sociale dhe familjare, marrëveshjet fiskale, ofrimin e strehimit familjar, përfitime për të sapo martuarit dhe mjete të tjera të përshtatshme.” Neni 31 i Kartës Sociale Evropiane parashikon: “Të drejtën e strehimit. Me qëllim që të garantojë zbatim efektiv të së drejtës për strehim, palët marrin përsipër masa të cilat: -nxisin aksesin tek strehimi i një standardi të përshtatshëm; -nxisin dhe zvogëlojnë mosstrehimin me qëllim eliminimin e plotë të tij; -ofrimin e çmimeve të shtëpive që janë të përballueshme për ata që nuk kanë mjetet e përshtatshme”.

tërmetit të datës 26.11.2019. Nga totali i problematikave evidentohet se 67% të tyre rrjedhin nga pasojat e tërmetit, 13% kanë të bëjnë me të drejtën për strehim përsa i përket trajtimit me banesa sociale, kredi të buta dhe bonus qiraje, 11.4% i përkasin problematikave të lidhura me përmirësimin e kushteve të jetesës, lidhur me vendstrehimet. Problematikat lidhur me të drejtën për strehim të komunitetit Rom dhe atij Egjiptian zënë një peshë prej 7% dhe ato që lidhen me cënimin e kësaj të drejte zënë rreth 1%. Më poshtë po paraqesim në mënyrë grafike shpërndarjen e rasteve lidhur me të drejtën e strehimit, sipas problematikave të trajtuara.



Paraqitja grafike e shpërndarjes së rasteve lidhur me të drejtën e strehimit.

Gjatë hetimit administrativ të këtyre rasteve është lehtësisht e evidentueshme se peshën më të madhe të tyre, për vitin 2020, e zënë problematikat që kanë të bëjnë me pasojat e tërmetit të Nëntorit 2019.

Avokati i Popullit ka vijuar të ndjekë me vëmendje shqetësimet e qytetarëve të prekur nga kjo fatkeqësi. Vëmendja e institucionit tonë vërehet në numrin e konsiderueshëm edhe të çështjeve që kemi ndërmarrë me iniciativë gjatë vitit 2020, të cilat janë bërë publike në mediat e shkruara dhe ato vizive. Gjithshtu, gjatë këtij viti, kemi trajtuar edhe ankesat e adresuara nga personat e prekur nga kjo fatkeqësi natyrore.

Nga numri total i këtyre çështjeve të trajtuara nga institucioni ynë gjatë këtij viti, një pjesë e tyre vazhdojnë të jenë në proces hetimi administrativ, ndërsa pjesa tjetër është mbyllur pasi objekt i tyre ka qenë bonusi i qirasë, i cili është akorduar gjatë hetimit administrativ apo problematika që kanë gjetur zgjidhje. Çështjet për të cilat vazhdon hetimi administrativ janë në proces, pasi pritet përgjigja e institucioneve përgjegjëse. Këtyre institucioneve u kemi kërkuar informacion dhe shpjegime, duke adresuar shqetësimet e ngritura nga ankuesit, për shkelje të të drejtave dhe interesave të tyre të ligjshme.

Lidhur me problematikat që kanë të bëjnë me pasojat e tërmetit, akoma vazhdojnë të paraqiten ankesa pranë institucionit tonë, si dhe të publikohen në media shqetësimet e qytetarëve mbi veprimtarinë e institucioneve përgjegjëse. Nga ankesat e paraqitura pranë institucionit të Avokatit të Popullit, si dhe ato të publikuara në media, gjatë vitit 2020, edhe pse një pjesë e mirë e tyre janë në proces hetimi administrativ, paraprakisht konstatohet se:

- Gjatë këtij viti janë paraqitur ankesa mbi miratimin e bonusit të qirasë, strehimit e përshtatshëm dhe mungesën e ndihmës nga institucionet shtetërore përgjegjëse. Disa qytetarë kanë shprehur shqetësimin e tyre mbi mungesën e bonusit të qirasë e cila u ka vështirësuar edhe më tej jetesën. Tërmeti ka dëmtuar ndjeshëm jetesën, sidomos kjo në zonat rurale dhe ato periferike, të cilat janë të predispozuar për t'u varfëruar akoma më shumë, pasi në pjesën më të madhe të rasteve të ardhurat e tyre janë prej gjësë së gjallë dhe punës sezonale.

Përgjegjësia e autoriteteve shtetërore, në raport me popullatën e këtyre zonave të prekura, mbetet shqetësuese. Konstatohet se banorët e prekur në zonat e thella rurale nuk kanë marrë informacion ose mbështetje të mjaftueshme nga organet kompetente, si ato vendore dhe ato të mbrojtjes civile, si përgjigje ndaj tërmetit dhe akomodimin në një vendstrehim të përshtatshëm. Edhe pse ka kaluar më shumë se një vit nga tërmeti, në këto zona banorët kanë kaluar dimrin dhe sezona të tjera në temperatura ekstreme, në çadra dhe në kushte ekstremisht të vështira. Pandemia e vështirësoi akoma më tej situatën ekonomike dhe shëndetësore të tyre. Jetesa në çadra apo vendstrehime të ngjashme, nuk përmbushin as kushtet minimale të jetesës. Nëse do t'i referohemi ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”,⁹⁵ dhe, në mënyrë të veçantë, nenit 4 të tij, konstatohet se ky ligj sanksionon parimin e strehimit të përshtatshëm. Që strehimi të konsiderohet i përshtatshëm për një individ apo familje, sipas këtij ligji, ai duhet të garantojë privatësinë, një jetesë të sigurtë, të qetë dhe me dinjitet. Strehimi është i përshtatshëm nëse plotëson:

- a) hapësira të mjaftueshme banimi sipas normave të strehimit dhe standardeve të ndërtimit, të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;
- b) shërbime bazë, brenda mjedisit të banimit;
- c) qëndrueshmëri dhe siguri nga rreziqe që burojnë nga veprimet ose mosveprimet njerëzore, faktorët natyrorë e klimaterikë;
- d) qasje në shërbimet publike, si furnizimi me ujë të pijshëm dhe energji elektrike, largimi i ujërave të ndotura dhe menaxhimi i mbetjeve;
- e) akses në shërbimet e punësimit, shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe social, në arsim dhe në shërbime të tjera komunitare;
- f) qasje të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe fëmijët, duke lehtësuar shkallën e plotësimit të nevojave të veçanta të banimit për ta.

Gjithashtu, ajo që konstatohet gjatë vitit 2020, është fakti se disa prej banorëve të prekur nga tërmeti dhe që jetojnë në çadra apo vendstrehime të tjera të barazvlefshme me to, të papërshtatshme, edhe pse kanë përfutur nga bonusi i qirasë, janë të detyruar ta përdorin atë për ilaçe dhe ushqime gjatë periudhës së pandemisë. Sipas tyre, shteti/bashkitë nuk kanë marrë masa për ardhjen në ndihmë të tyre dhe lehtësimin e jetesës në kushtet e pandemisë, duke i privuar kështu nga një strehim i përshtatshëm.

Me qëllim rindërtimin e banesave të dëmtuara nga tërmeti, në 17 Shkurt 2020 u zhvillua Konferenca Ndërkombëtare e Donatorëve për mbështetjen e Shqipërisë pas tërmetit shkatërrimtar të 26 nëntorit 2019, ku u shpreh angazhimi për dhurimin e një sasive të konsiderueshme fondesh. Qeveria Shqiptare duhet përshëndetur për këtë fakt e punën e bërë për mbledhjen e këtyre fondeve. Gjithashtu, pjesë e fondit të rindërtimit u bënë edhe donacione të tjera të mbledhura nga individë apo shoqëri të ndryshme, në mbështetje të rindërtimit. Por ajo që sjell shqetësim dhe është për tu evidentuar është fakti që këto fonde nuk janë përdorur

⁹⁵ Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse.

maksimalisht dhe në një kohë sa më të shkurtër. Ndërkohë që fondet ekzistojnë, plani i rindërtimit ka ecur me ritme të ngadalta edhe pse ka kaluar rreth një vit nga shprehja e vullnetit për donacione. Në daljet e saj publike qeveria shqiptare premtoi rindërtimin e banesave deri në fund të vitit 2020, por nuk rezultoi të jetë kryer brenda këtyre afateve.

Përdorimi i këtyre fondeve duhej bërë me prioritet dhe në kohë reale, madje vlerësojmë se duhej vepruar duke identifikuar dhe vijuar punën në mënyrë prioritare për famljet dhe individët të cilët vazhdojnë të jetojnë akoma në çadra, në kushte ekstremisht të vështira. Institucioni ynë ka në shqyrtim mjaft çështje, të marra me iniciativë por edhe ankesa drejtuar nga banorët e prekur nga kjo fatkeqësi, ku familjarët ankohen se vazhdojnë të jetojnë në çadra apo shtëpitë e dëmtuara dhe akoma nuk është bërë asgjë për rindërtimin e banesave të tyre. Për më tepër, situata e pandemisë së shkaktuar nga COVID-19 e ka përkeqësuar edhe më tej situatën e këtyre familjeve. Jetesa në çadra apo vendstrehime të barazvlefshme nuk ju mundëson këtyre individëve kushtet për të marrë masat ndaj virusit.

Mungesa e ujit, dritave apo hapësirat e kufizuara për ruajtjen distancimit social, por edhe problematika të tjera kanë vështirësuar në ekstrem jetesën e tyre. Institucionet përgjegjëse duhet të kishin marrë masa dhe të trajtohej me prioritet situata e kësaj kategorie, e këtyre individëve apo familjeve që jetojnë në kushte varfërie dhe në vendstrehime që përbëjnë rrezik për jetën dhe shëndetin e tyre në këtë situatë të pazakontë pandemie. Lidhur me këtë problematikë Avokati i Popullit ka marrë në shqyrtim dhe po vijon hetimin administrativ për një numër çështjesh, për të cilat do të shprehim qëndrimin tonë në përfundim të hetimit administrativ.

Problematika të tjera të evidentuara lidhur me të drejtën për strehim janë si më poshtë vijon:

- Mungesa e zgjidhjes për personat e pastrehë, të cilët jetojnë në kushte varfërie dhe nuk kanë mundësi të përballojnë shpenzimet e jetesës në rast të mungesës së subvencionimit nga pushteti vendor, kreditë e buta.
- Zbatimi i programit të banesave me kosto të ulët për familjet rome dhe egjiptiane vazhdon të mbetet shqetësues dhe kërkon më shumë angazhim dhe përgjegjshmëri nga institucionet përgjegjëse. Dëbimi i këtyre grupeve vulnerabël nga vendbanimet e tyre dhe zvarritja e procedurave nga strukturat shtetërore, cënon në mënyrë permanente të drejtën për strehim. Lidhur me këtë kategori, mbetet shqetësuese dhe ka vijuar hetimi administrativ gjatë vitit 2020, lidhur me trajtimin e vetëdeklarimeve të paraqitura nga disa familje rome dhe egjiptiane, nga DVASHK në zonën e Unazës së Re.
- Vazhdon të mbetet shqetësuese pamundësia e përfitimit të të varfërve nga programi për banesa me kosto të ulët dhe papërballueshmëria nga ana e tyre e këtij programi, për shkak të procedurave bankare tepër të gjata dhe të kushtueshme, të aplikueshme për këtë qëllim. Programi i banesave sociale me qira ka në fokus familjet me të ardhura të ulëta, por njerëzit që jetojnë pranë, ose nën kufirin e varfërisë, nuk mund ta përballojnë këtë program.
- Programi më i vogël është ai i subvencioneve të strehimit, ndërkohë që këto programe shihen si zgjidhje e përkohshme e problemeve të strehimit. Programet e strehimit social duhet të zgjerohen më tej për të përmbushur kërkesat e grupeve në nevojë dhe duhet të riorientohen drejt shtresave në pozita të pafavorizuara.
- Nevojitet përmirësimi i kushteve të jetesës në godinat e përshtatura për strehim nga institucionet përgjegjëse të cilat duhet t'i sigurojnë kësaj kategorie strehim të përshtatshëm dhe me dinjitet.
- Problematikë tjetër e trajtuar nga institucioni ynë mbi strehimin, gjatë këtij viti, ka qenë edhe ajo e dëbimit me forcë të poseduesve nga banesat në proces legalizimi në zonën e “Bregut të Lumit” dhe mos sigurimi i një strehimi të përshtatshëm i kësaj kategorie.

Lidhur me sa parashtruam më lart, Avokati i Popullit ka adresuar rekomandime kundrejt institucioneve përgjegjëse por nuk kemi përgjigje definitive dhe shteruese mbi këtë problematikë. Një pjesë e njësive të pushtetit vendor shprehen se kanë vështirësi financiare për ndërtimin e banesave sociale, apo edhe për ofrimin e programeve të tjera, sikundër për shembull, bonusi i qirasë apo rindërtimi i banesave sociale.

Nga sa parashtruam më sipër konstatohet të jetë cënuar parimi i strehimit të përshtatshëm, sipas të cilit, askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për të përfituar strehim në një nga programet sociale të strehimit, të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore.

➤ *E drejta për ofrimin e shërbimeve publike*

Në kuadër të të drejtave të qytetarëve për marrjen e shërbimeve publike dhe ekonomike, institucioni i Avokatit të Popullit ka kërkuar respektim të këtyre të drejtave nga institucionet përkatëse që kanë detyrimin e ofrimit të shërbimeve publike. Për këtë, nëpërmjet rekomandimeve, u është kërkuar që të veprojnë pozitivisht në ndërmarrjen e hapave të nevojshëm për garantimin dhe sigurimin e ofrimit të shërbimeve të cilat kanë ndikim në sigurinë dhe mbrojtjen e jetës.

Në këtë aspekt për tu përmendur kanë qenë ankesat drejtuar Institucionit tonë lidhur me problematikën që haset më së shumti në fushën e infrastrukturës dhe kryesisht në atë të pasjes së rrugëve sipas standardeve të përcaktuara, mirëmbajtjes së tyre, ambjenteve të përbashkëta sipas të gjitha normave mbi të drejtën në komunitet e më gjerë.

Në këndvështrimin e institucionit të Avokatit të Popullit e drejta për një ambient dhe infrastrukturë normale përveç se çon në zhvillim ekonomik shërben gjithashtu edhe në zhvillimin sa më të mirë social dhe kulturor të individëve.

➤ *Veprimtaria e IKMT dhe IMT*

Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) dhe Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit (IMT), në bashki janë strukturat kryesore që kanë si detyrë funksionale respektimin e normave, standardeve, kushteve zhvillimore të territorit, si dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme. Juridiksioni dhe kompetencat e tyre janë të përcaktuara në Ligjin nr.9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar. Të dy këto organe shfaqen me kompetenca vendimmarrëse/ekzekutive, që nga vendosja e gjobave, pezullimi i punimeve të ndërtimit e deri tek prishja e ndërtimeve të kundërligjshme.

Gjatë vitit 2020, Avokati i Popullit ka administruar 67 ankesa që lidhen me veprimtarinë dhe detyrat e IKMT-së në nivel kombëtar dhe IMT-ve në nivel lokal, pasi funksionojnë pranë bashkive. Nga ky numer total i ankesave, 20 prej tyre lidhen me veprimtarinë e IKMT-së dhe 47 të tjera me veprimtarinë e IMT-ve, në bashki.

Objekti i këtyre ankesave lidhet kryesisht me shkeljen e procedurave ligjore gjatë procesit të prishjes së ndërtimeve nga ana e IKMT-së, të cilat kanë ndërhyrë në lirimin e shesheve në zbatim të projekteve të mëdha publike apo në mungesë të kapaciteteve dhe mjeteve të ndërhyrjes nga ana e IMT-ve në nivel lokal, siç ka ndodhur në rastin e ndërhyrjes së IKMT në Velipojë para fillimit të sezonit veror. Në rastin e IMT-ve, në bashki, objekti i ankesave të paraqitura lidhet me tejkalimin e kompetencës së vendimmarrjes për prishje objekti, ndërkohë që ky i fundit rezulton ende në proces legalizimi pranë zyrave lokale të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; mosveprimin dhe zvarritje të procedurave të

konstatimit dhe sanksionimit të ndërtimeve të kundërligjshme; mosveprimin në ekzekutimin e vendimeve për prishje të objekteve të kundërligjshme.

Gjatë vitit 2020, Avokati i Popullit ka përpiluar dhe dërguar pranë IMT Tiranë dy rekomandime lidhur me konstatimet dhe problematikat që janë evidentuar nga ana jonë në kuadër të shkeljes të së drejtës së pronësisë së ndodhur në zonën e ish Stacionit të Trenit, pa një proces të rregullt ligjor, me qëllim zbatimin e projektit “*Bulevardi Verior i Tiranës dhe punimet civile përkatëse*”.⁹⁶

Gjithashtu, i është dërguar IMT Tiranë edhe një rekomandim lidhur me shkeljen e të drejtës së pronësisë dhe mungesës së zbatimit e respektimit të procedurave ligjore ndaj një objekti të ligjshëm dhe të pajisur me dokumentacion pronësie në zonën e ish-Selvisë, ndaj të cilit u ndërhy forcërisht me prishjen e tij në zbatim të një projekti me interes publik. Krahas evidentimit të shkeljeve dhe rekomandimit për vijimin e procedurave të dëmit jashtëkontraktor, ankuesi ka ndjekur tashmë edhe procedurat gjyqësore.

Një zhvillim negativ në fushën e ndërtimeve të paligjshme, të shoqëruar edhe me pamundësinë e veprimit për shkak të kufizimeve të lëvizjes por edhe me mungesën e vullnetit të kamufluar nën këtë regjim të lëvizjeve të kufizuara, ka luajtur edhe situata e pandemisë në Shqipëri, gjatë së cilës janë publikuar denoncime të shumta dhe ka patur një riaktivizim masiv të ndërtimeve pa leje në mbarë territorin.

Gjatë procesit të shqyrtimit nga ana jonë të këtyre çështjeve, janë konstatuar disa problematika kryesore, si më poshtë vijon:

- Mungesë transparence në veprimtarinë e këtyre organeve gjatë procedimeve të iniciuara në ngarkim të shtetasve, pa u vënë në dijeni dhe pa patur paraprakisht një njoftim zyrtar, mbi vendimmarrjen për ndërhyrjen që do të kryhej. Kjo gjë ka cënuar të drejtën e ankuesve për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.
- Vonesa dhe mungesë informacioni në vartësinë vertikale të detyrimit ligjor të raportimit të IMT-ve tek IKMT.
- Mungesë reagimi konkret të IKMT-së si një filtër i ligjshmërisë së vendimmarrjeve të organeve të tjera, në kuadër të zbatimit të parimit të ligjshmërisë në fushën e inspektimit të ndërtimit. Procedurat konkrete administrative, që duhet të zhvillohen rast pas rasti nga IKMT-ja, duhet të kenë si një element të domosdoshëm hetimin aktiv nga vetë ana e këtij organi, të fakteve, provave, dhe procedurave të ndjekura paraprakisht, me qëllim që të parandalohen shkelje të ligjit.
- Mungesa në procesin e verifikimit të procedurave ekzistuese të aplikimeve pranë strukturave të ASHK, për legalizimin e objekteve, në të cilat ose është ndërhyrë me prishje, ose janë sanksionuar me vendime për prishje. Ky mosveprim bie ndesh me parashikimin e kryer në nenin 66/1, të Kodit të Procedurave Administrative.
- Dëmi financiar i shkaktuar nga ana e IKMT-së, apo të IMT-ve në bashki, gjatë prishjes së objekteve të ndërtuara me leje që, paraprakisht janë përfshirë në procesin e shpronësimit për interes publik, por që ende nuk kanë marrë vleftën e dëmshpërblimit që i takon, përbën kosto shtesë dhe e vendos veprimtarinë e këtyre organeve në kushtet e parashikuara nga ligji nr.8510 datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike”, i ndryshuar.
- Mungesë bashkëpunimi gjatë procedurave të ndërmarra nga ana jonë për trajtimin dhe hetimin e shqetësimeve të parashtruara nga individë të ndryshëm, duke shkaktuar zvarritje

⁹⁶ Rekomandimi për këtë çështje gjendet në linkun: <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles/administrative-cases/pronat/rekomandime-mbi-shkeljet-ndaj-pronave-2020-530/>

dhe vonesa të trajtimit dhe shqyrtimit administrativ të problematikave të shumta që parashtron ushtrimi i veprimtarisë nga këto struktura të rëndësishme në mbrojtjen e ligjshmërisë mbi territor.

3.15 Respektimi i lirisë së shprehjes⁹⁷

Institucioni i Avokatit të Popullit, në përmbushje të misionit të tij kushtetues, ka monitoruar në vazhdimësi diskutimet e shumta në organet shtetërore shqiptare si edhe rekomandimet dhe komentet e grupeve të interesit e partnerëve ndërkombëtarë lidhur me Ligjin nr. 91/2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Për këtë ligj, është kërkuar dhe opinioni i Komisionit të Venecias, i cili dërgoi një mision në Shqipëri në datat 10-11 Shkurt 2020. Avokati i Popullit pati një takim me përfaqësuesit e Komisionit të Venecias në të cilin shprehu qëndrimin dhe mendimin e tij në lidhje me ligjin e miratuar dhe me implikimet e mundshme jo pozitive që mund të kenë për të drejtat e njeriut disa nga nenet e këtij ligji⁹⁸. Ky qëndrim gjeti reflektim të qartë në opinionin e Komisionit të Venecias mbi këtë çështje, opinion ky i dalë në datë 19 qershor 2020⁹⁹.

Sipas Komisionit të Venecias: *Ligji karakterizohet nga paqartësi dhe mund të ketë një efekt frenues të fjalës së lirë. Ligji mund të prodhojë censurë dhe autocensurë në median online dhe jo vetëm. Përbërja e AMA-s dhe Komiteti i Ankesave, i cili zgjidhet nga AMA në bazë të rregullave të hartuara nga AMA, mund të krijojë shqetësime të ligjshme për pavarësinë e këtyre dy organeve. Prania e përfaqësuesve të komunitetit të medias dhe shoqërisë civile që nuk janë të lidhur drejtpërdrejt me forcat kryesore politike, mund të jetë një hap që forcon pavarësinë e këtij organi.* Komisioni i Venecias, kritikon edhe gjobat e larta që parashikohen në rast të shkeljeve të ligjit nga mediat "online", që variojnë nga 100 mijë deri në 800 mijë lekë.¹⁰⁰ Komitetit të Ankesave dhe AMA-s i janë dhënë fuqi të mëdha administrative në lidhje me mediat online. Kjo është problematike për sa i përket lirisë së shprehjes së mediave online nga kufizimet paraprake dhe duke qenë se ka dyshime mbi pavarësinë e këtyre organeve; këto fuqi të reja nuk i duhen besuar këtyre organeve pa siguruar më parë se janë mjaftueshëm të pavarura nga partitë politike, bizneset e mëdha mediatike ose interesat e korporatave të lidhur me politikën.

Duke konsideruar se Komisioni Ankesave dhe AMA mund të ndërhyjnë në vetvete në ushtrimin e lirisë së shprehjes dhe pavarësia e tyre është në pikëpyetje, procedura e ankesave nuk ofron garanci të mjaftueshme mbrojtëse; KA/AMA mund të imponojë, me një procedurë të shpejtë administrative, gjoba të rënda të cilat hyjnë në fuqi menjëherë dhe të urdhërojnë heqjen e materialit nga interneti me efekt të menjëhershëm.

Lidhur me "Kapacitetin ekonomik" të portalit të medias ai nuk është faktor në përcaktimin e gjobës, i cili mund të rezultojë në një situatë ku aktivitetet e mediave më të vogla, apo bloggerëve individualë, paralizohen nga gjoba jo disproporcionale. Kjo do të shtojë efektin ngrirës të këtyre dispozitave dhe do të çojë drejt vetë-censurimit dhe degradimit të debatit politik që është thelbësor për çdo demokraci. Komisioni Venecias rekomandon që të rikonsiderohet adoptimi i draft amendamenteve të Ligjit 91/2013 dhe draft amendamentet e Ligjit 9918/2008, siç u votua në Parlament në dhjetor 2019. Problemet e identifikuara nga

⁹⁷ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Administratës në institucionin e Avokatit të Popullit.

⁹⁸ <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/home/news/this-article-is-available-only-in-albanian-309/>.

⁹⁹ [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-REF\(2020\)007-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-REF(2020)007-e).

¹⁰⁰ Raporti thekson se "Jashtëzakonisht problematike për lirinë e mediave në kontekstin shqiptar është natyra e ashpër dhe me efekte të mëdha negative e gjobave. Gjobat jashtëzakonisht të larta paraqesin një kërcënim me efekt pothuajse aq të fortë sa burgimi, megjithëse mund të shihet një mënyrë indirekte për të ushtruar presion në media".

autoritetet mund të jenë serioze por mjetet ligjore të prezantuara në draft amendamentet mund të bëjnë më shumë dëm sesa mirë për lirinë e shprehjes në Shqipëri dhe mediave online.

Komisioni i Venecias kërkon gjithashtu nga autoritetet shqiptare të mbështesin krijimin e një organi vetërregullues që funksionon në mënyrë efektive dhe që përfshin të gjithë aktorët përkatës në fushën e mediave.¹⁰¹

Deri në momentin e shkrimit të këtij raporti, asnjë nismë nuk ka vijuar në këtë drejtim.¹⁰² Avokati i Popullit do të vijojë të ketë në vëmendjen e tij ecurinë e garantimit të lirisë së shprehjes si dhe do të mbikëqyrë zbatimin korrekt të ligjit për mediat dhe ndryshimet që do të vijnë në këtë fushë të rëndësishme të së drejtës.

3.16 Mbrojtja dhe të drejtat e fëmijës¹⁰³

Problematikat e konstatuara gjatë kësaj periudhe janë të lidhura ngushtësisht me pandeminë COVID-19, që vazhdon të ketë ndikime afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata në të drejtat e fëmijës për arsim, shëndetësi, mbijetesë dhe zhvillim, standardet adekuate të jetesës, argëtim, liri, ushqim, si dhe mbrojtje nga çdo formë e dhunës. Është evidentuar që kjo situatë ka pasqyruar mungesën e qasjes së barabartë tek fëmijët, si rezultat i varfërisë së familjeve, që në strukturën e tyre kanë fëmijë, pasigurisë ushqimore, pabarazisë arsimore dhe ndikimit në shëndetin mendor, për shkak të përshtatjes me një jetesë të re, diktuar nga pandemia.

Si burim parësor, për trajtimin me iniciativë të rasteve, ankesave/kërkesave për vitin 2020, kanë shërbyer mediat e shkruara dhe vizive dhe ankesat e administruara drejtëpërdrejt.

Nëpërmjet trajtimit të tyre, në komunikimin administrativ me përfaqësues të pushtetit qendror dhe vendor, kemi synuar jo vetëm zgjidhjen e problematikave të parashtruara mediatikisht, por edhe promovimin dhe nxitjen e një kulture të re, sa i takon zbërthimit korrekt në praktikë të parimit të interesit më të lartë të fëmijëve dhe respektimit të detyrimeve ligjore që burojnë nga ligji nr.18/2017.

Në praktikën tonë administrative, për monitorimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës në nivel qendror dhe vendor, nisur nga shqyrtimi dhe trajtimi i rasteve me iniciativë, monitorimit *online* dhe inspektimeve të kryera në terren dhe *online*, kemi konstatuar shkeljen e të drejtave të fëmijëve lidhur me:

- *mbrojtja e fëmijës nga dhuna*, si pasojë e lundrimit në internet për një kohë të gjatë e të vazhdueshme, pa filtra sigurie dhe në funksion edhe të procesit të edukimit në platformën *online*.

¹⁰¹ Ndërkohë, Komisioni i Venecias inkurajon autoritetet shqiptare që të mbështesin krijimin e një enti rregullator efikas duke përfshirë gjithë aktorët përkatës në fushën e medias dhe i aftë për sigurimin e një sistemi efektiv dhe të respektuar të llogaridhënies në fushën e mediave online. Gjithashtu do të jetë e dobishme rishikimi i metodës së përzgjedhjes së anëtarëve të AMA dhe i Komisionit të Ankesave, për t'u siguruar se këto organe kanë një përbërje pluraliste dhe individësh të kualifikuar, që përfaqësojnë komunitetin e medias dhe gëzojnë një autonomi të besueshme nga qeveritë dhe kontrolli i korporatave. Për më tepër është e nevojshme të sigurohet efektiviteti i legjislacionit ekzistues dhe veçanërisht i mjeteve juridike për të luftuar shpifjen dhe gjuhën e urrejtjes përmes publikimeve online.

¹⁰² Më 30 janar 2020, 15 organizata mediatike në vend dolën me një deklaratë të përbashkët ku kërkuan mosaprovimin e kësaj pakete. Ligji për mediat u kundërshtua edhe nga institucionet ndërkombëtare si, rrjetet ndërkombëtare të mbrojtjes së gazetarëve, Komisioni Europian, Federata Europiane e Gazetarëve, dhe Qendra Europiane për Lirinë e Medias dhe Shtypit. Ato reagueshëm pas votimit në Kuvend të projekligjit "Anti-shpifje" duke e konsideruar si "censurim të lirisë së shprehjes".

¹⁰³ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Mbrojtjes së Fëmijëve në institucionin e Avokatit të Popullit.

- *cenimin e të drejtës së fëmijës për t'u arsimuar.* Mbyllja e institucioneve të edukimit gjatë periudhës së parë të pandemisë (karantinimi), solli pabarazi në aksesin e fëmijëve në procesin online të edukimit¹⁰⁴.
- *cenimi i të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara*¹⁰⁵.
- *mbrojtja e fëmijës nga dhuna në familje.* Si pasojë e masave kufizuese dhe izolimit të familjeve në shtëpi, fëmijë që kishin përjetuar forma të ndryshme të dhunës patën vështirësi në marrjen e shërbimeve të specializuara, për shkak të humbjes së kontaktit fizik me psikologët e shkollave dhe profesionistët e fushës¹⁰⁶.
- *cenimi i të drejtës së jetës dhe zhvillimit normal të fëmijës.* Pandemia COVID-19 preku ndjeshëm fëmijët e familjeve që jetojnë në varfëri, duke e bërë të pamundur garantimin e ushqimit ditor, për shkak të pamjaftueshmërisë së masës së ndihmës ekonomike, humbjes së vendeve të punës, mbylljes së shërbimeve ditore, si dhe dëmtimeve, që pat sjellë edhe tërmeti i 26 nëntorit 2019¹⁰⁷.
- *cenimi i të drejtës së jetës dhe shëndetit të të miturve në konflikt me ligjin e të privuar nga liria*¹⁰⁸.
- *mbrojtja e fëmijëve të vendosur në institucionet e përkujdesit social rezidencial*¹⁰⁹.

Të drejtat e fëmijëve në veçanti, pavarësisht situatës në të cilën gjendemi apo emergjencave dhe krizave, nuk mund të neglizhohen, anashkalohen apo shkelen. Garantimi i ushtrimit të këtyre të drejtave nga fëmijët, në vetvete është sfidë, sidomos në raste krizash apo emergjencash. Andaj, është detyrë parësore e institucioneve përgjegjëse shtetërore të përballen me sfidat e reja, qoftë në aspektin institucional, qoftë në atë ligjor.

Në përfundim, institucioni i AP-së ka adresuar një seri rekomandimesh për mekanizmat shtetërorë përgjegjës, pjesë e qenësishme e zinxhirit të sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, me qëllim mbrojtjen dhe garantimin e jetës së fëmijëve në përputhje me profilin dhe nevojat e tyre.

Më konkretisht, ndër rekomandimet më të qenësishme përmendim:

Së pari, në aspektin e garantimit të të drejtave të fëmijëve për mbrojtje sociale dhe kujdes shëndetësor, *Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*:

- *përmbushjen e detyrimeve dhe përgjegjësi për mbrojtjen e fëmijës dhe në veçanti, mbrojtjen e fëmijëve në nevojë dhe situatë rruge.*

¹⁰⁴ Konkretisht, fëmijët e familjeve që jetojnë në kushte të vështira social-ekonomike kishin mungesë të pajisjeve të teknologjisë së komunikimit dhe furnizimit me linjë interneti. Mungesa e unifikimit të një përvojë standarde të procesit të mësimdhënies online ndikoi në procesin e të nxënies (konjektiv) të fëmijës, në varësi të shkollës dhe vendbanimit të tyre.

¹⁰⁵ Ndër më të prekurit në këtë proces, kanë qenë fëmijët me aftësi të kufizuara, duke mos patur aksesin e duhur në procesin e mësimdhënies, me shërbime të përshtatshme dhe efektive për ta. Gjithashtu, këta fëmijë kanë përjetuar trauma gjatë kthimit në mjediset e institucioneve të edukimit për të kapur ritmin e boshllëqeve të krijuara gjatë procesit të mësimdhënies online. Gjatë fillimit të vitit të ri mësimor 2020-2021, me rihapjen e institucioneve të edukimit është konstatuar se shumë fëmijë janë izoluar rishtazi për periudha kohore të gjata, për shkak të protokollit Covid-19, duke krijuar pabarazi në qasjen e tyre ndaj procesit të mësimdhënies.

¹⁰⁶ Gjatë kësaj periudhe strukturat përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve u fokusuan në rastet në vazhdimësi. Shërbimet e ofruara për mbrojtjen e fëmijës dhe mbështetja e tyre nga shërbimet përkatëse u ulën në fillim të pandemisë, për shkak të mungesës së bashkëpunimit dhe bashkërendimit të strukturave përgjegjëse identifikuese, që operojnë në njësitë e qeverisjes vendore, të cilët mund të identifikonin në kohë çështjet në fjalë.

¹⁰⁷ Gjatë kësaj periudhe njësitë e qeverisjes vendore kanë shpërndarë ndihma ushqimore dhe veshmbathje për të siguruar standartin minimal të jetesës për këto familje.

¹⁰⁸ Kufizimet e lëvizjes ulën konsiderueshëm aksesin në arsim të kësaj kategorie, duke e kaluar pjesën më të gjatë të kohës të izoluar. Të miturit në konflikt me ligjin përjetuan një periudhë të zgjatur kohe pa kontakte ballë për ballë me familjet e tyre, avokatët, shërbimet mbështetëse, zgjatjen e procedurave gjyqësore. Këto problematika rrjedhimisht kanë ndikuar në shëndetin mendor të kësaj kategorie.

¹⁰⁹ Gjatë periudhës së izolimit/karantinimit, fëmijët e vendosur në institucionet e përkujdesit social kanë ndërprerë kontaktet fizike me familjarët e tyre, të afërm duke zgjatur në kohë institucionalizimin e tyre.

- *forcimin dhe garantimin e ofrimit të shërbimit të kujdesit shëndetësor për fëmijët, në veçanti për ata të prekur nga pandemia.*
- *krijimin e kushteve për realizimin e një vaksinimi të sigurtë të të miturve, sipas kalendarit të paracaktuar të vaksinimit.*
- *garantimin e vazhdimësisë së funksionimit të shërbimeve sociale, në interesin më të lartë të fëmijës.*

Së dyti, në aspektin e garantimit të të drejtave të fëmijëve për arsim, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë:

- *rishikimin e kuadrit ligjor ekzistues në fushën e arsimit parauniversitar e më gjerë, për parashikimin dhe ngritjen e platformave të studimit online, si një prej formave kryesore të të nxënës, sot në epokën digjitale;*
- *garantimin e zhvillimit të procesit të mësimdhënies online, në mënyrë të drejtë dhe gjithëpërfshirës, anekënd vendit;*
- *gjetjen e formave dhe alternativave të të mësuarit për fëmijët që nuk mund të ndjekin mësimin online, pasi nuk kanë akses në internet apo pajisjet e nevojshme;*
- *forcimin e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të respektimit të të drejtave të fëmijëve dhe vendosjen e të drejtave të fëmijëve në zemër të vullnetit të mësimdhënies;*
- *aplikimin e një pedagogjie të bazuar në të drejta, për të siguruar që fëmijët dhe të rinjtë të mësojnë në një mjedis ku respektohen këto të drejta;*
- *forcimin e punës për përsosjen e marrëdhënieve mësues-fëmijë/nxënës: marrëdhënie bashkëpunimi për arritjen e realizimit të objektivave të përbashkëta, ku një ndër të rëndësishmit është edhe parandalimi i çdo forme shkeljeje të të drejtave të tyre, edhe në këtë periudhë të pazakontë pandemie;*
- *rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet e internetit të pasigurt e të pakontrolluar, ndaj fëmijëve, në këtë situatë pandemie;*
- *ruajtjen e privatësisë dhe imazheve të fëmijëve-nxënës gjatë procesit të të mësuarit online, dhe konsolidimin e bashkëveprimit mësues dhe prindër në këtë kontekst, si konsideratë mjaft thelbësore;*
- *hartimin e një strategjie e cila mundëson mësimin alternativ të grupeve të ndryshme, duke mbajtur në konsideratë vendndodhjen dhe problematikat sociale të fëmijëve (psh.fëmijët e ngjuar, fëmijët me AK, fëmijët në nevojë, etj.).*

Së treti, për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës në periudhën e pandemisë, për strukturat e mekanizmit shtetëror përgjegjës të mbrojtjes së fëmijës, në nivel qendror dhe vendor:

- *fuqizimin e strukturave të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin, identifikimin, referimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve të dhunuar, në situatën e pandemisë.*
- *rritja e rolit interaktiv dhe proaktiv të të gjitha strukturave përgjegjëse në nivel vendor, për identifikimin e fëmijëve/familjeve të riskuara nga çdo formë e dhunës.*
- *identifikimin e familjeve të cilat kanë në përbërjen e tyre fëmijë që jetojnë në kushte të vështira sociale-ekonomike, për të bërë të mundur mbështetjen e tyre me paketa ushqimore, medikamente, etj.*

Së katërti, për garantimin e një drejtësie miqësore për të miturit në konflikt me ligjin, viktimat dhe/apo dëshmitarë, sidomos gjatë situatës së pandemisë, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme:

- *aplikimin e programeve rehabilituese dhe/ose të ndërmjetësit për dënimet alternative ose aplikimin e dënimeve alternative të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.*


- aplikimin e masave të shmangies alternative nga dënimi për të miturit në konflikt me ligjin.
- përmirësimin e kushteve dhe shërbimeve në mjediset e institucioneve të privimit të lirisë a paraburgimit, ku trajtohen të miturit në konflikt me ligjin, viktimat dhe/apo dëshmitarë, veçanërisht në situatën e pandemisë.

Në vijim, sfida kryesore për mekanizmat shtetërorë përgjegjës, pjesë të sistemit të integruar të mbrojtjes së të drejtave të fëmijës mbetet strukturimi i detyrave dhe përgjegjësi në kuadër të menaxhimit të pasojave që pandemia ka pasqyruar në jetët e individëve të shoqërisë, veçanërisht të fëmijëve. Kur kjo pandemi të vihet nën kontroll, të gjithëve do t'u duhet të maksimalizojnë përpjekjet e tyre, për të zgjidhur mangësitë e kahershme në ligj, praktikë dhe ligjërime, të cilat janë aq të dëmshme për dinjitetin dhe të drejtat e njeriut.

Të drejtat e fëmijës në kuadër të promovimit dhe garantimit

Viti 2020, ndryshe nga viti 2019, solli një qasje të re pune në kushtet e pandemisë së COVID-19 në drejtim të promovimit, parandalimit të shkeljeve dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. KMPDF ka realizuar veprimtari të ndryshme promovuese duke luajtur rol proaktiv në drejtim të promovimit të të drejtave të fëmijëve me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e institucioneve të administratës shtetërore në nivel qendror dhe vendor, në ushtrimin e detyrave të tyre funksionale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në funksion të zhvillimit të veprimtarive promovuese, institucioni i AP-së është fokusuar në drejtim të:



Veprimtaritë e zhvilluara me karakter informues, të publikuara në faqen zyrtare të rrjetit social facebook të Komisionerit dhe institucionit të AP, janë si vijon:

- Publikimi i deklarats¹¹⁰ me qëllim ndërgjegjësimin e fëmijëve dhe familjeve të tyre me liritë dhe drejtat e tyre në frymën e Konventës të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e

¹¹⁰ Avokati i Popullit bën thirrje për nevojën e vëmendjes mbi çështjet e mbrojtjes të të drejtave të fëmijëve në situatë pandemie.(20.03.2020).

Fëmijës, si dhe instrumentave të tjerë ndërkombëtare dhe evropiane të rëndësishme për të drejtat e njeriut edhe në situatë emergjence.

- Publikimi i udhëzuesit informues¹¹¹ për fëmijët rreth virusit COVID-19, për menaxhimin e emocioneve, në një gjuhë të thjeshtë dhe miqësore për ta.
- Publikimi i udhëzuesve shpjegues¹¹², të përgatitura nga UNICEF, OBSH apo organizata ndërkombëtare të ndryshme, për lehtësimin e pasojave të ankthit, stresit e frikës në situatën e pandemisë. Këto burime ofrojnë disa materiale edhe për prindërit, që edhe ata të përfshihen në aktivitete të ndryshme me fëmijët.

Gjithashtu, në partneritet me organizatat ndërkombëtare, janë realizuar publikime për të sjellë në vëmendje të organeve shtetërore respektimin e të drejtave të fëmijëve, edhe pse në situatë pandemie. Më konkretisht përmendim:

- Rekomandimet e ENOC drejtuar Komisionit Evropian dhe Këshillit të Evropës për të siguruar që të drejtat e fëmijës, të garantohen në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara të të Drejtave të Fëmijës dhe Komentet e Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, të respektohen gjatë kësaj situatë pandemie COVID-19.
- Deklarata e OSBE¹¹³ për sjelljen në vëmendje të rritjes së rrezikut të dhunës në familje, kryesisht tek gratë dhe fëmijët.
- Deklarata e Komitetit të Gjenevës për të Drejtat e Fëmijës¹¹⁴ për çështjet më të mprehta që lidhen me situatën e fëmijëve në nivel global, për shkak të efekteve të pandemisë COVID-19.
- Deklarata e Komitetit të Lanzarotit¹¹⁵ solli në vëmendjen e shteteve palë propozime konkrete në forcimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi në kohërat e pandemisë COVID-19.
- Rekomandimet e OBSH-së, si institucioni përgjegjës ndërkombëtar për certifikimin e protokolleve përgjegjëse në ruajtjen dhe garantimin e shëndetit të njeriut në përgjithësi dhe fëmijëve në veçanti.

Sikundër, Komisioneri për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve ka marrë pjesë aktive në shumë veprimtari, në të cilat ka prezantuar qasjen institucionale të Avokatit të Popullit, orientuar drejt dy komponentëve kryesore:

- a) *së pari*, ndarjen e përvojës dhe praktikave të mira të punës;
- b) *së dyti*, parashtrimin e problemeve dhe shkeljeve të konstatuara në kushtet e reja të të punuarit *online*.

Ndër veprimtaritë kryesore të organizuara përmendim si vijon:

- Tryezë pune me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Qamil Guranjaku" në qytetin e Elbasanit për të dëgjuar idetë dhe mendimet e tyre për draft-doracakun "Për edukimin për/rreth të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe fëmijëve në veçanti në programet mësimore".
- Webinaret *online* me fëmijët dhe nxënësit¹¹⁶, për prezantimin e doracakut "Për edukimin për/rreth të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe, fëmijëve në veçanti në programet mësimore".

¹¹¹ Heroi im je ti-si fëmijët mund të luftojnë Covid-19", datë 10 prill 2020.

¹¹² Deklaratë e publikuar, më datë 24.4.2020.

¹¹³ Deklarata e OSBE-së, më datë 2.4.2020.

¹¹⁴ Deklarata e Komitetit të Gjenevës për të Drejtat e Fëmijëve, më datë 10.4.2020.

¹¹⁵ Deklarata e Komitetit të Lanzarotit, më datë 9.4.2020.

¹¹⁶ Fëmijët e qyteteve të Peshkopisë dhe Burrelit; fëmijët e qyteteve të Durrësit dhe Elbasanit; fëmijët qytetit të Kuçovës; fëmijët e qytetit të Gjirokastrës; nxënësit e shkollës "Haki Stërmilli" dhe shkollës 9-vjeçare Kobenit (Peshkopi); nxënësit e shkollës 9-vjeçare Pöcest (Peshkopi).

- Takime /tryeza pune të organizuara me përfaqësues të autoriteteve publike në nivelin qendror dhe vendor, përgjegjëse për mbrojtjen sociale të fëmijëve, pjesë e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës në bashkitë e qyteteve Tropojë, Shkodër dhe Korçë, për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të fëmijëve në situatën e pandemisë dhe sfidat e hasura.

Në cilësinë e përfaqësuesit të institucionit të AP për promovimin e të drejtave të fëmijëve, KMPDF ka marrë pjesë në mënyrë aktive në disa veprimtari, ndër të cilat përmendim si vijon:

- Konferenca vjetore *online* e rrjetit ENOC, me temë diskutimi “Child Rights Impact Assessment - Vlerësimi i ndikimit tek të drejtat e fëmijëve” (CRIA).
- Takimi *online* i Sekretariatit të përhershëm të Nismës Adriatike-Joniane¹¹⁷, për rolin e Ombudsmanëve në menaxhimin e krizës COVID-19, si dhe shkëmbimi i eksperiencës dhe ndarja e praktikave më të mira në mbrojtjen e fëmijëve dhe adoleshentëve gjatë COVID-19, në vendet respektive.
- Takimi *online* i grupit të deputetëve të KRSH-së “Miq të fëmijëve”, në të cilin u prezantuan problematikat dhe rekomandimet për monitorimin e të drejtave të fëmijëve gjatë pandemisë COVID-19.
- Pjesëmarrja aktive në takimin e Mekanizmit Institucional për Monitorimin e Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur, duke sjellë në vëmendje zbatimin e rekomandimeve të AP-së për funksionimin “*de facto*” të Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve, institucionit të Edukimit dhe Rehabilitimit të të Miturve dhe Sistemit Elektronik të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur.
- Pjesëmarrja aktive në mbledhjen e grupit të deputetëve të Kuvendit të RSH-së “Miq të fëmijëve”, ku AP dhe KMPDF adresuan problematikat, gjetjet dhe rekomandimet, lidhur me risitë, sfidat dhe problematikat për platformën e të mësuarit *online*.
- Pjesëmarrje aktive në takimin *online* të realizuar në kuadër të Ditës Evropiane Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore¹¹⁸, në të cilin u prezantuan gjetjet dhe problematikat e evidentuara në punën e organeve shtetërore, aktorë të rrjetit të integruar të mbrojtjes sociale në rastet e dhunës dhe, në veçanti të shfrytëzimit seksual.
- Pjesëmarrja aktive në takimin *online* të Rrjetit ENOC, në të cilën u ndanë eksperiencat dhe praktikat e punës lidhur me sfidat e institucioneve të pavarura, gjatë ushtrimit të funksionit të tyre në evidentimin e shkeljeve të të drejtave të fëmijëve në periudhën e pandemisë.

Në ndryshim nga viti 2019, viti 2020 shënoi edhe një qasje të re në pjesëmarrjen proaktive në mediat vizive dhe të shkruara, për ndërgjegjësimin, edukimin dhe informimin e publikut me problematikat e identifikuar, adresimin e zgjidhjeve të këtyre problematikave nga organet përgjegjëse të administratës shtetërore në fushën e të drejtave të fëmijëve, si dhe advokimin e detyrimit kushtetues dhe ligjor të zbatimit të rekomandimeve të AP-së nga organet shtetërore të sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës.

3.17 Respektimi i të drejtës për kujdes shëndetësor¹¹⁹

Mbrojtja e shëndetit dhe e drejta për kujdes shëndetësor është një e drejtë e sanksionuar jo vetëm nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ligjore, por edhe nga një sërë aktesh ndërkombëtare në të cilat vendi ynë ka aderuar.

¹¹⁷ Organizuar nga Projekti EUSAIR, në bashkëpunim me zyrën e “Marche Region Ombusman”, me pjesëmarrjen e Ombudsmanëve për të Drejtat e Fëmijëve të Bosnje-Hercegovinës, Kroacisë, Greqisë, Italisë, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, San Marinos, Serbisë dhe Sllovenisë.

¹¹⁸ Aktivitet i organizuar nga CRCA/ECPAT Shqipëri, me qëllim prezantimin e Raportit “Shqipëria: Treguesit e përgjithshëm të vendit”, një raport mbi shkallën, natyrën dhe kontekstin e shfrytëzimit seksual të fëmijëve në Shqipëri.

¹¹⁹ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në institucionin e Avokatit të Popullit.

Organizata Botërore e Shëndetësisë, në kuadër të pandemisë COVID-19, orientoi qeveritë e vendeve të ndryshme drejt ngritjes dhe mirëfunksionimit të një sistemi të aksesit të barabartë dhe sigurimit të ofrimit të të gjithë spektrit të shërbimeve shëndetësore, për të gjithë qytetarët, duke monitoruar edhe progresin e kryer në këtë aspekt. Kohërat me pandemi, evidentojnë më qartë sa i rëndësishëm është shëndeti dhe e drejta e çdo individi për kujdes shëndetësor, i cili në funksion të gëzimit të qetë dhe realizimit efektiv të kësaj të fundit, të mund të përfitojë nga sistemi i sigurimit shëndetësor. Sigurimi universal i shëndetit nënkupton që çdo individ dhe komunitet të marrë të gjithë shërbimin shëndetësor të nevojshëm, pa vuajtur financiarisht. Shërbimi shëndetësor duhet të përfshijë të gjithë spektrin e shërbimit bazë të shëndetit cilësor, duke filluar me parandalimin, trajtimin, rehabilitimin dhe kujdesin paliativ.

Në qasjen e institucionit të Avokatit të Popullit, parimi mbi të cilin duhet të mbështet funksionimi i kujdesit shëndetësor është pikërisht tërësia e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor, cilësia e këtyre shërbimeve dhe efikasiteti, duke garantuar sigurinë e pacientit, pa kosto shtesë. Në këtë mënyrë zbatohet një tjetër standard ndërkombëtar që e ka filluesin që në Deklaratën Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se shpërthimi i pandemisë së COVID-19, thelloi, duke risjellë edhe njëherë në vëmendje problematikat e hershme, si dhe evidentoi problematika të reja, me të cilat u ballafaqua shoqëria, në raport me të drejtën e saj për kujdes shëndetësor të garantuar nga shteti.

Gjatë vitit 2020 individët e varfër dhe të cënueshëm financiarisht u përballën me kosto të larta ekonomike shtesë sa i përket kujdesit shëndetësor shoqëruar kjo edhe me mungesën e ofrimit të shërbimeve bazë të kujdesit shëndetësor. Sasia e kufizuar e kursimeve, mbulimi i ulët me sigurime shoqërore dhe përdorimi relativisht i ulët i shërbimeve publike, çojnë në rëndim të efekteve negative afatgjata të përballjes me krizën e pandemisë.

Rezultoi se familjet në nevojë u prekën nga diskriminimi social si dhe u goditën më shumë nga masat kufizuese kundër COVID-19. Gjithashtu, të moshuarit ishin relativisht më të predispozuar ndaj problemeve shëndetësore, më të rrezikuarit nga shpërthimi i pandemisë dhe më të shumtë në humbje jete gjatë pandemisë. Edhe komuniteti rom dhe pakicat e tjera etnike u përballën me rreziqe më të larta në lidhje me shëndetin, si pasojë e aksesit të ulët në shërbime bazë shëndetësore dhe mundësi të kufizuara ekonomike.

Përgjatë vitit 2020, diktuar nga rrethanat e reja të krijuara në kushtet e pandemisë globale, Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale hartoi një numër aktesh ligjore dhe nënligjore në funksion të rregullimit ligjor dhe faktik të pandemisë në vend, duke filluar nga *“Plan Strategjia ndaj COVID-19”*, të hartura me asistencën dhe sugjerimet e Komitetit Teknik, (strukturë e posaçme e krijuar prej muajit Mars 2020 e në vazhdim).

Me aktin normativ nr. 243, datë 24.3.2020 *“Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”*, qeveria shqiptare vendosi shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë, për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 dhe kufizimin e të drejtave të garantuara, deri në masën që konsiderohet e domosdoshme për të arritur ruajtjen e shëndetit të shtetasve.

Akti normativ i sipërcituar, u implementua jo pa sfida, duke evidentuar problematika të qarta veçanërisht në raport me të drejtën e informimit dhe transparencën ndaj publikut të gjerë lidhur me numrin e përgjithshëm të testeve, mundësinë reale dhe kapacitetin që kishte shteti për kryerjen e tyre, sasitë e porositura të testeve, shpalosjen e strategjisë së testimit si dhe respektimin e të drejtave të pacientëve të akomoduar në stukturat spitalore përgjatë pandemisë.

Megjithë përpjekjet e shtuara të strukturave përkatëse ligjzbatuese në funksion të menaxhimit të situatës, theksojmë se transparenca por edhe masa e ndihmave të alokuara qytetarëve përbën ende një sfidë të pa adresuar në mënyrën dhe masën e duhur gjatë kësaj pandemie.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se transparenca dhe informimi i publikut lidhur me kapacitetet e shtetit shqiptar për të kryer testimin e popullsisë, si dhe me arsyet e moskryerjes së testeve në masën e rekomanduar nga OBSH-ja, konsiderohet si i qënësishëm e i lidhur ngushtë jo vetëm me cilësinë e menaxhimit të situatës së pandemisë por edhe me besimin e qytetarëve tek autoritetet shtetërore, mbi të gjitha, me të drejtën e qytetarëve për akses të barabartë në shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe respektimin e të drejtave të pacientit kur ata akomodohen në strukturat spitalore.

Ekzistojnë dy aspekte të ndërlidhura të transparencës gjatë një pandemie:

Aspekti i parë i referohet cilësisë së komunikimit mbi informacionin që nevojitet nga njerëzit dhe komunitetet gjatë një emergjence në mënyrë që të shmangen sëmundjet dhe të ndalohej përhapja e saj. Kur publiku rrezikon nga një kërcënim i vërtetë ose i mundshëm për shëndetin, mundësitë e trajtimit mund të jenë të kufizuara, ndërhyrjet direkte mund të kërkojnë kohë për t'u organizuar dhe burimet mund të jenë të pakta. Prandaj, komunikimi i këshillave dhe udhëzimeve shpesh qëndron si mjeti më i rëndësishëm në dispozicion për administrimin e një rreziku. Përveç shërbimit të objektivave themelorë të shëndetit publik, komunikimi publik transparent, gjithashtu, adreson edhe objektivat kryesore strategjike - politike, ekonomike dhe psikosociale të cilat janë të lidhura me shfaqjen e shëndetit publik.

Aspekti i dytë i transparencës synon të promovojë besimin midis autoriteteve të shëndetit publik dhe publikut, duke u mundësuar qytetarëve identifikimin nga ana e tyre të nivelit të ushtrimit efektiv të së drejtës së tyre për kujdes shëndetësor, aksesin e barabartë në tërësinë e shërbimeve të kujdesit shëndetësor të cilësisë së duhur, sanksionuar në Konventën e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Dinjitetit të Qënies Njerëzore si dhe respektimin e të drejtave të pacientit, të sanksionuara në Kartën për të Drejtat e Pacientit.

Me një qasje e cila ka në fokus të saj respektimin e të drejtave të njeriut dhe pacientit, e përcaktuar specifikisht në aktet ndërkombëtare dhe të brendshme, (të cilat i rekomandojnë autoriteteve shtetërore të shteteve të ndryshme, që në masat që do ndërmarrin për përballimin e pandemisë, të kenë në vëmendje respektimin e të drejtave të njeriut dhe aksesin e barabartë të qytetarëve për kujdes shëndetësor nga shteti), institucioni hartoi rekomandimin drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për adresimin e problematikave të sipërcituara në lidhje me nivelin e testeve dhe realizimin e transparencës së autoriteteve shtetërore me qytetaret, duke kërkuar shprehimisht:

- *Marrjen e masave të menjëhershme, për gjetjen e mundësive për shtrirjen masive dhe kryerjen e testeve të qytetarëve për COVID-19, në përputhje me sugjerimet dhe udhëzimet e OBSH-së dhe sipas parashikimeve të akteve ligjore specifike në fuqi;*
- *Informim dhe transparenca lidhur me sasitë e tamponëve testues dhe kapacitetin për të testuar;*
- *Garantimin e të drejtës për testim të çdo qytetari shqiptar për COVID-19, qoftë dhe edhe me kosto shtesë financiare, e cila të përballohet nga vetë qytetari, në përmbushje të detyrimit që ka shteti, që t'i mundësojë në mënyrë të barabartë shtetasve të tij të drejtën për kujdes shëndetësor;*
- *Procedura e kryerjes së testit COVID-19 të liberalizohet konform akteve ligjore në fuqi dhe direktivave të OBSH-së, duke lejuar institucioneve dhe operatorë të tjerë shëndetësorë, të certifikuar rregullisht, të ofrojnë këtë shërbim jetik në situatë pandemie.*

Referuar ankesave të regjistruara nga institucioni i Avokatit të Popullit për vitin 2020, rezulton të jenë regjistruar 130 ankesa, nga të cilat 115 rezultojnë të jenë raste të bazuara në *investigimet “ex-officio”*, si pasojë e implementimit me sukses të mekanizmit të monitorimit mbi bazë ditore dhe konstatimit të problematikave të bëra publike në mediat tradicionale dhe ato on- line, përmes grupeve të punës të ngritura posaçërisht, në kushtet e distancimit fizik e social.

Ankesat/rastet me iniciativë evidentuan ekzistencën e problematikave kryesore të tilla si: trajtimi mjekësor jo konform standardeve; burokracira lidhur me rradhët e pritjes në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUT) dhe spitalet Covid 1 dhe 2; mungesa e protokolleve mjekësore të trajtimit të COVID-19; mungesa e mjeteve mbrojtëse për personelin mjekësor dhe mungesa e dezinfektantëve në spitale e poliklinika, në kuadër të masave të mbrojtjes ndaj COVID-19.

Problematikë serioze u identifikua të ishte edhe mungesa e personelit mjekësor dhe infermier në spitale rajonale dhe zona rurale, çka passolli detyrimisht radhë të gjata të pacientëve në Tiranë, edhe pas udhëzimeve për pezullime të shumë operacioneve dhe procedurave të tjera për pacientët me sëmundje të tjera.

Një problematikë shumë e shprehur ishte mungesa e ofrimit për shumë qytetarë e shërbimit të urgjencës, si dhe mohimi i ofrimit të shërbimit shëndetësor të nevojshëm për sëmundshmëri, të ndryshme nga ajo e infektimit me COVID-19.

Nga numri total i ankesave të shqyrtuara, rezulton se *për 100 ankesa është përmbyllur shqyrtimi*, ndërsa të tjerat vijnë ende të jenë në proces hetimi administrativ. Në numrin e ankesave të shqyrtuara rreth 70 prej tyre rezultojnë të jenë zgjidhur në favor të qytetarëve dhe problematikave të ngritura, të bëra prezent në objektin e ankesës.

Referuar rasteve specifike të shqyrtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit, të cilat janë finalizuar me hartimin e rekomandimeve përkatëse për vitin 2020, spikasin rekomandimet sa më poshtë, drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:

- *Rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme, për krijimin e mundësive për kryerjen e testeve të nxënësve dhe studentëve që studiojnë jashtë vendit për COVID-19, edhe kundrejt pagesës së një tarife të orientuar drejt kostos, si një e drejtë e tyre dhe një detyrim i shtetit për ta realizuar atë.*
- *Rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme për planifikimin e fondeve për blerjen e (EEG) për fëmijët në repartin e pediatri në QSUT, e cila doli jashtë përdorimit në kohën e vështirë të pandemisë.*
- *Rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme për vënien në dispozicion të Shoqërisë “Life” Shpk, të informacionit i cili konsiston në listën e barnave me çmimet “CIF-EXE”, miratuara për vitet 2014-2019, në përmbushje të detyrimit ligjor që autoriteti publik, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi “Për të drejtën e informimit” dhe botimin e listës së barnave në faqen e ministrisë, në formatin e duhur.¹²⁰*

Përgjatë vitit 2020, në kushtet e një qasjeje të re të diktuar nga distancimi social dhe fizik, bashkëpunimi i institucionit të Avokatit të Popullit me shoqatat e shoqërisë civile që operojnë në mbrojtje të të drejtave të pacientit, ka njohur një hop të dukshëm cilësor, përmes komunikimit on-line me to, në funksion të evidentimit të problematikave dhe adresimit të shqetësimit të tyre

¹²⁰ Për më shumë lexoni rekomandimet në linkun: <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/categories/general-issues>.

në institucionet shëndetësore përgjegjëse. Në takimet e organizuara janë bërë prezente studime, raporte, monitorime dhe analizuar gjetje e rekomandime, për përmbushjen e qëllimit të përbashkët, atë të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të pacientëve.

Institucioni i Avokatit të Popullit duke vlerësuar përpjekjet e vazhdueshme të institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e pandemisë COVID-19, shprehet se është i domosdoshëm angazhimi serioz i qeverisë për një menaxhim më të kujdeshëm e më efektiv, i orientuar drejt një qasje e cila synon ofrimin e të gjithë shërbimeve të kujdesit shëndetësor të cilësisë së duhur, eliminimin e rasteve korruptive të shfaqura në shëndetësi, rritjen e transparencës mbi vendimmarrjen e Komitetit Teknik në raport me publikun, publikimin e akteve të ndryshme ligjore e nënligjore, të hartuara në kuadër të kësaj pandemie, të cilat prekin të drejtën për kujdes shëndetësor, si dhe gjetjen e mekanizmave financiarë për mbështetjen dhe amortizimin e kostove shtesë financare që ka gjeneruar për qytetarët pandemia e COVID-19.

3.18 Respektimi i të drejtës për arsimim¹²¹

Rëndësia e kësaj të drejte është e pamohueshme, jo vetëm pasi është një nga të drejtat themelore të njeriut, por mbi të gjitha pasi ka karakteristikat e një të drejte si instrument nëpërmjet të cilës realizohen të drejtat e tjera të njeriut. Ajo është një nga të drejtat bazë sepse luan një rol të rëndësishëm në përparimin dhe zhvillimin e shoqërisë dhe të vetë shtetit.

Institucioni i Avokatit të Popullit, vlerëson se pandemia ka kompromentuar thellësisht nivelin aktual të arsimit, duke e përkeqësuar atë. Fëmijë nga familje me të ardhura të ulëta, fëmijë që jetojnë në zona rurale me infrastrukturë të dobët, fëmijë nga pakica etnike dhe gjuhësore, fëmijë me aftësi të kufizuara e fëmijë në konflikt me ligjin, përpos problematikave të hershme me të cilat përballen në përditshmërinë e tyre, tanimë po ndeshen edhe me barriera të reja domethënëse e të pakërcyeshme sa i përket pjesëmarrjes aktive në arsim e të qënurit pjesë integrale e procesit të nxënies, si pasojë e mungesës së aksesit në mësimin on- line, duke përfituar për pasojë arsim të një niveli më të dobët, i cili materializohet në më pak rezultate pozitive krahasuar me bashkëmoshatarët e tyre.

Institucionet e edukimit arsimor nuk janë vetëm vendi i të nxënësve akademik, por edhe i të nxënësve social dhe emocional, vendi i ndërveprimit dhe mbështetjes sociale. Mbyllja e tyre për një periudhë të gjatë kohore nuk ka ndërprerë vetëm të nxënësve e fëmijëve, por edhe mirëqenien e tyre emocionale e sociale si pasojë e mungesës së referimit tek shërbimet shëndetësore dhe shërbimet sociale bazë.

Sfida që shoqëroi qeverinë, drejtuesit e institucioneve në sferën e kompetencës të të cilave është arsimi, drejtuesit e institucioneve të edukimit arsimor dhe vetë mësuesit e nxënësve ishte planifikimi i ofrimit të arsimit në kohë shumë të pasigurt, në kushtet e reja të distancimit social e fizik.

Qasja e re alternative, e adoptuar nga qeveria, ajo e të nxënësve dhe edukimit përmes platformave on-line të edukimit me gjithë përpjekjet e bëra, u implementua me jo pak sfida. U evidentua ekzistenca e problematikave kryesore të tilla si: mungesa e infrastrukturës për ndjekjen e mësimi përmes platformave online të edukimit nga fëmijet dhe të rinjtë e grupeve të marginalizuara, që pamundësohej nga mungesa e tabletave, kompjuterave, celularëve apo dhe lidhjes me internet si dhe mosndjekja në zonat e thella dhe të varfra ekonomikisht e televizionit, konkretisht e Televizionit Publik Shqiptar, i cili trasmentonte nje platforme mësimi on-line.

¹²¹ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në institucionin e Avokatit të Popullit.

Gjithashtu mësuesit u përballën me vështirësitë konkrete në kushtet e mungesës së trajnimit për ofrimin e dhënies të mësimin on-line por edhe orëve të gjata të punës.

Referuar ankesave të regjistruara nga institucioni i Avokatit të Popullit për vitin 2020, rezulton të jenë regjistruar *110 ankesa, nga të cilat 98 rezultojnë të jenë raste të bazuara në investigimet “ex-officio”*, si pasojë e implementimit me sukses të mekanizmit të monitorimit mbi bazë ditore dhe konstatimit të problematikave të bëra publike në mediat tradicionale dhe ato on-line, përmes grupeve të punës të ngritura posaçërisht, në kushtet e distacimit fizik e social.

Një problematikë shqetësuese e që meriton specifikisht vëmendje për nga numri i lartë i ankesave të regjistruara, janë ankesat të cilat kanë në objekt të tyre vonesat në akordimin e bursave të studentëve si dhe kërkesën për uljen e tarifave studentore, si rezultat i vitit të vështirë dhe i pamundësisë së shumë familjeve që u preken nga papunësia dhe probleme të ndryshme sociale.

Nga numri total i ankesave të shqyrtuara, rezulton se për 70 ankesa është përmbyllur shqyrtimi, ndërsa të tjerat vijojnë ende të jenë në proces hetimi administrativ. Në numrin e ankesave të shqyrtuara, rreth 50 prej tyre rezultojnë të jenë zgjidhur në favor të qytetarëve dhe problematikave të ngritura të bëra prezent në objektin e ankesës.

Referuar rasteve më specifike të shqyrtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit për të cilat është hartuar edhe rekomandim për vitin 2020, do veçonim atë, për ankesën e shtetasit A.Ç, drejtuar Zyrës Vendore Arsimore, Tiranë në lidhje me:

- *Marrjen e masave të menjëhershme, në cilësinë e institucionit arsimor epror, për lejimin e prindit A. Ç për të marrë informacion për edukimin e fëmijëve të tij, nga ana e shkollës 9 vjeçare “Shqyri Peza”, Kombinat, Tiranë,*
- *Marrjen e masave të nevojshme për miratimin e procedurave konkrete për garantimin e aksesit në informacion në raste të tjera të ngjashme.*

Përgjatë vitit 2020, në kushtet e një qasjeje të re të diktuar nga distacimi social dhe fizik, institucioni i Avokatit të Popullit ka konsoliduar partneritetin e tij me të gjitha organizatat e shoqërisë civile, përmes komunikimit on-line, duke luajtur rol proaktiv për evidentimin e problematikave dhe adresimin e shqetësimeve të tyre në institucionet arsimore përgjegjëse. Në vazhden e sa më sipër, ishte edhe pjesëmarrja në konferencën *"Edukimi për Qytetari Demokratike"*, e organizuar nga Këshilli i Evropës në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në kuadër të projektit “Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri”, financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson përpjekjet e institucioneve përgjegjëse dhe specifikisht të mësuesve, për menaxhimin e një qasjeje të re të edukimit dhe nxënies, përmes rritjes së numrit të mësuesve në funksion të përballimit të situatës së krijuar, si dhe përfundimit të procedurave të konkurimit të psikologëve dhe punonjësve social në institucionet e edukimit arsimor, si një domosdoshmëri e diktuar nga niveli i lartë i stresit shfaqur tek fëmijët dhe adoleshentët për shkak të distancimit social dhe fizik.

Në kushtet e një qasjeje të re të edukimit dhe nxënies, përmes platformave on-line vijon të mbetet detyrim prioritar kryerja e trajnimeve të mësuesve dhe rritja e kapaciteteve të tyre, përshtatja e teksteve shkollësi si dhe gjetja e teknologjive sa më të aksesueshme, jo vetëm për nxënësit në zonat rurale, por edhe ato urbane.

Gjetja e mekanizmave financiarë për mbështetjen dhe motivimin e mësuesve, merr tashmë trajtën e detyrimit ndaj kësaj kategorie, e renditur e dyta, pas personelit mjekësor dhe infermier për ngarkesën më të cilën u ballafaqua gjatë pandemisë COVID-19.

3.19 Respektimi i të drejtës për kujdes social¹²²

Një nga parimet e Axhendës 2030 të Kombeve të Bashkuara është progresi drejt Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke ju kushtuar vëmendje të veçantë individëve dhe familjeve të varfëra. Qeveria shqiptare, në këtë kuadër dhe në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 dhe Dokumentin Politik për Përfshirjen Sociale 2016-2020, ka nisur një reformë të sistemit të mbrojtjes shoqërore, duke investuar në hartimin e një legjislacioni të ri në këtë fushë dhe ndërtimin e mekanizmave për të siguruar një sistem efektiv të mbrojtjes sociale.

Si një nga programet e mbrojtjes sociale, që gjen rregullimin e veçantë në ligjin nr.57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, është dhe ai i ofrimit dhe shpërndarjes së ndihmës ekonomike.

Përpjekjet për rritjen e efektivitetit dhe modernizimin e skemës së ndihmës ekonomike në Shqipëri me asistencën e Bankës Botërore, projekt i cili u zbatua në nivel kombëtar në 2018, patën rezultate pozitive në shumë aspekte. Kjo skemë pati edhe disavantazhe, të cilat qeveria i adresoi nëpërmjet fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike për Pushtetin Vendor, por kjo ndërhyrje nuk garantoi mbulimin e të gjitha familjeve që jetonin në varfëri për të pasur mbështetje financiare, çka evidentohet qartazi në numrin e ankesave dhe larmishmërisë së problematikave të parashtruara në objektin e ankesave të regjistruara pranë institucionit tonë.

Pas shpërthimit të COVID-19, institucioni i Avokatit të Popullit, ka monitoruar me kujdes, masat e marra nga autoritetet shqiptare për kategoritë më të ekspozuara ndaj cënueshmërisë financiare, me qëllim garantimin e jetesës normale në kushtet e izolimit.

Me një qasje të tillë, institucioni i Avokatit të Popullit hartoi rekomandimin drejtuar 61 kryetarëve të bashkive, duke kërkuar shprehimisht:

- vijimin pa ndërprerje të dhënies së pagesës së ndihmës ekonomike, pasi kjo pagesë është i vetmi burim jetese për këto familje;
- nga ana e administratorëve shoqërorë, të bëhet evidentimi i atyre familjeve në nevojë, të cilat nuk kanë asnjë mundësi për aplikimin online të ndihmës ekonomike dhe ofrimi i asistencës në kryerjen e plotësimit të aplikimit, me qëllim përfitimin e pagesës së ndihmës ekonomike.

Në vlerësimin e institucionit të Avokatit të Popullit, VKM nr.254, datë 27.3.2020 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike e të pagesës të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore të shpallur si pasojë e COVID-19”, i cili përcaktonte se një nga kategoritë që përfitonin dyfishin e pagesës janë individët që përfitojnë ndihmë ekonomike, u implementua jo me pak sfida. Në çdo rast Avokati i Popullit vlerëson faktin që për këtë periudhë mujore vlera e masës së pagesës u dyfishua duke e konsideruar këtë ndërhyrje shumë të rëndësishme.

Problematikat më të shprehura, të cilat shoqëruan procesin e ofrimit dhe shpërndarjes së “pagesës së luftës” për përfituesit e ndihmës ekonomike, ishte mungesa e aksesit në kryerjen e aplikimit dhe plotësimit të formularit përkatës, për përfitimin e saj.

¹²² Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në institucionin e Avokatit të Popullit.

Sipas parashikimeve të VKM-së së sipërcituar, aplikimet për ndihmën ekonomike do të pranohen nga administratorët shoqërorë të njësive administrative, në formë elektronike ose postare. Pavarësisht se formulari përkatës, që duhet të plotësohet për përfitimin e ndihmës ekonomike ishte online, duhet theksuar fakti se jo të gjithë individët kanë akses për të bërë këtë aplikim. Shumë familje nuk kanë asnjë mundësi për të aplikuar, pasi nuk kanë në përdorim mjete elektronike apo komunikimi, veçanërisht ato që jetojnë në zona të thella.

Një problematikë tjetër e raportuar është edhe vonesa në lëvrimin e fondeve të “pagës së luftës” për përfituesit e ndihmës ekonomike, duke i vënë ata në pamundësinë konkrete për të marrë të vetmen pagesë, e cila siguron jetesën e tyre,

Referuar rasteve të trajtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit, jo vetëm ankesa apo kërkesa të shtetasve, por dhe si raste të iniciuara për trajtimin me iniciativë, për vitin 2020, rezulton të jenë trajtuar gjithsej 43 raste, nga të cilat 29 kanë marrë zgjidhje dhe përgjigje në favor të ankuesve/kërkuesve, 7 raste prej tyre kanë rezultuar të pabazuara, ndërsa 6 raste janë në trajtim. Prej tyre u evidentua ekzistenca e problematikave kryesore, të tilla si: mospërfitimi i ndihmës, pezullimi dhe ndërprerja e përfitimit të ndihmës ekonomike, si dhe paqartësia e qytetarëve për arsyet e mospërfitimit apo mospërfshirjes së tyre në skemën e përfitimit të ndihmës ekonomike.

Masa e ndihmës ekonomike vijon të raportohet nga qytetarët në ankesat e tyre, edhe përgjatë vitit 2020, si shumë e ulët në raport me shpenzimet mujore më të domosdoshme për të mbijetuar, e jo më pastaj të synojë të zbusë varfërinë dhe të mundësojë integrimin social të individëve dhe familjeve, çka përbën dhe objektivin kryesor të këtij instrumenti të mbrojtjes sociale.

Problematiche shfaqet situata e ofrimit dhe shpërndarjes së ndihmës ekonomike në komunitetin Rom, të cilët kanë mungesë të dokumentave identifikues (ID), gjë që i përjashton automatikisht nga përfitimi i saj.

Institucioni i Avokatit të Popullit, duke e konsideruar si të pajustificueshme në qasjen e tij mungesën e përcaktimit të një minimumi jetik, i cili duhet të qëndrojë në themel të hartimit të politikave sociale që ndjek shteti për grupet në nevojë, inicioi gjatë vitit 2020 hartimin e raportit “Për Standardin e Minimumit Jetik në Shqipëri”.

Qëllimi i këtij raporti është të bëjë një vlerësim të situatës ekonomike, ligjore dhe sociale, sa i përket situatës së mospërcaktimit të minimumit jetik si përkufizim dhe si bazë, jo vetëm për ndihmën ekonomike, por edhe për politikat e tjera në mbështetje të individëve dhe familjeve të varfra në Shqipëri.

Objektivat e raportit janë: 1. të bëjë një panoramë aktuale të situatës ekonomike dhe të varfërisë në Shqipëri dhe të projektojë një nivel të minimumit jetik; 2. të eksplorojë zhvillimet e legjislacionit në Shqipëri sa i përket mbrojtjes sociale dhe të vlerësojë nëse këto zhvillime përputhen me parimin e “jetës me dinjitet”; 3. të analizojë politikat aktuale për ndihmën ekonomike dhe ndikimin e saj në zbutjen e varfërisë dhe reintegrimin e grupeve të cënueshme; 4. të ofrojë rekomandime për përmirësimin e ndikimit të ndihmës ekonomike në zbutjen e varfërisë dhe reintegrimin në shoqëri të përfituesve të saj.

Edhe përgjatë vitit 2020, institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se varfëria vijon të mbetet qartazi një problematikë e mprehtë në nivel kombëtar.

Varfëria nuk është vetëm mungesë e të ardhurave, por edhe mungesë shërbimesh dhe pjesëmarrjeje në shoqëri, të cilat janë thelbësore për gëzimin e të drejtave të njeriut. Varfëria si shkak, por edhe si pasojë e shkeljeve të të drejtave të njeriut, duhet të adresohet në kontekstin e

detyrimeve të shtetit për respektimin e garantimin e të drejtave të njeriut. Ndaj, një qasje e bazuar në të drejtat e njeriut, do të thotë që standardet dhe parimet e të drejtave të njeriut të jenë në thelbin e planifikimit të politikave shtetërore sociale që ndërmerr shteti.

3.20 Respektimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar¹²³

Personat me aftësi të kufizuar, si të gjithë shtetasit shqiptarë, padyshim që duhet të konsiderohen si persona të mundësive, si persona të barabartë mes të barabartëve, persona me dinjitet të lindur dhe me të drejta të patjetërsueshme. Nga ky këndvështrim, personat me aftësi të kufizuar janë ajo pjesë e shoqërisë, e cila e ka të domosdoshme mbështetjen e vazhdueshme nga shteti, për t'iu respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore, si dhe aksesin dhe përshtatjen e arsyeshme në çdo fushë të jetës.

Shpërthimi i pandemisë COVID-19 ka qenë një sfidë në shumë drejtime, e veçanërisht, rezultoi e vështirë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuar. Masat për të parandaluar infeksionin, të tilla si distancimi shoqëror e fizik dhe izolimi, ishin të pamundura për këtë kategori që mbështeshtja në ndihmën e të tjerëve është themelore për mbijetesën e tyre.

Ndaj, qasja institucionale e Avokatit të Popullit, në mbështetje të respektimit të të drejtave të kësaj kategorie, tejet e ekspozuar edhe ndaj cënueshmërisë financiare apo varfërisë përgjatë këtij viti pandemik, ka qënë në fokusin e punës së institucionit. Me një qasje të tillë, institucioni i Avokatit të Popullit hartoi rekomandimin drejtuar 61 kryetarëve të bashkive, për adresimin e problematikave akute të kësaj kategorie, duke kërkuar shprehimisht:

- *Evidentimin e të gjithë personave me aftësi të kufizuar, veçanërisht ata që banojnë në zonat e thella, me qëllim vijimin e ofrimit të shërbimeve sociale që mundësohen nga njësitë e qeverisjes vendore.*
- *Evidentimin e personave të pastrehë, të cilët janë me aftësi të kufizuar dhe marrjen e masave për strehimin e tyre.*
- *Furnizimin periodik me paketa të ndihmave ushqimore e mbështetjes ekonomike gjatë periudhës së kohëzgjatjes së pandemisë.*

Me të njëjtin vizion, institucioni i Avokati i Popullit ka adresuar tek drejtuesit e Institucioneve Rezidenciale të Përkujdesjes Shoqërore, ku janë të akomoduar persona me aftësi të kufizuar, duke kërkuar shprehimisht marrjen e masave për mbrojtjen nga përhapja e COVID-19 dhe verifikimin periodik të gjendjes shëndetësore të përfituesve të akomoduar në këto institucione.

Për të përçuar një informacion të kuptueshëm dhe të arritshëm për kategorinë e personave që kanë probleme me dëgjimin, Avokati i Popullit ka inkurajuar me anë të një Deklarate shtimin e përdorimit të gjuhës së shenjave në komunikimet publike zyrtare, duke i bërë thirrje të gjitha autoriteteve publike që të marrin masat për të mundësuar komunikim të drejtpërdrejtë me njerëzit që nuk dëgjojnë, përmes gjuhës së shenjave.

Referuar ankesave të regjistruara nga institucioni i Avokatit të Popullit për vitin 2020, rezulton të jenë *regjistruar 76 ankesa*, kryesisht raste të bazuara në investigimet “*ex-officio*”, nga të cilat kanë *përfunduar 22 çështje ku 10 prej tyre janë zgjidhur në favor të ankuesve*.

Ankesat/rastet me iniciativë, evidentuan ekzistencën e problematikave të tilla si: mungesa e mjeteve të jetesës, duke i ekspozuar individët me aftësi të kufizuar edhe familjet e tyre drejt varfërisë ekstreme dhe mbijetesës si dhe problematika e qasjes në infrastrukturën rrugore për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar në shikim. Një problematikë serioze e evidentuar

¹²³ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në institucionin e Avokatit të Popullit.

herët, është mungesa e nxjerrjes së akteve nënligjore nga hyrja në fuqi e ligjit 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, i ndryshuar. Problematikë e spikatur, e raportuar që në vitin 2018, vijon të jetë edhe ajo e mospërfshatimit nga taksa e ndërtesës të kategorisë së invalidëve të punës.

Më specifikisht, sa i përket problematikës së qasjes në infrastrukturën rrugore të personave me aftësi të kufizuara, ajo është e pranishme në të gjitha qytetet e Shqipërisë, në kundërshtim flagrant me detyrimet e parashikuara në Konventën e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”, (ratifikuar nga shteti shqiptar) dhe me rekomandimin e Komiteti Drejtues për Zbatimin e Konventës së OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, i cili kërkon nga shteti shqiptar marrjen e masave mbi të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të jetuar të pavarur dhe për t'u përfshirë në komunitet.

Për adresimin e kësaj problematike, institucioni i Avokatit të Popullit, hartoi një rekomandim drejtuar 12 qarqeve të Republikës së Shqipërisë, duke kërkuar shprehimisht:

- *Marrjen e masave për realizimin e infrastrukturës rrugore për personat me aftësi të kufizuara në shikim, sipas standardeve të elementëve të përshtatshmërisë, duke përfshirë në këtë proces edhe këta persona.*
- *Hartimin e një plani pune për të adresuar brenda afateve kohore të përshtatshme sa është kërkuar më sipër.*

Me referencë, problematikën e mosnxjerrjes së akteve nënligjore për shërbimet për një jetesë të pavarur dhe vendimmarrjen e mbështetur për personat me aftësi të kufizuara, Avokati i Popullit, në cilësinë e tij si monitorues i zbatimit të ligjit “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”, hartoi rekomandim përkatës drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për:

- *Marrjen e masave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 6/pika 3 dhe nenit 7/pika 3 të këtij ligji.*

Në përgjigje të rekomandimit, informohemi se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, do të finalizojë projektaktet sipas sugjerimeve të Avokatit të Popullit, për të përmirësuar jetesën e personave me aftësi të kufizuara, që përfitojnë nga shërbimet, duke respektuar parimet e ligjit nr.93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.

Sa i përket problematikës së mospërfshatimit nga taksa e ndërtesës të kategorisë së invalidëve të punës, pas korrespondencës intensive me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si dhe me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për adresimin e kësaj problematike, rezultoi si domosdoshmëri ndërmarrja e nismave ligjore për rregullimet e nevojshme në ligjin specifik “Për invalidët e punës”, i ndryshuar, me qëllim përshtatjen e tij me ndryshimet që legjislacioni tatimor ka bërë ndër vite.

Në këto kushte, institucioni i Avokatit të Popullit hartoi rekomandim drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për:

- *Marrjen e iniciativës ligjore për një shtesë në nenin 16 të ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 “Për Statusin e Invalidëve të Punës”, i ndryshuar;*
- *Bashkëpunimin ndërmjet institucioneve për këtë rregullim ligjor.*

Në përgjigje të rekomandimit, informohemi se Ministria e Financave dhe Ekonomisë e vlerëson rekomandimin e Avokatit të Popullit në lidhje me marrjen e iniciativës ligjore për rregullim ligjor, me qëllim përjashtimin e invalidëve të punës nga taksa e ndërtesës. Kërkesat e shprehura

nga qytetarët, që gëzojnë statusin e invalidit të punës, do të jenë në vëmendjen e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në momentin që do të bëhen ndryshime ligjore në këtë fushë.

Mbeten problematika të shprehura në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, të raportuara ndër vite, mungesa e aksesit në mjediset publike dhe private, në marrjen e informacionit, aksesit në drejtësi, vonesa në lëvrimin e fondeve për personat me aftësi të kufizuar, moszbatimi i dispozitave ligjore për punësimin e personave me aftësi të kufizuar, moszbatimi i rimbursimit të biletës në transportin urban, i mjeteve didaktike të posaçme, etj.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se, kërkohet ndërgjegjësimi i të gjithë shoqërisë për t'u përfshirë e qënë pjesëmarrës aktive në procesin e integritetit të personave me aftësi të kufizuar në shoqëri.

Kërkohet veçanërisht vëmendje e shtuar e institucioneve shtetërore, në nivel qendror dhe lokal, e të gjithë aktorëve të shoqërisë civile, angazhim më serioz dhe prioritet në trajtimin e problematikave me të cilat ndeshen personat me aftësi të kufizuar, për të garantuar vijueshmërinë e mbështetjes në një mënyrë të sigurt përgjatë pandemisë dhe jo vetëm, përmes dhënies së shërbimeve, në përputhje me nevojat e veçanta të tyre.

3.21 Barazia gjinore dhe të drejtat e komunitetit LGBTI¹²⁴

Padyshim, gratë, vajzat dhe komuniteti LGBTI kanë qënë pjesë e një vëmendje të shtuar institucionale të Avokatit të Popullit përgjatë vitit pandemik 2020. Këtë vit një tjetër pandemi ka njohur një rritje eksponenciale: *ajo e dhunës ndaj grave e vajzave*. Stresi i shtuar dhe tensioni që solli izolimi në kushtet e reja të distancimit social e fizik forcuar modelet disfunktionale të sjelljes midis anëtarëve të familjes ose partnerëve abuzivë.

Ndërkohë që statistikat treguan për një rritje të dhunës në familje, *(1.5% më shumë se gjatë vitit 2019)*, të dhënat nuk pasqyruan shkallën e vërtetë të problemit, pasi viktimat shpesh hezituan të raportojnë incidente dhe episode të përjetimit të një apo disa prej prej formave të dhunës në marrëdhëniet familjare. Në raportimin e ulët të dhunës në familje vlerësohet se ndikuan faktorë të tillë tipikisht pandemik, si frika nga ndëshkimi nga partnerët abuzivë apo ato tradicionale siç janë stereotipet që ekzistojnë për dhunën në familje, varësia ekonomike, etj.

Qysh në një fazë të hershme të pandemisë (Prill 2020), institucioni i Avokati të Popullit, nisur nga rrezikshmëria e fenomenit të dhunës, përmes rrjeteve sociale, u bëri thirrje grave dhe vajzave, si dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre, të denonconin çdo episod apo sjellje të ushtrimit të dhunës në familje, duke ju bërë të njohur numrat pa pagesë të Linjës Kombëtare për viktimat e dhunës në familje, Policisë së Shtetit, Qendrës Liliu për rastet e emergjencës të dhunës seksuale, si edhe një numri të vetë institucionit të Avokatit të Popullit.

Përmes thirrjeve publike institucioni i Avokatit të Popullit solli në vëmendje të institucioneve përgjegjëse, anëtare të Mekanizmit të Koordinuar kundër Dhunës në Familje, që të jenë në gatishmëri të lartë e në funksionalitet të plotë, duke vijuar me menaxhimin e çdo rasti dhune të referuar, në funksion të garantimit të një mbrojtjeje efektive për viktimat e dhunës.

Me të njëjtën qasje, institucioni i Avokatit të Popullit inkurajoi dhe mbështeti organizatat e shoqërisë civile për vijimin e mbështetjes për viktimat e dhunës, qoftë me këshillimet online apo shërbime të çdo natyre tjetër që ato ofrojnë, duke e vlerësuar ofrimin e këtyre shërbimeve si shumë të rëndësishme për periudhën e pandemisë.

¹²⁴ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në institucionin e Avokatit të Popullit.

Insitucioni i Avokatit të Popullit vlerëson si një problematikë tipikisht të këtij viti pandemik atë të humbjes së vendit të punës të një numri të konsiderueshëm grash e vajzash të punësuar si kujdestare për fëmijë apo të moshuar, apo punëtore ndihmëse në familje, me pasojë të drejpërdrejtë mospërfitimin e “*pagës së luftës*” për shkak të punësimit informal.

Kjo situatë prirej të përforconte përkeqësimin e gjendjes social-ekonomike të grave e vajzave, veçanërisht në ato familje ku gratë janë kryefamiljare apo personat e vetme që rezultojnë të punësuar.

Problematikat tradicionale të bëra prezent ndër vite vijuan edhe gjatë këtij viti pandemik të jenë të pranishme të cilat, në përmbatjen e tyre, konsistojnë në pretendime për punësim, ndihmë ekonomike, pension, akses në drejtësi, mosekzekutim të detyrimeve ushqimore të vendosura në vendimet e gjykatave, etj.

Dhuna në marrëdhëniet familjare u identifikua sërish si një fenomen i rrezikshëm bashkëshoqërues i mendësisë së shoqërisë sonë që në muajt e parë të vitit 2020. Institucioni i Avokatit të Popullit evidentoi raste të dhunës në marrëdhëniet familjare, të cilat u përmyllën fatalisht me vdekjen e viktimës, objekt i dhunës në marrëdhëniet familjare.

Në këto kushte institucioni i Avokatit të Popullit, në vijim të kryerjes së misionit ligjor në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, ka përcjellë pranë institucioneve përkatëse rekomandime specifike “*Për marrjen e masave të nevojshme nga strukturat kompetente për identifikimin, administrimin, referimin dhe ndjekjen e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare*”¹²⁵.

Në përgjigje të rekomandimit, informohemi se institucionet përgjegjëse të adresuara vlerësojnë rekomandimin e Avokatit të Popullit dhe kanë nisur zbatimin e tij.

Referuar problematikës së dhunës në marrëdhëniet familjare, në raste specifike, kur dhuna është e përsëritur, është e raportuar rregullisht dhe konstatohet se institucionet përgjegjëse në tejkalim të afateve ligjore nuk kanë ndërmarrë veprimet e ngarkuara me ligj, institucioni i Avokatit të Popullit i ka rekomanduar organit të Prokurorisë që të zhvillohen veprime të menjëhershme dhe

¹²⁵ 1. Marrjen e masave të menjëhershme nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për trajnimin në vijim dhe me prioritet të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit, për referimin e rasteve pranë strukturave të posaçme që trajtojnë çështjet e dhunës në marrëdhëniet familjare, lidhur me detyrimet ligjore si autoritet përgjegjës në të gjitha strukturat vendore në varësi të saj sipas ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, me qëllim njohjen dhe zbatimin me korrektesë të detyrimeve ligjore.

2. Marrjen e masave të menjëhershme nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe bashkërendim më të mirë me Mekanizmin e Koordinuar të Referimit të Rasteve të dhunës në familje (MKR) në bashkitë e vendit, që është rrjeti i organizuar i institucioneve përgjegjëse në nivel vendor për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, me qëllim identifikimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, vlerësimin e riskut dhe parandalimin e ngjarjeve të rënda që sjellin humbjen e jetës së viktimave të dhunës.

3. Marrjen e masave të menjëhershme nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë për përgatitjen dhe dërgimin e një letërporosie Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallëve të Para për vlerësimin dhe hetimin e shpejtë, me objektivitet e profesionalizëm të kallëzimeve për dhunë në marrëdhëniet familjare.

4. Analizimin e rastit nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë, nxjerrjen e përgjegjësisë konkrete ligjore dhe marrjen e masave përkatëse ndaj personave përgjegjës. Po ashtu, përgjithësimin e këtij rasti me qëllim mos përsëritjen e qëndrimeve të tilla në të ardhmen.

5. Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të Rasteve të dhunës në familje në Bashki, duhet të rrisë bashkëpunimin me komunitetin me qëllim parandalimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare nëpërmjet identifikimit, vlerësimit, referimit, menaxhimit të këtyre rasteve dhe përcaktimit të detyrave për secilin nga anëtarët e institucioneve përgjegjëse dhe të garantimit të mbrojtjes së shëndetit dhe jetës së viktimave të dhunës në familje.

të thelluara hetimore, si dhe të merren masat e përshtatshme me qëllim ndërprerjen e dhunës ndaj raportueses së saj dhe parandalimin e ndonjë ngjarjeje tjetër dhune ndaj saj.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson masat e marra nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, me miratimin e dy protokolleve respektive:

- *Protokoll për funksionimin e Qendrave Rezidenciale Publike dhe jo Publike që ofrojnë Shërbimin e Strehimit (Strehëzat) për Viktimat e Dhunës në Familje dhe Trafikimit në Situatën e Pandemisë së COVID-19.*
- *Protokoll i Menaxhimit të Rasteve të Dhunës në Familje në Nivel Vendor Përmes Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR), gjatë Situatës së COVID-19”.*

Në tagrin e tij ligjor si nxitës dhe promovues i standardeve më të larta të të drejtave të njeriut, me fokus të veçantë rritjen e kapaciteteve të tij në drejtim të nxitjes të barazisë gjinore, mbrojtjes së të drejtave të grave dhe vajzave apo monitorimit të zbatimit të konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë, institucioni ka ndërmarë një sesion trajnimesh ku spikat ai mbi *“Përdorimin e treguesve gjinorë për monitorimin e të Drejtave të Njeriut dhe SDG”*, që u realizua me mbështetjen e zyrës së UN WOMEN.

Ky trajnim synonte standardizimin e të dhënave gjinore të prodhuara nga institucioni i Avokatit të Popullit, përdorimin e këtyre të dhënave të disagreguara për monitorimin e të drejtave të njeriut dhe Objektivave Global të Kombeve të Bashkuara, si dhe prezantimin e treguesve gjinorë në botimin vjetor të INSTAT për Burrat dhe Gratë.

Për herë të parë në publikimin *“Burrat dhe Gratë në Shqipëri 2020”*, një publikim me periodicitet vjetor, që paraqet të dhëna në fusha të ndryshme të jetës të ndara sipas gjinisë, me qëllim reflektimin e problematikave të shoqërisë në kuadër të arritjes së barazisë gjinore, u përfshi një kapitull me tregues mbi të drejtat e njeriut. Statistikat mbi të drejtat e njeriut pasqyrojnë të dhëna sipas gjinisë mbi ankesat për pretendime të shkeljeje të të drejtave, të trajtuara nga Avokati i Popullit, sipas llojit të së drejtës.

Në funksion të mandatit të tij promovues, gjatë vitit 2020, institucioni i Avokatit të Popullit, në kushtet e qasjes së re të të punuarit on-line, ka zhvilluar dhe marrë pjesë në një numër të konsiderueshëm aktivitetesh promovuese e fushatash ndërgjegjëse, të cilat qëllimuan jo vetëm njohjen më të thelluar nga gratë e vajzat të legjislacionit vendas për të drejtat e grave dhe barazi gjinore, por në të njëjtën kohë edhe njohjen me standartet më të larta të këtyre të drejtave, të cilat parashikohen në Konventat Ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë. Më konkretisht:

- Përfaqësues nga Seksioni i Përgjithshëm / Institucioni i Avokatit të Popullit morrën pjesë në eventin online për lançimin e fillimit të *programit të ri rajonal për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në Ballkanin Perëndimor*, nga UN Women dhe i mbështetur financiarisht nga Sida (Bashkëpunimi Ndërkombëtar Suedez për Zhvillim). Përmes këtij programi rajonal katër-vjeçar synohet të reformohen politikat dhe financimi i veprimeve në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë dhe Serbi për të përsheptuar zbatimin e angazhimeve kombëtare dhe ndërkombëtare të barazisë gjinore.
- Në kuadër të 20 vjetorit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë, përfaqësues nga Seksioni i Përgjithshëm / Institucioni i Avokatit të Popullit morrën pjesë në takimin online të organizuar nga zyra e UN Women për rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore dhe OSBE me temë: *Angazhimet e rinovueshme për Axhendën e Grave, Paqes dhe Sigurisë në rajonin e OSBE-së*. Diskutimi

u përqendrua në përvojën reale lidhur me zbatimin e Rezolutës 1325 si dhe propozimet praktike për veprime në të ardhmen.

- Si çdo vit, Avokati i Popullit /Seksioni i Përgjithshëm ju bashkua fushatës Kombëtare të 16 ditëve kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje me sloganin: *Dëgjo. Beso. Mbështet gratë dhe vajzat!*

Gjithashtu, Avokati i Popullit organizoi më datë 10 Dhjetor, në Ditën Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, takim online me temë: Të Drejtat e Grave janë të Drejta të Njeriut. “Dëgjo. Beso”. Mbështet gratë dhe vajzat! Në takim u prezantuan gjetjet e Raportit Alternativ të zbatimit të Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) të përgatitur nga institucioni i Avokatit të Popullit. *Për më shumë në lidhje me këtë raport referojuni Kreut 4, pika 4.4. (Angazhime të tjera institucionale).*

➤ Të drejtat e komunitetit LGBTI

Shqipëria ka njohur progres lidhur me njohjen e të drejtave të personave LGBTI, duke startuar që nga hartimi i një legjislacioni efikas kundër diskriminimit, diskutimit publik mbi të drejtat e LGBTI, krijimin e një komuniteti të konsoliduar dhe aktiv në mbrojtje të këtyre të drejtave, për ta përmbyllur me hartimin e një Plan Veprimi me detyra konkrete për çdo institucion.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se komuniteti LGBTI u ballafaqua me problematika të shtuara përgjatë këtij viti pandemik të tilla si: ekonomia e përkeqësuar, punësimi, strehimi dhe siguria, si dhe mundësinë e komunitetit LGBTI për të plotësuar nevojat e tij bazike.

Këshillimi psikologjik dhe paketat ushqimore kanë qenë nevojat elementare të komunitetit LGBTI gjatë pandemisë, fakt ky që i jep këtij realiteti dimensionet e një krize për ekzistencë. Papunësia raportohet, një nga problematikat kryesore përgjatë vitit pandemik 2020. Një ndër arsyet kryesore pse shifra e papunësisë mes komunitetit LGBTI është më e lartë se shifra e papunësisë së popullsisë së gjerë në Shqipëri, ka të bëjë me faktin se komuniteti LGBTI vuante nga numri i lartë i papunësisë sistematike që përpara shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, për shkaqe të tilla si: diskriminimi, bullizmi dhe largimi i komunitetit LGBTI nga sistemi arsimor.

Përgjatë vitit 2020, në kushtet e një qasjeje të re të diktuar nga distacimi social dhe fizik, bashkëpunimi i institucionit të Avokatit të Popullit me shoqatat e shoqërisë civile që operojnë në mbrojtje të të drejtave të komunitetit LGBTI, ka njohur një hop të dukshëm cilësor, përmes komunikimit on-line me to, në funksion të evidentimit të problematikave dhe adresimit të shqetësimit të tyre në institucionet përgjegjëse. Në takimet e organizuara janë bërë prezente studime, raporte, monitorime dhe analizuar gjetje e rekomandime, për përmbushjen e qëllimit të përbashkët, atë të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të këtij komuniteti. Më specifikisht:

- Në datë 16 shtator, institucioni i Avokatit të Popullit në zbatim të Nenit 30 të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, organizoi një takim konsultues online me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që punojnë për të drejtat e komunitetit LGBTI në Shqipëri, takim që shërbeu për të marrë mendimet e tyre për gjendjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut të këtij komuniteti në vend. Në këtë takim u diskutua gjithashtu mbi zbatimin e Planit të Veprimit për mosdiskriminimin e personave LGBTI në Shqipëri, aktivitetet e përealizuara si dhe nevojën për hartimin e një plani të ri veprimi me masa e aktivitete konkrete dhe të buxhetuara.
- Në datë 2 nëntor përfaqësues nga Seksioni i Përgjithshëm / Institucioni i Avokatit të Popullit morrën pjesë në Konferencën “Adresimi i nevojave dhe standardizimi i shërbimeve për

komunitetin LGBTI+ në Shqipëri”, të organizuar nga Qendra Strehë në bashkëpunim dhe me Ambasadën Gjermane në Tiranë. Në këtë konferencë u prezantuan gjetjet paraprake të raportit: *“Vlerësimi i Nevojave të Personave të Komunitetit LGBTI+”*, përmes të cilit synohet të kuptohen më mirë nevojat aktuale dhe sfidat e komunitetit LGBTI + në Shqipëri. Studimi analizon aspekte të ndryshme të jetës së personave LGBTI+ përfshirë ekspozimin ndaj dhunës dhe diskriminimit, plotësimin e nevojave bazike për ushqim, strehim dhe ndihmë mjekësore, plotësimin e nevojave ligjore, plotësimin e nevojave arsimore, formim profesional, punësim etj. Në këtë Konferencë gjithashtu u prezantua edhe drafti i dokumentit *“Standardet e Kujdesit Rezidencial për Personat LGBTI + në Shqipëri”*.

- Në datë 5 nëntor u prezantua në një takim online studimi mbi *“Situatën e Komunitetit LGBTI+ gjatë pandemisë COVID-19”* nga Aleanca LGBTI në bashkëpunim me institucionin e Avokatit të Popullit dhe Komisionerit kundër Diskriminimit. Ky studim, synon të identifikojë pasojat e pandemisë së COVID-19 mes komunitetit LGBTI dhe është zhvilluar online përmes një sondazhi të plotësuar nga 228 individë të vetëidentifikuar si pjesëtarë të komunitetit LGBTI, si dhe përmes realizimit të fokus-grupeve.

3.22 Respektimi i të drejtave të personave të moshuar¹²⁶

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion që garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, ka në prioritetet e punës së tij edhe mbrojtjen e të drejtave të të moshuarve, të cilët kategorizohen si një ndër grupet më vulnerabël dhe më të ekspozuar ndaj riskut të mosrespektimit dhe garantimit të të drejtave të tyre, të saksionuara në legjislacionin vendas dhe atë ndërkombëtar.

Pandemia COVID-19 rezultoi veçanërisht e rrezikshme për të moshuarit, duke kërcënuar në mënyrë disproporcionale të drejtën e tyre për shëndet, si dhe të drejtat e tjera njerëzore. Distancimi i domosdoshëm shoqëror e fizik, si objektiv, padyshim do të përkeqësonte problemin alarmues të izolimit të të moshuarve.

Qysh në një fazë të hershme të pandemisë, Mars 2020, institucioni i Avokatit të Popullit ka bërë thirrje për solidaritet shoqëror, përveç distancimit social e fizik, duke iu drejtuar autoriteteve shtetërore, qëndrore dhe vendore, me kërkesën specifike për zgjerimin e gamës së shërbimeve sociale të ofruara për këtë kategori, veçanërisht për të moshuarit me aftësi të kufizuar dhe ata që janë të vetmuar, duke vlerësuar se ekspozimi i tyre ndaj varfërisë, përjashtimi dhe izolimi social, ka një ndikim të drejtpërdrejtë në gjendjen e tyre shëndetësore, fizike e mendore.

Në kuadër të tagrit të tij ligjor, institucioni i Avokatit të Popullit ka monitoruar përgjatë vitit 2020, nivelin e respektimit të të drejtave të të moshuarve, të akomoduar në Institucionet e Përkujdesjes Shoqërore, nëpërmjet inspektimeve on-line, përkatësisht në Shtëpitë e të Moshuarve Gjirokastrë, Shkodër, Kavajë, Fier, Tiranë dhe Qendra Polivalente Poliçan. Qëllimi i inspektimit, tashmë me një qasje të re të diktuar nga kushtet e distancimit social dhe fizik, ishte identifikimi i masave të marra nga autoritetet shtetërore për parandalimin e përhapjes së COVID-19.¹²⁷

¹²⁶ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në institucionin e Avokatit të Popullit.

¹²⁷ A është kryer dezinfektimi i ambienteve të institucionit? -A janë të mjaftueshëm detergjentet dhe dezinfektantët? -Si paraqitet gjendja shëndetësore e të moshuarve? -A janë paraqitur nga të moshuar shqetësime lidhur me izolimin e tyre? -Si është organizuar puna që të moshuarit ta kalojnë sa më lehtë këtë periudhë izolimi? -A ka patur të moshuar apo pjesëtarë të stafit të infektuar me Covid19? Nëse po, cfarë masash janë marrë dhe si paraqitet gjendja e tyre aktualisht? -A jeni të furnizuar me maska dhe a është i mjaftueshëm numri i tyre? -Duke qenë se po afrojnë virozat stinë, a janë marrë masa për furnizimin me medikamente shtesë?

Duhet të vlerësohet fakti që nga masat e marra nga shërbimi rezidencial në kuadër të parandalimit të përhapjes së COVID-19, përfshirë dhe kufizimin e lëvizjes së kujdestarëve, nuk pati asnjë humbje jete.

Referuar ankesave të adresuara pranë institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2020, si pasojë e implementimit me sukses të mekanizmit të monitorimit mbi bazë ditore dhe konstatimit të problematikave të bëra publike në mediat tradicionale dhe ato on-line, përmes grupeve të punës të ngritura posaçërisht, në kushtet e distancimit fizik e social, numri i çështjeve të regjistruara e të trajtuara të cilat kishin në objekt të tyre problematika të të moshuarve, pësoi një rritje të konsiderueshme.

Pas shqyrtimit të problematikave të parashtruara në objektin e ankesave, u jemi drejtuar zyrtarisht institucioneve të qeverisjes vendore, me rekomandimin për marrjen e masave për verifikimin e gjendjes social-ekonomike e shëndetësore të të moshuarve dhe furnizimin periodik me paketa të ndihmave ushqimore e mbështetjes ekonomike gjatë periudhës së kohëzgjatjes së pandemisë.¹²⁸

Përgjatë vitit 2020, në kushtet e një qasjeje të re të diktuar nga distancimi social dhe fizik, bashkëpunimi on-line i institucionit të Avokatit të Popullit me shoqatat e shoqërisë civile që operojnë në mbrojtje të drejtave të të moshuarve është konsoliduar. Në këtë kontekst, në Ditën Ndërkombëtare të të Moshuarve, organizata “Shoqëria Shqiptare për të gjitha Moshat –ASAG”- , organizoi eventin: “Ç’rrenjosja e varfërisë për të Moshuarit është obligim”, për t’iu bashkuar thirrjes për veprim “Dekada e Moshimit të Shëndetshëm 2020-2030”.

Në kuadër të kësaj Dite, ASAG i akordoi institucionit të Avokatit të Popullit një Certifikatë Mirënjohje:

- *Për ndjeshmërinë dhe kontributin në favor të të moshuarve shqiptarë, duke u bërë pjesëmarrës në zotimin për mbështetjen e “Moshimit Aktiv”*
- *Për t’i dhënë fund diskriminimit transparent dhe inkurajuar të tjerë të përfshihen në njohjen e këtij brezi plot kontribute, të cilët me përpjekjet dhe arritjet na kanë ndihmuar të përcaktohem si komb.*

Institucioni i Avokatit të Popullit duke vlerësuar përpjekjet e vazhdueshme të institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të të moshuarve, e veçanërisht përpjekjet për menaxhimin e pandemisë COVID-19, artikulon edhe njëherë domosdoshmërinë e miratimit të ligjit “Për statusin e moshës së tretë”, për të mbështetur plotësisht dhe efektivisht pjesëmarrjen e të moshuarve në shoqëri, bazuar në nevojat dhe preferencat e tyre.

3.23 E drejta e minoriteteve (pakicave) kombëtare¹²⁹

Të gjithë individët dhe të drejtat e tyre kanë qënë në mënyrë të padiskutueshme fokusi i veprimtarisë dhe aktivitetit konkret të Avokatit të Popullit, në këtë vit problematik, por vëmendja kryesore i është përkushtuar dukshëm grupeve, komuniteteve dhe individëve vulnerabël apo në risk, të cilët janë më të cënueshëm dhe të pambrojtur nga pjesa tjetër e popullsisë nga pasojat e kësaj situate të pazakontë.

¹²⁸ Marrjen e masave për vlerësimin e kushteve social ekonomike, trajtimin dhe ofrimin e ndihmës dhe të mbështetjes ekonomike në vazhdimësi, drejtuar Bashkisë Krujë, Bashkisë Rrogozhinë, Njesisë Administrative nr.1/Tiranë, Njesisë Administrative nr.6/Tiranë, Njesisë Administrative Laç, Njesisë Administrative Shëngjergj,etj.

¹²⁹ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në institucionin e Avokatit të Popullit.

Padyshim minoritetet kombëtare kanë qënë pjesë e kësaj vëmendje të shtuar institucionale, me një konsiderim të veçantë ndaj minoritetit kombëtar Rom dhe atij Egjiptian, të cilët janë përballuar me një situatë të rënduar gjatë vitit 2020.

Për shkak të masave kufizuese të vendosura nga autoritetet shtetërore për parandalimin e pandemisë së COVID-19, veprimtaria e Avokatit të Popullit lidhur me respektimin e të drejtave të minoriteteve kombëtare ka njohur një hop të dukshëm proaktiviteti, të bazuar në identifikimin e çështjeve nga media dhe shtypi i shkruar dhe investigimin e tyre “ex-officio”.

Identifikimi i rasteve individuale është kombinuar me konstatime dhe gjetje të cilat kanë sjellë ndërhyrje me anë të rekomandimeve tona, në nivelin sistematik të çështjeve dhe të mënyrës se si administrata publike dhe shoqëria jonë duhet të konsiderojnë dhe ofrojnë zgjidhje, për barazinë, përfshirjen dhe integrimin e pakicave kombëtare jo vetëm në një situatë normale por edhe në kushte të pazakonta dhe sfiduese për vet shtetin dhe shoqërinë. Nuk kanë munguar edhe ankesa individuale të paraqitura nga individë, pjesëtarë të minoriteteve kombëtare.

Avokati i Popullit është prirur që të gjendet sa më afër individëve dhe komuniteteve pjesë e minoriteteve kombëtare, duke shtuar kontaktet “on-line” me individët që kanë dashur të paraqesin ankesat e tyre në institucion, por duke shfrytëzuar edhe një “urë lidhëse” shumë efektive, përmes bashkëpunimit dhe kontaktimit të vazhdueshëm me organizatat jofitimprurëse, të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në kuadër të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të minoriteteve kombëtare.

Gjatë vitit 2020, janë filluar me *iniciativë 15 çështje*, për problematika që i përkasin kryesisht komuniteteve përkatëse, të minoriteteve (pakicave) kombëtare, në të gjithë vendin. Specifika qëndron në faktin se, identifikimi dhe trajtimi në një këndvështrim të gjerë komunitar, ka qënë një qasje e kushtëzuar nga situata e krijuar nga pandemia e COVID-19.

Ndërkohë në shumë ankesa të tjera të trajtuara nga ana e Avokatit të Popullit, janë identifikuar çështje që lidhen me pretendime të ngritura nga individë pjesëtarë të minoriteteve kombëtare, por që nuk i përkasin mirëfilltazi kësaj fushe të të drejtave të njeriut. Këto ankesa sikurse edhe në vitin paraardhës kanë pasur në objekt të tyre të drejtën për strehim, të drejtën për punësim, të drejtën për të përfituar nga sistemi i perkujdesjes shoqërore (ndihma ekonomike), apo edhe me të drejtën për furnizim me ujë të pijshëm, si dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në tërësi.

Krahas shqyrtimit të ankesave individuale të paraqitura, vend të rëndësishëm kanë zënë rekomandimet, që kanë të bëjnë me një qasje sistematike ndaj problematikave të konstatuara, të cilat kërkonin një zgjidhje afatshkurtër, si dhe një ndryshim në politikat dhe aktivitetin e përditshëm, specifikisht të njësive të vetëqeverisjes vendore në të gjithë vendin.

Më konkretisht janë hartuar dhe dërguar këto rekomandime:

- Rekomandim për përmbylljen e procesit të nxjerrjes së akteve nënligjore, në bazë dhe për zbatim, të Ligjit nr.96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, drejtuar (me shkresën Nr.K1/I10-2, datë 25.02.2020), Kryetarit të Këshillit të Ministrave dhe Kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Rekomandim “Për marrjen e masave të domosdoshme, të menjëhershme, për komunitetet Rome dhe Egjiptiane. (Për evidentimin e numrit real të individëve dhe familjeve në nevojë, pjesë e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, të vendosura brenda territorit të njësisë administrative, të administruar nga ana e bashkive). Ky rekomandim i është dërguar me shkresën nr. K1/I15-2, datë 04.04.2020, të gjitha njësive të qeverisjes vendore;
- Rekomandim për realizimin e procesit të ratifikimit të Kartës Evropiane të Gjuhëve Rajonale, ose Minoritare, dërguar me shkresën Nr.K1/I74-2, datë 10.09.2020, Kryetarit të Kuvendit dhe Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë.

- Rekomandim për marrjen e masave të mëtejshme, për përballimin e kostove financiare të sigurimit të barrierave mbrojtëse (maskave) ndaj përhapjes së COVID-19, për pjesëtarët e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane. Ky rekomandim i është dërguar me shkresën nr. K1/I171-2, datë 19.11.2020, të gjitha njësive të qeverisjes vendore;
- Rekomandim për procesin e hartimit të një dokumenti të ri strategjik kombëtar, për integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, si dhe të objektivave kryesore që duhet të trajtohen në të. Ky rekomandim i është dërguar me shkresën tonë nr.K1/I147-64, datë 29.12.2020, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- Rekomandim për hartimin dhe miratimin e dokumenteve strategjike në nivel vendor, për marrjen e masave për integrimin e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane. Ky rekomandim i është dërguar me shkresën tonë nr.K1/I35-7 datë 30.12.2020, të gjitha bashkive në vend (të grupuara sipas qarqeve).

Nga ana e institucioneve draftuese të këtyre projektvendimeve, konstatojmë se ka patur një reagim pozitiv ndaj mendimeve dhe sugjerimeve të dhëna nga ana e Avokatit të Popullit, për përmirësimin, apo ndryshimin e përmbajtjes së tyre. Në një masë të mirë mendimet dhe sugjerimet e dhëna janë pranuar dhe reflektuar në përmbajtjen e këtyre projektvendimeve, të cilët na janë përcjellë rishtazi pas rishikimit të tyre, për mendim dhe konsultim të mëtejshëm.

Pjesëmarrja në një sërë aktiviteteve on-line të organizuara nga OJF të ndryshme në mbrojtje të të drejtave të pakicave kombëtare, si dhe nga institucione përgjegjëse shtetërore, ku është analizuar dhe diskutuar gjendja e të drejtave të këtyre minoriteteve, ka qënë e vazhdueshme dhe e nevojshme.

Para konfirmimit zyrtar të pandemisë së COVID-19, në vendin tonë, në kuadër të aktivitetit me qëllim mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve kombëtare nga ana e Seksionit të Përgjithshëm, ishte parashikuar zhvillimi i inspektimeve në zona të ndryshme të vendit, ku edhe ka përqëndrim të komuniteteve përfaqësuese të këtyre minoriteteve. Në pamundësi për shkak të masave kufizuese të vendosura, kemi zhvilluar aktivitete on-line me disa shoqata dhe qendra, që përfaqësojnë pikërisht këto minoritete.

Mund të veçojmë këtu aktivitetin e zhvilluar nga ana e Seksionit të Përgjithshëm, në institucionin e Avokatit të Popullit, në datën 13.11.2020, mbi gjendjen e të drejtave të minoritetit kombëtar Rom dhe Egjiptian, duke u përqëndruar tek zbatimi i Planit Kombëtar të Integritimit për Romët dhe Egjiptianët, 2016-2020, arsimimi i fëmijëve Romë dhe Egjiptianë, në kushtet e pandemisë së COVID-19, si dhe gjendja e përgjithshme e kushteve të jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në këtë situatë.

Në vijim në datën 18.12.2020, kemi zhvilluar një trajnim, në bashkëpunim me “Roma Versitas Albania”, për të rinj Rom, në fushën e të drejtave të njeriut. Ky trajnim do të pasohet nga të tjerë të cilët do të vijnë përgjatë vitit 2021.

Së fundmi, në kuadër të plotësimit dhe përmirësimit të kuadrit ligjor për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve, janë dhënë mendime, vërejtje dhe sugjerime, për katër projektvendime të Këshillit të Ministrave, të hartuara në kuadër të akteve nënligjore që janë nxjerrë dhe që do të nxirren në zbatim të ligjit nr.96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të cilat i gjeni të detajuara në *Kreun 5 (Bashkëpunimi)*.

Vëmendja jonë e shtuar duhet të drejtohet tek fenomeni i “antixhipsizmit”, i cili shfaqet si një manifestim i shprehjeve dhe akteve individuale si dhe i politikave institucionale dhe praktikave të marxhinalizimit, përjashtimit, dhunës fizike, zhvleftësimit të kulturës dhe stilit të jetesës së Romëve, në gjuhën e urrejtjes të drejtuar ndaj Romëve, si dhe ndaj individëve të tjerë apo

grupeve të tjera të perceptuara, stigmatizuara apo persekutuar gjatë periudhës naziste, si edhe sot, të njohura si “gypsies”. Ky fenomen shqetësues për një shoqëri demokratike, çon në trajtimin e Romëve por edhe jo rrallë edhe të Egjiptianëve, si një grup i huaj, i dyshuar, dhe i lidh ata me një sërë stereotipesh negative dhe imazhe të deformuara që përfaqësojnë një formë specifike të racizmit.

Antixhipsizmi si një fenomen shumëplanësh i përhapur në pranimin e tij social dhe politik, përbën një pengesë kritike për përfshirjen e gjerë të Romëve dhe Egjiptianëve në shoqëri duke i penguar ata në gëzimin e të drejtave të barabarta, mundësive dhe pjesëmarrjes së frytshme në jetën shoqërore të një vendi.¹³⁰

Ajo që kërkohet sot është tejkalimi i gjendjes së “ngërthyer”, nga barazia formale e garantuar me ligj, në garancinë thelbësore të materializuar në veprimtarinë konkrete të organeve shtetërore, të institucioneve të pavarura në mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe të shoqërisë sonë në tërësinë e saj. Ky kapërcim real do të garantojë barazinë para ligjit dhe mosdiskriminim. Dhe duhet të jemi të bindur se nëse kjo gjë arrihet, kemi hedhur baza të shëndosha të një sistemi efektiv të të drejtave të njeriut.

Barazia, përfshirja dhe integrimi real i minoriteteve kombëtare në të gjitha sferat e jetës, në nivelin e qeverisjes vendore dhe atë qendrore, do të sjellë padyshim produktin e pritshëm të një shoqërie demokratike dhe të harmonisë tradicionale të bashkëjetesës, e cila mbetet një objektiv i qënësishëm dhe plotësisht i realizueshëm.

3.24 Respektimi i të drejtave në fushën e sigurimeve shoqërore¹³¹

E drejta në fushën e sigurimeve shoqërore është një e drejtë e sanksionuar shprehimisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila në pikën 52/1, parasheh se “*kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i paaftë për punë, sipas një sistemi të caktuar me ligj*”.

Respektimi dhe implementimi i kësaj të drejte është me rëndësi jetike për qytetarët, ndaj kjo kategori sensitive e së drejtës duhet që të respektohet e realizohet në mënyrë efikase e brenda afateve ligjore. Referuar ankesave të regjistruara nga institucioni i Avokatit të Popullit, *për vitin 2020, rezulton të jenë trajtuar 75 ankesa nga qytetarët*.

Nga perspektiva e institucionit të Avokatit të Popullit, në ushtrim të mandatit të tij, si mbrojtës i të drejtave dhe lirive të individit, konstatohet se problematikat më të spikatura e të parashtruara në objektin e ankesës së qytetarëve, vijnë të jenë identike apo të ngjashme me problematikat e raportura në vitet pararendës, ku spikasin: masa e ulët e përfitimit të pensionit të pleqërisë, mosnjohja e vjetërsisë në punë, mosdhënia e grupit të invaliditetit nga Komisionet përkatëse të Caktimit të Aftësisë për Punë, mospërfitimi i shtesave të pensionit të pleqërisë, për datën e lidhjes së pensionit të pleqërisë, ulja e masës së pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe nxjerrja debitorë, mosvënie në dispozicion të kopjeve të dokumentacionit të dosjes të pensionit, ndërprerje të padrejtë të pensioneve të pleqërisë, mosnjohja e viteve të punës në shtetin Grek për shkak të mospasjes së një marrëveshje në fushën e sigurimeve shoqërore, etj.

¹³⁰ Sipas një përkufizimi të dhënë nga Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), mbi këtë fenomen, përcaktohet se antixhipsizmi është: “Një formë e veçantë e vazhdueshme, e dhunshme, e përsëritur dhe e zakonshme e racizmit, një ideologji e bazuar në superioritetin e racës, një formë e dehumanizimit dhe racizmit institucional e ushqyer nga diskriminimi historik, që shprehet, mes të tjerash tek dhuna, gjuha e urrejtjes, shfrytëzimi, stigmatizimi dhe lloji më flagrant i diskriminimit”.

¹³¹ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në institucionin e Avokatit të Popullit.

Në kushtet e pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, duke marrë shkas nga rastet e bëra publike në media për grumbullime qytetarësh në filialet e shpërndarjes së pensioneve të pleqërisë, e adresuam këtë problematikë pranë Postës Shqiptare, për marrjen e masave në shpërndarjen e pensioneve të pleqërisë në banesat e pensionistëve, e veçanërisht për kategorinë e pensionistëve, të cilët janë të vetmuar dhe nuk kishin asnjë mundësi për të aplikuar për ofrimin e këtij shërbimi në banesat e tyre.

Gjithashtu vërehet përgjatë procesit të trajtimit të ankesave të depozitura nga qytetarët, identifikimi i një numri të konsiderueshëm ankesash si të pabazuara. Në tagrin e tij ligjor si këshillues, Avokati i Popullit ka orientuar qytetarët se si t' i qasen zgjidhjes së problematikës, përmes ndjekjes së ankimit administrativ në Komisionet Rajonale të Apelit pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore si dhe në Komisionin Qëndror të Apelit pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Më specifikisht, institucioni i Avokatit të Popullit, evidenton dhe shtjellon sa më poshtë, problematikat më përfaqesuese, të cilat prekën një numër të konsiderueshëm qytetarësh gjatë vitit 2020, në fushën e sigurimeve shoqërore:

- *Mosmarrje përgjigje lidhur me kërkesat, për verifikimin e vjetërsisë së punës përpara lindjes të së drejtës për të përfutur pension pleqërie.*

Nga ankesat e adresuara pranë institucionit të Avokatit të Popullit, kemi konstatuar se, për problemet e njohjes së vjetërsisë në punë, individë të ndryshëm kanë ndjekur rrugën gjyqësore. Përfundimi i procesit gjyqësor, i cili ka zgjatur më shumë se një periudhë dy a më shumë vjeçare, ka penalizuar shtetasit për të përfutur pension pleqërie që nga momenti i lindjes të së drejtës për përfitim.

Bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e sigurimeve shoqërore, paraqitja e kërkesës për verifikim të vjetërsisë në punë mund të kërkohej një vit përpara lindjes të së drejtës për përfitim, ndërsa kërkesa për lidhjen e pensionit të pleqërisë duhet kërkuar jo më vonë se një vit nga data që i lind kjo e drejtë¹³².

Duke qenë se proceset gjyqësore, përgjithësisht kanë përfunduar pas afateve ligjore për të drejtën e përfitimit të pensionit të pleqërisë, qytetarët janë penalizuar duke iu mohuar kjo e drejtë dhe përfitimi ka filluar pas paraqitjes së vendimit gjyqësor.

Në kushtet e së drejtës që ka çdo qytetar për t'u informuar për aktet e mbajtura nga autoritetet publike në çdo kohë sipas Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i cili garanton të drejtën për njohjen me informacionin arkivor të çdo lloji,¹³³ me qëllim që deri në momentin e lindjes së të drejtës për përfitim qytetari të ketë mundësi të plotësojë edhe kriterin e vjetërsisë së punës e të fillojë të gëzojë pensionin e pleqërisë, i jemi drejtuar me rekomandim Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, për verifikimin e plotë të vjetërsisë së punës sipas listë-pagesave përkatëse.

- *Masë e ulët e pensionit të pleqërisë nga mosmbledhja e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore nga Drejtoria Përgjithshme e Tatimeve.*

Një problem tjetër i konstatuar nga trajtimi i ankesave të qytetarëve është dhe mosllogaritja dhe derdhja e kontributeve nga subjektet përkatëse në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore. Derdhja e kontributeve të sigurimeve shoqërore nga subjektet ku ata janë të punësuar, do t'i mundësojnë qytetarëve që të marrin ato të drejta që i garanton Kushtetuta e Republikës së

¹³² Neni 62 pika 2 i ligjit nr. 7702 datë 11.03.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

¹³³ Neni15, pika 5 i ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Shqipërisë dhe Ligji nr.7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për të përfituar një masë më të lartë pensioni pleqërie.

Në analizë të akteve ligjore, që rregullojnë mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore, përgjegjësia për mbledhjen e kontributeve shoqërore i takon organeve tatimore.¹³⁴ Me qëllim adresimin e kësaj problematike, për përfitimin e plotë të pensionit të pleqërisë sipas kontributit të dhënë ndër vite nga qytetarët, iu drejtuam me rekomandim Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve duke kërkuar që për raste të tilla është përgjegjësi e tyre mbledhja e menjëhershme të kontributeve të sigurimeve shoqërore nga çdo subjekt privat.

Në funksion të përmirësimeve ligjore, institucioni i Avokatit të Popullit, ka identifikuar tashmë dispozita ligjore të legjislacionit në fushën e sigurimeve shoqërore, të cilat duhet të përmirësohen në funksion adresimit dhe zgjidhjes së problematikave të prezantura nga qytetarët, proces i cili do të pasohet me hartimin e rekomandimeve përkatëse.

¹³⁴ Ligji nr. 9136 datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, ka përcaktuar se: “Kontributet mblidhen nga organet tatimore për llogari të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjor”.

KREU 4

Angazhime të tjera institucionale

4.1 Veprimtaria e institucionit të Avokatit të Popullit gjatë periudhës së pandemisë të shkaktuar nga COVID-19

Vendosja e kufizimeve në ushtrimin e disa të drejtave gjatë periudhës së gjendjes së fatkeqësisë natyrore si pasojë e pandemisë, e vendosi institucionin e Avokatit të Popullit në pozitën e institucionit pararojë për të garantuar se të drejtat e njeriut nuk mund të jenë dytësore edhe në një situatë pandemie dhe njëkohësisht për të qenë sa më afër qytetarëve në funksion të garantimit të mbrojtjes së të drejtave të tyre.

Mandati kushtetues i institucionit të Avokatit të Popullit në këtë aspekt është zbatuar duke ushtruar njëkohësisht rolin mbikëqyrës dhe atë promovues.

Kontrolli, mbikëqyrja dhe vlerësimi i politikave, veprimtarisë dhe vendimmarrjes së autoriteteve shtetërore gjatë kohëzgjatjes së pandemisë ishte veçanërisht i rëndësishëm në kushtet kur veprimtaria parlamentare dhe ajo gjyqësore u bllokuan, dhe kompetenca ligjvënese i kaloi pushtetit ekzekutiv, duke realizuar procesin e kontrollit parlamentar vetëm post-factum.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur me shqetësim informacionet mbi konfirmimin e pacientëve të parë me infeksionin e COVID-19 në vendin tonë, dhe ka theksuar që herët nevojën që institucionet e shëndetit publik të jenë në lartësinë e duhur të performancës për t'u shërbyer qytetarëve tanë dhe për të minimizuar pasojat e kësaj epidemie globale në vendin tonë, duke kërkuar transparencë, sigurim të fondeve të nevojshme shtesë nga buxheti i shteti, kryerje të kontrolleve rigoroze në pikat hyrëse të vendit, angazhim të të gjitha strukturave shtetërore, pajisje me mjetet e nevojshme mbrojtëse për personelin mjekësor, parashikim të një plani në rast të rritjes eventuale të numrit të të prekurve, karantinim për personat e identifikuar si të prekur në një zonë të sigurtë dhe dizinfektim të të gjitha ambjenteve publike dhe private, të cilat paraqesin rrezik të veçante për transmetimin e virusit¹³⁵.

➤ *Organizimi i punës brenda institucionit të Avokatit të Popullit*

Pas vendosjes së masave në kuadër të pandemisë, institucioni i Avokatit të Popullit, morri një sërë masash për të siguruar vijimësinë e punës duke respektuar kufizimet e vendosura nga autoritetet shtetërore:

- ✓ U ndërpre pritja e qytetarëve dhe komunikimi me ta bëhej vetëm nëpërmjet mjeteve elektronike si e-maillet e telefoni, aplikacioni për telefonat inteligjentë , si dhe shërbimit postar.
- ✓ Në faqen e institucionit u publikua njoftimi “Mbi vazhdimësinë e punës në institucionin e Avokatit të Popullit gjatë masave në kuadër të COVID-19”, ku jepej informacion për të gjitha mënyrat e kontaktit me institucionin¹³⁶.

Stafi i institucionit të Avokatit të Popullit u transferua nga puna në zyrë në punën nga shtëpia, me orar të plotë. Në rast të nevojës për punë nga zyra, punonjësit respektuan masat e distancimit

¹³⁵ <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/news/this-article-is-available-only-in-albanian-400/>.

¹³⁶ <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/home/news/this-article-is-available-only-in-albanian-420/>.

fizik dhe të higjienës personale. Sipas një grafiku të miratuar në fillim të çdo muaji, një grup prej pesë punonjësish, ishin të pranishëm fizikisht në institucion për të garantuar vijueshmërinë e shërbimeve të domosdoshme. Nga ana tjetër, u vendos sistemi i raportimit ditor të veprimtarisë së çdo punonjësi që punonte nga shtëpia, u realizuan takime periodike me çdo njesi organizative në institucion, si dhe me grupe të veçanta pune.

Gjatë kësaj periudhe pati një ulje të numrit të ankesave të regjistruara në institucion nga qytetarët, por nga ana tjetër, pati rritje të numrit të rasteve të ndjekura me iniciativën e vet institucionit. Kjo erdhi si rezultat i veprimtarisë monitoruese të shërbimeve mediatike: medias së shkruar, televizionit dhe rrjeteve sociale. Punonjësit e institucionit u organizuan sipas një grafiku në grupe të përditshme me nga 5 anëtarë për të monitoruar online median duke identifikuar rastet e shkeljes së të drejtave themelore të individëve.

Stafi i Zyrës së Pritjes së Qytetarëve, ndihmëskomisionerët dhe në disa raste të veçanta edhe anëtarët e kabinetit ofruan ndihmë juridike në formën e këshillimin ligjor lidhur me çështje/pyetje të ndryshme të adresuara nga qytetarët, kryesisht nëpërmjet e-mailit.

U pezulluan inspektimet në vendet e privimit të lirisë, apo institucionet e tjera shtetërore dhe komunikimi me to bëhej nëpërmjet e-mailit.

Si rezultat i këtyre masave, gjatë periudhes së karantinës, nuk pati asnjë punonjës të institucionit tone të prekur nga COVID-19.

➤ *Roli proaktiv*

Gjatë periudhës së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, institucioni i Avokatit të Popullit i kushtoi një rëndësi të veçantë ushtrimit të rolit promovues e proaktiv, duke siguruar praninë në media, duke publikuar vazhdimisht thirrje për të drejtat e grupimeve të caktuara¹³⁷, si edhe duke përcjellë pranë autoriteteve shtetërore por edhe për qytetarët udhëzimet/rekomandimet e organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare.

Institucioni i Avokatit të Popullit publikoi një material shpjegues lidhur me gjendjen e fatkeqësisë natyrore, kufizimet e të drejtave dhe rolin e autoriteteve shtetërore, për t'iu ardhur në ndihmë të gjithë qytetarëve.¹³⁸

Veprimtaria për ushtrimin e rolit të institucionit kombëtar të të drejtave të njeriut solli si rezultat rritjen e vizibilitetit të aktivitetit institucional, si dhe rritjen e reagimit/angazhimit të qytetarëve kundrejt institucionit të Avokatit të Popullit. Sipas të dhënave të faqes zyrtare të institucionit të Avokatit të Popullit, *në periudhën Mars-Prill 2020 numri i personave të cilët kishin konsultuar faqen u rrit me 359% ndërsa reagimet në postimet e institucionit u rritën me 167%.*

¹³⁷ Të drejtat e fëmijëve: <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/news/this-article-is-available-only-in-albanian-407/>.

Parimet e Këshillit të Europës për trajtimin e personave në vendet e privimit të lirisë:

<https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/news/statement-of-principles-relating-to-the-treatment-of-persons-deprived-of-their-liberty-in-the-context-of-the-coronavirus-disease-covid-19-pandemic-408/>

Të drejtat e të moshuarve: <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/news/this-article-is-available-only-in-albanian-409/>.

Thirrje për vemendje ndaj qytetarëve shqiptarë të mbetur jashtë territorit të vendit:

<https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/news/this-article-is-available-only-in-albanian-410/>.

Tw drejtat e komunitetit Rom dhe Egjiptian: <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/news/this-article-is-available-only-in-albanian-412/>; <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/news/peoples-advocate-asks-for-better-inclusion-and-equality-for-roma-people-on-their-international-day-419/>.

Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara: <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/news/this-article-is-available-only-in-albanian-411/>.

¹³⁸ <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/news/this-article-is-available-only-in-albanian-406/>.

4.2 E drejta e shtetasve për të mos iu cënuar integriteti fizik dhe trajtuar me dinjitet (Rasti i shembjes së Teatrit Kombëtar)¹³⁹

Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur me vëmendje të veçantë ngjarjet që lidhen me TK dhe me shqetësim të thellë ato të ndodhura në orët e para të mëngjesit të datës 17.05.2020 dhe protestave në orët në vijim. Në këtë datë rreth orës 04:30, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë (IMT) Tiranë, i mbështetur nga forca të Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake Tiranë, zbatoi vendimin e Këshillit Bashkiak Tiranë, për shembjen e godinës së TK.

Ideja dhe vendimmarrjet për shembjen e Teatrit Kombëtar, janë kundërshtuar nga qytetarë të ndryshëm, përfshirë edhe figura të njohura të fushës së artit, kulturës, apo personalitete të tjera të vendit. Pas vendimit të marrë nga Këshilli Bashkiak Tiranë për prishjen e godinës së TK pati një ngritje të toneve nga palët e përfshira në mbrojtjen e kësaj godine, të cilat e kanë konsideruar vendimin të kundërligjshëm dhe shtetas të ndryshëm u shprehën në atë kohë se do të bënin qëndresë dhe nuk do të lejonin prishjen e godinës.

Vlen për t'u theksuar se si Vendimi i Këshillit Bashkiak Tiranë, ashtu edhe kryerja e operacionit nga dy institucionet e lartëpërmendura në zbatim të tij, janë realizuar në një periudhë krejtësisht të pazakontë. Në një kohë kur e gjithë veprimtaria ekonomike, administrative dhe shoqërore në vend ishte mbyllur apo kufizuar, si masë mbrojtëse ndaj përhapjes së Virusit COVID-19, kur institucionet shtetërore kishin miratuar akte që kufizonin liritë dhe të drejtat e individëve me qëllim ruajtjen e shëndetit dhe jetës, nga disa institucione shtetërore, u kryen veprime që përfshinë një numër të madh punonjësish në të njëjtin vend, pavarësisht se grumbullimet masive ishin rreptësisht të ndaluara.

Institucioni i Avokatit të Popullit, në ushtrim të misionit kushtetues si mbrojtës i të drejtave dhe lirive themelore të individit verifikoi ligjshmërinë e veprimeve të punonjësve të Policisë së Shtetit gjatë dhe pas operacionit për shembjen e godinës së Teatrit Kombëtar. Më pas janë paraqitur edhe disa ankesa nga shtetas të cilët pretendonin se ishin dhunuar nga disa punonjës të policisë.

Avokati i Popullit organizoi punën në grupe me ekspertë të institucionit për të vizituar Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë dhe të gjitha Komisariatet e Policisë Tiranë, për të marrë takim me personat e shoqëruar dhe dëgjuar dëshmitë tyre, për të këqyru regjistrat e personave të shoqëruar, për të administruar dokumentacionin që lidhet me ngjarjen, si dhe për të parë në vend masat e marra në zbatim të protokolleve për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19. Në përfundim të shqyrtimit të këtij rasti konstatuam se:

- Shembja e godinës së TK u bë në kohë pandemie.
- Shembja e saj në kohë pandemie nuk përbënte emergjencë dhe domosdoshmëri.
- Numri i punonjësve të Policisë së Shtetit të angazhuar në operacion, i punonjësve të Policisë Bashkiake, i punonjësve të IMT-së Tiranë dhe i protestuesve ishte shumë i madh dhe për këtë arsye janë shkelur aktet normative për ndalimin e grumbullimeve masive në kuadër të masave të marra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19.
- Një pjesë e punonjësve të Policisë së Shtetit nuk mbanin maska dhe se nga punonjësit e policisë nuk është respektuar distanca me njëri-tjetrin, ndërmjet tyre dhe qytetarëve protestues, si dhe protestuesit me njëri-tjetrin. Për rrjedhojë edhe nga vetë punonjësit e policisë u shkelën masat anticovid të përcaktuara nga aktet normative në fuqi.
- Nga inspektimi në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë dhe komisariatet në varësi të saj u konstatua se ndaj personave të shoqëruar nuk ishin respektuar masat anti COVID-19, si

¹³⁹ Rekomandimi i plotë i Avokatit të Popullit në lidhje me këtë çështje gjendet në linkun:

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20Teatri%20Kombetar%20nensor%202020.pdf>

respektimi i distancës, të shoqëruarve nuk iu ishin dhënë maska dhe doreza, në hyrje të dhomave të shoqërimit apo brenda tyre nuk u gjetën dezinfektantë dhe se nuk ishte bërë një shpërndarje e të shoqëruarve në mënyrë proporcionale me kapacitetet e ambienteve të shoqërimit.

- Për shkak të mos marrjes së këtyre masave, punonjësit e policisë u bënë një burim i mundshëm i përhapjes së virusit COVID-19, si brenda radhëve të tyre, ashtu edhe ndaj qytetarëve protestues dhe veçanërisht ndaj personave të shoqëruar.
- Përgjegjësia parësore për zbatimin e masave që parandalojnë përhapjen e virusit bie mbi institucionet shtetërore.
- Orari i nisjes së operacionit për shembjen e godinës së TK ka qenë i papërshtatshëm, sepse si rregull vendimet e marra nga administrata shtetërore ekzekutohen ndërmjet orës 07:00 - 19:00.
- Disa nga punonjësit e policisë që morrën pjesë në këtë operacion nuk kishin numrin e identifikimit në uniformën e tyre.
- Nga disa punonjës të policisë është tejkaluar forca, është ushtruar dhunë fizike dhe verbale ndaj disa protestuesve dhe gazetarëve duke konsumuar elementët e veprës penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare” në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 250 dhe 25 të Kodit Penal, të ndryshuar.
- Të shoqëruarve në organet e policisë nuk iu është dhënë “Proces verbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar”.

Për sa më sipër iu rekomandua Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë si më poshtë:

- Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit, për analizimin e thelluar, me objektivitet dhe profesionalizëm, të veprimeve/mosveprimeve të kundërligjshme, të kryera nga punonjës të Policisë së Shtetit, si ndaj disa shtetasve që në orët e para të datës 17.05.2020 kanë qenë në godinën e Teatrit Kombëtar për të kundërshtuar prishjen e tij, ashtu edhe të protestuesve në orët në vijim të po kësaj date.
- Identifikimin dhe fillimin e ecurisë disiplinore për ata drejtues apo punonjës të Policisë së Shtetit që, me veprimet/mosveprimet e tyre, nuk kanë garantuar jetën dhe shëndetin e popullatës (përfshi edhe punonjësit shtetërorë), duke mbështetur veprimtari/operacione, të cilat kanë përbërë në vetvete apo kanë çuar në grumbullime masive, në kohën kur ishte shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore.
- Identifikimin dhe fillimin e ecurisë disiplinore për ata punonjës të Policisë së Shtetit që kanë kryer veprime me të shoqëruarit në organet e policisë, për arsye se nuk kanë zbatuar detyrimin ligjor për mbajtjen e procesverbalit mbi veprimet e kryera me të shoqëruarit dhe dhënien e një kopjeje të tij personave të shoqëruar, si dhe nuk kanë dokumentuar hyrjen e personave të shoqëruar në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.
- Identifikimin dhe fillimin e ecurisë disiplinore për ata punonjës të Policisë së Shtetit që me veprimet e tyre kanë cenuar informimin e qytetarëve, duke penguar punonjësit e organeve të medias për të dokumentuar pjesë të ndryshme nga këto ngjarje.
- Identifikimin dhe fillimin e ecurisë disiplinore, për ata drejtues të Policisë së Shtetit, që nuk lejuan vënien në dispozicion të pamjeve filmike të kërkuara nga institucioni i Avokatit të Popullit, duke penguar kështu hetimin administrativ.
- Marrjen e masave të nevojshme organizative dhe financiare nga strukturat qendrore të Policisë së Shtetit, për pajisjen e të gjithë punonjësve të policisë së shtetit, me mjetet mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga virusi COVID-19, në zbatim të akteve normative të miratuara me qëllim për të garantuar veprimtarinë ligjore të Policisë së Shtetit, gjatë periudhës së pandemisë dhe që ata të mos bëhen burim rreziku për përhapjen e tij. Të njëjtat masa të merren dhe respektohen edhe për shtetasit e

shoqëruar/ndaluar/arrestuar në ambientet e policisë së shtetit, apo edhe gjatë transportit të tyre për në ambientet e mësipërme.

- Identifikimin dhe fillimin e ecurisë disiplinore ndaj atyre drejtuesve të strukturave të Policisë së Shtetit, që nuk kanë marrë masat e nevojshme për pajisjen e disa punonjësve të policisë, të caktuar me shërbim tek ish godina e Teatrit Kombëtar dhe e atyre që ishin me shërbim në komisariate, si dhe të personave të shoqëruar, me maska mbrojtëse, doreza e dezinfektantë, në zbatim të akteve normative të nxjerra nga organet kompetente, me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga virusi COVID-19.
- Marrjen e masave të nevojshme organizative dhe financiare nga strukturat qendrore të Policisë së Shtetit, për të bërë të mundur pajisjen sa më parë të të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit me numrat personalë të identifikimit të tyre, duke respektuar kështu detyrimet ligjore për uniformën e punonjësve të Policisë së Shtetit, por edhe për të identifikuar më me lehtësi shkeljet ligjore që mund të kryhen prej tyre gjatë ushtrimit të detyrave. Identifikimin dhe fillimin e ecurisë disiplinore për ata drejtues të Policisë së Shtetit, që kanë lejuar ushtrimin e detyrës nga punonjës të Policisë së Shtetit, pa numrin përkatës të identifikimit.
- Marrjen e masave të nevojshme organizative nga strukturat qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit, për të bërë të mundur trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve të policisë, për njohjen dhe respektimin e të drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasve, për mënyrën dhe masën e përdorimit të forcës, si dhe për sjelljen me etikë dhe korrektesë me shtetasit.
- Shpejtimin e hetimit të procedimit penal të regjistruar nga organi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ndaj strukturave të Policisë së Shtetit për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, lidhur me dërgimin e forcave RENEA tek ish godina e Teatrit Kombëtar, para shembjes së saj.
- Shpejtimin e hetimit të procedimeve penale të regjistruara nga organi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për kallëzimet e bëra nga shtetasit M.G., M.Z., A.L. dhe S.C., duke mbajtur në konsideratë rekomandimet e bëra nga Komiteti Europian për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor ose Poshtërues (CPT), gjatë vizitës në Shqipëri të kryer nga CPT në datat 20-30 nëntor 2018. Në këtë rekomandim midis të tjerave përcaktohet se: *“Komiteti rekomandon që në raste të keqtrajtimit të mundshëm policor të hetohen nga prokurorët të cilët nuk janë të lidhur me hetimet penale kundër viktimave të pretenduara të keqtrajtimit”*.¹⁴⁰

Deri aktualisht na kanë kthyer përgjigje Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, të cilat kanë pranuar si shkelje vetëm mosmbajtjen dhe dhënien e procesverbalit mbi veprimet e kryera me disa të shoqëruar nga Komisariati i Policisë nr. 6, Tiranë.

4.3 E drejta kushtetuese e shtetasve për tubim në gjendje pandemie

Pas shpalljes së gjendjes së pandemisë botërore në datën 11 Mars 2020 nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, nga ana e strukturave kompetente shtetërore u miratuan një sërë aktesh¹⁴¹ për marrjen e masave të veçanta administrative në përputhje me situatën, të cilat sollën kufizimin e disa të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese dhe ligjore.

¹⁴⁰ <https://rm.coe.int/168097986b>.

¹⁴¹ Akti normativ nr. 3, datë 15.3.2020, i Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, i ndryshuar, VKM nr. 243, datë 24.03.2020, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, nxjerrja e një sërë aktesh normative nga Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile si organi më i lartë për koordinimin dhe bashkërendimin e veprimeve të institucioneve shtetërore dhe të subjekteve private, si dhe të burimeve financiare e materiale për përballimin e fatkeqësisë natyrore për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, si dhe nga disa ministra kryesisht Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Pavarësisht kësaj gjendjeje, institucioni i Avokatit të Popullit ka kryer në vijimësi detyrën në përmbushje të misionit të tij kushtetues, për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve si edhe evidentimin e rasteve të ndryshme të mosrespektimit apo mosgarantimit të tyre, në atë masë që janë të pakufizueshme apo të pakufizuara nga aktet normative të nxjerrë për këtë qëllim.

Në këtë kuadër, nga ana jonë janë ndjekur me vëmendje nëpërmjet mediave protestat e qytetarëve të organizuara në qytete të ndryshme të vendit gjatë periudhës së pandemisë dhe vendosjes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore për shkak të përhapjes së infeksionit nga COVID-19. Nëpërmjet tubimeve ata kanë shprehur shqetësimet e tyre dhe i kanë bërë publike ato për të tërhequr vëmendjen dhe sensibilizuar opinionin publik.

Kështu, protesta janë organizuar nga punonjësit e ndërmarrjeve private për shkak të mos marrjes së “pagës së luftës”, për shkak të largimit nga puna; nga banorë të cilët kanë pasur probleme të dëmtimit të banesave të tyre nga tërmetet e vitit të kaluar, etj. Ndërsa, në disa raste të tjera, ato janë organizuar nga aktivistë të shoqërisë civile dhe qytetarë të ndryshëm për shkak të masave kufizuese të vendosura nga autoritetet shtetërore gjatë pandemisë; kundër prishjes së ish godinës së Teatrit Kombëtar; ato të mbajtura pas vrasjes së të riut Klodian Rasha nga një punonjës i Policisë së Shtetit, etj.

Gjatë zhvillimit të protestave, në një mori prej tyre, kanë ndërhyrë strukturat e Policisë së Shtetit të cilat kanë bërë shoqërime në organet e policisë të organizatorëve dhe disa pjesëmarrësve në protestë, e më pas referimin e materialeve procedurale në organet e prokurorisë.¹⁴²

Për të bërë të mundur vlerësimin e rasteve si dhe të sjelljes së strukturave të Policisë së Shtetit lidhur me trajtimin e tyre, duke mbajtur në konsideratë faktin se e drejta e shtetasve për tubim është një e drejtë themelore kushtetuese, u jemi drejtuar strukturave të Policisë së Shtetit lidhur me qëndrimin e mbajtur nga ana e tyre në rastet e zhvillimit të protestave. Gjatë vitit 2020, lidhur me të drejtën e tubimit kemi *trajtuar 13 ankesa dhe 14 raste të regjistruara me iniciativë*.

Nga përgjigjet e dërguara institucionit tonë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë evidentohet fakti se bazuar në aktet në fuqi zhvillimi i aktiviteteve publike, si grumbullime, tubime e protesta në vende të mbyllura dhe të hapura, janë të ndaluara.

Në vijim, iu referuam akteve normative në të cilat bazoheshin pretendimet e Policisë së Shtetit për ndalimin e grumbullimeve, tubimeve, protestave, etj., gjatë periudhës së shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore për shkak të infeksionit COVID-19 dhe konkretisht:

- Në Aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 2 të tij parashikohet se:
“Subjektet apo individët që organizojnë zhvillimin e aktiviteteve publike dhe jopublike, si aktivitete sportive, kulturore dhe konferenca, apo grumbullimet masive në vende të mbyllura apo të hapura, si koncerte, tubime dhe dëgjesa publike, dënohen me gjobë në masën 5 000 000 (pesë milion) lekë për organizatorët dhe ndalimin e aktivitetit”.
- Në VKM nr. 243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, pika 6.1, gërma “dh”, parashikohet se:

¹⁴² Referimi përgjithësisht është bërë për veprat penale “Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme” dhe “Prishja e qetësisë publike”, parashikuar nga nenet 262 dhe 274 të Kodit Penal.

“Institucionet publike të ndalojnë tubimet, manifestimet dhe grevat;”

- Në Urdhërin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 132, datë 08.03.2020 “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura”, i ndryshuar, pika 2, parashikohet se:
“Urdhëroj: anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura të tilla si koncerte, tubime dhe dëgjesa publike....”

Nga aktet e cituara më lartë veçuar dhe analizuam Aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, nga përmbajtja e të cilit kuptohet në mënyrë të qartë se gjatë kohëzgjatjes së periudhës së pandemisë në vendin tonë ndalohen grumbullimet masive në vende të mbyllura apo të hapura, si koncerte, tubime dhe dëgjesa publike. Kjo do të thotë se grumbullimet jo masive në vende të mbyllura apo të hapura, si koncerte, tubime dhe dëgjesa publike, *nuk ndalohen*.

Ndërsa, Urdhëri nr.132, datë 8.3.2020, i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, jo mjaftueshmërisht i qartë nga pikëpamja e përmbajtjes legjislative, duket se ka për qëllim kufizimin, ndalimin apo anulimin e disa të drejtave lidhur me aktivitetet publike dhe grumbullimet në vende të mbyllura dhe të hapura. Ai është interpretuar në mënyrë drastike nga autoritetet shqiptare si një ndalim tërësor e absolut i ushtrimit të të drejtave që kufizohen prej tij.

Ndërkohë që pas trajtimit të disa rasteve nga ana jonë dhe nxjerrjes së një sërë rekomandimesh konkrete lidhur me cenimin e ushtrimit të lirisë së tubimit, nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është miratuar Urdhëri Nr. 633, datë 17.11.2020 "Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura", në pikën 1 të të cilit përcaktohet se:
"Urdhëroj: Ndalohen grumbullimet me më shumë se 10 persona në vende të mbyllura apo të hapura, konferencat, tubimet, mbledhjet partiake, ceremonitë e festave, ceremonitë martesore dhe organizimet përtej familjare të ceremonive mortore, deri në një urdhër të dytë...."

Ndërkohë kemi vërejtur se gjatë kësaj periudhe kohore janë zhvilluar grumbullime, si takime, mbledhje partiake, dëgjesa publike, etj, masive apo jo masive dhe me/ose jo masa sigurie nga autoritete të ndryshme të administratës publike, subjekte politike, të cilat janë bërë publike në media. Qëllimi i organizimit dhe zhvillimit të tyre ka qënë lidhur me marrjen e masave mbrojtëse ndaj COVID-19, për zhvillimin e ekonomisë nëpërmjet turizmit, projekteve publike, etj. Po ashtu janë organizuar edhe koncerte me një numër të reduktuar artistësh. Ndërsa nga ana tjetër grumbullimet apo protestat e qytetarëve të thjeshtë si një mjet për të realizuar të drejtën e tyre për të shprehur pakënaqësitë dhe opinionet e tyre, pavarësisht garantimit nga ana e tyre të rregullave të distancimit social, nuk janë lejuar.

Gjatë shqyrtimit të ankesave/rasteve me iniciativë konstatuam se aktet normative të cituara më lartë janë kuptuar, interpretuar dhe zbatuar jo në mënyrë të drejtë e korrekte nga ana e strukturave të Policisë së Shtetit. Për rrjedhojë, ato kanë penguar dhe cenuar ushtrimin e një lirie/të drejte kushtetuese të shtetasve. Qëndrimet jo ligjore të mbajtuara në këto raste nga organet e policisë cenojnë rëndë imazhin e Policisë së Shtetit dhe besimin e publikut tek ky organ, të cilat janë të domosdoshme në kryerjen me sukses të misionit ligjor të saj për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike.

Avokati i Popullit në disa raste e ka shprehur në mënyrë të qartë qëndrimin e tij në lidhje me ushtrimin e të drejtës/lirisë së tubimit nga qytetarët si një nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Sjellim në vëmendje se liria e tubimeve është parashikuar dhe garantuar nga neni 47 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 11 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kufizimet e vendosura ndaj të drejtave dhe lirive themelore të njeriut sikurse është dhe liria e tubimit nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane të të Drejtave

të Njeriut (KEDNJ)¹⁴³ e interpretuar nëpërmjet Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), duke paravendosur si kusht që këto kufizime të jenë proporcionale me gjendjen që e ka shkaktuar nevojën për vendosjen e tyre. Shteti ka diskrecion për të konstatuar domosdoshmërinë e kufizimit të një apo disa të drejtave në përputhje me rrethanat që diktojnë këtë nevojë, duke mbajtur në vëmendje deri në ç'masë është e nevojshme të vijohet me kufizimet në përpjekje për të kapërcyer gjendjen e emergjencës.¹⁴⁴ Masat të cilat ndërhyjnë tek e drejta për lirinë e tubimit paqësor shkelin nenin 11, nëse ato nuk përmbushin një nevojë shoqërore urgjente, si dhe duhet të jenë mjet proporcional i synimit të mbrojtjes së shëndetit publik. GJEDNJ ka pranuar se qartësia absolute lidhur me pasojat e veprimeve të njerëzve mund të jetë e pamundur të arrihet, meqënëse ligjet duhet të ruajnë një shkallë fleksibiliteti për të lënë vend për ndryshimin e rrethanave.¹⁴⁵

Gjykata në praktikën e saj i ka dhënë rëndësi faktit se ata që marrin pjesë në tubime nuk kërkojnë vetëm të shprehin opinionin e tyre, por, edhe ta shprehin atë së bashku me të tjerë.¹⁴⁶ Po ashtu Gjykata, ka konsideruar se njoftimi, dhe madje procedurat e autorizimit, për një ngjarje publike normalisht nuk shkelin mbi thelbin e së drejtës në bazë të nenit 11 të Konventës për sa kohë që qëllimi i procedurës është që të lejojë autoritetet të marrin masa të arsyeshme dhe të përshtatshme për të garantuar zhvillimin normal të çdo tubimi, mbledhje apo grumbullimeve të tjera.¹⁴⁷ Organizatorët e tubimeve publike duhet të veprojnë në përputhje me rregullat që rregullojnë këtë proces duke respektuar rregulloret në fuqi. Njoftimi paraprak i shërben jo vetëm qëllimit të bashkërendimit të të drejtës së tubimit me të drejtat dhe interesat e ligjshëm duke përfshirë lirinë e lëvizjes të të tjerëve, por gjithashtu qëllimit të parandalimit të trazirave apo krimit. Edhe në rastin kur nuk është bërë një lajmërim paraprak për protestë, ky element teknik nuk duhet të shkelë kurrësi thelbin e së drejtës për ta ushtruar lirinë e tubimit.¹⁴⁸

Rregullat procedurale që disiplinojnë ushtrimin e kësaj të drejte janë të përcaktuara në mënyrë të shprehur në ligjin nr. 8773, datë 23.4.2001 “Për tubimet”, ku parashikohen edhe kufizimet apo ndalimet shteruese të cilat nuk mund të tejkalohen në ushtrimin e së drejtës së tubimit. Ky ligj pasi përcakton se, çdo person ka të drejtë të organizojë dhe të marrë pjesë në një tubim paqësor dhe pa armë, parashikon gjithashtu se Policia e Shtetit garanton dhe mbron të drejtën e çdo personi për të organizuar e marrë pjesë në tubime paqësore dhe pa armë. Ndalimi dhe shpërndarja e një tubimi lejohet vetëm në rastet e parashikuara me ligj. Nga referimi në përmbajtjen e dispozitave të këtij ligji rezulton se për ushtrimin e kësaj të drejte kërkohet vetëm bërja e njoftimit në një kohë të përcaktuar i organeve të policisë ku të pasqyrohen disa të dhëna që lidhen me zbatimin e detyrës së saj si garantuese e ushtrimit të kësaj të drejte duke i dhënë kohë për të marrë masat e nevojshme për mbarëvajtjen e tubimit.

Përveç dispozitave të cituara më sipër, duke i referuar nenit 15/2 të Kushtetutës dhe nenit 2 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, Avokati i Popullit vlerëson se nga organet e pushtetit publik kërkohet që, jo vetëm të mos bëhen pengesë për ushtrimin e lirisë së tubimeve të shtetasve, por përkundrazi duhet të kontribuojnë në realizimin e saj.

Në përfundim të shqyrtimit të një rasti dhe me qëllim për t’u krijuar lehtësi shtetasve për realizimin e të drejtave të tyre kushtetuese e ligjore, por edhe për të unifikuar qëndrimin e organeve të Policisë së Shtetit, prokurorisë dhe atyre gjyqësore në të tilla raste, u vlerësua se

¹⁴³ Neni 17 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

¹⁴⁴ Me notën verbale të Misionit Permanent të RSH pranë Këshillit të Evropës, të datës 31 Mars 2020, shteti shqiptar, në përputhje me nenin 15/3 të KEDNJ, i ka njoftuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës derogimin nga disa të drejta të parashikuara nga nenet e Konventës, për shkak të gjendjes së epidemisë. Ndërkohë, afati për të cilin është bërë derogimi ka rënë dhe aktualisht ai e ka humbur fuqinë ligjore.

¹⁴⁵ Shih, Ezelin k.Francës, 26 prill 1991, Nr. 11800/85 § 45.

¹⁴⁶ Shih, Primov dhe të tjerë k.Rusisë, 12 qershor 2014, Nr. 17391/06 § 91.

¹⁴⁷ Shih, Sergey Kuznetsov kundër Rusisë, nr. 10877/04, § 45, 23 tetor 2008.

¹⁴⁸ Shih, Éva Molnár kundër Hungarisë, 7 tetor 2008, kërkesa nr. 10346/05.

strukturat kompetente shtetërore duhet të përmirësojnë aktet normative që rregullojnë lirinë e tubimit, me qëllim që ajo të ushtrohet edhe në rastet e pandemive apo shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Gjatë procesit të përgatitjes së këtyre akteve duhet të mbahen parasysh vendi se ku do të zhvillohet tubimi, i mbyllur apo i hapur, sipërfaqja e tij, numri i pjesëmarrësve, masat mbrojtëse ndaj përhapjes së infeksionit, parimi i rëndësishëm i proporcionalitetit, etj.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, përgatiti një rekomandim¹⁴⁹ drejtuar, Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Komitetit Ndërmnistror të Emergjencave Civile ku rekomandoi:

- Marrjen e masave të nevojshme për ndërprerjen e menjëhershme të praktikës së deritanishme të strukturave të Policisë së Shtetit për moslejimin e grumbullimeve jo masive në vende të mbyllura apo të hapura, si tubime dhe dëgjesa publike, organizuar nga subjekte të ndryshëm gjatë periudhës së kohëzgjatjes së pandemisë dhe të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore.
- Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat përkatëse për të bërë propozimet konkrete drejtuar organeve që kanë të drejtën e nismës legislative për të mundësuar ndryshimet në ligjin nr. 8773, datë 23.4.2001 “Për tubimet”, për të garantuar të drejtën e tubimeve spontane si dhe antiprotestat në përputhje me rekomandimet dhe aktet ndërkombëtare;
- Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat e Policisë së Shtetit për të garantuar të drejtën e ushtrimit të profesionit dhe raportimit të ngjarjeve nga gazetarët e pranishëm në tubime apo aktivitete të tjera të kësaj natyre.
- Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat e pushtetit publik për përmirësimin e akteve normative në fuqi që rregullojnë lirinë e tubimit me qëllim garantimin e kësaj të drejte kushtetuese edhe në periudha pandemie dhe të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, duke respektuar protokollet përkatës shëndetësorë.
- Përgatitjen dhe miratimin e një udhëzimi apo qarkore nga Prokuroria e Përgjithshme, në bashkëpunim me KLP dhe KLGJ për unifikimin e praktikave të organeve të prokurorisë dhe ato gjyqësore për ndjekjen penale dhe gjykimin e çështjeve për veprën penale “Organizimi dhe pjesëmarrja në tubim të paligjshëm”, parashikuar nga neni 262 i Kodit Penal.
- Marrjen e menjëhershme të masave nga Prokuroria e Përgjithshme për përgatitjen e propozimeve konkrete drejtuar strukturave kompetente me qëllim ndryshimin e nenit 262 të Kodit Penal në përputhje me frymën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut si dhe praktikës së deritanishme të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Të gjithë institucionet të cilave iu drejtuam rekomandimin kthyen përgjigje, me përjashtim të Komitetit Ndërmnistror të Emergjencave Civile. Sqarojmë se prej tyre, *vetëm Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e vlerësoi atë dhe shprehu gadishmërinë për bashkëpunim për përmirësimin e akteve normative që rregullojnë lirinë e tubimit, por ndërkohë nuk mori asnjë veprim tjetër për ta konkretizuar atë.*

Ne vlerësojmë se autoritetet shtetërore për të justifikuar një ndalim të përgjithshëm, duhet të demonstrojnë që ekziston një rrezik real që nuk mund të parandalohet përmes masave të tjera

¹⁴⁹ Në muajin korrik 2020, Avokati i Popullit u ka dërguar disa institucioneve “Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme për respektimin e lirisë kushtetuese të tubimit edhe gjatë gjendjes së jashtëzakonshme”. Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës:

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20marrjen%20e%20masave%20t%C3%ABr%20nevojshme%20p%C3%ABr%20respektimin%20e%20liris%C3%ABr%20kushtetuese%20t%C3%ABr%20tubimit%20edhe%20gjat%C3%ABr%20gjendjes%20s%C3%ABr%20jasht%C3%ABzakonshme.%20.pdf>

më pak shtrënguese. Duhet të merret parasysh efekti i ndalimit dhe të konkludohet që disavantazhet e shkaktuara nga ndalimi kanë qartazi më shumë peshë se konsideratat e sigurisë dhe që nuk ka mënyra të tjera të mundshme për të shmangur këto efekte të padëshirueshme, për shembull duke reduktuar fushëveprimin ose kohëzgjatjen e ndalimit.¹⁵⁰

Kufizimi absolut i të drejtës së qytetarëve për t'u mbledhur në kërkim të të drejtave të tyre, pra për t'u organizuar në tubime, ishte masë proporcionale në momentin e marrjes së një sërë masave të tjera për një interes më të lartë publik, por, që respektimi i këtij parimi të garantohet edhe sot, duhet që të rishikohet domosdoshmërisht mënyra e zbatimit të kufizimit apo e ndalimit.

Në këtë kuptim, një qasje korrekte edhe në respektim të Kushtetutës e të instrumentave ndërkombëtarë në fushën e të drejtave të njeriut do të ishte rishikimi i kësaj mase, duke lejuar ushtrimin e të drejtës për të tubuar edhe në rastet e pandemive apo shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, nën garancinë e rregullave strikte të përcaktuara nga autoritetet, ashtu siç në fakt, po veprohet për shumë masa të tjera kufizuese. Gjatë procesit të përgatitjes së këtyre akteve të mbahen parasysh vendi se ku do të zhvillohet tubimi, i mbyllur apo i hapur, sipërfaqja e tij, numri i pjesëmarrësve, masat mbrojtëse ndaj përhapjes së infeksionit, parimi i rëndësishëm i proporcionalitetit, etj.

Lidhur me këtë çështje sjellim në vëmendje edhe qëndrimin dhe eksperiencën pozitive ndërkombëtare.

Raportuesi Special i Kombeve të Bashkuara për lirinë e tubimit dhe organizimit u është drejtuar të gjithë shteteve anëtare me një thirrje duke kërkuar prej këtyre të fundit që masat e marra ndaj COVID-19 të mos çenojnë lirinë e tubimit dhe organizimit.¹⁵¹ Në rekomandimin adresuar shteteve anëtare janë listuar dhjetë parime e udhëzime themelore që shtetet duhet të mbajnë në konsideratë për të garantuar respektimin e kësaj të drejte dhe përfshirjen e shoqërisë civile e aktorëve të tjerë si partnerë në përballimin e krizës që po kalon çdo shtet.¹⁵²

Ndër eksperiencat pozitive të shteteve evropiane në këtë drejtim mund të përmendim Gjermaninë, e cila gjatë periudhës së pandemisë ka lejuar zhvillimin e grumbullimeve dhe tubimeve deri në një numër të kufizuar pjesëmarrësish duke ruajtur distancimin fizik gjatë situatave të tilla. Gjykata Kushtetuese Gjermane është shprehur mbi të drejtën e personave për të zhvilluar protesta, nëse zbatojnë rregullat e distancës fizike në mënyrë që të pengojnë përhapjen e infeksionit COVID-19 duke theksuar se një ndalim i përgjithshëm i tubimeve do të ishte jokushtetues dhe se shqetësimet shëndetësore të lidhura me pandeminë e koronavirusit nuk janë bazë për një ndalim të përgjithshëm të protestave.¹⁵³

4.4 Monitorimi i protestave (të muajve maj dhe dhjetor 2020)

Institucioni i Avokatit të Popullit ka monitoruar të drejtën për organizimin e tubimeve në vazhdimësi, nëpërmjet inspektimeve të kryera në organet e Policisë së Shtetit, si dhe nëpërmjet

¹⁵⁰ Shih, Christians against Racism and Fascism k. Mbretërisë së Bashkuar, vendimi për pranueshmërinë i 16 korrikut 1980, Nr.8440/78.

¹⁵¹ COVID-19 restrictions should not stop freedom of assembly and association, says UN expert: <https://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=25792&LangID=E>.

¹⁵² States responses to Covid 19 threat should not halt freedoms of assembly and association” – UN expert on the rights to freedoms of peaceful assembly and of association, Mr. Clément Voule: <https://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=25788&LangID=E>.

¹⁵³ Federal Constitutional Court, April 15, 2020 – 1 BvR 828/20: https://www.bundesverfassungsgericht.de/SharedDocs/Entscheidungen/DE/2020/04/rk20200415_1bvr082820.html.

kryerjes së hetimit administrativ lidhur me procedurat e ndjekura nga punonjësit e policisë me personat e shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar.

Grupet e monitorimit të Avokatit të Popullit kanë ndjekur nga afër në terren jo vetëm protestat, por edhe situatën pasuese, gjatë shoqërimeve të qytetarëve nga ana e Policisë, si edhe në spitalet vendore ku janë shtruar të lënduarit gjatë protestave, në përputhje me mandatin tonë të përcaktuar në ligj.

Institucioni i Avokatit të Popullit, ka monitoruar protestat e muajve maj dhe dhjetor 2020 sipas një plani pune të miratuar nga Avokati i Popullit. Vazhdimisht institucioni ynë gjatë të gjitha ditëve të zhvillimit të protestës ka theksuar nevojën për ushtrimin në mënyrë paqësore të së drejtës së protestës, si një e drejtë kushtetuese, pa e kufizuar në asnjë mënyrë këtë të drejtë, si dhe duke ju bërë thirrje palëve për vetëpërmbajtje.

Avokati i Popullit bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, kreu një verifikim në Komisariatin e Policisë Nr.1, Tiranë në datën 15.05.2020 pas regjistrimit të një ankese në zyrën e pritjes së qytetarëve për shoqërimin e disa shtetasve, ndër ta edhe i shtetasit K.Ç. nga strukturat e Komisariatit të Policisë nr.1, gjatë një aktiviteti që po zhvillohej në sheshin “Skënderbej”, Tiranë.

Në këtë kuadër, institucioni ynë ka filluar menjëherë hetimin administrativ për verifikimin e veprimeve për shoqërimin e tij. Nga hetimi Administrativ rezultoi se: *Z. K.Ç. nuk i janë sqaruar arsyet e shoqërimit, nuk i është lejuar të kontaktojë me Avokatin e Popullit, nuk i është vënë në dispozicion karta e të drejtave dhe as nuk i është dhënë mundësia për të kontaktuar me një avokat mbrojtës apo me familjarët.* Nga të dhënat e regjistrimit të personave të shoqëruar rezultoi se shoqërimi është realizuar përkatësisht në oraret 12:40 dhe 12:45. *Theksojmë se deri në momentin e kryerjes së verifikimit nga Avokati i Popullit, në orën 15:00 nuk ishte kryer asnjë nga procedurat standarde të shoqërimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

Nga monitorimi i ambienteve të komisariateve shpesh herë është konstatuar se të drejtat e personave të shoqëruar nuk zbatohen në mënyrë të rregullt përgjatë orëve të para të shoqërimit në komisariate. Problematikat e konstatuara janë:

- Persona të shoqëruar/ndaluar nga policia shpesh herë në orët e para të shoqërimit nuk kanë pasur qasje në avokat (e drejta për të pasur një avokat privat, të komunikojë me të dhe të jetë i pranishëm gjatë marrjes në pyetje)¹⁵⁴.
- Persona të shoqëruar /ndaluar nga punonjësit e policisë nënshkruajnë deklaratën që vërteton se morrën një kopje të fletës së fakteve me të drejtat e tyre në përfundim të procesit të marrjes në pyetje në organin e policisë.¹⁵⁵ Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (CPT) i ka rekomanduar institucioneve përgjegjëse përgjatë vitit 2018- të se personat e shoqëruar/ndaluar duhet të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar informacione të qarta verbale rreth të drejtave ligjore/proceduriale që ata kanë që në fillim të privimit të lirisë. Sipas gjetjeve, fleta shpjeguese me të drejtat e personave të ndaluar u jepet atyre në fund të procesit të marrjes në pyetje.
- Është konstatuar se personat e shoqëruar/ndaluar nga policia kanë pasur vonesa në qasjen me kujdesin shëndetësor në dispozitat e përcaktuara në manual/procedurë për trajtimin dhe sigurimin me rigoroza të ekzaminimit fillestar.

¹⁵⁴ Ligji nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, Neni 109, pika 3.

¹⁵⁵ Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës ju ka rekomanduar CPT/Inf (2019) 28.

- Libri i ankesë/kërkesave shpesh herë është i pa plotësuar, sikurse përcaktohet në neni 115 të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.
- Orari i shoqërimit të personave nuk përputhet me orarin e shënuar në regjistër nga punonjësi i policisë në komisariat¹⁵⁶, sipas ligji Nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, neni 109, pika 4.

Dëshirojmë të theksojmë gjithashtu se gjatë verifikimit të kryer në ambientet e Komisarariatit të Policisë nr.1 Tiranë, u konstatua se respektimi i masave të detyrueshme për mbrojtjen nga përhapja e sëmundjes infektive COVID-19, nuk ishte në nivele të kënaqshme¹⁵⁷. E përmendim këtë fakt, pasi shoqërimi i shtetasit K.Ç. në Komisarariat ka ardhur si rezultat i aksionit për shpërndarjen e një aktiviteti, me qëllim parandalimin e përhapjes së COVID-19, ndërkohë që vetë masat mbrojtëse dhe kushtet në ambientet e komisarariatit ku personi u shoqërua nuk jepnin garanci për mbrojtjen e shëndetit të tyre.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit u ka rekomanduar organeve të Policisë së Shtetit:

- ✓ Evidentimin e rastit dhe nxjerrjen e përgjegjësive konkrete administrative për shkeljet e konstatuara në shoqërimin e gazetarit K.Ç. në ambientet e komisarariatit nr. 1 që lidhen konkretisht me:
 - *Mosçaktimin e një avokati mbrojtës.*
 - *Mosofrimin e shërbimit të nevojshëm mjekësor.*
 - *Mosvendosjen në dispozicion të kartës së të drejtave.*
- ✓ Marrjen e masave për të mundësuar identifikimin paraprak të personave që shoqërohen nga organet e policisë, për të bërë dallimin e gazetarëve apo personave të tjerë të cilët janë në ushtrim të detyrës dhe jo pjesëmarrës në aktivitetin ku zhvillohet aksioni i policisë.
- ✓ Marrjen e masave për të mundësuar qasje të menjëhershme për avokat që në momentin e shoqërimit apo ndalimit të personave në organet e policisë së shtetit.
- ✓ Marrjen e masave të menjëhershme për të mundësuar qasje të menjëhershme për mjek që në orët e para të privimit të lirisë ndaj personave në organet e policisë së shtetit.
- ✓ Marrjen e masave të nevojshme për personat e shoqëruar/ndaluar që të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar informacione të qarta verbale rreth të drejtave ligjore/procedurale që ata kanë që në fillim të privimit të lirisë, dhe vënia në dispozicion të kartës të të drejtave për njohjen me to.
- ✓ Marrjen e masave për plotësimin dhe saktësimin në regjistr të kohës së privimit të lirisë nga punonjësi i policisë.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka monitoruar të drejtën për organizimin e tubimeve në vazhdimësi, nëpërmjet inspektimeve të kryera në organet e Policisë së Shtetit, si dhe nëpërmjet kryerjes së hetimit administrativ lidhur me procedurat e ndjekura nga punonjësit e policisë me personat e shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar. Në lidhje me situatën e të shoqëruarve në drejtorinë dhe komisarariatet e policisë Tiranë, institucioni me *shkresën nr.K4/I62-2 prot., datë 24.12.2020* i është drejtuar SHÇBA-së në Ministrinë e Brendshme, mbi monitorimin e veprimeve policore gjatë protestave të zhvilluara *në datat 10-13 dhjetor 2020* dhe procedurat hetimore të ndjekura ndaj punonjësve të policisë që janë konstatuar në tejkalim të kompetencave dhe ushtrim dhune ndaj protestuesve.

Në përgjigje të kërkesës tonë, SHÇBA me shkresë nr.2349/1 prot., datë 18.01.2021, informon se:

¹⁵⁶ Ligji nr. 108/2014, neni 109, Shoqërimi në polici.

¹⁵⁷ Për këtë çështje Avokati i Popullit po përgatit një rekomandim të veçantë ku do të pasqyrohen të gjitha problematikat përkatëse.

- Nga strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë dhe Komisariatet e Policisë Nr.1,2,3,4 dhe 6, për datat 10, 11, 12 dhe 13 dhjetor 2020, janë shoqëruar gjithsej 354 shtetas, prej të cilëve 115 të mitur.
- Për të gjithë shtetasit e mitur janë kryer veprime verifikuese për identifikimin e tyre dhe është marrë kontakt me përfaqësuesit ligjor (prindin) dhe pasi janë këshilluar janë larguar nga mjediset e policisë.
- Për 87 shtetas (asnjë i mitur) pas kryerjes së veprimeve të para është bërë arrestimi/ndalimi dhe materialet procedurale janë referuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë.

Gjatë monitorimit në një rast është konstatuar se punonjës të Policisë së Shtetit kanë vepruar në tejkalim të kompetencave, nga ku SHÇBA ka nisur hetimin kryesisht dhe konkretisht:

- Inspektimi i iniciuar kryesisht nga SHÇBA për shoqërim të padrejtë, si dhe ushtrim dhune nga punonjës të Komisariatit të Policisë Nr.1 Tiranë, në mbrëmjen e datës 19.12.2020 të shtetasve A.S, E.M, D.M, dhe G.H, përfaqësues të Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit.
- Nga tërësia e veprimeve të kryera nga SHÇBA, rezulton se janë shkelur procedurat standarde të punës "Për rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit" miratuar me Urdhër, nr. 938 datë 24.07.2019 të DPPSH-së.
- Për këto shkelje të konstatuara SHÇBA i ka rekomanduar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, fillimin e hetimit disiplinor për 4 punonjës të Komisariatit të Policisë Nr.1, Tiranë.
- Sa i përket pretendimit për ushtrim dhune pas trajtimit të rastit dhe në mbështetje të provave të ofruara nga shtetasit dhe atyre të siguruara gjatë inspektimit, SHÇBA në përmbushje të misionit dhe detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr.70/2014, me shkresë nr.2355 prot, datë 29.12.2020 ka dërguar materialet e administruara referuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Në adresë të Shërbimit janë paraqitur gjithsej 8 ankesa me objekt ushtrimin e dhunës nga strukturat policore prej të cilave:

- Në 3 raste janë referuar materialet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Në 2 raste për 6 punonjës është sugjeruar fillimi i hetimit disiplinor.
- Në 3 raste veprimet e punonjësve të Policisë së Shtetit kanë qenë në përputhje me kuadrin ligjor.

Pavarësisht referimeve të rasteve të mësipërme, organet kompetente për shqyrtimin e tyre duhet të marrin në konsideratë deklaratën e Komisioneres së Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, Dunja Mijatović ku shprehet lidhur me përshkallëzimin e përplasjeve midis policisë dhe protestuesve pas gjuajtjes fatale me armë të një të riu nga policia gjatë orarit të ndalim-qarkullimit gjatë natës në vend, se "Autoritetet shqiptare duhet të tregojnë përmbajtje në policimin e demonstratave dhe të sigurojnë hetime të hollësishme, të pavarura dhe efektive për të gjitha pretendimet për përdorim të tepruar të forcës. Përdorim joproporcional i forcës është raportuar gjithashtu edhe në lidhje me demonstratat e tjera që u zhvilluan në Shqipëri në fillim të këtij viti,"¹⁵⁸

¹⁵⁸ Për më tepër linku: https://www.coe.int/sq/web/tirana/news/-/asset_publisher/SENehJ2ESZrW/content/albanian-authorities-must-prevent-further-police-violence-and-uphold-the-right-to-freedom-of-peaceful-assembly?inheritRedirect=false&redirect=https%3A%2F%2Fwww.coe.int%2Fsq%2Fweb%2Ftirana%2Fnews%3Fp_id%3D101_INSTANCE_SENehJ2ESZrW%26p_p_lifecycle%3D0%26p_p_state%3Dnormal%26p_p_mode%3Dview%26p_p_col_id%3Dcolumn-4%26p_p_col_count%3D1.

4.5 Monitorimi i veprimtarisë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED)

Sic kemi informuar edhe më parë, institucioni i Avokatit të Popullit ndjek me vëmendje dhe dedikim të posaçëm zbatimin e Reformës në Drejtësi në përgjithësi dhe, veçanërisht, veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (më poshtë KED). Kjo, pasi roli i institucionit të Avokatit të Popullit në këtë rast është i dyfishtë, jo vetëm si institucion Kushtetues i parashikuar për mbrojtjen dhe garantimin e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, por edhe si një institucion të cilit Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacioni për Reformën në Drejtësi, i kanë dhënë rol dhe kompetenca të posaçme në këtë proces.

Më konkretisht, neni 149/d, pika 3 e Kushtetutës, parashikon se: « ...Avokati i Popullit merr pjesë si vëzhgues në procedurën e hedhjes së shortit, si dhe në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi». Gjithashtu, sipas nenit 233, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”: “1. Mbledhjet e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi janë të mbyllura. Avokati i Popullit merr pjesë në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit. ... ».

Pra, nisur nga detyrimet e mësipërme institucioni ynë fillimisht ka qenë prezent në hedhjen e të gjitha shorteve ndër vite, për zgjedhjen e anëtarëve të KED, ku në përfundim të të cilëve, bazuar në detyrimet e parashikuara nga neni 221, pikat 7 dhe 11, si dhe neni 284 pika 6, të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, sipas të cilave: “Presidenti i Republikës, në prani të Avokatit të Popullit, përzgjedh anëtarët e Këshillit me short, midis datës 1 dhe 5 dhjetor të çdo viti kalendarik. ...”, “Avokati i Popullit bën menjëherë publik në faqen zyrtare të institucionit raportin e monitorimit të procesit të shortit”, ka hartuar e publikuar edhe raportet përkatëse. Konkluzioni i raportit tonë të monitorimit mbi procedurën e hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për vitin 2021, zhvilluar nga Presidenti i Republikës në datën 04.12.2020, ishte që ky proces u krye në përputhje të plotë me ligjin.¹⁵⁹

Po sipas detyrimeve kushtetuese dhe ligjore të sipërcituara, institucioni ynë ka marrë pjesë në të 22 (njëzet e dy) mbledhjet e KED-së të zhvilluara gjatë vitit 2020, duke u përpjekur të ushtrojë si duhet detyrat e përcaktuara nga legjislatori (mendimet e dhëna nga institucioni ynë janë publikuar të përmbledhura në proces-verbalet e mbledhjeve të KED-së).¹⁶⁰ Ne vlerësojmë punën e bërë nga KED gjatë vitit 2020, punë e cila përmblihte në vetvete jo pak problematika, për të bërë të mundur përzgjedhjen e kandidatëve të vlefshëm për t’iu paraqitur organeve të emërtesës. Gjithashtu nevoja e thekshme e vendit, për të pasur një Gjykatë Kushtetuese me kuorumin e nevojshëm për të marrë vendime, ishte një përgjegjësi e shtuar e këtij Këshilli. Rezultati i punës së KED 2020 u ndikua jo pak nga numri i ulët i kandidimeve, por edhe nga përputhshmëria e kandidaturave me kriteret e përcaktuara nga ligji, si në nivel kushtetues ashtu edhe atë ligjor. Avokati i Popullit vlerëson në të njëjtën kohë dedikimin dhe përkushtimin e anëtarëve të Këshillit të cilët arritën që me dedikim e përgjegjshmëri, të përfundonin procesin e verifikimit dhe vlerësimit të kandidatëve për të tëra vakancat në shyrtime për vitin 2020, duke ia dërguar ato organeve të emërtesës. Mbetet ende një çështje thelbësore për funksionimin e Gjykatës Kushtetuese me numrin e parashikuar nga Kushtetuta, nisja dhe përmbyllja e procesit të emërimit të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, që emërohen nga organi i emërtesës, Gjykata e Lartë.

Disa nga çështjet kryesore të karakterit administrativ funksional, të evidentuara nga institucioni ynë gjatë veprimtarisë së KED 2020, kanë qenë: *Ndërprerja disamujore e punës nga ky organ;*

¹⁵⁹ <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Hedhja%20e%20shortit%20te%20KED%20Dhjetor%202020.pdf>

¹⁶⁰ http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Procesverbale_te_mbledhjeve_6468_1.php

mosparashikimi i buxhetit të nevojshëm dhe mungesa e kapaciteteve njerëzore të nevojshëm për kryerjen e detyrës në përputhje me afatet ligjore dhe efikasitetin që kërkon ligji por edhe qytetarët.

Duke qenë se funksionimi sa më parë dhe me kapacitet të plotë i Gjykatës Kushtetuese ishte një nga kushtet që institucionet ndërkombëtare i rekomanduan vendit tonë, në kuadër të integritetit evropian, mendojmë se funksionimi i KED në mënyrë optimale, duhet të ishte prioritet dhe të adresoheshin më mirë çështjet e mësipërme.

Për sa i përket *ndërprerjes disamujore të punës* (nga 06.02.2020 – 30.06.2020), pavarësisht mungesës së ndonjë njoftimi publik të bërë nga kryetari i KED 2020, ne mendojmë se arsyeja e ndërprerjes së punës, kishte të bënte me situatën e emergjencës shëndetësore, të shkaktuar nga virusi COVID-19, por vlen për tu përmendur fakti që, ndryshe nga mjaft institucione të tjera të cilat morën masa për të vazhduar punën online, nga ana e KED 2020, nuk u bë një gjë e tillë. Ndonëse nga ana e kryetarit të atëhershëm të KED,¹⁶¹ u deklarua në media se po shqyrtohej mundësia e kryerjes së punës online, kjo çështje nuk iu shtrua për diskutim Këshillit të KED 2020, duke bërë që ky organ të mos funksiononte për më tepër se 4 muaj (për më shumë shih edhe raportin vjetor të KED 2020).¹⁶²

Kjo periudhë rezulton të mos jetë shfrytëzuar as për përgatitjen e disa akteve rregullatore të nevojshme për punën e KED. Konkretisht, në mbledhjen e KED të datës 06.02.2020, u vendos «Ngritja e një grupi pune për hartimin e rregullores së brendshme lidhur me detyrat e këshilltarëve dhe personelit administrativ të Gjykatës së Lartë të caktuar për mbështetjen e veprimtarisë së Këshillit, për veprimet e ndryshme administrative, për krijimin dhe mbajtjen e regjistrave, dokumentacionit, protokollit, arkivave dhe për sistemin e administrimit të çështjeve» (detyrim ky i parashikuar edhe nga nenin 22 i Rregullores së Brendshme të KED), por kjo Rregullore nuk u hartua gjatë vitit 2020.

Për sa i përket *buxhetit*, pavarësisht se ky problem ishte ngritur nga institucioni ynë edhe më parë, sërish për KED 2020 u përsëritën të njëjtat problem. Kështu për ta nuk pati një fond të veçantë, por shpenzimet e këtij organi vazhduan të mbuloreshin nga buxheti i Gjykatës së Lartë.

Edhe për sa i përket *ngarkesës* që përballojnë: *si anëtarët e KED*, ashtu edhe *stafi ndihmës*, konstatohet se legjislacioni ekzistues nuk parashikon lehtësira për gjyqtarët dhe prokurorët që zgjidhen anëtarë të KED. Për sa i përket stafit ndihmës të KED (këshilltarë, sekretarë), nisur nga fakti që në muajin mars 2020 nisi punë Gjykata e Lartë (e cila sipas ligjit mbështet me staf ndihmës KED), kjo vështirësoi punën e KED 2020, për shkak të nevojës që vetë Gjykata e Lartë kishte për tërë kapacitetet e saj dhe çështjeve të mbartura.

Përfitojmë nga rasti të kujtojmë se edhe për institucionin e Avokatit të Popullit, ndjekja e veprimtarisë së KED përbën një ngarkesë të konsiderueshme dhe se legjislacioni për Reformën në Drejtësi, i caktoi institucionit të Avokatit të Popullit një sërë detyrash, të cilat nuk u shoqëruan as me shtim buxheti dhe as me shtim të stafit.

- *Përpjekja e KED 2019 për kufizimin e kompetencave të institucionit të Avokatit të Popullit*

¹⁶¹ Kujtojmë se KED 2020 fillimisht drejtohej nga z. Adrian Dvorani, por pas largimit të tij si gjyqtar nga Gjykata e Lartë, drejtimin e KED 2020 e mori zv/kryetarja Vitore Tusha.

¹⁶² http://www.gjykataelarte.gov.al/web/raporti_vjetor_ked_2020_3538.pdf

Sic kemi përmendur në raportin vjetor të vitit 2019¹⁶³, KED e vitit 2019, nisi fillimisht punën me hartimin dhe miratimin e rregulloreve të saj, por gjatë hartimit të këtyre rregulloreve, ndër të tjera u vendos edhe për një çështje, e cila nuk ishin parashikuar nga ligji. Më konkretisht u vendos kufizimi i rolit dhe kompetencave të institucionit të Avokatit të Popullit, në raport me KED. Pra ndryshe nga sa ishte parashikuar në dispozitat ligjore¹⁶⁴ të cituara më sipër, Avokatit të Popullit j'u ndalua pjesëmarrja në gjithë procesin që zhvillonte KED për zgjedhjen e kandidatëve.

Institucioni ynë e kundërshtoi një parashikim të tillë që në momentin e hartimit të projektregullores, por argumentat tona ligjore nuk u morën parasysh nga KED 2019. Duke qenë se nuk pati rezultat pozitiv për të garantuar transparencë në aktivitetin e këtij Këshilli, mbledhjet e të cilit janë të mbyllura për publikun, e vetmja rrugë për të vënë në vend këtë të drejtë të shkelur, mbetej ajo gjyqësore.

Për rrjedhojë, nga ana e institucionit tonë, në datën 30 dhjetor 2019 u paraqit në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë një padi, kundër Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me objekt: Shfuqizimin e pikës 41, të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, si dhe shfuqizimi i pikave 46 dhe 62, të Vendimit nr.5 datë 2.04.2019 “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

Ndërkohë që zhvillohej ky proces gjyqësor, në muajin shkurt 2020, vendi ynë u vizitua nga një ekip i Komisionit të Venecias pranë Këshillit të Evropës, i cili ishte ftuar nga Kuvendi dhe Presidenti i Republikës për të dhënë një opinion në lidhje me emërimin e Gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese. Ky ekip i Komisionit të Venecias, në kuadër të misionit të tij faktmbledhës, pati takim edhe me institucionin e Avokatit të Popullit,¹⁶⁵ ku ndër të tjera j'u parashtruan të njëjtat argumenta që i kishim paraqitur edhe KED 2019, në lidhje me këtë çështje.

Në opinionin e tij, ky Komision i gjeti të drejta argumentat tona, ndaj edhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2020, në mbledhjen e tij të datës 30.06.2020, nisur nga Rekomandimet e bëra nga Komisioni i Venecias në Opinionin nr. 978/2020, datë 19 qershor 2020 “Për Emërimin e Gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese”, për pjesën që lidhej me veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, KED 2020 vendosi ngritjen e një grupi pune, i cili do pasqyronte këto rekomandime.

Në vijim të këtij vendimi, në mbledhjen e KED-2020, që u zhvillua në datën 10.07.2020, u miratua në mënyrë unanime, nga gjithë anëtarët e KED-se, disa ndryshime në Rregulloret e KED, të cilat ndër të tjera, hoqën edhe kufizimin për institucionin e Avokatit të Popullit, për të marrë pjesë në të gjithë veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.¹⁶⁶ Për gjithë sa më sipër, në seancën gjyqësore të datës 21.07.2020, institucioni ynë hoqi dorë nga gjykimi i padisë.

¹⁶³ Raporti vjetor 2019, faqe 122 -130.

¹⁶⁴ Neni 149/d, pika 3, e Kushtetutës dhe neni 233 i ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”

¹⁶⁵ <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/home/news/this-article-is-available-only-in-albanian-310/>

¹⁶⁶ Për me shume informacion, njoftimi per shtyp botuar ne faqen e KED: http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Mbledhja_e_KED_date_10_07_2020_7067_1.php.

Gjithashtu pas miratimit në mbledhjen e KED-së dy prej këtyre akteve (“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 4, datë 11.03.2019 të Këshillit për Emërime në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar” dhe “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 5, datë 02.04.2019 të Këshillit për Emërime në Drejtësi “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar”), u botuan edhe në Fletoren Zyrtare nr. 131, date 14.07.2020.

Gjithashtu për shkak të problematikave të konstatuara nga institucioni ynë, për punën e KED 2019¹⁶⁷, gjatë vitit 2020 institucioni ynë hartoi një raport të veçantë.¹⁶⁸ Ky raport u përfundua në Mars 2020, por për shkak të pasojave të shkaktuara nga pandemia e COVID-19, u publikua në fund të muajit Maj 2020.¹⁶⁹ Nga informacioni që ne kemi deri më sot, institucionet e mësipërme nuk janë shprehur për këtë Raport.

- *Ndjekja e proceseve gjyqësore, të zhvilluara në Gjykatën Administrative të Apelit gjatë vitit 2020, nga kandidatët e ndaluar nga KED.*

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2020, gjatë procesit të verifikimit e shqyrtimit të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, për një numër kandidatësh, vendosi ndalimin e kandidimit të tyre¹⁷⁰. Kandidatët e ndaluar nga KED 2020, duke mos qenë dakord me këto vendime, konform parashikimeve ligjore, i ankimuan ato pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë

Duke qenë se në këto procese gjyqësore, nga paditësit, institucioni ynë ishte ftuar të merrte pjesë si person i tretë, nga ana jonë, u ndoqën pothuajse të gjitha këto procese gjyqësore, duke dhënë edhe qëndrimin përkatës.

4.6 Monitorimi i institucioneve të rivlerësimit në kuadër të zbatimit të reformës në drejtësi

Institucioni i Avokatit të Popullit vijon të ndjekë me vëmendje të veçantë zbatimin e reformës në drejtësi në përgjithësi dhe, ndër të tjera, veçanërisht rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Në kuadër të rolit kushtetues e ligjor, institucioni ynë ka ndjekur dhe monitoruar zbatimin e reformës në drejtësi edhe për vitin 2020, në të tërë komponentët e vet. Në këtë pjesë do të përqëndrohemi kryesisht tek institucionet e rivlerësimit, të krijuara për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Konkretisht kemi ndjekur e monitoruar me vëmendje të veçantë seancat dëgjimore të zhvilluara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim KPK) po ashtu edhe seancat publike të zhvilluara nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim KPA), si dhe kemi ndjekur me vëmendje edhe ankimet e ushtruara nga Institucioni i Komisionerëve Publik (në vijim IKP).

Gjatë vitit 2020 kemi monitoruar 54 seanca dëgjimore të zhvilluara nga KPK, 26 seanca publike të zhvilluara në ambjentet e KPA-së në total 80 seanca.


- **KPK** për vitin 2020 ka përfunduar procesin e hetimit administrativ dhe rivlerësuar 103 subjekte, duke u shprehur me vendimet përkatëse. Nga këto vendime, 40 prej tyre janë konfirmime në detyrë, 32 shkarkime nga detyra, 28 ndërprerje procesi, pasi subjektet e rivlerësimit janë dorëhequr nga detyra (para nisjes së procesit ose edhe në fazë të avancuar të tij) dhe procesi është ndërprerë, sipas parashikimeve të pikes G të Aneksit të Kushtetutës. Ndërkohë, 2 raste janë pa vendim përfundimtar (kjo pasi subjektet e rivlerësimit kanë mbushur moshën për pension) dhe një subjekt është pezulluar nga detyra, sipas përcaktimeve të pikes E/1 të Aneksit të Kushtetutës.

¹⁶⁷ Kujtojmë që KED është një organ që rinovohet çdo vit.

¹⁶⁸ Ky raport iu dërgua Kuvendit, Presidentit të Republikës dhe Kryetarit të Këshillit të Ministrave.

¹⁶⁹ <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raport%20per%20veprimtarine%20e%20KED%202019.pdf>


¹⁷⁰ Për më shumë hollësi shih pikën 5.1 dhe 5.2 të Raportit vjetor për veprimtarinë e KED për vitin 2020.



Paraqitja grafike e vendimeve të KPK për vitin 2020.


- **Institucioni i Komisionerit Publik (IKP)** ka administruar një numër prej 105 vendimesh për vitin 2020 dhe në zbatim të detyrave të tij kushtetuese e ligjore ka proceduar, duke i shqyrtuar këto vendime dhe ka arritur në vendimet përfundimtare, si më poshtë:

- 16 ankime për vitin 2020;
- ka shpallur 89 vendime mosankimi.



Paraqitja grafike e vendimeve të IKP-së përgjatë ushtrimit të detyrës në vitin 2020.

- **Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA)** për vitin 2020 ka regjistruar 63 çështje dhe ka dhënë 42 vendime në total.




Paraqitja grafike e veprimtarisë së KPA për vitin 2020.

- **Gjetjet mbi monitorimin e seancave dëgjimore pranë KPK dhe atyre publike pranë KPA.**

Përsa i përket veprimtarisë së KPK-së, nëse do t'i referohemi veprimtarisë së këtij të fundit në mënyrë kronologjike, pra që nga shpallja e vendimit të parë, konstatohet se për vitin 2018 janë dhënë 95 vendime nga ky institucion dhe e shprehur në përqindje rreth 11.875% e tyre, ndërsa për vitin 2019 janë dhënë një numër prej 126 vendimesh dhe e shprehur në përqindje rreth 15.75 % e tyre.


Nga viti 2018 në vitin 2019 shohim një trend në rritje të numrit të subjekteve të rivlerësuar, por jo i mjaftueshëm ky numër për përfundimin e procesit brenda afatit të përcaktuar në ligj e aneksin e kushtetutës, sikurse kemi përmendur edhe në raportin vjetor të vitit 2019. Ndërkohë, sikurse edhe parashtruam më lart për vitin 2020 rezulton një numër në ulje i vendimeve/subjekteve të rivlerësuar, kjo pasi për vitin 2020 rezulton të jenë rivlerësuar 103 subjekte rivlerësimi. E shprehur kjo në përqindje 13,26 % të numrit total të subjekteve të rivlerësimit. Megjithatë, në vlerësimin e ecurisë së procesit të rivlerësimit për vitin 2020, duhet të kemi parasysh edhe situatën pandemike të shkaktuar nga COVID-19, e cila mund të justifikojë uljen e vendimarrjeve krahasuar me vitin paraardhës.



Paraqitja grafike e numrit të subjekteve të rivlerësimit nga KPK gjatë 3 viteve.

KPK është ngritur si institucion dhe ka marrë funksionet e tij zyrtarisht në Qershor 2017, pra përreth tre vite e gjysëm dhe gjendet drejt fundit të mandatit të tij zyrtar. Deri në 31.12.2020 duhet të ishin rivlerësuar rreth 573 subjekte rivlerësimi, ndërkohë që nga marrja e detyrës së këtij institucioni numri total i vendimeve të rivlerësive është 324. E shprehur në përqindje rezulton se janë rivlerësuar 40.5% e subjekteve të rivlerësimit deri në datën 31.12.2020, ndërkohë që nëse do duhej që rivlerësimi i subjekteve të përfundonte brenda afatit të përcaktuar, duhet të ishin vetuar 71.6% e subjekteve deri në këtë afat. Ky numër nuk është i mjaftueshëm për përfundimin e procesit të rivlerësimit brenda afatit ligjor të përcaktuar në kushtetutë dhe Ligjin 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Neni 70/1 i këtij ligji parashikon:

“Institucionet e rivlerësimit pushojnë së funksionuari sipas nenit 179/b, pika 9, të Kushtetutës.”, ndërsa neni 179/B, pika 8 e Kushtetutës, parashikon: *“Mandati i anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerit Publik është 5 vjet nga data e fillimit të funksionimit tyre”*. Nëse i referohemi mesatares së gjithë viteve, pra të periudhës nga marrja e mandatit deri në datën 31.12.2020, rezulton se me këtë ritëm do duheshin 8.6 vite për përfundimin e procesit të rivlerësimit.




Paraqitja grafike e ecurisë së procesit të rivlerësimit në KPK nga marrja e mandatit të tij deri në 31.12.2020.

Ndësa përse i përket vitit 2020 (vitit raportues), ku rezulton se një numër total vendimesh prej 103, në rastin më të mirë dhe nëse mendojmë në mënyrë hipotetike se dhe për vitet në vazhdim do të ecet me këto ritme dhe do të kemi fatin që subjekte të tjera do të dorëhiqen apo do të mbushin moshën për pension, do të duhej të paktën 6 vite të tjera që procesi të përfundonte. Por nëse do t'i referohemi ecurisë së deritanishme të këtij procesi dhe të njëjtit trend vendimarrjesh, atëherë do të duheshin të paktën edhe 4.6 vite që procesi të përfundonte, pra, edhe tre vite plus pas mbarimit të mandatit të këtij institucioni. Sa më sipër, rezulton se kjo vjen në kundërshtim edhe me opinionin e Komisionit të Venecias, lidhur me këtë pikë, ku dha opinion për reformën në drejtësi duke sugjeruar një kohëzgjatje prej 5 vitesh të këtij procesi.

- Gjatë vitit 2020 u miratua rritja e fondit për institucionet dhe strukturat e vetingut nga buxheti i shtetit, duke përfshirë edhe rritjen e buxhetit për këtë institucion. Ky shtim i buxhetit në favor të KPK-së dhe institucioneve të tjera është akorduar me qëllim shtimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe intensifikimin e punës. Edhe institucioni i Avokatit të Popullit, në raportin vjetor të vitit 2019 ka shprehur qëndrimin e tij për shtimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore tek institucionet e rivlerësimit. Kjo gjë na bën të kemi pritshmëri pozitive në rritjen e numrit të vendimarrjeve dhe përfundimin e procesit në një afat kohor më të shkurtër.

- **Në lidhje me zhvillimin e seancave publike.** Nëse do t'i referohemi edhe veprimtarisë së këtij të fundit në mënyrë kronologjike, konstatohet se për vitin 2018 janë regjistruar 40 çështje dhe dhënë 12 vendime. Nëse e shprehim në përqindje rezulton se për vitin 2018 janë dhënë vendime vetëm për 30% të çështjeve të regjistruara. Ndërsa për vitin 2019 janë regjistruar 62 çështje dhe janë dhënë një numër prej 34 vendime dhe e shprehur në përqindje rezulton se nga çështjet e mbartura dhe ato të regjistruara për këtë vit janë dhënë vendime për rreth rreth 37.7

% të numrit total të çështjeve të administruara. Ndërkohë, përsa i përket vitit raportues, pra vitit 2020, rezulton se janë regjistruar 63 çështje dhe me një vendimmarrje prej 42 vendimesh. Edhe në këtë rast duket se jemi shumë larg ritmeve me të cilat ky institucion duhet të ecë, nëse i referohemi përqindjeve të vendimmarrjeve dhe çështjeve të regjistruara plus ato të mbartura nga viti paraardhës. Për vitin 2020 janë dhënë vendime vetëm për 33% të çështjeve të administruara.



Paraqitja grafike e numrit të subjekteve të rivlerësimit nga KPA gjatë 3 viteve.

Nga të dhënat statistikore që disponojmë duket se edhe ky institucion rivlerësimi ka ritëm mjaft të ulët në procesin e rivlerësimit të subjekteve dhe nëse do ecet me këto ritme do të duhej kohë shumë më e gjatë se ajo e parashikuar në ligjin 84/2016, për mbarimin e mandateve të komisionerëve apo gjyqtarëve për përfundimin e procesit. Në fakt është e vështirë të bëhet një parashikim në këtë rast se sa do të zgjaste procesi i rivlerësimit nëse procedohet me këto ritme, pasi nuk mund të parashikohet numri i vendimeve të konfirmimit të KPK-së të cilat nuk do të ankimohet nga IKP apo ato të shkarkimit të subjekteve që mund të ankimohen nga vetë subjektet. Por një gjë është e sigurtë, që procesi në këtë institucion po ecën me ritme shumë të ngadalta, kjo referuar numrit të vendimeve.

Ndërsa përsa i përket veprimtarisë së IKP-së, e parë në mënyrë kronologjike, nga marrja e mandatit deri në datën 31.12.2020, rezulton që për vitin 2018 ky institucion ka ushtruar ankim ndaj 16 vendimeve të KPK-së, ndërsa për 57 vendime ka vendosur mosankimin e tyre. Për vitin 2019 ky institucion ka ushtruar ankim ndaj 13 vendimeve, ndërsa për 114 vendime ka vendosur mosankimin e tyre. Kurse për vitin raportues, pra vitin 2020 rezulton se ka ushtruar ankim ndaj 16 vendimeve dhe ka vendosur për të mos ushtruar ankim ndaj 89 vendimeve. Ndërkohë, ajo që evidentohet është fakti që subjektet e rivlerësimit ushtrojnë ankim pothuaj ndaj të gjitha vendimeve të KPK-së që kanë vendosur shkarkimin e tyre.



Paraqitja grafike e veprimtarisë së IKP-së përgjatë viteve 2018-2020.

Nga sa parashtruam më lart lidhur me veprimtarinë e institucioneve të rivlerësimit për vitin 2020, një gjë është e sigurtë dhe larg çdo parashikimi ligjor këto institucione e kanë të pamundur të përfundojnë veprimtarinë e tyre brenda afateve të parashikuara nëse do të vijojnë të punojnë me këto ritme.

4.7 Raporti Alternativ në kuadër të zbatimit të Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), për periudhën 2016-2020

Raporti Alternativ i përgatitur nga institucioni i Avokatit të Popullit përbën një vlerë të shtuar në pasqyrimin real të situatës së të drejtave të grave në vendin tonë, të statusit të përmbushjes së detyrimeve të parashikuara në Konventën CEDAW nga ana e shtetit shqiptar, si edhe nivelit të përmbushjes së rekomandimeve të Komitetit CEDAW në përfundim të Sesionit të katërt të raportimit nga ana e Shqipërisë.

Raporti evidenton aspektet kyç të situatës së të drejtave të grave në lidhje me aksesin në drejtësi dhe ndihmën juridike të garantuar nga shteti, makinerinë kombëtare për avancimin e grave, dhunën me bazë gjinore kundër grave, aksesin e grave në të drejtat ekonomike dhe sociale dhe situatën e grave në zonat rurale dhe grupet e pafavorizuara. Për secilën prej këtyre fushave, analiza vlerësuese e Avokatit të Popullit përmbillet me ofrimin e rekomandimeve për përmirësimin e situatës në vitet në vazhdim.

Rekomandimet u drejtohen autoriteteve shqiptare në nivelin qendror dhe lokal me qëllim përmirësimin e kornizave ligjore dhe të politikave si dhe zbatimin e tyre për mbrojtjen e të drejtave të grave.

➤ Gjetjet e raportit lidhur me Aksesin në Drejtësi dhe Ndhmën Ligjore të Garantuar nga Shteti

Kuadri ligjor në sferën e aksesit në drejtësi është përmirësuar. Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, i cili hyri në fuqi nga 1 qershor 2018, zgjeroi kategorinë e grave vulnerabel që mund të përfitojnë ndihmë juridike. Viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe abuzimit seksual përfitojnë ndihmë juridike falas pavarësisht të ardhurave. Megjithatë, miratimi me vonesë të pajustificuar i akteve nënligjore

dhe ngritja jashtë afateve e mekanizmave institucionale penguan garantimin në praktikë të ndihmës juridike për gratë, duke vënë në rrezik funksionimin e sistemit të ndihmës ligjore për një pjesë të madhe të tyre. Mungon alokimi i mjaftueshëm i fondeve shtetërore për garantimin e ofrimit të ndihmës ligjore. Shkalla e ulët e ndërgjegjësimit, mungesa e shtrirjes së klinikave të ofrimit të ndihmës ligjore në të gjithë vendin, diskriminimi i shumëfishtë dhe gjendja ekonomike jo e favorshme kufizojnë shkallën e aksesit në drejtësi të grave të komunitetit rom, egjiptian, LGBTI, grave me aftësi të kufizuara dhe grave të moshuara. Nevojitet veprimi i shpejtë i Ministrisë së Drejtësisë për të marrë masa me qëllim që aksesit në drejtësi të jetë i mundshëm për t'u arritur nga të gjitha grupet e grave vulnerabël pavarësisht aftësisë së kufizuar, nivelit arsimor, gjendjes ekonomike apo statusit social.

Ndryshimet ligjore në sferën e shërbimit përmbartimor privat dhe në ligjin nr. 9669 datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", me gjithë efektet pozitive, nuk e kanë ndryshuar situatën e grave në lidhje me sigurimin e të drejtave të tyre përmes ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Shqetësuese mbetet mosekzekutimi i vendimeve në lidhje me detyrimin për pagimin e pensionit ushqimor nga ana e ish-bashkëshortëve; detyrimi për të takuar fëmijët apo pjesëtimi i pasurisë. Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të Urdhërave të Mbrojtjes dhe Urdhërave të Menjëhershëm të Mbrojtjes ka rritur rrezikun për jetën dhe shëndetin e grave viktimë të dhunës me bazë gjinore duke lejuar ripërsëritjen e akteve të dhunës në marrëdhëniet familjare. Nevojitet rritja e shkallës së reagimit të strukturave përgjegjëse, duke përfshirë institucionin e përmbartimit me qëllim ekzekutimin plotësisht dhe pa vonesë të vendimeve gjyqësore për të siguruar të drejtat e grave. Me përparësi shihet trajnimi i specializuar dhe rritja e kapaciteteve profesionale të përmbartuesve, në lidhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe trajtimin me profesionalizëm të të gjitha kërkesave për ekzekutim të ngritura nga gratë. Nevojitet rritja e vëmendjes së Ministrisë së Drejtësisë për të monitoruar në vazhdimësi respektimin e afateve ligjore në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë që përmbajnë UMM/UM dhe marrja e masave për zbatimin e sanksioneve për subjektet dhe/ose përmbartuesit që nuk ekzekutojnë/pengojnë zbatimin në kohë të vendimeve gjyqësore.

Avokati i Popullit vlerëson pozitivisht nismën e ndërmarrë nga qeveria shqiptare në lidhje me parashikimin e parimit të barrës së përmbysur të provës gjatë ndryshimit të dispozitave të Kodit të Punës dhe Kodit të Procedurës Administrative në RSH. Megjithatë, ky parim nuk gjen zbatim në Kodin e Procedurës Civile. Gjyqtarët nuk e zbatojnë në të gjitha rastet dispozitën e barrës së përmbysur të provës. Nevojitet adresimi i këtij ndryshimi në KPrC dhe marrja e masave për rritjen e kapaciteteve të gjyqësorit në kuadër të zbatimit korrekt të parashikimeve ligjore.

➤ *Gjetjet e raportit lidhur me Makinerinë Kombëtare për Avancimin e Grave*

Strukturat e barazisë gjinore kanë nevojë të madhe të forcohen. Ristrukturimi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u pasua me reduktim të strukturës së mëparshme të Barazisë Gjinore në kundërshtim me objektivat strategjike të shtetit shqiptar. Mungojnë nëpunësit gjinorë të posaçëm në të gjitha ministrinë dhe bashkitë e vendit.¹⁷¹ Në nivel vendor mungon ndarja e kompetencave të Nëpunësit Gjinnor nga punonjësit social apo koordinatorët e dhunës në familje. Rritja e buxhetit në lidhje me programet e barazisë gjinore dhe parashikimi i mbulimit buxhetor për rritjen e kapaciteteve dhe trajnimin e vazhdueshëm të Nëpunësit Gjinnor është i nevojshëm.

¹⁷¹ Nëpunësit e barazisë gjinore në nivel qendror janë 11 persona nëpër ministri si dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe INSTAT, të cilët përveç detyrës së tyre funksionale janë dhe pika kontakti për barazinë gjinore. Ndërkohë, në nivel vendor janë 61 nëpunës gjinorë dhe koordinator vendor kundër dhunës, shumica e të cilëve nuk janë me kohë të plotë për çështjet e barazisë gjinore, por janë kryesisht koordinator vendor kundër dhunës në familje. Këta persona zakonisht mbulojnë edhe detyra të tjera si ndihmën ekonomike, personat me aftësi të kufizuar, fëmijët, etj.

Periudha 2016-2018 është shoqëruar me rritjen e vëmendjes së qeverisë shqiptare në drejtim të përfshirjes së Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjnor në dokumentet strategjike dhe kuadrin ligjor dhe atë nënligjor. Kjo solli një rritje të numrit të programeve buxhetore që përfshijnë Buxhetimin e Përgjigjshëm Gjnor dhe rritjen planifikimit të shpenzimeve buxhetore për realizimin e tyre. Megjithatë, shpenzimet mbi adresimin e pabarazive gjinore dhe luftën ndaj dhunës me bazë gjinore zënë një zë pothuajse të papërfillshëm në buxhetin e përgjithshëm vjetor të institucioneve. Mungon matja e ndikimit të programeve buxhetore të planifikuara në arritjen e barazisë gjinore, përmirësimin e gjendjes së grave/burrave dhe reduktimin e varfërisë për secilën gjini. Mungojnë raportet e monitorimit të realizimit faktik të Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjnor në nivel qendror dhe lokal. Institucionet nevojitet të mbajnë të dhëna të ndara gjinore për çdo produkt që buxhetojnë me qëllim përdorimin e drejtë dhe efektiv të fondeve publike dhe kryerjen e analizave të detajuara të hendeqeve gjinore/politike/financiare/ligjore dhe institucionale që pengojnë implementimin. Nevojitet kryerja e analizës gjinore nga çdo institucion buxhetor si fazë paraprake e hartimit të Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjnor me qëllim identifikimin sa më real të nevojave, prioriteteve, kufizimeve dhe problemeve të veçanta të burrave dhe grave.

➤ *Gjetjet e raportit lidhur me Dhunën me Bazë Gjinore Kundër Grave*

Periudha 2016-2020 është karakterizuar nga ndryshime të rëndësishme ligjore në fushën e parandalimit dhe luftimit të dhunës me bazë gjinore. Avokati i Popullit mbështet ngritjen e Linjës Kombëtare të Këshillimit për gratë dhe vajzat viktime të dhunës në nivel kombëtar dhe parashikimin e ngritjes së këtyre linjave edhe në nivel vendor. Megjithatë, mungon funksionimi i tyre me kohë të plotë në të gjithë vendin. Gratë vulnerabël, sidomos ato të grupeve të pafavorizuara, pothuajse nuk janë të informuara për ekzistencën e linjave këshilluese. Niveli i raportimit të dhunës me bazë gjinore, veçanërisht ngacmimi seksual dhe dhuna seksuale, mbetet shumë i ulët. Mungon mbledhja e të dhënave sistemike dhe të ndara nga pikëpamja gjinore për të gjitha format e dhunës me bazë gjinore. Avokati i Popullit thekson nevojën e alokimit të nevojshëm të fondeve financiare për adresimin efektiv të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Nëpunësve të ngarkuar me këshillimin telefonik të viktimave të Dhunës me Bazë Gjinore duhet të trajnohen. Qendrat e ndihmës juridike falas duhet të ngrihen në çdo bashki dhe të jenë të arritshme nga të gjitha kategoritë e grave vulnerabël.

Iniciativa për krijimin e një rrjeti të koordinuar të mekanizmave për mbrojtjen nga dhuna në familje në Shqipëri nuk mjafton për garantimin e mbrojtjes së grave nga të gjitha format e dhunës. Mekanizmi i referimit të dhunës mungon pothuajse në gjysmën e bashkive të vendit. Shqetësuese mbetet mbështetja e kufizuar financiare e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të Dhunës nga buxheti i shtetit dhe zëvendësimi i shpeshtë të burimeve njerëzore të këtij Mekanizmi. Alokimi i fondeve të mjaftueshme dhe rritja e kapaciteteve të punonjësve të qendrave të trajtimit të viktimave të dhunës në familje është i nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave të grave të dhunuara dhe riintegrimin e tyre me dinjitet në shoqëri.

Në vitin 2018, Ligji për dhunën në familje¹⁷² pësoi ndryshime të rëndësishme me qëllim krijimin e garancive më të mëdha të mbrojtjes për viktimat e dhunës në familje. Përveç Urdhërave të Mbrojtjes dhe Urdhërave të Menjëhershëm të Mbrojtjes, u parashikua lëshimi i Urdhërit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme (UMPM). Periudha 2016-2019 shënon rritje të numrit të kërkesave për Urdhëra të Mbrojtjes dhe Urdhëra të Menjëhershëm të Mbrojtjes për dhunën në familje. Megjithatë, shqetësuese mbetet mungesa ose kufizimi i Urdhërave të Mbrojtjes dhe Urdhërave të Menjëhershëm të Mbrojtjes për format e tjera të dhunës me bazë gjinore. Në një pjesë të rasteve, Urdhërat e Mbrojtjes dhe Urdhërat e Menjëhershëm të Mbrojtjes nuk ekzekutohen nga ana e autoriteteve. Nevojitet monitorimi i zbatimit të Urdhërave të

¹⁷² Ligji nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhinet familjare”, i ndryshuar.

Mbrojtjes dhe Urdhërave të Menjëhershëm të Mbrojtjes dhe marrja e masave penalizuese për nëpunësit që kanë penguar/vonuar zbatimin e tyre. Gjykatat duhet që të kenë kujdes në arsyetimin e vendimeve për lëshimin e Urdhërave të Mbrojtjes dhe Urdhërave të Menjëhershëm të Mbrojtjes me qëllim që vendimet e tyre të mos bëhen shkak për vonesën dhe/ose moszbatimin e vendimeve gjyqësore. Punonjësit e Policisë së Shtetit, që trajtojnë rastet e dhunës në familje duhet të trajnohen në mënyrë të vazhdueshme në identifikimin e rasteve të dhunës në familje, vlerësimin e riskut dhe intervistimin e viktimës e të dhunuesit.

➤ *Gjetjet e raportit lidhur me Aksesin e Grave në të Drejtat Ekonomike dhe Sociale*

Ndryshimet ligjore 2016-2019 përmirësuan pozitën juridike të grave në fushën e shërbimeve ekonomike dhe mbrojtjes sociale. Ligji 59/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” përcaktoi si kategori përfituese nga ndihma ekonomike viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare dhe viktimat e trafikimit. Tavani i masës së ndihmës ekonomike u hoq me qëllim rritjen e përfitimit të saj. Ligji Nr. 22/2018 “Për strehimin social” përcaktoi si subjekte me përparësi për të përfituar nga shërbimet e strehimit viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit, vajzat nëna.

Megjithatë, problem ende shumë thelbësor mbetet mungesa e përcaktimit të minimumit jetik në Shqipëri dhe masa e ulët e ndihmës ekonomike. Sistemi i dixhitalizuar i ndihmës ekonomike ka sjellë paqartësi dhe konfuzion jo vetëm tek gratë dhe vajzat në nevojë, por edhe tek nëpunësit publikë që e përdorin atë. Mungojnë të dhënat e ndara nga pikëpamja gjinore në lidhje me përfituesit nga Ndihma Ekonomike dhe strehimi social, gjë që sjell vështirësi në kuadër të analizës së statusit të mbrojtjes së të drejtave ekonomike-sociale të grave dhe vajzave në përputhje me objektivat strategjike. Problem mbetet mungesa e ofrimit të zgjidhjes për gratë e pastreha kryesisht në zonat rurale, por edhe në periferitë e qyteteve. Përfitimi i viktimave të dhunës/trafikimit nga e drejta e strehimit social apo bonuset e qirave mbetet i ulët. Deri në vitin 2018, asnjë prej tyre nuk kishte përfituar ndonjëherë nga skemat e strehimit social. Hartimi i legjislacionit në fushën e strehimit social duhet të shoqërohet me rritjen e buxhetit si dhe me mbështetjen që duhet të japë qeverisja qendrore ndaj organeve të qeverisjes vendore me projekte sociale të strehimit. Shërbimet e Ndihmës Ekonomike duhet të koordinohen me programet e nxitjes së punësimit të grave dhe vajzave vulnerabël në përputhje me qëllimet strategjike të shtetit shqiptar në këtë fushë.

Pavarësisht parashikimeve ligjore në lidhje me mbrojtjen e të drejtave pronësore të grave në mënyrë të barabartë me burrat, zbatimi praktik i kuadrit ligjor nuk ka rezultuar gjithmonë në mbrojtje të kësaj të drejte. Prona e përbashkët nuk regjistrohet në çdo rast në emër të të dy bashkëshortëve. Më problematike ka qenë gëzimi i kësaj të drejte për gratë në zonat rurale. Për sa më sipër, përfshirja në ligjin Nr. 111/2018 “Për Noterinë” dhe në ligjin Nr. 111/2018, “Për kadastrën” e ndryshimeve me fokus garantimin e parimit të barazisë gjinore dhe mbrojtjen e grave nga diskriminimi për shkak të gjinisë është pozitive. Megjithatë, problematike mbetet rritja e kapaciteteve të profesionistëve të së drejtës dhe nëpunësve të ngarkuar me detyrimin për zbatimin e ligjit, në lidhje me informimin dhe trajnimin e tyre mbi rritjen e kuadrit ligjor në fushën e të drejtave pronësore të grave dhe aplikimin korrekt të tij. Gjithashtu, nevojitet rritja e ndërgjegjësimin të grave sidomos në zonat rurale dhe të largëta në lidhje me ndryshimet ligjore.

➤ *Gjetjet e raportit lidhur me Situatën e Grave në Zonat Rurale dhe Grupet e Pafavorizuara*

Avokati i Popullit vlerëson masat ligjore dhe politikat strategjike të ndërmarra nga shteti shqiptar gjatë periudhës 2016-20, me fokus të veçantë fuqizimin ekonomik të grave në zonat rurale. Megjithatë, gratë në zonat rurale vazhdojnë të vuajnë kufizimin e aksesit në të drejta, mallra dhe shërbime për shkak të mungesës së infrastrukturës, diskriminimit gjinor, mentalitetit

patriarkal apo mungesës së shërbimeve të mundshme për t'u arritur, sidomos në zonat e largëta. Problem mbetet punësimi informal i grave në këto zona si edhe garantimi i aksesit të grave rurale në shërbimet e kujdesit shëndetësor, shërbimet e ndihmës ligjore falas si edhe nga e drejta për arsim. Aksesit në furnizimin me ujë të pijshëm është i kufizuar për gratë në zonat rurale dhe gratë rome/egjiptiane. Nevojitet ngritja e qendrave të kujdesit shëndetësor në të gjitha njësitet administrative dhe përmirësimi i infrastrukturës së zonave rurale me qëllim rritjen e aksesueshmërisë dhe nivelit të sigurisë në këto zona. Rekomandohet shtimi i përpjekjeve të të gjitha institucioneve në nivel qendror dhe lokal për rritjen e ndërgjegjësimit të grave në zonat rurale në lidhje me të drejtat e tyre dhe garancitë ligjore.

Në krahasim me grupet e tjera, gratë pjesë e grupeve vulnerabël gëzojnë status më të kufizuar në të drejtat e tyre dhe qasjes në shërbime, për shkak të moszbatimit efektiv të kuadrit ligjor në fuqi. Me gjithë ndryshimet ligjore, për shumicën e tyre barrierat në lidhje me qasjen në punësim, arsim, strehim apo mbrojtje sociale janë të mëdha. Në zonat rurale kufizimet për këto kategori janë akoma më të mëdha. Mungesa e një kuadri ligjor për mbrojtjen e të drejtave të të moshuarve në Shqipëri sjell pengesa në lidhje me ofrimin e garancive ligjore për mbrojtjen e të drejtave të kësaj kategorie. Situata paraqitet problematike edhe për gratë e dënuara apo ato me probleme të shëndetit mendor. Nevojitet rritja e aksesit të grave me aftësi të kufizuar, rome, egjiptiane, gra të moshuara kufizuar në qendrat e kujdesit shëndetësor. Është e nevojshme rritja e fondeve për përmirësimin e kushteve dhe trajtimin e denjë të grave të dënuara apo paraburgosura si edhe të grave të hospitalizuara në qendrat e shëndetit mendor. Hartimi i projekt ligjit për moshën e tre është imediat. Në të njëjtën kohë, nevojitet rritja e nivelit të arsimit të grave rome/egjiptiane, fuqizimin ekonomik të tyre përmes përfshirjes në skemat e nxitjes së punësimit dhe marrjen e masave për të ulur numrin e grave rome/egjiptiane si pjesë e viktimave të ngacmimeve seksuale apo dhunës me bazë gjinore.

4.8 Operacionet e përbashkëta me FRONTEX për rikthimin e shtetasve të parregullt nga vendet e BE-së

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) në zbatim të marrëveshjes të lidhur midis Avokatit të Popullit dhe FRONTEX, që prej vitit 2014, është pjesë e grupit monitorues të procesit të riatdhesimit të shtetasve shqiptarë nga vende të BE dhe shteteve të zonës Schengen, duke *monitoruar në mënyrë të pavarur operacionet e kthimit të shtetasve nga BE në vendet e origjinës*. Në këtë mënyrë, kjo strukturë luan rolin e vet ligjor dhe kushtetues duke përbushur njëkohësisht dhe Direktivën 2008/115/EC¹⁷³ të Parlamentit Evropian për standardet e përbashkëta ndërmjet vendeve të BE me vendet e treta.

Nga eksperiencia disa vjeçare e monitorimit të këtij operacioni, standardet dhe procedurat e ndjekura nga shtetet anëtare të BE dhe FRONTEX, kanë evoluuar pozitivisht në aspektin e respektimit të të drejtave të shtetasve që riatdhesohen në Shqipëri nga këto vende, të cilët janë të pajisur me vendim për rikthim të detyruar.

Viti 2020 ka qenë specifik për shkak të kufizimeve të fluturimeve të ndërsjellta me vendet e BE-së, si pasojë e marrjes së masave në kuadër të situatave emergjente për parandalimin e sëmundjes infektive COVID-19.

Pavarësisht situatës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë Kufitare dhe të Migracionit dhe FRONTEX nga *25 operacione të zhvilluara gjatë vitit 2020*, MKPT ka qenë pjesë e grupit të

¹⁷³ Direktiva 2008/115/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 dhjetor 2008, parashikon standardet dhe procedurat e përbashkëta në shtetet anëtare për kthimin e shtetasve të vendeve të treta që qëndrojnë në mënyrë të paligjshme në këto vende.

monitorimit në 10 operacione të riatdhesimit vullnetar e të detyruar të shtetasve shqiptarë nga vendet e BE-së dhe konkretisht Francës.

Monitoruesi kombëtar i MKPT-së në operacionet e rikthimit të shtetasve të parregullt, asiston kqyrjen dhe dorëzimin e dokumentacionit për secilin shtetas nga policia franceze, përfaqësuesit të policisë së kufirit dhe migracionit të policisë së shtetit. Nga ana jonë, kontrollohet me kujdes nëse shtetasit që do të riatdhesohen janë të pajisur me vendim të formës së prerë për rikthimin e tyre në Shqipëri, si dhe nëse janë njohur apo jo me këtë vendim, përmes firmosjes të vendimit nga secili shtetas.

Përfaqësuesi i MKPT-së zhvillon intervista me këta shtetas para nisjes dhe gjatë udhëtimit në bord, lidhur me kushtet e trajtimit në qendër, nëse janë të njohur me vendimin për rikthimin e tyre, si dhe nëse janë të informuar për procedurat e shoqërimit të detyruar gjatë imbarkimit dhe fluturimit të tyre për në atdhe. Gjatë intervistimit, shtetasit kanë ngritur shqetësimin për cilësinë e ushqimit gjatë ditëve të qëndrimit në qendër, si dhe pamundësinë e tyre për të apeluar vendimin për largimin apo dëbimin e detyruar nga vendet e BE-së.

Përfaqësuesit e MKPT-së, në takimet e zhvilluara me përfaqësuesit e FRONTEX dhe të Drejtorisë së Policisë Kufitare dhe të Migracionit, kanë sugjeruar marrjen e masave për të garantuar kthimin në mënyrë njerëzore duke respektuar plotësisht të drejtat themelore të emigrantëve shqiptarë sipas standardeve të BE-së, si dhe legjislacionit shqiptar.

Si rezultat i kontakteve të vazhdueshme dhe sugjerimeve të dhëna në rolin e monitoruesve kombëtar të MKPT-së, FRONTEX konsideroi të rëndësishme propozimet tona për vendosjen e përkthyesit në gjuhën shqipe dhe mjekut për kryerjen e vizitave mjekësore në qendrat e grumbullimit të emigrantëve të paligjshëm, bashkë me grupin e përbashkët të monitorimit të FRONTEX, për të asistuar shtetasit shqiptarë para nisjes për në atdhe.

Pavarësisht progresit të bërë në këtë drejtim, mbetet ende problematikë fakti që shtetasit shqiptarë që rikthehen, nuk kanë shumë informacion në lidhje me marrjen e vendimit dhe mënyrën e ekzekutimit për rikthimin e detyrueshëm të tyre, nga vendet e BE-së për në vendin tonë.

Gjithashtu, problematikat më të mëdha për shtetasit e rikthyer, fillojnë me mbërritjen e tyre në atdhe, për shkak të mungesës së ri-integrimit të tyre në jetën shoqërore, sociale dhe ekonomike, si dhe koha e gjatë e ndalimit për të hyrë dhe lëvizë lirshëm e këtyre shtetasve në vendet e BE-së, për një periudhë nga 1 deri në 10 vjet për shtetas të veçantë. Por, veç kësaj mase kufizuese, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.805, datë 01.08.2017 “Për forcimin e kontrollit të shtetasve shqiptarë që kalojnë kufirin shtetëror”, këtyre shtetasve ju ndalohej lëvizja edhe në drejtim të vendeve që nuk janë pjesë e BE-së.

Institucioni i Avokatit të Popullit, sapo është vënë në dijeni të këtij fakti nga ankesat e këtyre shtetasve, nisur nga e drejta themelore universale që gëzon çdo shtetas për tu larguar dhe rikthyer lirisht në vendin e tij,¹⁷⁴ u ka rekomandur institucioneve qëndrore shtetërore si drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Brendshme, shfuqizimin e urdhërit të lartpërmendur.

Ky urdhër sipas përgjigjes të këtyre institucioneve është shfuqizuar, por ka hyrë menjëherë në fuqi Urdhëri Nr.641, datë 20.12.2019 i Ministrit të Brendshëm duke ju ndaluar lëvizjen

¹⁷⁴ Neni 38/2 të Kushtetutës përcakton se: “Askush nuk mund të pengohet të dalë lirisht jashtë shtetit”. Neni 13, pika 2, e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, përcakton se: “Çdo person ka të drejtë të largohet nga çdo vend, përfshirë edhe vendin e tij, si dhe të kthehet në vendin e tij”. Neni 2, pika 2, e Protokollit nr.4 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, përcakton se: “Çdo person është i lirë të largohet nga çdo vend, duke përfshirë edhe të tijin”.

qytetarëve që nuk plotësojnë kushtet e udhëtimit për hyrjen dhe qëndrimin në vendet e BE-së dhe zonës Shengen, si dhe në vendet jashtë BE-së.

Një problematikë tjetër e ndeshur nga ankesat e disa shtetasve që kanë “*Ekspuls*” dhe kërkojnë të kalojnë kufirin me qëllim për të lëvizur jashtë vendit për arsye të ndryshme, lidhet me faktin se ata nuk marrin asnjë informacion nga punonjësit e policisë në pikat kufitare për arsyet e kthimit apo ti informojnë ata për kohën e skadimit të kësaj mase kufizuese.

Ndërkohë, një problem ende për tu zgjidhur dhe që kërkon angazhimin e Qeverisë Shqiptare, është pamundësia e këtyre shtetasve për të ndjekur procedurën e apelimit të kësaj mase administrative në vendet e BE-së dhe jo vetëm, që e kanë vendosur këtë masë kufizuese, pasi atyre nuk j’u lejohej të hyjnë për një periudhë

KREU 5

Bashkëpunimi

5.1 Bashkëpunimi me institucionet e administratës publike dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve të AP-së

Roli i institucioneve të pavarura është kyç në një demokraci funksionale pasi ato *janë shtylla kurrizore e një shteti dhe shoqërie demokratike*, në funksionin e tyre për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit që mbron të drejtat dhe liritë themelore.

Institucioni i Avokatit të Popullit, me qëllim përmirësimin e funksioneve të ekzekutivit dhe për mbrojtjen e interesit publik, nxjerr rekomandime por nuk ka kompetenca për të detyruar zbatimin e tyre. Prandaj, roli i Kuvendit, i cili vëzhgon si institucionet ekzekutive ashtu edhe ato të pavarura, për të siguruar që i pari zbaton rekomandimet e këtij të fundit, konsiderohet shumë i rëndësishëm.

Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2019 evidentoi zbatim të dobët të rekomandimeve të institucioneve të pavarura. Më konkretisht, ky raport vë në dukje se *“zbatimi efektiv i rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga administrata publike duhet të forcohet dhe të bëhet më sistematike”*. Për më tepër, sipas Komunikatës 2019 për Politikën e Zgjerimit të BE-së, e drejta e qytetarëve shqiptarë për një administratë të mirë *është kufizuar nga dështimi i vazhdueshëm i institucioneve publike në vend për zbatimin e rekomandimeve të organeve mbikëqyrëse*.

Mekanizmi i përbashkët për monitorimin sistematik të rekomandimeve të bëra nga institucionet e pavarura u krijua pikërisht me frymën dhe qëllimin për të trajtuar këto mangësi përmes promovimit të një sistemi transparent dhe një vlerësimi më efikas të zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura për organet ekzekutive dhe ato vartëse. Por deri më sot, nuk ka ndonjë vlerësim të thelluar mbi efektivitetin apo efektshmërinë e këtij mekanizmi dhe ndikimin real të tij në rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve.

Zbatimi i rekomandimeve të institucioneve të pavarura nga institucionet e administratës publike është treguesi më i mirë i zbatimit të ligjit organik dhe kuadrit rregullator përkatës, si dhe i përmbushjes së misionit institucional, duke garantuar autoritetin dhe pavarësinë e këtyre institucioneve.

Në këtë kuptim, vlerësojmë se nevojiten përmirësime të mëtejshme që mekanizmi të bëhet më funksional për të mundësuar zbatimin efektiv të legjislacionit ekzistues dhe përmirësimin e tij në fusha që kanë lidhje me të drejtat e njeriut. Për rrjedhojë, kemi mbështetur iniciativën për krijimin e një grupi ndërinstitutional pune për rishikimin e vendimit nr.49/2017 të Kuvendit “Për ngritjen e Mekanizmit Ndërinstitutional”.

➤ Niveli i zbatimit të rekomandimeve

Niveli i zbatimit të rekomandimeve për vitin 2020 është si më poshtë:

Institucioni i Avokatit të Popullit ka konstatuar shkelje të të drejtave të njeriut në 256 raste për të cilat ka bërë dhe rekomandimet përkatëse¹⁷⁵ drejtuar organeve të Administratës Publike duke përfshirë atë qendrore dhe vendore. Nga numri total i rekomandimeve rezultojnë se:

¹⁷⁵ Më shumë informacion rreth objektit të rekomandimeve, statusit të tyre si dhe institucioneve të cilat u janë drejtuar gjendet në linkun:

- ✓ 142 rekomandime ose 55 % e tyre janë pranuar;
- ✓ 24 rekomandime ose 9% e tyre janë refuzuar;
- ✓ 34 rekomandime ose 13% e tyre janë pa përgjigje;
- ✓ 49 rekomandime ose 19 % e tyre janë në proces;
- ✓ 7 rekomandime ose 3% e tyre janë me status të papërcaktuar.

Siç rezulton nga të dhënat e mësipërme numri i rekomandimeve të regjistruara për vitin 2020 është 256¹⁷⁶, por 49 prej tyre janë në proces, që do të thotë se *për këto rekomandime ende nuk kanë kaluar afatet procedurale* për të konsideruar nëse janë pranuar apo refuzuar, zbatuar apo pa zbatuar, me apo pa përgjigje, duke qënë se janë dërguar në fund të vitit 2020 apo në fillim të vitit 2021 për inspektime të kryera gjatë vitit 2020.

Rekomandimet me status të papërcaktuar, janë ato rekomandime për të cilat ka mosmarrëveshje mes institucioneve sa i takon kompetencës lëndore për shqyrtimin e rekomandimit e, për rrjedhojë, ende nuk ka një qëndrim sa i takon zbatimit të këtyre rekomandimeve.

Në këto kushte, për të mundësuar raportimin e të dhënave sa më të sakta, përllogaritja e nivelit të zbatueshmërisë së rekomandimeve do të realizohet në dy forma: (1) edhe mbi bazën e rekomandimeve faktike (200 rekomandime) të cilët efektivisht u janë dërguar subjekteve përkatëse dhe janë ezauruar afatet procedurale për të konkluduar lidhur me pranimin apo zbatimin e tyre nga institucionet, (2) edhe mbi bazën e totalit të rekomandimeve të adresuara gjatë vitit 2020 (256 rekomandime).

Më poshtë përllogaritjet e indikatorëve me shpjegimet përkatëse:

- **Raporti i rekomandimeve të lëshuara nga Avokati i Popullit pa përgjigje të dhënë nga institucioni në fjalë;**

Lidhur me rekomandimet pa përgjigje, evidentohet se nga totali i rekomandimeve të dërguara, për të cilat kanë kaluar afatet procedurale për kthimin e një përgjigje (**200 rekomandime**), 34 rekomandime ose rreth 17% e tyre rezultojnë pa përgjigje nga institucionet shtetërore:

$$R_{NoA} = \frac{\text{Numri rekomandimeve të Avokatit të Popullit pa përgjigje}}{\text{Numri i rekomandimeve të nxjerra nga Avokati i Popullit}} \times 100\%$$

$$R_{NoA} = 17\%$$

- **Raporti i rekomandimeve të zbatuara kundrejt të rekomandimeve të pranuar nga institucionet;**

a. Përllogaritja në raport me rekomandimet e adresuara për të cilat kanë kaluar afatet procedurale për kthimin e një përgjigje;

Nga numri i rekomandimeve të adresuara në total për të cilat kanë kaluar afatet procedurale për kthimin e një përgjigje (200), rezulton se:

- ✓ 142 ose rreth 71% e rekomandimeve janë pranuar;
68 prej rekomandimeve të pranuar, ose rreth 48% e tyre, kanë gjetur zbatim të plotë;

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandimet%20Janar%20Dhjetor%202020%20te%20s ekretuara.pdf>.

¹⁷⁶ Këto rekomandime përmbajnë në mjaft raste më shumë se një rekomandim në brendësinë e tyre.

42 prej rekomandimeve të pranuar, ose rreth 30% e tyre kanë gjetur zbatim të pjesshëm;
32 prej rekomandimeve të pranuar, ose rreth 23% e tyre nuk janë zbatuar ndonëse janë pranuar;

- ✓ 24 prej rekomandimeve, ose rreth 9% e tyre janë refuzuar;
- ✓ 34 rekomandime, ose rreth 17 % e tyre nuk kanë marrë asnjë përgjigje.

b. Përlllogaritja në raport me të gjitha rekomandimet e adresuara gjatë vitit 2020

Nga numri i rekomandimeve të adresuara në total, duke përfshirë edhe rekomandimet për të cilat nuk kanë kaluar afatet procedurale për kthimin e një përgjigje (256), rezulton se:

- ✓ 142 ose rreth 55% e rekomandimeve janë pranuar
68 prej rekomandimeve të pranuar, ose rreth 48 e tyre, kanë gjetur zbatim të plotë;
42 prej rekomandimeve të pranuar, ose rreth 30% e tyre kanë gjetur zbatim të pjesshëm.
32 prej rekomandimeve të pranuar, ose rreth 23% e tyre nuk janë zbatuar
- ✓ 24 prej rekomandimeve, ose rreth 9% e tyre janë refuzuar
- ✓ 34 rekomandime, ose rreth 13 % e tyre nuk kanë marrë asnjë përgjigje
- ✓ 49 rekomandime, ose rreth 19% e tyre janë në proces;
- ✓ 7 rekomandime, ose rreth 4% e tyre janë me status të papërcaktuar.

$R_{AÇ} = \frac{\text{Numri rekomandimeve të Avokatit të Popullit të zbatuara}}{\text{Numri total i rekomandimeve të pranuar}} \times 100\%$

$$R_{AÇ} = *100 = 48 \%$$

$$R_{AÇ} = *100 = 30 \%$$

- **Raporti i Kërkesave për sqarime të nxjerra nga Avokati i Popullit, për të cilat nuk është dhënë përgjigje nga institucionet;**

Përsa i takon numrit të kërkesave për shpjegime pa përgjigje, rezulton se për vitin 2020, institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar në total 2146 kërkesa për shpjegime drejtuar organeve të administratës publike, prej të cilave rreth 206 ose rreth 9.6% e tyre nuk kanë marrë përgjigje nga institucionet përkatëse.

$R_{RfC} = \frac{\text{Numri i Kërkesat për Sqarim që nuk kanë marrë përgjigje}}{\text{Numri Total i Kërkesave}} \times 100\%$

$$R_{RfC} = *100 = 9.6 \%$$

Siç vihet re, numri i kërkesave për shpjegime nga institucioni i Avokatit të Popullit të cilat nuk marrin përgjigje nga institucionet ka pësuar rritje të lehtë, nga 8% që ka qënë në vitin paraardhës, në 9.6% për vitin 2020. Në lidhje me këtë çështje, dëshirojmë të saktësojmë se për përlllogaritjen e këtij indikator i jemi referuar vetëm rasteve kur nuk ka pasur përgjigje nga institucionet, pavarësisht kërkesave tona të përsëritura për shpjegime.

Duhet të theksohet se mungesa e marrjes së përgjigjeve, zvarritja e tyre apo përgjigjet e pasakta që nuk kanë lidhje me atë çfarë kërkohet, sigurisht që ndikojnë negativisht në ushtrimin e mandatit tonë kushtetues.

Nga ana tjetër, për një pjesë të rasteve nevojitet ndërhyrja e institucionit tonë me disa kërkesa të përsëritura, për të marrë një përgjigje, përfshirë këtu edhe rastet e përgjigjeve të dërguara jashtë afateve ligjore dhe të arsyeshme. E bëjmë këtë saktësim pasi, për nga vetë natyra e punës

së institucionit të Avokatit të Popullit është e rëndësishme që shpjegimet apo informacionet nga institucionet e AP të dërgohen brenda afateve të arsyeshme, në koherencë me mundësinë efektive të institucionit tonë për të ndërhyrë në zgjidhjen e çështjeve.

Në përfundim, vlen të theksohet se institucioni i Avokatit të Popullit do të vazhdojë si dhe më parë të promovojë parimet e qeverisjes së mirë si dhe të shtetit të së drejtës në administratën qendrore dhe lokale, duke konsideruar faktin se një administratë publike funksionale është parakusht për një qeverisje demokratike, transparente dhe efektive.

➤ *Bashkëpunimi në dhënien e mendimeve/komenteve për projekt-akte*

Edhe gjatë vitit 2020, në veprimtarinë e institucionit të Avokatit të Popullit vëmendje të posaçme ka marrë angazhimi i tij institucional i përfshirjes në fazën e konsultimit të jashtëm për projekakte të propozuara nga ministritë e linjës si dhe përfshirja në procesin legjislativ për dhënien e mendimeve apo sugjerimeve për projektligje të ndryshme. Konkretisht, janë adresuar rekomandime të natyrës legjislative, me qëllim përmirësimin e legjislacionit dhe ndryshimin e praktikave të gabuara administrative, në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, ku duhet të përmendim:

- propozime për ndryshime ligjore në funksion të mbrojtjes së fëmijëve nga shfrytëzimi për punë, si dhe nga punët e rënda për ta;
- miratimin e ndryshimeve të nevojshme në Kodin e Familjes, për parandalimin e martesave të hershme dhe mbrojtjen e fëmijëve prej tyre;
- ndryshimin e vendimit të Këshillit të Ministrave,¹⁷⁷ që rregullon shërbimin e transportit të fëmijëve, për të garantuar të drejtën e fëmijës për arsim;
- përmirësimin e legjislacionit në fushën e komunikimit, teknologjisë dhe inovacionit, për garantimin e të drejtave të fëmijës në mjedisin digjital;
- përmirësimin e instrumentave ligjorë, për zbatimin në praktikë të së drejtës së fëmijës për t'u argëtuar;
- detyrimi ligjor për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit për arsimin parauniversitar,¹⁷⁸ për garantimin e të drejtës për arsim të fëmijës me aftësi të kufizuara, në interesin më të lartë të tij;
- ndryshime ligjore në ligjin për asistencën sociale, për përfshirjen e fëmijës në masat e mbrojtjes, si përfitues i ndihmës ekonomike,¹⁷⁹ për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, që ka pësuar dhunë ose ka qenë i pranishëm kur është ushtruar dhunë.

Janë dhënë mendime, vërejtje dhe sugjerime, për katër projektvendime të Këshillit të Ministrave, të hartuara në kuadër të akteve nënligjore që janë nxjerrë dhe që do të nxirren në zbatim të ligjit nr.96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të tilla si:

- Projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes, funksioneve dhe procedurës së Komisionit për shqyrtimin e kërkesës për njohjen e një pakice kombëtare”;
- Projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes, funksioneve dhe procedurës së Komisionit për shqyrtimin e kërkesës për njohjen e një pakice kombëtare”;
- Projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen e të dhënave për identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare”;

¹⁷⁷ Vendimi nr.682, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënëseve që mësojnë jashtë vendbanimit”, të ndryshuar.

¹⁷⁸ Pikat 1 dhe 6, të nenit 64, të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH”, të ndryshuar.

¹⁷⁹ Shkronja “d”, e nenit 7, të ligjit nr.57/2019 “Për asistencën sociale në RSH”.

- Projektvendimin e Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e përdorimit të gjuhës së pakicave kombëtare në marrëdhëniet ndërmjet personave që i përkasin pakicave kombëtare dhe organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Ka filluar shqyrtimin me iniciative, të problematikës së realizimit të objektivave, të vendosura në Planin Kombëtar të veprimit për integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2016-2020.

Gjithashtu, janë dhënë komente dhe opinione ligjore edhe për projekt-aktet e mëposhtëm:

- “Për Policinë e Burgjeve”;
- “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”;
- “Për shtetësinë”;
- “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar.
- “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”; “Për një ndryshim në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”;
- “Për një ndryshim në ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar”. (Tetor 2020. Të gjitha këto projektligje ishin iniciativa të deputetëve me qëllim harmonizimin me përmbajtjen e Kodit Zgjedhor, i cili u ndryshua në korrik 2020).
- Rishikimin e plotë të paketës ligjore “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.
- Projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut, 2019-2023”.
- Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar.

➤ *Bashkëpunimi në kuadër të procesit të integritetit evropian*

Në përputhje me mandatin e tij kushtetues, institucioni i Avokatit të Popullit si një nga aktorët kyç në sistemin kombëtar të mbrojtjes të të drejtave të njeriut e ka vlerësuar maksimalisht këtë proces duke bashkëpunuar me të gjitha strukturat shtetërore që janë të ngarkuar me ndjekjen dhe zbatimin e detyrimeve, përmes ofrimit të kontributeve domethënëse që luajnë një rol të rëndësishëm në respektimin e të drejtave të njeriut dhe forcimin e shtetit të së drejtës, si premisa për integrimin e vendit në Bashkimin Evropian.

Referuar Urdhërit nr.81/2 prot., datë 2012.2018 “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit të punës, për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Komisionit Evropian në kuadër të procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, i ndryshuar, institucioni i Avokatit të Popullit vazhdon të kontribuojë në gjithë këtë proces përmes pjesëmarrjes në takimet e formateve të ndryshme BE-Shqipëri, por edhe nëpërmjet kontributeve të dërguara sipas Grupeve Ndërinstitucionale të Punës (GNP) të ngritura në përputhje me kapitujt e acquis.

Vlen për tu përmendur veçanërisht angazhimi i vazhdueshëm dhe kontributi i ofruar në kuadër të Kapitullit 23, i cili mbulon disa aspekte në fushën e përgjithshme të *Gjyqësorit dhe të Drejtave Themelore*. Gjithashtu, pjesëmarrje dhe kontribute konkrete janë ofruar dhe për kapitujt 19 (Politikat Sociale dhe Punësimi) dhe 24 (Drejtësia, Liria dhe Siguria).

Avokati i Popullit ka marrë pjesë në mënyrë aktive dhe në kuadër të mbledhjeve dhe raportimeve të zhvilluara nga Këshilli Kombëtar i Integritetit Evropian (KKIE) si struktura më

e lartë këshillimore kombëtare për integrimin evropian që funksionon pranë Kuvendit, me qëllim nxitjen dhe garantimin e bashkëpunimit gjithëpërfshirës ndërmjet forcave politike, institucioneve publike dhe shoqërisë civile, si dhe rritjen e transparencës në vendimmarrjen për çështjet e integritetit.

Gjatë vitit 2020, institucioni i Avokatit të Popullit ka marrë pjesë dhe kontribuar edhe në kuadër të takimeve të përbashkëta të zhvilluar me BE-në, ku duhet të përmenden:

- Pjesëmarrja dhe kontributi për *takimin e 11-të të Komitetit të Stabilizim-Asociimit (KSA)*, i zhvilluar më datë 9 dhjetor 2020, kontribut i cili u fokusua tek:
 - *Legjislacioni për pakicat, duke përfshirë legjislacionin dytësor;*
 - *Liria e shprehjes dhe ndryshimet në Ligjin për median;*
 - *Konsolidimi i të drejtës së pronësisë;*
 - *Mbrojtja sociale dhe përfshirja e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane;*
 - *Barazia Gjinore/LGBTI; si dhe*
 - *Të drejtat e fëmijëve.*
- Pjesëmarrja dhe kontributi për *takimin e 12-të të Nënkomitetit Bashkimi Evropian – Shqipëri “Drejtësia, Liria dhe Siguria”*, i zhvilluar më datë 30 Qershor - 1 Korrik 2020, kontribut i cili u fokusua tek:
 - *Të drejtat procedurale; sistemi i drejtësisë së të miturve; aksesit në drejtësi; ndihma ligjore (zbatimi i kuadrit të ri ligjor);*
 - *E drejta e jetës, parandalimi i torturës dhe i keqtrajtimit dhe sistemi i burgjeve (duke u fokusuar në zbatimin e rekomandimeve të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor ose Degradues);*
 - *Mbrojtja e minoriteteve;*
 - *Politikat e anti-diskriminimit dhe mbrojtjes së grupeve të rrezikuara, të drejtat e fëmijëve, personat me aftësi të kufizuara, personat e komunitetit LGBTI;*
 - *Barazia gjinore dhe dhuna mbi bazë gjinore;*
 - *Përfshirja e komunitetit Rom/ Egjiptian.*

5.2 Bashkëpunimi ndërkombëtar

Bashkëpunimi Ndërkombëtar i institucionit të Avokatit të Popullit ka qenë dhe vazhdon të mbetet një nga fushat më të rëndësishme të angazhimit institucional në përmbushje të misionit kushtetues për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Gjatë vitit 2020, si pasojë e situatës së pandemisë përfaqësues të institucionit të Avokatit të Popullit kanë marrë pjesë në një sërë aktiviteteve Ndërkombëtare të zhvilluara në platformë virtuale. Në kuadër të këtij bashkëpunimi dypalësh dhe shumëpalësh veprimtaria e Avokatit të Popullit renditet si vijon:

- **Bashkëpunimi në kuadër të Rrjetit Global të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (GANHRI) dhe Rrjetit European të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI)**

Avokati i Popullit të Shqipërisë për periudhën 2019-2022 ushtron mandatin si anëtare e bordit të dy strukturave mjaft të rëndësishme dhe me impakt në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, në nivel Evropian dhe Global të institucioneve homologe. Përfaqësimi i Shqipërisë në

këto nivele, mundëson jo vetëm një imazh pozitiv për Shqipërinë, por mbi të gjitha i hap rrugë zhvillimeve të mëtejshme bashkëkohore në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut. Rrjedhimisht edhe veprimtaria dhe angazhimi i institucionit të Avokatit të Popullit ka qenë serioz dhe impenjativ në këto dy rrjete duke zhvilluar veprimtarinë e mëposhtme:

- Takimet e vitit 2020 kanë filluar me pjesëmarrjen e Avokates së Popullit si dhe përfaqësuesve të tjerë të lartë të institucionit, në takimin konsultues të zhvilluar në Bruksel në datat 4- 6 shkurt, në kuadër të përgatitjeve të procesit të hartimit të Paketës së Zgjerimit të vitit 2020.
- Mbledhja e Bordit të ENNHRI-t, për shkak të pandemisë, për herë të parë është zhvilluar online në datat 24 -25 Shkurt 2020. Në mbledhje morri pjesë Avokatja e Popullit e shoqëruar nga Këshilltarja për Marrëdhëniet me Jashtë.
- Në datat 10-13 Mars 2020 u organizua Takimi Vjetor i GANHRI si dhe Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme. Në këto takime morri pjesë Avokatja e Popullit shoqëruar nga përfaqësues të nivelit të lartë të institucionit. Ndër shumë diskutime të tjera u trajtua dhe çështja e *eksperiencave dhe qasjeve të NHRI-së si dhe sfidave në adresimin e të drejtave të njeriut si dhe ndryshimet klimatike*.
- Institucioni i Avokatit të Popullit u përfaqësua në seminarin e organizuar nga ENNHRI mbi “Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG)” në datat 17-18 Mars 2020, ky seminar u pasua nga takimi online i Forumit Rajonal për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën- UNECE në datat 19-20 Mars në Gjenevë.
- Përfaqësues të institucionit u përzgjedhën në *qershor të vitit 2020* nga ENNHRI, për të ndjekur Akademinë online të zhvilluar nga Zyra e OSCE/ODHIR në bashkëpunim me ENNHRI. Gjatë këtij kursi u trajtua *perspektiva e çështjeve të migracionit dhe të drejtat e njeriut*.
- Me ftesë të dërguar nga ENNHRI, përfaqësues të Kabinetit të Avokatit të Popullit ndoqën Konferencën me temë: *"Mbrojtja e sundimit të ligjit në Europë-rëndësia e një sistemi gjyqësor të pavarur"*, organizuar në 25 qershor 2020.
- Përfaqësues të institucionit të Avokatit të Popullit morën pjesë në webinar-in e organizuar nga GANHRI, zhvilluar në datën 3 Shtator 2020, me temë *"Mbrojtja dhe fuqizimi i personave me aftësi të kufizuar në kontekstin COVID-19, rolin dhe përvorjet e institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut."*
- Përfaqësues të institucionit të Avokatit të Popullit morën pjesë në webinar-in e organizuar nga ENNHRI, zhvilluar në datën 23 Shtator 2020, me temë *"Mbi monitorimin në terren të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar gjatë pandemisë COVID-19"*.
- Avokatja e Popullit morri pjesë në Webinarin e organizuar nga ENNHRI në datat 9-10 nëntor ku u diskutuan çështje lidhur me *"Rolin dhe mbështetjen ndaj Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (NHRI-të) që promovojnë sundimin e ligjit, demokracinë dhe të drejtat e liritë themelore të njeriut"* si dhe në webinarin lidhur me *"Ndikimin nga politika e jashtme e BE-së mbi sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe demokracia - roli dhe mbështetja për NHRI-të"*.
- Në datën 18 nëntor u zhvillua online Asambleja e Përgjithshme e ENNHRI, ku Avokatja e Popullit u shoqërua nga Këshilltarja për Marrëdhëniet me Jashtë.
- Avokatja e Popullit dhe përfaqësues të institucionit morën pjesë në takimin vjetor online të organizuar nga GANHRI, zhvilluar në datat 30 Nëntor – 4 Dhjetor 2020. Në takim u shtruan diskutime si dhe u shkëmbyen ide dhe eksperiencat e pjesëmarrësve lidhur me situatën e pandemisë. Gjatë konferencës u diskutuan gjithashtu çështjet e *Zbatimit të mandatit të NHRI-ve në kontekstin e COVID-19 si dhe Roli i Institucioneve të të Drejtave të Njeriut në Ndryshimet Klimatike*.
- Në datën 2 dhjetor u zhvillua online Konferenca vjetore e ENNHRI me temë *"Ndërtimi së bashku më mirë i të drejtave të njeriut, demokracisë dhe shtetit të së drejtës në Evropë:"*

Njohja dhe roli i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut". Takimi u ndoq me interes nga Avokatja e Popullit shoqëruar nga staf i nivelit të lartë.

- Avokatja e Popullit dhe përfaqësues të lartë të institucionit ndoqën seminarin online të organizuar nga ODIHR dhe ENNHRI, në datën 11 Dhjetor 2020 me temë: *"Mbi rritjen e rolit të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut përgjatë gjendjes së jashtëzakonshme"*.

➤ **Bashkëpunimi në kuadër të Shoqatës së Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM)**

Avokati i Popullit të Shqipërisë vijon të jetë zv.Presidente e dytë e Shoqatës së Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM). Për vitin 2020 Mbledhja e Bordit u zhvillua online në datën 1 dhjetor 2020, në të cilën u miratua plani i punës për vitin 2021 si dhe u diskutuan çështje të tjera të shoqatës.

➤ **Bashkëpunimi në kuadër të shoqatës së Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanit (IOI)**

- Përfaqësues të Institucionit morën pjesë në workshopin e organizuar nga IOI dhe Ombudsmani i Katalonjës në datat 2 dhe 3 mars, në Barcelonë, Spanjë, ku u trajtua tema *"Inteligjenca Artificiale dhe të Drejtat e Njeriut"*.
- Përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit ndoqën webinarin e zhvilluar online, në datën 3 shtator 2020, me temë: *"Mbrotjtja dhe fuqizimi i personave me aftësi të kufizuara në kontekstin COVID-19; roli dhe përvojat kombëtare të të drejtave të njeriut"*.
- Avokatja e Popullit mori pjesë në webinarin e organizuar nga IOI me temë: *"COVID-19 dhe Ombudsmani-Përballja me sfidën e pandemisë"*, organizuar në datën 24 nëntor 2020, si dhe nëpërmjet një video mesazhi ndau me pjesëmarrësit eksperiencën e Institucionit të Avokatit të Popullit në situatën e pandemisë, si dhe sfidat dhe objektivat për të ardhmen.

➤ **Aktivitetet e institucionit të Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT)**

- Me ftesë të Institucionit Garantues Kombëtar të të Drejtave të të Burgosurve ose të privuar nga liria personale të Italisë, Komisionerja e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ndoqi konferencën përmblylëse të projektit *"Implementimi i sistemit të monitorimit të kthimit të detyruar"*, zhvilluar në datën 18 shkurt 2020, në Romë, Itali.
- Përfaqësues të lartë të Institucionit të Avokatit të Popullit ndoqën workshopin e zhvilluar online në datat 12-13 maj 2020, me temë *"Masat që duhet të merren në orët e para të shoqërimit në polici"*, organizuar nga Mekanizmi i Parandalimit të Torturës i Kroacisë, në kuadër të ushtrimit të Presidencës të Rrjetit të Mekanizmave për Parandalimin e Torturës të Evropës Juglindore, në bashkëpunim me Shoqatën për Parandalimin e Torturës (APT).
- Avokatit i Popullit dhe Komisionerja e MKPT-së morrën pjesë në webinarin e organizuar, në datën 15 shtator 2020, nga Zyra e Inspektimit të Burgjeve në Irlandë *"Mbi prezantimin e kuadrit ligjor të inspektimit të bugjeve"*.
- Në trajnimin me temë *"Monitorimi dhe vlerësimi i kuadrit ligjor dhe politikave në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore"*, zhvilluar në datat 9-11 dhjetor 2020, institucioni i Avokatit të Popullit u përfaqësua nga stafi teknik i Seksionit të Mekanizmit për Parandalimin e Torturës. Aktiviteti u organizua online nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL).

- Në ditën botërore të emigrantëve (18 dhjetor 2020), përfaqësues të Seksionit të MKPT-së me ftesë të Shërbimit të Informacionit të Kombeve të Bashkuara në Vienë (UNIS) dhe IOM morrën pjesë në aktivitetin me temë “Only our home”.

➤ **Aktivitete të tjera dhe bashkëpunime me partnerët ndërkombëtar**

- Avokatja e Popullit, me ftesë të Rrjetit European të Ombudsmanit (ENO), mori pjesë në takimin e zhvilluar në datën 12 Maj 2020, duke ndarë me homologët eksperiencën e institucionit në menaxhimin e situatës së pandemisë.
- Avokatja e Popullit, në datën 29 qershor 2020, në kuadër të marrëdhënieve të ngushta të bashkëpunimit me homologun e Kosovës, zhvilloi një vizitë zyrtare në institucionin e Avokatit të Popullit të Kosovës, me rastin e përfundimit të mandatit të Avokatit të Popullit z.Hilmi Jashari.
- Në datën 9 korrik, përfaqësues të nivelit teknik të institucionit të Avokatit të Popullit morrën pjesë në webinarin e organizuar nga Kombet e Bashkuara me temë: “Në hijen e COVID-19: Mësimet e nxjerra në hapësirën qytetare dhe e drejta publike”. Gjatë Konferencës u diskutua roli aktiv dhe monitorues i institucioneve të të drejtave të njeriut, në mbikqyrjen e mënyrës se si e gjithë shoqëria po përballet me pasojat post-pandemike.
- Avokatja e Popullit mori pjesë në Seminarin e organizuar nga Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) me temë: “Komunikimi i mesazhit të barazisë dhe diversitetit”, i cili u zhvillua online në datat 28-29 Shtator. Në takim merrnin pjesë përfaqësues të rëndësishëm nga institucionet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut nga e gjithë Evropa.
- Avokatja e Popullit si dhe përfaqësues të nivelit të lartë të institucionit ndoqën Forumin Vjetor të Sundimit të Ligjit në Evropën Juglindore i cili u mbajt në datat 16-17 tetor në Tiranë. Forumi u organizua nga organizatat “Civil Right Defenders” dhe “AIRE Center”, pjesë e së cilit ishin autoritete të rëndësishme të drejtësisë nga vendi dhe rajoni.
- Me ftesë të Rrjetit Evropian të Ombudsmanit (ENO), Institucioni i Avokatit të Popullit u përfaqësua në konferencën vjetore të datës 26 Tetor 2020, në të cilën u diskutuan temat mbi sfidat e së ardhmes, forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit midis homologëve si dhe ndikimi i situatës së COVID-19. Në këtë takim, titullarja e Institucionit të Avokatit të Popullit znj. Erinda Ballanca, bëri një pasqyrë të veprimtarive dhe ndikimit që pandemia globale ka pasur edhe në lëmin e të drejtave të njeriut në vendin tonë si dhe te institucionet që mbrojnë këto të drejta.
- Me ftesë të OSCE, Avokatja e Popullit adresori në 6 nëntor 2020 problematikat dhe sfidat e NHRI-ve në kontekstin e pandemisë COVID-19, në webinarin me temë “Roli i Mbrojtësve të të Drejtave të Njeriut në promovimin dhe mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut”.
- Organizata Ndërkombëtare e Frankofonisë (OIF) në bashkëpunim me Institutin Ndërkombëtar të së Drejtës Humanitare të Sanremos (IIHR) organizoi në datat 2-27 nëntor kursin online me temë: "Mbrojtja e të drejtave të migrantëve: standardet ndërkombëtare përballë sfidave bashkëkohore". Nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit kursi u ndoq nga përfaqësues të kabinetit.
- Përfaqësues të stafit teknik të Institucionit të Avokatit të Popullit u angazhuan në webinarin online të datës 12 nëntor, me temë: “Gjinia, Diversiteti dhe Drejtësia në Evropën Juglindore”, organizuar nga ODIHR. Ky organizim bashkoi profesionistë të fushës së drejtësisë, përfaqësues nga shoqëria civile dhe ekspertë ndërkombëtarë duke u dhënë pjesëmarrësve një mundësi për të ndarë praktikat më të mira lidhur me përfshirjen e këtyre tri kategorive në fushën e drejtësisë.
- Në datën 2 Dhjetor, përfaqësues të institucionit të Avokatit të Popullit morrën pjesë në webinar-in e organizuar nga OHCHR dhe European Center for Not-For-Profit Law Sticking

(ECNL), me temë “*Mbi nxitjen e pjesëmarrjes së Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (NHRI) në çështjet publike*”.

- Përfaqësues të institucionit të Avokatit të Popullit morrën pjesë në trajnimin e organizuar online nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL), zhvilluar në datat 9-11 Dhjetor me temë “*Mbi monitorimin dhe vlerësimin e kuadrit ligjor dhe politikave në luftë kundër trafikimit të qenieve njerëzore*”.

5.3 Bashkëpunimi në kuadër të projekteve

Siç kemi informuar edhe më parë, në kuadër të programit të përbashkët të BE-së dhe Këshillit të Evropës- “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2020”, në muajin dhjetor 2019 u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit për krijimin e “Aleancës kundër gjuhës së urrejtjes”. Gjate vitit 2020, Aleanca kundër gjuhës së urrejtjes ka vijuar aktivitetet për të sensibilizuar dhe ndërgjegjësuar publikun mbi ngritjen e vetëdijes, informimin dhe kontribuimin në dialogun, veçanërisht midis të rinjve, për luftën ndaj gjuhës së urrejtjes.

Deklarata e qëndrime të përbashkëta të të gjithë anëtarëve të Aleancës kundër gjuhës së urrejtjes janë publikuar dhe bërë të njohura për gjithë publikun, sa herë që janë konstatuar qëndrime seksiste apo përdorim i një gjuhe misogjene apo diskriminuese nga persona publikë si në emisione të ndryshme televizive, në shkrime apo fjalime e dalje të tyre për mediat. Në kuadër të anëtarësimit në aleancë Avokati i Popullit së bashku me anëtarët e tjerë të saj, të mbështetur nga Këshilli i Evropës kanë publikuar spot sensibilizues ku shpjegojnë se çfarë është gjuha e urrejtjes dhe legjislacionin që mbron individët nga kjo gjuhë.

Avokati i Popullit ka vijuar zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me UNHCR për monitorimin e pikave të kalimit të migrantëve dhe forcimin si dhe respektimin e të drejtave të tyre. Në këtë kuadër, në janar të vitit 2020 janë kontraktuar dy ekspertë të jashtëm për të mundësuar vazhdimin e monitorimit të pikave të kalimit kufitar në Gjirokastër dhe Kapshticë. Zbatimi i këtij projekti ka mundësuar rritjen e mbështetjes dhe forcimit të kapaciteteve (në burime njerëzore dhe infrastrukturë) të Avokatit të Popullit në cilësinë e Mekanizmit Kombëtar kundër Torturës (MKPT), përfshirë këtu edhe prodhimin e materialeve promovuese, realizimin e trajnimeve etj.

Që prej muajit tetor 2019, Avokati i Popullit është bërë pjesë e projektit të financuar nga Programi i Drejtësisë së Bashkimit Evropian me titull “*B- Competent “Forcimi i Kompetencave të stafit penitenciar në Evropë*”. Në kuadër të zbatimit të këtij projekti, Avokati i Popullit (Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës) si dhe Qendra Europiane në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, kanë zhvilluar disa takime (online) si dhe kanë kontribuar në disa nga aktivitetet e këtij projekti të cilat kryesisht u fokusuan në dy shtylla kryesore:

- a. *Analiza e mangësive të trajnimit dhe nevoja të stafit të burgjeve në 6 shtete (Itali, Spanjë, Greqi, Francë, Shqipëri dhe Mali i Zi) me fokus të veçantë të drejtat e të burgosurve të huaj.*
- b. *Kuadri ligjor për metodologjinë e programeve të trajnimit për trajnerët e stafit penitenciar.*

Gjithashtu, institucioni i Avokatit të Popullit është angazhuar për të përmbushur disa detyra brenda Paketës së Punës 2 “*Analiza paraprake e mungesave në trajnime dhe identifikimi i praktikave më të mira*”, në kuadër të të cilës në Shqipëri, Mal të Zi dhe Greqi janë realizuar nga Takimet e Fokus Grupeve si dhe janë zhvilluar kërkime mbi programet ekzistuese të trajnimit.

Edhe gjatë vitit 2020, ka vazhduar zbatimi i projektit “*Supporting People’s Advocate institution for identification and addressing of child rights violations*”, me mbështetjen e ofruar nga

UNICEF. Për arsye objektive të shkaktuara nga situata e pandemisë, institucioni i Avokatit të Popullit hasi në vështirësi sa i përket realizimit të aktiviteteve të parashikuara në projekt që do kryeheshin në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve. Për këtë arsye projekti u shtri në kohë, pa kosto shtesë, deri në muajin qershor 2020.

Ndërkohë, në Shtator 2020, u nënshkrua me UNICEF *Marrëveshja e re e Bashkëpunimit për periudhën 1 Tetor 2020 - 30 Shtator 2021*. Marrëveshja i referohet Planit të Punës 2020-2021 mes UNICEF dhe Qeverisë Shqiptare dhe parashikon një kontribut për Avokatin e Popullit i cili do kontribuojë në forcimin institucional, me fokus të shtuar në forcimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore të Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, me qëllim evidentimin dhe adresimin e shkeljeve të të drejtave të fëmijës.

Bazuar në këtë marrëveshje dhe në zbatim të legjislacionit të administrimit të drejtësisë penale për të mitur, Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve realizoi katër inspektime në institucionet kryesore, që trajtojnë të mitur në konflikt me ligjin e në kushtet e privimit të lirisë, me qëllim zbatimin e rekomandimeve të adresuara nga institucioni i Avokatit të Popullit një vit më parë. Po në zbatim të kësaj marrëveshjeje, një ndër objektivat e planit të veprimtari është edhe mbrojtja sociale. Kështu, janë organizuar tri tryeza pune me përfaqësues të autoriteteve publike në nivelin vendor, përgjegjëse për mbrojtjen sociale të fëmijëve, pjesë e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, kryesisht në bashkitë e qyteteve Tropojë, Shkodër dhe Korçë, për ofrimin e shërbimeve sociale të dedikuara fëmijëve.

Në datë 3 shtator 2020, u nënshkrua *Memorandumi i Mirëkuptimit* midis Avokatit të Popullit dhe Institutit të Statistikave, “*Për bashkëpunimin në fuqizimin e mbledhjes së të dhënave, përhapjen dhe analizën në dritën e të drejtave të njeriut dhe Agjendës së Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030*”. Qëllimi i këtij Memorandumi është krijimi i një programi bashkëpunimi midis palëve për të promovuar një kuptim më të gjerë të rëndësisë së zhvillimit dhe përdorimit të informacionit statistikor për të informuar, zbatuar dhe vlerësuar politikat kombëtare dhe programet të cilat mund të kenë ndikim mbi respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave të njeriut në kuadër dhe të realizimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

KREU 6

Shërbimet mbështetëse

6.1 Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Administrative

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kombëtar për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, në veprimtarinë e tij duhet të mbështetet nga një infrastrukturë që mundëson realizimin e objektivave dhe qëllimeve të tij, në përputhje të plotë me Parimet e Parisit¹⁸⁰ dhe Parimet e Venecias.¹⁸¹ Janë këto parime, të cilat i lejojnë një institucion kombëtar për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, të përshtatë strukturën me prioritetet e tij, qoftë edhe nëpërmjet krijimit të strukturave ad hoc, duke pasur një autonomi organizative për sa i përket strukturës dhe mënyrës së funksionimit të saj.

Kjo qasje është nënvizuar edhe nga Raporti i Komisionit Evropian, për vitin 2020¹⁸², në të cilin është theksuar, ndërmjet të tjerash, nevoja për një *qasje gjithëpërfshirëse për të forcuar kapacitetin e Avokatit të Popullit* në trajtimin e rasteve të shkeljeve të të drejtave të njeriut. Ndërkohë, dhe *Universal Peer Review* (Rishikimi Periodik Universal) i vitit 2019,¹⁸³ arriti në përfundimin se *mungesa e burimeve të mjaftueshme njerëzore, teknike dhe financiare të institucionit të Avokatit të Popullit po minonte punën për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut*.

E njëjta gjë është konstatuar dhe nga Raporti i Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI-t) për Shqipërinë (Cikli i gjashtë i Monitorimit)¹⁸⁴, miratuar në prill 2020, duke theksuar që *“Autoritetet duhet të sigurojnë që Zyra e Avokatit të Popullit të marrë burimet e nevojshme financiare dhe të personelit për të mbuluar plotësisht dhe në mënyrë të qëndrueshme të gjitha aspektet e mandatit të saj dhe forcimin e ndjekjes së rekomandimeve të organeve të barazisë”*.

Vlen të theksohet se të gjitha raportet e sipër-përmendura nuk inkurajojnë thjesht zbatimin e rekomandimeve nga institucionet publike apo qasjen mbështetëse për rritjen e burimeve njerëzore dhe financiare me qëllim që të reflektojë mandatin e gjërë që ka Avokati i Popullit, por çfarë është më kryesorja këto raporte (dhe jo vetëm) e kanë identifikuar Avokatin e Popullit si një nga burimet më të besueshme në lidhje me raportimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut në vend.

Përtej këtyre problematikave, institucioni i Avokatit të Popullit është përpjekur maksimalisht të rrisë dhe forcojë më tej kapacitetet institucionale, nëpërmjet rritjes së nivelit të kualifikimit dhe të trajnimit, përmirësimit të menaxhimit të burimeve njerëzore, njohjes dhe zbatimit të plotë të legjislacionit në fushën e shërbimit civil, rritjes së transparencës dhe përgjegjshmërisë në të gjitha nivelet e vendimmarrjes, me qëllim krijimin e një administrate sa më funksionale, eficiente dhe të aftë për të realizuar misionin dhe objektivat e institucionit.

¹⁸⁰ <https://ganhri.org/paris-principles/>.

¹⁸¹ [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2019\)005-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2019)005-e).

¹⁸² <https://www.parlament.al/DokumentaIntegrimi?integrimId=2>.

¹⁸³ <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/UPR/Pages/ALindex.aspx>.

¹⁸⁴ <https://www.coe.int/en/web/european-commission-against-racism-and-intolerance/albania>.


Gjatë vitit 2020, një problematikë e madhe sa i perket menaxhimit të burimeve njerëzore dhe ushtrimit normal të detyrave funksionale ka qenë dhe mbetet çështja e situates së krijuar nga pandemia (COVID-19). Për adresimin e një situatë të tillë, pa cënuar thelbësisht ushtrimin e mandatit dhe realizimin e objektivave institucional, Avokati i Popullit miratoi Urdhërin nr.66, datë 10.03.2020, “Për miratimin e rregullores për marrjen e masave në drejtim të kufizimit në drejtim të përhapjes së infeksionit COVID-19 në drejtim të punonjësve të Avokatit të Popullit” si dhe Udhëzimin nr.141, datë 18.11.2020, “Për rregullat që duhet të zbatohen punonjësit e institucionit të Avokatit të Popullit gjatë punës në distancë (online)”.

Qëllimi i këtyre akteve ishte organizimi dhe funksionimi i punës në institucion për të garantuar vijimësinë e punës dhe të ushtrimit të detyrave funksionale në distancë, ose të kombinuar me punën në zyrë, në kuadër të masave të marra për të parandaluar përhapjen e COVID-19. Pavarësisht pezullimit pjesor të shërbimeve direkte për qytetarët, puna u organizua në një mënyrë të tillë që mundësoi marrjen e ankesave vetëm nëpërmjet postës zyrtare, postës elektronike apo aplikacionit telefonik. Për këtë arsye, u vendos dhe një njoftim publik në ambientet e jashtme të institucionit si dhe në faqen zyrtare të tij, ku përcaktoheshin qartësisht adresat postare dhe elektronike.

Për më shumë rreth menaxhimit të burimeve njerëzore dhe administrative, referojuni dhe pikës 8 të Kreut II (Zbatimi i Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë).

➤ Struktura dhe Organigrama

Me ndryshimet e bëra me Urdhërin nr.42, datë 18.02.2020 “Për disa ndryshime në urdhërin nr.252, datë 22.11.2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të institucionit të Avokatit të Popullit”, i ndryshuar, struktura dhe organika e institucionit është si më poshtë:



Paraqitja grafike e organigramës së institucionit të Avokatit të Popullit.

Tabela e strukturës së institucionit të Avokatit të Popullit.

Emërtimi i funksionit	Numri i Punonjësve (56)	Kategoria/Klasa
Avokati i Popullit	1	Ligji nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar
Kabineti	7	
· Drejtor Kabineti	1	VKM nr. 187, datë 08.03.2017, i ndryshuar
· Këshilltar	5	I-b
· Sekretar	1	VKM nr. 187, datë 08.03.2017, i ndryshuar
Sekretar i Përgjithshëm	1	I-a
Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre	7	
· Komisioner	1	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar
· Ndihmëskomisioner	3	II-a
· Ndihmëskomisioner	3	II-b
Seksioni për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor	5	
· Komisioner	1	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar
· Ndihmëskomisioner	2	II-a
· Ndihmëskomisioner	2	II-b
Seksioni i Përgjithshëm	5	
· Komisioner	1	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar
· Ndihmëskomisioner	3	II-a
· Ndihmëskomisioner	1	II-b
Seksioni për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve	4	
· Komisioner	1	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar

· Ndhimëskomisioner	2	II-a
· Ndhimëskomisioner	1	II-b
Mekanizimi për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues	5	
· Komisioner	1	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar
· Ndhimëskomisioner	2	II-a
· Ndhimëskomisioner	2	II-b
Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve	18	
· Drejtor	1	II-b
Spektori i Burimeve Njerëzore	3	
· Përgjegjës Spektori	1	III-a
· Specialist për Burimet Njerëzore	1	III-b
· Specialist Protokolli	1	III-b
Spektori i Shërbimeve	8	
· Përgjegjës Spektori	1	III-a
· Arkivist/Bibliotekar	1	Klasa VIII
· Shofer i titullarit	1	Klasa VI
· Shofer	2	Klasa IV
· Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme	1	Klasa VI
· Punëtor pastrimi	2	Klasa I
Spektori i Financës dhe Prokurimeve	3	
· Përgjegjës Spektori	1	III-a
· Specialist i Financës	1	III-b
· Specialist i Prokurimeve	1	III-b
Spektori i IT dhe Pritjes së Qytetarëve	3	
· Përgjegjës sektori	1	III-a
· Specialist i Shërbimeve ndaj Qytetarit	2	III-b
- Spektori për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe integrimin evropian	3	
- Përgjegjës Spektori	1	III-a
- Specialist	2	III-b

Siç dhe kemi informuar më parë, përveç zyrës qendore, në bashkëpunim me pushtetin vendor janë krijuar dhe funksionojnë 7 zyra rajonale¹⁸⁵, përfaqësuesit e të cilave nuk janë pjesë e strukturës së miratuar të institucionit, por punojnë me kontrata të pjesshme (6 orë në ditë) bazuar në vendimet e përvitshme që miratohen nga Këshilli i Ministrave në lidhje me përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme në Njësitë e Qeverisjes Vendore. Gjatë vitit raportues e në vijim, bazuar në marrëveshjen e nënshkruar me UNHCR për monitorimin e emigrantëve në pikat e kalimit kufitar, në mbështetje të punës së Seksionit të MKPT-së janë rekrutuar me kohë të plotë 2 ekspertë të jashtëm. Ndërkohë, me mbështetjen e UNICEF, institucioni i Avokatit të Popullit ka mundur rekrutimin edhe të 2 ekspertëve të tjerë të jashtëm për të mbështetur punën e Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve.

6.2 Vështrim mbi të ardhurat dhe shpenzimet

Në mbështetje të ligjit nr. 88/2019, datë 18.12.2019, "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2020", Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012, "Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave nr. 2, datë 20.01.2020 "Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2020", i ndryshuar, performanca e produkteve të buxhetit për institucionin e Avokatit të Popullit, sipas programit buxhetor të miratuar për vitin 2020, paraqitet si më poshtë:

Programi - "Shërbimi Avokatisë"

Buxheti i akorduar për këtë program (i vetmi program që ka institucioni i Avokatit të Popullit) ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës së Programit (DPP) të hartuar gjatë procesit të PBA 2020-2022 dhe ka për qëllim arritjen e objektivave e produktit të përcaktuar e të miratuara në dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm (2020-2022)

Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve për vitin 2020

Me Ligjin Nr. 88/2019, datë 18.12.2019, "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2020", fondet e akorduara me ndryshimet e bëra gjatë vitit për funksionimin e aktivitetit të institucionit të Avokatit të Popullit, sipas artikujve, paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Tabela e Raportit të Shpenzimeve Faktike të programit sipas Artikujve

Nr. Llog.	Emërtimi	Plani fillestar	Shtesa dhe Pakësime	Plani i ndryshuar	Fakti
600	Paga	86,000,000	-1,000,000	85,000,000	81,052,368
601	Sig. Shoqërore e Shëndetësore	12,500,000		12,500,000	11,238,920
602	Mallra dhe shërbime të tjera	14,900,000	- 960,000	13,940,000	13,136,353
605	Transferta. Korente të Huaja	1,600,000	40,000	1,640,000	1,626,241
606	Transferta për buxhetet familjare	500,000	110,000	610,000	101,730
231	Investimet	1,000,000		1,000,000	999,360
	TOTALI	116,500,000	-1,810,000	114,690,000	108,154,972

¹⁸⁵ Zyra Rajonale Shkodër, Dropull, Kukës, Pogradec, Vlorë, Berat dhe Sarandë.

Tabela e Raportit Vjetor të Realizimeve të Shpenzimeve për vitin 2020

Nr.	Emërtimi	Plani i ndryshuar	Fakti	Diferenca	Realizimi në %
1	Paga	85,000,000	81,052,368	3,947,632	95.36
2	Sigurime Shoqërore e Shëndetësore	12,500,000	11,238,920	1,261,080	89.91
3	Mallra dhe shërbime të tjera	13,940,000	13,136,353	803,647	94.23
4	Transferta Korente të Huaja	1,640,000	1,626,241	13,759	99.16
5	Transferta për buxhetet familjare	610,000	101,730	508,270	16.68
6	Investimet	1,000,000	999,360	640	99.94
	Totali	114,690,000	108,154,972	6,535,028	94.30

Siç përmendet dhe më poshtë, diferenca e mosrealizimeve (6.7 %) të buxhetit për vitin 2020 lidhet në pjesën më të madhe me fondin *paga dhe sigurime shoqërore* të cilat vijnë për shkak të mosplotësimit të strukturave organike duke pasur në konsideratë procedurat që kërkohen të ndiqen dhe afatet kohore që duhen të respektohen për rekrutimin e stafit në pozicionet e punës që bien brenda ligjit për shërbimin civil. Gjithashtu, edhe në zërin 602 (*mallra dhe shërbime*) kemi një diferencë në mosrealizim për shkak të vetë situatës së pandemisë gjë që realisht pamundësoi realizimin e shumë aktiviteteve të parashikuara apo realizimin e tyre pa kosto financiare (aktivitete online).

➤ Shpenzime Personeli

Realizimi i fondit të pagave reflekton strukturën dhe organikën, lëvizjet e brendshme dhe të jashtme. Ky fond i akorduar për vitin 2020, për mbulimin e shpenzimeve në paga personeli ishte 86,000,000 lekë, i ndryshuar me Akt-Normativ nr. 15, datë 15.04.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 88/2019, ‘Për buxhetin e vitit 2020’”, në 85,000,000 lekë, ndërsa realizimi është 81,052,368 lekë ose 95.36%, i buxhetit të ndryshuar, si dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore ishin në plan 12,500,000 lekë, ndërsa realizimi është 11,238,920 lekë ose në masën 89.91% i buxhetit. Të dyja zërat së bashku paga personeli dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore (600+601) për vitin 2020 janë realizuar në masën 94.66% i buxhetit të ndryshuar.

Gjatë vitit 2020, numri mesatar i punonjësve ka qenë 53,25 punonjës nga 56 punonjës që ka qenë kufiri i miratuar me ligjin e lartpërmendur. Mosrealizimi i këtij zëri të shpenzimeve vjen për shkak të mosplotësimit të strukturave organike si rezultat i vendeve vakant të krijuara në fund të vitit 2019 dhe gjatë vitit 2020 nga lëvizja e punonjësve të institucionit tonë në detyra të tjera. Numri i punonjësve i miratuar me ligj për vitin 2020, nuk është plotësuar në të gjithë strukturat përbërëse të tij gjatë këtyre periudhave.

Ka patur mungesa në katër/mujorin e parë:

- 1 Ndhimëskomisioner në Seksionin për policinë, shërbimin sekret, burgjet, forcat e armatosura dhe pushteti gjyqësor për katër muaj;

- 1 Ndhimëskomisioner në Mekanizmin për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues për katër muaj;
- 1 Përgjegjës në Sektorin e Shërbimeve për dy muaj;
- 1 Specialist në Sektorin e Financës dhe Prokurimeve për një muaj;
- 1 Specialist i Shërbimeve ndaj Qytetarëve për një muaj.

Gjatë katër/mujorit të dytë institucioni ka patur këto mungesa:

- 1 Ndhimëskomisioner në Seksionin për policinë, shërbimin sekret, burgjet, forcat e armatosura dhe pushteti gjyqësor për një muaj;
- 1 Ndhimëskomisioner në Seksionin për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të tëtretëve që veprojnë për llogari të tyre për tre muaj,
- 1 Ndhimëskomisioner në Mekanizmin për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues për katër muaj;
- 1 Përgjegjës në Sektorin e Shërbimeve për tre muaj.

Gjatë katër/mujorit të tretë institucioni ka patur këto mungesa:

- 1 Ndhimëskomisioner në Seksionin për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të tëtretëve që veprojnë për llogari të tyre për katër muaj;
- 1 Ndhimëskomisioner në Mekanizmin për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues për dy muaj;
- 1 Përgjegjës në Sektorin e Shërbimeve për një muaj;
- 1 Specialist në Sektorin për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrimin Evropian për dy muaj.

Nr.	Vitet	Miratuara					
		600-601	602-606	231	Nr. i Punonjësve		Totali
		Paga dhe sigurime	Shpenzime Operative	Investime	Nd/Komisioner	Gjithsej	
1	2014	75,500	16,000	4,000	21	50	95,500
2	2015	75,500	16,000	4,000	21	51	95,500
3	2016	84,500	17,000	4,000	21	55	105,500
4	2017	84,500	18,000	4,000	21	56	106,500
5	2018	94,500	17,500	4,000	21	56	116,000
6	2019	104,500	18,600	2,000	21	56	125,100
7	2020	98,500	17,000	1,000	21	56	116,500
8	2021	98,500	17,500	3,000	21	56	119,000

➤ Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera

Fondi i akorduar për shpenzime mallra e shërbime (**zëri 602**) për periudhën janar – dhjetor 2020 ishte 14,900,000, i ndryshuar me Akt-Normativ nr. 15, datë 15.04.2020, “Për disa ndryshime

dhe shtesa në Ligjin nr. 88/2019, ‘Për buxhetin e vitit 2020’, në 13,940,000 lekë ndërsa realizimi është 13,136,353 lekë ose 94.23% i buxhetit të ndryshuar.

Për këtë periudhë shpenzimet operative, janë përdorur kryesisht për pagesat e blerjeve për kancelari, materiale pastrimi, elektrike, materiale veshje speciale antiCOVID-19, materiale promovuese, furnizim me materiale të tjera zyre, shpenzime për energjisë elektrike, ujë, Albtelecom, Vodafone, shërbimi postar, siguracion automjeteve, blerje karburant, shpenzime për mirëmbajtjen e automjeteve të institucionit, dieta brenda dhe jashtë vendit, shpenzime për mirëmbajtje ndërtimore, shpenzime për mirëmbajtje aparatura e pajisje teknike, shpenzime pritje-përcjellje të huajve, si dhe shpenzime për taksa të paguara.

Fondi për transfertat korente të huaja (**zëri 605**) për vitin 2020, ishte 1,600,000 lekë, i ndryshuar me shkresë nr. 20372/1 Prot., datë 03.11.2020, “Transferim fonde për vitin 2020” në 1,640,000 lekë ndërsa realizimi është 1,626,241 lekë ose 99.16% i buxhetit të ndryshuar.

Për vitin 2020 këto fonde janë përdorur për shlyerjen e detyrimeve në kohë të kuotave të anëtarësimit ku institucioni i Avokatit të Popullit është anëtarë në organizata ndërkombëtare si:

- Associationdes Ombudsmanset Mediateurs dela Francophonie(AOMF);
- European Ombudsman Institute (EOI);
- Association of Mediterranean Ombudsman (AOM);
- International Ombudsman Institute (IOI);
- Global Alliance of National Human Rights Institutions (GANHRI);
- European Network of National Human Rights Institutions (ENNHRI);
- European Network of Ombudspersons for Children (ENOC).

N r.	Emërtimi i Organizatës	Mone dha	Kuotacionet në vite						
			Vlera në vite						
			2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
1.	Shoqata e Ombudsmanit të Vendeve Mesdhetare (AOM)	Euro	750	750	750	750	750	1,000	1,000
2.	Shoqata e Ombudsmanëve dhe Mediatorëve të Frankofonisë (AOMF)	Euro	650	650	650	750	900	900	900
3.	Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare të Drejtave të Njeriut (ENNHRI)	Euro	3,000	3,000	3,000	3,000	4,000	4,000	4,000
4.	Rrjeti Evropian të Ombudsmanit për Fëmijë (ENOC)	Euro	0	0	1,100	1,100	1,100	1,100	1,100
5.	Instituti Evropian i Ombudsmanit (EOI)	Euro	350	350	350	350	350	350	350
6.	Aleanca Globale e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (GANHRI)	CHF	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000
7.	Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanit (IOI)	Euro	750	750	750	750	750	750	750

Fondi për transferta buxhetore familjare dhe individë (**zëri 606**) për periudhën Janar - Dhjetor 2020, ishte 500,000 lekë, i ndryshuar me shkresat nr. 20372/1, datë 03.11.2020, “Transferim fonde për vitin 2020”, si dhe “Dërgohet detajimi fondit të veçantë për vitin 2020” nr. 23003/1, datë 21.12.2020 në 610,000 lekë, ndërsa realizimi është 101,730 lekë ose 16.68% i buxhetit të ndryshuar.

➤ **Shpenzime në investime**

Fondi i investimeve akorduar nga buxheti i shtetit është 1,000 mijë lekë, ndërsa realizimi 641 mijë lekë.

Projekti	Kodi i Projektit	Në mijë/lekë		
		Plan	Fakt	%
Pajisje - Kompjuterike	M660001	641	641	100
Blerje elektromotori për derën	M660001	197	196	99
Blerje kondicioner	M660001	120	120	100
Blerje orendi zyre	M660001	42	42	100

“Blerje Pajisje kompjuterike”

Për këtë zë të investimeve siç paraqitet në tabelën mësipërme është realizuar në vlerën prej 640,800 lekë, ose në masën 100%.

“Blerje elektromotori për derën”

Për këtë zë të investimeve siç paraqitet në tabelën mësipërme është realizuar në vlerën prej 197,000 lekë, ose në masën 99%.

“Blerje kondicioner”

Për këtë zë të investimeve siç paraqitet në tabelën mësipërme është realizuar në vlerën prej 120,000 lekë, ose në masën 100%.

“Blerje orendi zyre”

Për këtë zë të investimeve siç paraqitet në tabelën mësipërme është realizuar në vlerën prej 42,000 lekë, ose në masën 100%.

KREU 6

Shifra dhe fakte në lidhje me ankesat dhe trajtimin e tyre

Për vitin 2020 e gjithë bota, ashtu si dhe vendi ynë është përballur me një emergjencë shëndetësore të lidhur me virusin COVID-19. Kjo pandemi ndër të tjera ka ndryshuar mënyrën e jetetës së individëve, ka goditur ekonominë globale si dhe po vijon të sjellë pasoja të rënda psikologjike për gjithë popullsinë. Gjendja e rënduar ekonomike, gjendja e ankthit si dhe kufizimi i disa të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, ka bërë që për vitin 2020 të ketë një shtim të numrit të rasteve të ndjekura nga institucioni i Avokatit të Popullit.

Konkretisht, institucioni i Avokatit të Popullit e ka ushtruar mandatin kushtetues në drejtim të mbrojtjes, promovimit dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të individit/grupeve shoqërore nëpërmjet:


- ✓ këshillimit/orientimit të qytetarëve lidhur me rrugët ligjore që ata duhet të ndjekin për zgjidhjen e problemit të tyre;
- ✓ marrjes në shqyrtim të ankesave, për të cilat janë zhvilluar hetimet administrative përkatëse;
- ✓ monitorimit të përditshëm të shërbimeve mediatike në Republikën e Shqipërisë për identifikimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të qytetarëve dhe ndjekien e këtyre rasteve me iniciativë;
- ✓ ushtrimit të veprimtarisë inspektuese/monitoruese;
- ✓ përgatitjes së raporteve të ndryshme për çështjet e të drejtave të njeriut;
- ✓ dhënies së mendimeve/opinioneve për iniciativat e ndryshme për ndryshime ligjore;
- ✓ monitorimit të organizatave ndërkombëtare, homologëve si dhe organizatave të shoqërisë civile për të drejtat e njeriut;
- ✓ informimit të qytetarëve për të drejtat e tyre, nëpërmjet daljes publike në media, publikimit të informacioneve shpjeguese apo thirrjeve për respektimin e të drejtave të grupeve të ndryshme shoqërore;

Kështu, përgjatë vitit 2020, institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar gjithsej **5537** raste, për ndjekien e të cilave është vendosur në lëvizje nga ankesat e qytetarëve, nga media, ose shoqëria civile. Nga këto raste, rezulton se:

- 1125 raste, pas vlerësimit të ekspertëve të institucionit janë cilësuar si ankesa “brenda juridiksionit dhe kompetencës” së Avokatit të Popullit;
- 655 raste janë ndjekur me iniciativën e institucionit të Avokatit të Popullit¹⁸⁶;
- 3463 janë trajtuar në formën e këshillimeve dhe orientimeve (verbale, ose në rrugë elektronike) mbi rrugët ligjore që duhet të ndjekin qytetarët për trajtimin e mëtejshëm të problemit të tyre;
- 294 raste janë konstatuar jashtë juridiksionit ose kompetencës së institucionit të Avokatit të Popullit. Nga këto raste, 112 prej tyre raste janë konstatuar se janë jashtë juridiksionit në momentin e vlerësimit nga grupi i shqyrtimit të ankesave, dhe individët

¹⁸⁶ Për më tepër informacion lidhur me veprimtarinë e Avokatit të Popullit në drejtim të monitorimit të rasteve të shkeljes së të drejtave të qytetarëve të bëra publike nga media, prej fillimit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, referohuni në kapitulli “Kreu 4”

janë orientuar me shkrim, formalisht nga Zyra e Pritjes së Qytetarëve për rrugët ligjore që duhet të ndjekin për problematikën e tyre, ndërsa 33 raste jashtë juridiksioni dhe 149 raste jashtë kompetence janë konstatuar gjatë hetimit administrativ.




Paraqitja grafike e rasteve të shqyrtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2020.


Format e administrimit të ankesave/rasteve të shkeljes së të drejtave dhe lirive themelore nga shtetasit shqiptarë, shtetasit e huaj, personat pa shtetësi, organizatat e shoqërisë civile apo mbrojtësit e të drejtave të njeriut, media, etj., janë si më poshtë:

- Paraqitja e personit fizikisht pranë institucionit;
- Shërbimi postar;
- Rrjetet sociale;
- Posta elektronike;
- Aplikacioni mobile dhe faqa zyrtare e institucionit;
- Telefon;
- Monitorim i përditshëm i shërbimeve mediatike (televizioni, radio, mediat sociale, etj.).

Më poshtë paraqiten të dhënat lidhur me shqyrtimin e ankesave dhe të rasteve të ndjekura nga institucioni i Avokatit të Popullit, në formë statistikore, të ndara sipas seksioneve, llojit të rastit, gjinisë qytetarëve, fushës së të drejtës, institucioneve të administratës publike, shpërndarjes territoriale, mënyrës së përfundimit të hetimit administrativ, dhe veprimtarisë së zyrave rajonale.




Paraqitja grafike e rasteve të trajtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit ndër vite.




Paraqitja grafike e rasteve të depozituara dhe të trajtuara pranë institucionit të Avokatit të Popullit dhe 7 Zyrave Rajonale të tij.


Në vitin 2020, pranë zyrave rajonale të institucionit të Avokatit të Popullit janë depozituar 1874 raste duke sjellë një rritje të qytetarëve që i janë drejtuar institucionit për të shprehur shqetësimet e tyre krahasuar me vitin 2019.



Paraqitja grafike e numrit të rasteve të depozituara pranë zyrave rajonale të AP-së krahasuar me vitin 2019.



Paraqitja grafike e shpërndarjes së ankesave/këshillimeve dhe rasteve me iniciativë në 7-të Zyrat Rajonale të institucionit të AP-së.




Paraqitja grafike e shpërndarjes së rasteve të shqyrtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit sipas qarqeve është si në grafikun e mësipërm.



Paraqitja grafike e shpërndarjes së rasteve të shqyrtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit sipas qyteteve është si në grafikun e mësipërm.

Totali i ankesave dhe rasteve me iniciativë të ndjekura nga Seksionet gjatë vitit 2020 është gjithsej 1780, nga të cilat 1125 ankesa dhe 655 raste me iniciativë. Shpërndarja e totalit të ankesave të cilat pas vlerësimit të ekspertëve të institucionit janë cilësuar si ankesa “brenda juridiksionit dhe kompetencës” sipas Seksioneve, si dhe e totalit të të gjithë rasteve sipas Seksioneve, paraqitet në grafikët e mëposhtëm.



Paraqitja grafike e totalit të rasteve (ankesa dhe raste me iniciativë) të shqyrtuara nga AP krahasuar me vitin 2019.



Paraqitja grafike e shpërndarjes së rasteve sipas seksioneve për vitin 2020



Paraqitja grafike e shpërndarjes së shqyrtimit të rasteve me iniciative nga Seksionet e AP-së.



Shpërndarja e rasteve me iniciativë sipas seksioneve e shprehur në përqindje.


Përsa i përket rasteve me iniciativë vihet re një rritje prej 248% nga viti 2019 në vitin 2020. Kjo rritje lidhet me problematikat e shumta të shkaktuara nga pandemia COVID-19, të cilat janë trajtuar gjerësisht nga media si dhe me vëmendjen e shtuar të AP-së ndaj tyre.



Paraqitja grafike e ndryshimit të vlerave të rasteve me iniciativë të shqyrtara nga insititucioni në vitet 2018-2020.




Paraqitja grafike e shpërndarjes së rasteve sipas institucioneve përgjegjëse për shkelje ndaj qytetarëve



Paraqitja grafike e rasteve të regjistruara dhe të trajtuara gjatë vitit 2020 sipas fushës së të drejtës dhe gjinisë.

Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, përgjatë vitit 2020 ka përfunduar hetimin e 1303 rasteve nga të cilat 45% e rasteve i përkasin rasteve të regjistruara në vitin 2020 dhe 55% raste të mbartura ndër vite.




Paraqitja grafike e rasteve për të cilat ka përfunduar hetimi administrativ gjatë vitit 2020.

Nga totali i 1303 rasteve për të cilat ka përfunduar hetimi administrativ gjatë vitit 2020, rezulton se:


- 26% rasteve janë përfunduar duke konstatuar se rasti/ankesa ka qënë e pabazuar;
- 8% e rasteve janë përfunduar si pasojë e heqjes dorë të ankuesit;

- 3% e rasteve kanë rezultuar jashtë juridiksionit, gjatë hetimit administrativ;
- 11% e rasteve kanë rezultuar jashtë kompetence, gjatë hetimit administrativ;
- 39% e rasteve janë përfunduar duke adresuar problematikat/shkeljet e konstatuara gjatë hetimit administrativ, pa nevojën e ndërhyrjes me rekomandim;
- 13% e rasteve janë përfunduar duke adresuar problematikat/shkeljet e konstatuara gjatë hetimit administrativ, nëpërmjet rekomandimeve.




Paraqitja grafike e rasteve për të cilat ka përfunduar hetimi administrativ gjatë vitit 2020.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative institucioni i Avokatit të Popullit për vitin 2020 ka adresuar në total 256 rekomandime drejtuar organeve të Administratës Publike duke përfshirë atë qendrore dhe vendore.




Praqtja grafike e rekomandimeve sipas seksioneve të institucionit për vitin 2020


Në totalin e 256 rekomandimeve të adresuara organeve të administratës publike, institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar gjithsej 829 nën-rekomandime (nën-çështje, verpime apo mosveprime konkrete të rekomanduara).




Paraqitja grafike e numrit të zërave të rekomanduara sipas seksioneve.



Paraqitja grafike e numrit të institucioneve tek të cilët u janë adresuar rekomandimet.



¹⁸⁷ Paraqitja grafike e rekomandimeve në vitet 2018, 2019, 2020.




Paraqitja grafike e rekomandimeve sipas gjinisë së ankuesit.¹⁸⁸

¹⁸⁷ Paraqitja grafike e rekomandimeve të realizuara në 3 vitet e fundit ku vihet re një trend rritës. Nga 256 rekomandime të adresuara, 142 rekomandime i përkasin rasteve të vitit 2020 dhe 114 rekomandime rasteve të mëparshme.

¹⁸⁸ Rekomandimet e adresuara në të cilat gjinia është e papërcaktuar, prek një grup që përfshin të dyja gjinitë.

Shpërndarja e rekomandimeve sipas Objektivave të Zhvillimit të Qendrueshëm (SDG)

Shpërndarja e rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit sipas Objektivave të Zhvillimit të Qendrueshëm (SDG) për vitin 2020, paraqitet si më poshtë vijon:



Paraqitja grafike e rekomandimeve sipas Objektivave të Zhvillimit të Qendrueshëm



Zhdukja e varfërisë në të gjitha format e saj

Shumë faktorë ndikojnë në kushtet e jetesës dhe mirëqenien personale. Disa nga më themelore janë të jemi në gjendje të mbijetojmë dhe të kemi një çati mbi kokë për të na mbajtur ngrohtë.



Shëndet i mirë dhe mirëqënie



Edukim Cilësor


Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të të nxënës gjatë gjithë jetës për të gjithë

5 GENDER EQUALITY 	Të arrihet barazia gjinore dhe të fuqizohen të gjitha gratë dhe vajzat
8 DECENT WORK AND ECONOMIC GROWTH 	Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë
10 REDUCED INEQUALITIES 	Reduktimi i pabarazisë ndërmjet shteteve
11 SUSTAINABLE CITIES AND COMMUNITIES 	Bëni qytetet dhe vendbanimet njerëzore gjithëpërfshirëse, të sigurta, elastike (fleksibël) dhe të qëndrueshme
16 PEACE, JUSTICE AND STRONG INSTITUTIONS 	Promovimi i shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe krijimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet


Ushtrimi i veprimtarisë inspektuese/monitoruese

Institucioni i Avokatit të Popullit ka ushtruar veprimtarinë inspektuese/monitoruese, si nëpërmjet kryerjes së inspektimeve/monitorimeve të planifikuara, ashtu edhe nëpërmjet monitorimit të tubimeve spontane të zhvilluara përgjatë vitit 2020 për çështje të ndryshme që shqetësojnë qytetarët¹⁸⁹. Konkretisht, janë realizuar gjithsej 764 inspektime/monitorime, nga të cilat 662 monitorime dhe 102 inspektime të cilat paraqiten më poshtë sipas seksioneve.


¹⁸⁹ Për më tepër informacion lidhur me veprimtarinë inspektuese/monitoruese referohuni në kapitullin “_____”




Paraqitja grafike e monitorimeve / inspektimeve të realizuara nga institucioni i Avokatit të Popullit.




Paraqitja grafike e monitorimeve / inspektimeve të realizuara nga Seksioni i Përgjithshëm.




Paraqitja grafike e monitorimeve / inspektimeve të realizuara nga Seksioni i Veçantë.



Paraqitja grafike e monitorimeve / inspektimeve të realizuara nga Seksioni i Administratës.



Paraqitja grafike e monitorimeve / inspektimeve të realizuara nga Seksioni i MKPT-së.




Paraqitja grafike e monitorimeve / inspektimeve të realizuara nga Seksioni i Fëmijëve.

Trajtimi i kërkesave për informacion


Gjatë vitit 2020 pranë institucionit të Avokatit të Popullit janë regjistruar gjithsej 32 kërkesa për informacion, sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Të gjitha kërkesat janë pranuar dhe u është kthyer përgjigje sipas objektit, duke u siguruar për kufizimin e të dhënave personale sipas legjislacionit në fuqi. Koha mesatare e kthimit të përgjigjeve kërkesave për informacion është 9 ditë kalendarike.

Nga totali i kërkesave për informacion të regjistruara gjatë vitit 2020, rezulton se 20 prej tyre janë adresuar nga qytetarët, 2 prej tyre nga zyra të avokatisë, 6 nga organizata të shoqërisë civile dhe 4 nga media. Prej totalit të 32 kërkesave, 13 prej tyre kanë pasur për objekt kërkesë për kopje dokumentacioni, 11 prej tyre kërkesë për informacion dhe 8 kërkesa për informacion dhe dokumentacion.

Ecuria e numrit të kërkesave për informacion të regjistruara dhe të trajtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit ndër vite, prej vitit 2016 paraqitet si më poshtë vijon:




Paraqitja grafike e numrit të kërkesave për informacion ndër vite.



Paraqitja grafike e kontributeve dhe botimeve të institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2020.

Monitorime / Inspektime të realizuara nga Seksioni i Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve




Paraqitja grafike e monitorimeve / inspektimeve të realizuara nga Seksioni i Fëmijëve.

Trajtimi i kërkesave për informacion


Gjatë vitit 2020 pranë institucionit të Avokatit të Popullit janë regjistruar gjithsej 32 kërkesa për informacion, sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Të gjitha kërkesat janë pranuar dhe u është kthyer përgjigje sipas objektit, duke u siguruar për kufizimin e të dhënave personale sipas legjislacionit në fuqi. Koha mesatare e kthimit të përgjigjeve kërkesave për informacion është 9 ditë kalendarike.

Nga totali i kërkesave për informacion të regjistruara gjatë vitit 2020, rezulton se 20 prej tyre janë adresuar nga qytetarët, 2 prej tyre nga zyra të avokatisë, 6 nga organizata të shoqërisë civile dhe 4 nga media. Prej totalit të 32 kërkesave, 13 prej tyre kanë pasur për objekt kërkesë për kopje dokumentacioni, 11 prej tyre kërkesë për informacion dhe 8 kërkesa për informacion dhe dokumentacion.

Ecuria e numrit të kërkesave për informacion të regjistruara dhe të trajtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit ndër vite, prej vitit 2016 paraqitet si më poshtë vijon:



Paraqitja grafike e numrit të kërkesave për informacion ndër vite.



Paraqitja grafike e kontributeve dhe botimeve të institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2020.

ANEKS 1

Tabela pasqyruese në nivel kombëtar mbi dhomat e shoqërimit dhe sigurisë

Nr.		Emërtimi	Dhoma shoqërimi			Dhoma sigurie		
			Numri	Kapaciteti	Përmasat	Numri	Kapaciteti	Përmasat
I		QARKU TIRANË						
1		DVP Tiranë	3 dhoma shoqërimi	totali 15 persona /4-5 persona në dhomë	afërsisht 4x5 m secila dhomë shoqërimi	8 dhoma sigurie: (6 për persona të rritur; 1 për femra; 1 për të mitur)	kapaciteti fizik për 10 persona: - 6 dhoma/ 8 shtretër; - 2 dhoma/2 shtretër	6 dhoma plotësohet kriteri 5 m2 / person; 2 dhoma dhoma <u>nuk plotësohet</u> kriteri 5 m2 / person;
2		Komisariati Nr.1	1 dhomë për personat e rritur: (personat femra dhe të mitur mbahen në zyrat e punonjësve të policisë).	totali 3 persona	afërsisht 4x3 m	2 dhoma sigurie për persona të rritur;	kapaciteti fizik për 5 persona.	nuk plotësohet kriteri 5 m2 / person

3		Komisariati Nr.2	3 dhoma shoqërimi;	totali 12 persona/ 4 persona në dhomë.	afërsisht 4x3 m secila dhomë	2 dhoma sigurie për personat e rritur;	kapaciteti fizik 5 persona;	nuk plotësohet kriteri 5 m ² / person
4		Komisariati Nr.3	2 dhoma shoqërimi	totali 10 persona;	afërsisht 3x3m dhe 4x5 m	1 dhomë sigurie për të rritur	kapaciteti fizik 2 persona	nuk plotësohet kriteri 5 m ² / person
5		Komisariati Nr.4	3 dhoma shoqërimi;	totali 9 persona;	afërsisht 3x3 m dhe 2x3 m			
6		Komisariati Nr.5 (Kamëz)	3 dhoma shoqërimi	totali 9 persona;	afërsisht 2x3 m	3 dhoma sigurie (1 për të rritur, 1 për femra dhe 1 për të mitur)	kapaciteti fizik për 4 persona;	plotësojnë kriteret 5m ² /person
7		Komisariati Nr.6	3 dhoma shoqërimi;	totali 15 persona	afërsisht 4x4 m			
8		Komisariati Kavajë	3 dhoma shoqërimi;	totali 10 persona;	afërsisht 3x3 m	3 dhoma sigurie (1 për të rritur, 1 për femra dhe 1 për të mitur)	kapaciteti fizik për 3 persona;	plotësojnë kriteret 5m ² /person
II		QARKU DURRËS						

1		Drejtoria/komisariati policisë Durrës	4 dhoma shoqërimi	totali 15 persona	afërsisht 4x4 m	8 (tetë) dhoma sigurie: (6 për personat e rritur, 1 për femra dhe 1 për të mitur)	kapaciteti fizik 8 persona	plotësojnë kriteret 5m2/person
2		Komisariati Kruje	2 dhoma shoqërimi	totali 6 persona	afërsisht 3x4m			
3		Komisariati Shijak	3 dhoma shoqërimi	totali 12 persona	afërsisht 4x4m			
III		QARKU ELBASAN						
1		Drejtoria/komisariati policisë Elbasan	2 dhoma shoqërimi	totali 8 persona	afërsisht 3x3 m	7 (shtatë) dhoma sigurie: (5 për persona të rritur, 1 për femra dhe 1 për të mitur).	kapaciteti fizik për 12 persona	nuk plotësohet kriteri 5 m2 / person
2		Komisariati Gramsh	3 dhoma shoqërimi	totali 10 persona;	afersisht 4x4 m			
3		Komisariati Librazhd	3 dhoma shoqërimi	totali 10 persona;	afersisht 4x4 m			
4		Komisariati Peqin	3 dhoma shoqërimi	totali 10 persona;	afersisht 3x3 m			

5		Komisariati Cërrik	1 dhomë shoqërimi	totali 5 persona	afersisht 5x3 m			
IV		QARKU KORÇË						
1		Drejtoria/komisariati policisë Korçë	3 dhoma shoqërimi	totali 10 persona;	afersisht 4x4 m	6 dhoma sigurie: (4 për persona të rritur; 1 për femra; 1 për të mitur)	kapacitet fizik për 6 persona	plotësojnë kriteret 5m ² /person
2		Komisariati Devoll	3 dhoma shoqërimi	totali 9 persona	afërsisht 4x4 m			
3		Komisariati Ersekë	2 dhoma shoqërimi	totali 8 persona	afersisht 4x4 m			
4		Komisariati Pogradec	1 dhomë shoqërimi	totali 4 persona	afërsisht 4x4 m			
5		Komisariati Maliq	nuk ka			nuk ka		
V		QARKU GJIROKASTËR						
1		Drejtoria/komisariati policisë Gjirokastrë	3 dhoma shoqërimi	totali 10 persona	afërsisht 4x4 m	8 (tetë) dhoma sigurie: (6 për personat e rritur, 1 për femra dhe 1 për të mitur)	kapaciteti fizik për 9 persona	plotësojnë kriteret 5m ² /person

2		Komisariati Tepelenë	3 dhoma shoqërimi	totali 9 persona	afërsisht 4x4 m			
3		Komisariati Përmet	3 dhoma shoqërimi	totali 10 person	afërsisht 4x4 m			
VI		QARKU BERAT						
1		Drejtoria/komisariati policisë Berat	2 dhoma shoqërimi	totali 4 persona	2x3m dhe 3x3m	3 dhoma sigurie (2 dhoma për të rritur dhe për të mitur ndodhen në IEVP Berat dhe 1 dhomë për femra Sp.Rajonal)	kapaciteti 7 persona	nuk plotësohet kriteri 5 m2 / person
2		Komisariati Skrapar	1 dhomë shoqërimi	totali 3 persona	afërsisht 3x3 m			
3		Komisariati Kuçovë	2 dhoma shoqërimi	totali 5 persona	afërsisht 3x3 m			
VII		QARKU VLORE						
1		Drejtoria/komisariati policisë Vlorë	2 dhomë shoqërimi	totali 5 persona	afërsisht 4x3 m	4 dhoma sigurie (2 për personat e rritur, 1 për femra dhe 1 për të mitur).	kapaciteti 7 persona	nuk plotësohet kriteri 5 m2 / person

2		Komisariati Sarandë	1 dhomë shoqërimi	totali 3 persona	afërsisht 3x4 m	2 dhoma sigurie (1 për personat e rritur dhe 1 për të mitur).	kapacitet 2 persona	nuk plotësohet kriteri 5 m2 / person
3		Komisariati Delvinë	1 dhomë shoqërimi	totali 3 persona	afërsisht 3x3 m			
VIII		QARKU DIBËR						
1		Drejtoria/komisariati policisë Dibër	2 dhoma shoqërimi	totali 6 persona	dhomë 3x3 m dhomë 6x5 m	5 dhoma sigurie (3 për personat e rritur, 1 për femra dhe 1 për të mitur).	kapaciteti 5 persona	nuk plotësohet kriteri 5 m2 / person
2		Komisariati Burrel	2 dhoma shoqërimi	totali 6 persona	afërsisht 3x3 m	4 dhoma sigurie (2 për personat e rritur, 1 për femra dhe 1 për të mitur).	kapaciteti 6 persona	nuk plotësohet kriteri 5 m2 / person
3		Komisariati Bulqizë	3 dhoma shoqërimi	totali 10 persona	afërsisht 3x4 m			

IX		QARKU SHKODËR						
1		Drejtoria/komisariati policisë Shkodër	3 dhoma shoqërimi	totali 6 persona	afërsisht 3x3 m	Projekt ndertimi: 14 dhoma sigurie (10 për personat e rritur, 2 për femra dhe 2 për të mitur).	kapaciteti 14 persona	plotësohet kriteri 5 m2 / person
2		Komisariti Puke	1 dhomë shoqërimi	totali 5 persona	afësisht 4x4 m			
3		Komisariati M.Madhe	1 dhomë shoqërimi	totali 5 persona	afërsisht 4x4 m			
X		QARKU LEZHË						
1		Drejtoria/komisariati policisë Lezhë	3 dhoma shoqërimi	totali 15 persona	afërsisht 5x3m	4 dhoma sigurie (2 për personat e rritur, 1 për femra dhe 1 për të mitur).	kapaciteti 6 persona	2 dhoma nuk plotësojnë kriterin 5 m2/ person. 2 dhomat e tjera e plotësojnë kriterin për jetesë.

2		Komisariati Kurbin	3 dhoma shoqërimi	totali 12 persona	afërsisht 5x4m			
3		Komisariati Mirditë	3 dhoma shoqërimi	totali 8 persona	afërsisht 5x3m			
XI		QARKU KUKËS						
1		Drejtoria/komisariati policise Kukes	2 dhoma shoqërimi	totali 8 persona	afërsisht 4x4 m	6 dhoma sigurie: (4 për persona të rritur; 1 për femra; 1 për të mitur)	kapaciteti 6 persona	plotësojnë kriteret 5m2/person
2		Komisariati Has	2 (dy) dhoma shoqërimi	totali 6 persona	afërsisht 2x3m			

3		Komisariati Tropojë	nuk ka dhoma shoqërimi			4 dhoma sigurie (2 për persona të rritur; 1 për femra dhe 1 për të mitur)	kapaciteti 4 persona	plotësojnë kriteret 5m2/person
XII		QARKU FIER						
1		Drejtoria/komisariati policise Fier	3 dhoma shoqërimi	totali 12 persona	afërsisht 4x4 m	6 dhoma sigurie: (4 për persona të rritur; 1 për femra; 1 për të mitur)	kapaciteti fizik për 10 persona: - 6 dhoma me 8 shtretër; - 2 dhoma/2 shtretër	nuk plotësohet kriteri 5m2 personi
2		Komisariati Lushnje	1 dhomë shoqërimi	totali 8 persona	afërsisht 8x7m			
3		Komisariati Mallakaster	1 dhomë shoqërimi	totali 4 persona	afërsisht 4x3 m			